



UNIVERSITETI "FAN S . NOLI "
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË



KONFERENCA

LIDHJET KULTURORE DHE HISTORIKE SHQIPTARO-RUMUNE

Korçë, mars 2013

Përmbledhja e akteve të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “ Lidhjet kulturore dhe historike shqiptaro-rumune” u realizua në kuadrin e Projektit “Botime FEF”

REDAKSIA PËR BOTIMIN

Prof. dr. ALI JASHARI

Z. VIOREL STANILA

Prof. dr. EMIL LAFE

Prof. as. dr. ANYLA MAXHE- SARAÇI

Msc. DANIELA STOICA

Redaktimi: Prof.as.dr. ANYLA MAXHE- SARAÇI

Përkthimi i materialeve në shqip: Msc. DANIELA STOICA

ISBN: 9789928146144

Shtëpia Botuese “PROMO PRINT”

Korçë, 2014

PËRMBAJTJA

- FJALA E HAPJES SË KONFERENCËS, Z. ALI JASHARI, DEKAN I FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
- PËRSHËNDETJA E REKTORIT TË UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, PROF. AS. DR. GJERGJI MERO.
- PËRSHËNDETJE NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME E RUMANISË, Z. VIOREL STANILA, AMBASADOR I RUMANISË NË SHQIPËRI
- GRIGORE BRÂNCUȘ: ARUMANISHTJA NË AKADEMINË E VOSKOPOJËS
- ALI JASHARI, DHIMITRI BELLO: SHQIPJA DHE RUMANISHTJA SI GJUHË BALLKANIKE.
- NICOLAE SARAMANDU: MOMENTI MOSKOPOLE NË HISTORINË E MARRËDHËNIEVE GJUHËSORE SHQIPTARO-RUMUNE.
- EMIL LAFE: FAQE NGA BASHKËPUNIMI I GJUHËTARËVE SHQIPTARË ME GJUHËTARËT RUMUNË.
- CĂTĂLINA VĂTĂȘESCU: SHËNIME RRETH TEKSTIT TË PARË SHQIP, MESHARI, I GJON BUZUKUT.
- MIMOZA KARAGJOZI-KORE: MARRËDHENIET E SHQIPES ME RUMANISHTEN SIPAS GRIGORE BRÂNCUȘ.
- DION TUSHI: PUBLICISTIKA DHE LETËRSIA SHQIPE E PAVARËSISË NË KONTEKSTIN E LIDHJEVE SHQIPTARO-RUMUNE.
- NISTOR BARDU: NDIKIMI I GJUHËS SHQIPE MBI TË FOLMEN E SOTME TË ARUMUNËVE “VOSKOPOJARË” NGA LOKALITETI GRABOVA (GREAVA) NË SHQIPËRI. ASPEKTE LEKSIKORE.
- JONELA SPAHO: NDIKIMI I POEZISË MODERNE RUMUNE NË VËLLIMIN “PSALLME MURGU” TË ASDRENIT
- MANUELA NEVACI: ASPEKTE GJUHËSORE DHE ETNOGRAFIKE TË KONTAKTIT TË ARUMUNËVE ME SHQIPTARËT.
- ELONA BIBA: DUKE IU REFERUAR AKADEMIKUT HARALAMB MIHAESKU, EDHE NJË ARGUMENT PËR AUTOKTONINË E SHQIPTARËVE NËN DRITËN E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO- AROMANE.
- DR. BEGZAD BALIU: TOPONIMIA ARUMUNE NË KOSOVË.
- ANYLA SARAÇI (MAXHE): VËSHTRIM PËRQASËS NË SISTEMIN ZANOR TË SHQIPES DHE RUMANISHTES.
- DANIELA STOICA: ASPEKTE TË NDIKIMIT TË SHQIPES MBI TË FOLMEN E ARUMUNËVE TË KORÇËS NË RRAFSHIN LEKSIKOR DHE MORFOLOGJIK.
- ILIR SHYTA: KOLONIA SHQIPTARE E BUKURESHTIT-VATRA E FORMIMIT LETRAR TË INTELEKTUALËVE NË VITET ’30 TË SHEKULLIT XX.
- NELI NAÇO: DISA PIKA KONTAKTI TË RRËFIMIT TË MITRUSH KUTELIT ME LETËRSINË RUMUNE

- N. S. TANAȘOCA: RUMANIA, ARUMUNËT DHE SHQIPTARËT NË DRITËN E KORRESPONDENCËS SË IOAN D. CARAGIANI
- DANIELA BUȘA: DIJETARI NIKOLAE JORGA-NJË MILITANT KONSEGUENT PËR RILINDJEN DHE PAVARËSINË E SHQIPËRISË
- BASHKIM JAHOLLARI: SHQIPËRIA DHE RUMANIA NË LUFTËN PËR ÇLIRIMIN KOMBËTAR
- STOICA LASCU: PAVARËSIA E SHQIPËRISË- NËN DRITËN E DËSHMIVE RUMUNE TË EPOKËS
- PANDI BELLO: MARRËDHËNIET KULTURORE SHQIPTARO-RUMUNE
- ION TEODORESCU: LUFTRAT BALLKANIKE. ÇËSHTJA SHQIPTARE NË ARKIVAT E M. P. J. RUMUNE
- MARIUS DOBRESKU: LUFTRAT BALLKANIKE DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE
- PAVLLO CICKO: SHOQËRITË SHQIPTARE NË RUMANI - URA LIDHËSE MIDIS DY VENDEVE

Prof. dr. ALI JASHARI

DEKAN I FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË, UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË

FJALA E HAPJES SË KONFERENCËS

Të nderuar pjesëmarrës!

Ju përshëndes të gjithëve dhe në emër të stafit akademik dhe të studentëve të Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë, ju uroj mirëseardhjen në Universitetin e Korçës. Kjo konferencë është një realizim konkret i idesë që dha një vit më parë z. Viorel Stanila, ambasador i Rumanisë në Shqipëri dhe i dëshirës së pedagogëve të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë dhe i mjaft profesorëve nga universitete dhe institucione shkencore të Rumanisë, Shqipërisë dhe Kosovës.

Konferenca shkencore ndërkombëtare **“LIDHJET KULTURORE DHE HISTORIKE SHQIPTARO-RUMUNE”** organizuar nga Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Rumanisë, Ambasadën e Rumanisë në Tiranë dhe Akademinë Rumune ka karakter shkencor e jubilar, për nga vlerat që sjell, për momentin që po mbahet, çka përkon me datën 26 mars, kur 100 vjet më parë Rumania njohu pavarësinë e Shqipërisë, por, mbi të gjitha, për faktin se ajo rrok një sërë problemesh për lidhjet historike dhe kulturore shqiptaro-rumune, që do të trajtohen nga 25 profesorë dhe studiues. Në këtë kontekst unë përshëndes pjesëmarrjen e Akad. GRIGORE BRÂNCUȘ, në Akademinë Rumune; Prof. univ. dr. NICOLAE SARAMANDU, në Universitetin e Bukureshtit dhe në Institutin e Linguistikës dhe Dialektologjisë; Dr. CĂTĂLINA VĂTĂȘESCU, në Institutin e Studimeve për Evropën Juglindore në Akademinë Rumune; Konf. univ. dr. NISTOR BARDU, në Universitetin “Ovidius” të Kostancës; KS II dr. MANUELA NEVAKI në Universitetin e Bukureshtit dhe në Institutin e Linguistikës dhe dialektologjisë Prof. univ. dr. Nikolae S. TANAȘOKA, Instituti për Studime të Evropës Juglindore në Akademinë Rumune; Prof. univ. DANIELA BUȘA, Universiteti i Galacit dhe kërkuese në Institutin “Nikolae Jorga”; Konf. univ. dr. STOJKA LASKU, në Universitetin “Ovidius” Kostancë; Muzeograf kryesor ION TEODORESCU, Kompleksi Kombëtar “Oborri mbreteror” Tergovishte; Përkthyesi dhe shkrimtari MARIUS DOBRESKU, kryeredaktor i gazetës “Shqiptari”, Bukuresht. Si dhe të profesorëve: EMIL LAFE, MIMOZA KORE, DHIMTËR BELLO nga Universiteti i Tiranës; dhe prof. BEGZAD BALIU nga Universiteti i Prishtinës. Më në fund, do të përmend përkushtimin e lektore Daniela Stoica dhe gjithë stafit akademik dhe ndihmësmësimor të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë për realizimin cilësor të kësaj konference.

Punimet e konferencës i deklaroj të hapura!

Faleminderit!

Prof. as. dr. GJERGJI MERO
REKTOR I UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, KORÇË

FJALA PËRSHËNDETËSE

I nderuar ambasador i Rumanisë, z. Viorel Stanila!
I nderuar N/kryetar i Bashkisë Korçë, z. Sotiraq Filo!
I nderuar Drejtor i Drejtorisë Arsimore Korçë, z. Arben Belba!
Të nderuar akademikë, pedagogë, studentë dhe të ftuar,
Të nderuar pjesmarrës në këtë konferencë,

Kam nderin që t’ju përshëndes të gjithëve dhe t’i uroj punime të mbara kësaj konference, që Universiteti i Korçës po organizon në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Rumanisë, Ambasadën e Rumanisë në Tiranë dhe Akademinë Rumune, me rastin e 100- vjetorit të njohjes nga Rumania të Pavarësisë të Shqipërisë si dhe me rastin e 100 -vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve tona.

Kjo Konferencë është një kontribut i vyer i përpjekjeve që kanë bërë pedagogët dhe studiuesit jo vetëm të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë të Universitetit tonë, por është edhe një ndihmë e çmuar e profesorëve e studiuesve nga Tirana, Kosova dhe veçanërisht profesorët nga Universiteti i Kostancës dhe i Tërgovishtes në Rumani, të cilët i përshëndes për gatishmërinë dhe impenjimin që treguan duke sjellë kontribute të rëndësishme nga fushat e gjuhësisë, letërsisë, historisë, etnografisë, publicistikës etj., në këtë konferencë shkencore që po organizojmë sot, duke i siguruar se ata dhe institucionet që përfaqësojnë do të jenë bashkëpunëtorët tanë të denjë dhe të rëndësishëm edhe në të ardhmen.

Kjo veprimtari shkencore e përbashkët mendoj se është fryt i kërkimeve dhe hulumtimeve që studiuesit kanë bërë dhe po bëjnë për të ndriçuar edhe më shumë historinë e ndritur të lidhjeve dhe marrëdhënieve të ngushta dhe vllazërore midis dy popujve tanë ndër shekuj, si dhe njëherësh ajo është një nderim për të gjithë ata patriotë, shkrimtarë, historianë dhe njerëz të shquar nga të dy popujt tanë që kanë mbajtur të ndezur dhe na kanë lënë trashëgimi këtë lidhje kaq të fortë miqësore ndoshta e rrallë jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë.

Shteti rumun, historikisht ka vijuar të jetë vendi kryesor i strehimit të emigrantëve të krahinave të ndryshme të Turqisë Evropiane, pra edhe të një numri të madh shqiptarësh. Për shkak të lidhjeve tradicionale ndërmjet dy popujve dhe të interesave të përbashkëta politikë në Ballkan, shteti rumun e përkrahte luftën çlirimtare të shqiptarëve dhe veprimtarinë e kolonisë shqiptare në Rumani. Kolonitë shqiptare në Rumani, duke qenë numerikisht më të mëdha, materialisht më të forta dhe në rrethana politike më të favorshme, morën përsipër një rol të veçantë e me shumë rëndësi në lëvizjen kombëtare, duke ndihmuar për ngritjen e shtypshkronjave, për botimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe, për nxjerrjen e gazetave shqiptare, për hapjen e shkollave kombëtare etj.

Pikërisht, kur po shtypej Lidhja e Prizrenit dhe kur ishin krijuar kushte të vështira për veprimtarinë e Shoqërisë së Stambollit, zuri fill Shoqëria e Bukureshtit, cila si nga numri i anëtarëve, ashtu edhe nga veprimtaria, u bë shoqëria më e rëndësishme kulturore e kësaj periudhe. Gjithashtu, nuk duhet të lëmë mënjanë edhe faktin, se një ndër komunitet më të fuqishme shqiptare edhe sot ndodhet në Rumani. Ky komunitet ka luajtur një rol të rëndësishëm në themelimin e modernizimit të shtetit shqiptar, në modernizimin e shtetit rumun si dhe në raportet diplomatike mes Shqipërisë e Rumanisë. Ja çfarë shkruan **Maria Dobrescu** në librin e saj *“Pesë dekada diplomaci për marrëdhëniet romune-shqiptare”*, *“Është i pamohueshëm fakti se Nikolla Naço (1843-1913, udhëheqës i komunitetit shqiptar në Rumani), pasi u vendos në Bukuresht më 1884, ka ndikuar dhe rigjallëruar përmes aktivitetit të tij lëvizjen shqiptare në kryeqytetin e Rumanisë. Marrëdhëniet e tij, me qeveritarët rumunë dhe autoritet shkencore në Bukuresht- V. A. Urechia, B. p. Hadeu, D. Butulescu, N. Lahovari etj., u materializuan me mbështetjen e kauzës shqiptare nga rumunët. Gjithashtu, po në këtë libër autorja shkruan se: “Rumania ishte vendi i parë që njohu pavarësinë e Shqipërisë, që u shpall më 28 nëntor 1912, pasi u “projektua” në takimin e patriotëve shqiptarë më 5 nëntor, në Bukuresht. Midis tyre ishte Ismail Qemali, Kryeministri i Shqipërisë në vitet 1912-1914”*.

Në këtë kuadër, Universiteti i Korçës, duke shkruar në traditën e mirë të këtyre marrëdhënieve, ka sot lidhje të forta bashkëpunimi me Universitetin e Tërgovishtes, me të cilin kemi bërë aktivitete të përbashkëta shkencore dhe botuese. Universiteti ynë është anëtar i asociuar i Rrjetit të Universiteteve të Detit të Zi, duke marrë pjesë në dy kongrese që janë zhvilluar në Kostanca dhe Tiranë, si dhe bashkëpunon në kuadër të projekteve Tempus me Universitetin e Timishoarës dhe do të vazhdojë të shtojë përpjekjet për të shtuar marrëdhëniet e bashkëpunimit edhe me universitete të tjera të Rumanisë. Sot në Universitetin tonë punojnë disa pedagogë që kanë përfunduar studimet në Rumani, si dhe dy pedagogë rumune të martuara në Korçë, të cilët kanë sjellë përvojën e traditës së mirë të universiteteve rumune dhe janë pika të forta lidhje midis universiteteve tona.

Para nesh sot lind një detyrim i madh që kemi para brezit të ri, që t’i edukojmë dhe t’i rritim me këtë frymë dashurie dhe ndjenje miqësie ndaj popujve e kombeve që kanë ndihmuar dhe kontribuar në ecurinë shekullore të mundimshme të popullit tonë për të qenë i lirë dhe sovran, por edhe për të shpërblyer sadopak mundin dhe sakrificat që kanë bërë në shekuj për vendin tonë, atdhetarët, mësuesit, shkrimtarët, poetët, artistët etj.

Është e vështirë të radhitësh dhe të kujtosësh në një konferencë të vetme atë se çfarë ata i kanë dhënë kombit dhe vendit tonë, të sjellësh në retrospektivë vlerat historike, patriotike, arsimore, kulturore letrare të një qyteti që ka nxjerrë kaq shumë njerëz të shquar të dijes kulturës, artit dhe shkencës, ashtu si Korça evokon këtë pasuri, por ndërkohë është përgjegjësi dhe obligim që duhet të kemi ne, intelektualët e studiuesit, institucionet dhe universiteti, qytetarët dhe cilido qoftë që t’i njohim, ruajmë dhe trasmetojmë këto vlera brez pas brezi, për të na shërbyer sa më gjatë me dëshmitë e mesazhet e tyre shekullore, t’ua mësojmë dhe trasmetojmë atë ashtu, të pasur dhe të bukur brezave që do të vijnë, për të evidentuar dhe ngritur edhe më lart marrëdhëniet shumë të mira të skalitura ndër shekuj midis popullit rumun e atij shqiptar.

Natyrisht, një konferencë nuk mund të rrokë të gjitha problemet që lidhen me studimet në fushat e gjuhësisë, letërsisë, historisë, etnografisë, publicistikës, për lidhjet kulturore dhe historike shqiptaro-rumune, por kam bindjen se kumtesat që do të mbahen këtu, do të jenë një prurje e re në vazhden e studimeve dhe veprimtarive të tjera shkencore të organizuara në Korçë dhe në universitetin tonë.

Edhe një herë ju uroj punë të mbarë dhe suksese!

Z. VIOREL STANILA
AMBASADOR I RUMANISË NË SHQIPËRI

PËRSHËNDETJE NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME E RUMANISË

Të nderuar përfaqësues të kulteve fetare,
Të nderuar përfaqësues të pushtetit lokal,
I nderuar Z. prof. as. dr. Gjergji Mero – Rektori i Universitetit “Fan S. Noli” Korçë,
I nderuar Z. prof. dr. Ali Jashari – Dekani i Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj pjesëmarrës,
I nderuar auditor,

Më lejon të përcjell përshëndetjen time në hapjen e këtij sesiioni të parë të konferencës, e cila mbart në vete një histori 100 -vjeçare marrëdhëniesh miqësore shqiptaro-rumune.

Në mënyrë që të kuptojmë më mirë rëndësinë e atyre momenteve, le të kujtojmë se cila ishte rrethana historike në momentin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Territoret shqiptare të pushtuara ushtarakisht pothuajse të gjitha. Statusi i territoreve shqiptare ishte një objekt negociatash midis pjesëmarrësve në luftë dhe midis fuqive të mëdha, si dhe kufijtë e këtyre territoreve.

Në këto kushte, Rumania, besnike e miqësisë së saj për popullin shqiptar, jo vetëm se mbajti konferencën historike në të cilën Ismail Qemali mori vendimin për shpalljen e pavarësisë, por dhe u shpreh në favor të pavarësisë së Shqipërisë në kuadër të Konferencës së Ambasadorëve në Londër.

Në këtë mënyrë, në memorandumin e paraqitur Konferencës në 27 mars 1913 nga ana e Nikolae Mishu-i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë i Rumanisë në Londër, qeveria rumune deklaronte se “shihnte me kënaqësi krijimin e një shteti shqiptar të pavarur”¹. Vihet re se Rumania fliste për një shtet shqiptar të pavarur, ndërkohë që Fuqitë e Mëdha flisnin për një shtet shqiptar autonom.

Më shumë se kaq, nëpërmjet Dekretit Mbretëror nr. 6949 të datës 18 dhjetor 1913, Rumania emëroi M. N. Burgele si të parin të dërguar të jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë pranë qeverisë së Shqipërisë (në Durrës), duke nisur më datën 15 dhjetor 1913. M. N. Burgele filloi

¹Cf. “Dokumenta Diplomatike. Ngjarjet e Gadishullit Ballkanik. Veprimtaria e Rumanisë (shtator 1912 – gusht 1913)”, në Librin Jeshil, Bukuresht, 1913, f. 122.

misionin diplomatik në datën 25 shkurt 1914 dhe e mbajti këtë detyrë deri në 15 janar 1915.²

Dikush ndoshta do të pyeste se përse mbahet kjo konferencë shkencore përkujtimore pikërisht në qytetin e Korçës, por të mos harrojmë se elita shqiptare në Rumani, në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, vinte nga Korça dhe për më tepër, Universiteti “Fan S. Noli” është i binjakëzuar me Universitetin “Valahia” të Tërgovishtes dhe me Universitetin “Ovidius” të Konstancës.

Kam bindjen se shpalosja e punës suaj kërkimore gjatë këtyre dy ditëve do rritë rëndësinë e këtij takimi, paraqitja e fakteve historike dhe e të dhënave shkencore të kombinuara këto me momentin e 100-vjetorit të shtetit shqiptar do risjellin në dritë kontributin e vyer dhe mbështetjen e dhënë nga shteti rumun si në hapat e para të Rilindjes Kombëtare Shqiptare ashtu dhe në aktin suprem të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Dua të falenderoj drejtuesit e Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës dhe drejtuesve të Fakultetit të Edukimit dhe Filiologjisë të këtij universiteti për pritjen tejet të ngrohtë që i bënë kolegëve nga Universitetet e binjakëzuara të Konstancës dhe Tërgovishtes dhe përfaqësuesve të Akademisë Rumune.

Gjithashtu, dua të falenderoj për efortin tuaj për sigurimin e një niveli organizator dhe shkencor kaq të lartë për konferencën dhe të uroj suksese në aktivitetin tuaj!

²“Në lidhje me raportin e Ministrit Tonë të Ministrisë së Punëve me nr. 29987 të datës 15 dhjetor 1913; Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Riorganizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të datës 15 mars 1912, Dekretuam dhe dekretuam:

Neni. 1 Emërohet si përfaqësues i Rumanisë në Shqipëri në datën 15 dhjetor 1913, zoti Burghele (M. N), Ministër i Plotfuqishëm, drejtor për çështjet ekonomike dhe konsullore.

Neni. 2 Ministri ynë i Punëve të Jashtme, ngarkohet me ekzekutimin e këtij Dekreti.

Lëshuar në datën 18 dhjetor 1913.

Carol

Arkiva MPJ, Dosja 77/B, 35, Fq. 116; Fletorja Zyrtare nr. 210 e datës 19 dhjetor 1913/ 1 janr 1914 (dekret i shkurtuar).

Në konformitet me Origjinalin,
N. Nicolescu

ARUMANISHTJA – DIALEKT ARKAIK

Acad. Gregore Brâncuș

Academia Română

Dihet se arumanshtja është një dialect më arkaik se dakorumanishtja, fakt i vënë re prej shumë kohësh nga ana e të gjithë kërkuesve, të cilët u morën me dialektet rumune në jug të Danubit dhe me rindërtimin e rumanishtes së përbashkët. Më të freskëta janë pohimet e Znj. Matilda Caragiu Marioțeanu: «Arumanishtja, ashtu si dielektet e tjera në jug të Danubit, ka një karakter më konservator, të shprehur në të gjitha nivelet e gjuhës (fonetikë–fonologji, morfologji, sintaksë, leksik, por më të dukshme në dy kopartimentet e para, në përgjithësi më të rezistushme)»³. Arkaizmi i arumanishtes përfaqëson, ashtu si dhe dihet, mbështetjen më të rëndësishme, i marrë si term krahasimi, në rrugën e ndërtimit të rumanishtes së përbashkët.

«Karakteristikat arkaike të arumanishtes e afrojnë shumë me rumanishten së përbashkët.»⁴, thekson Matilda Caragiu Marioțeanu, duke paraqitur një deklaratë shumë më të mprehtë të Ovid Densusianu: «Makedorumanishtja duhet të përfaqësojë rumanishten primitive, e folura romanike në jug të Danubit, e cila u formua në afërsi të shqipes, si pasojë e bashkimit të latinishtes me ilirishten»⁵, ose «Filologët janë dakort se makedorumanishtja nuk është, pas së gjithash, [...] një degë e rumanishtes primitive e dalë nga përzjerja e latinishtes me elementin autokton ballkanik»⁶. Sipas Densusianu, karakteri unitar i rumanishtes së përbashkët rrjedh nga uniteti i dy dialekteve: «Në qoftë se do krahasojmë ato dy dialekte, ndeshim në çdo hap karakteristika të përbashkëta [...] të cilat nuk mund të shpjegohen veçse në qoftë se pranojmë se makedorumanishtja dhe dakorumanishtja mbështeten në të njëjtin fond gjuhësor»⁷. Densusianu është midis studiuesve të parë të cilët, edhe pse kishin informacione të përmbledhura, kërkuar rreth fenomenit të migracionit të pandërprerë të arumunëve në të gjitha zonat: «Ky ndryshim vendbanimi i makedorumunëve nuk duhet të na habitë. Dihet se në cilësinë e tyre të çobenjve ata kanë bërë gjatë gjithë kohës një jetë nomade, duke përshkruar nga Veriu në Jug me turmat e tyre të gjithë gadishullin Ballkanik [...] Ky instabilitet i karakterizon dhe në ditët e sotme një numër të madh makedorumunësh, fërsherotë, të cilët banojnë në dimër në Shqipëri, largohen nga banesat në pranverë dhe bredhin për muaj me radhë nëpër male»⁸. Ai shton faktin se «vendet përtej Danubit kanë qenë shekuj me radhë të trazuara nga invazionet dhe shkatërrimet e barbarëve», fakt i cili bëri që dhe makedorumunët «të braktisin disa herë vendbanimet e tyre të vjetra».

Ndryshimet midis arumanishtes dhe dakorumanishtes, të mara në konsideratë me nivelin e mëparshëm të zhvillimit të latinishtes danubiane, janë venë re prej shumë kohësh. Sipas

³M. C. Marioțeanu, *Përmbledhje diaktologjike rumune*, Shtëpia Botuese Shkencore dhe Enciklopedike, Bukureshti, 1975, f. 222 ; shih Nicolae Saramandu, *Rumaniteti oriental*, EA, Bukuresht, 2004, f. 81.

⁴Ibid.

⁵O. Densusianu, *Historia e gjuhës rumune*, vers. rum., Shtëpia Botuese Shkencore dhe Enciklopedike, Bukureshti, 1961, f. 208.

⁶Id., *op. cit.*, q. 210.

⁷Ibid.

⁸Id., *op. cit.*, f. 209.

mendimit të disa studiuesve nuk përjashtohet mundësia që një pjesë e tyre të jetë prodhuar në periudhën e supozuar të rumanishtes së përbashkët. Por duhet parë se ato nuk janë ndryshime thelbësore, çka do të thotë se janë zhvilluar relativisht vonë, pas periudhës së rumanishtes së përbashkët. Sidoqoftë, në rumanishten e përbashkët, e folur në një territor të gjerë, në veri dhe në jug të Danubit, domethë në Daki, në Panoni dhe në të dy Moesitë, duhet të kishte pasur disa ndryshime nga një zonë te tjetra. Th. Capidan shprehet qartë në këtë drejtim: «Gjuha rumune shfaq ndryshime të vogla idiomatike rajonale qysh para ndarjes së saj në dialektet e tanishme. Këto ndryshime duhet të ishin aq më te theksuara sa dhe larg njëra –tjetrës gjendeshin popullatat rumune»⁹. Dyndja e sllavëve i izoloj rumunët e veriut nga ata të jugut të Danubit. Sipas Capidan, daton nga rumanishtja e përbashkët qiellzorëzimi i tingujve buzorë, bashkëtingëlloret *ț* dhe *dz* (nga *c*, *g* të ndjekura nga zanore qiellzore), mungesa e rotacizmit (në rumanishten e përbashkët është e mundur të ketë ekzistuar si fenomen dialektor) dhe të hundorëzimit (*n* ngelet te *gârnu*, *fârnu*, *ună*), shkurtimi i shpeshtë i zanoreve të patheksuara (si pasojë e «një unui tempo më të nxituar» në të folur)¹⁰.

Në vazhdim do paraqisim disa karakteristika fonetike, morfologjike dhe leksikore të mjaftueshme për ta vendosur arumanishten në një shkallë zhvillimi më të vjetër se sa dakorumanishtja. Arumanishtja është një dialekt më konservator se sa rumanishtja në veri të Danubit, më e përafërt me rumanishten e përbashkët. «Arkaitzmi» i saj shpjegohet nga kushtet historike specifike të arumunëve.

Nga fonetika, vëmë re së pari fenomenin e ruajtjes së zanores qendrore *ă* në pozicion hundor, e shndërruar në *î* në dakorumanisht: *călcănu*, *păne*, *plăngu*, *sămtu*. Zanoja *ă* është e përhapur në të folurën fërsherote, domethënë dhe në tekstet e studiuesve të Voskopojës, tek të cilët raportohemi gjithmonë për vjetërsinë e fenomeneve të hasura. Në qoftë se te fërsherotët *ă* është ruajtur e pa prekur¹¹, duhet thënë se në të folura të tjera të arumanishtes vihet re dhe *î*¹², nga ku del dhe hipoteza se në rumanishten e përbashkët të vonshme sistemi zanoz ishte ndërtuar nga shtatë njësi ose me tepër, që në arumanisht ishte tashmë, pavarësisht prirjes së mbylljes së *ă* në pozicionin e dhënë në dakorumanisht. Te fërsherotët *ă* shpjegohet dhe me kontaktin e gjatë me shqipen toske, në të cilën nuk njihet fenomeni i mbylljes së *ë*. Në të gjitha rastet, ruajtja e *ă* të theksuar e ndjekur nga hundore është një shenjë e rëndësishme e karakterit arkaik të arumanishtes. Shfaqja e *ă* (e theksuar ose jo) është në të njëjtën linjë me fenomenin e përgjithshëm të mbylljes së zanoreve: *e* > *i*, *o* > *u*, gjë që nuk do të thotë se *ă* është shfaqur «spontanisht». Hipoteza e ndërhyrjes së nënshtresës në procesin e gjenezës së gjuhës nuk duhet asimiluar me një «shpjegim të jashtëm», e vlefshme për influencat e mëvonshme.

⁹ Th. Capidan, *Arumunët. Dialektul arumun*, Bukuresht, 1932, f. 141.

¹⁰ Ibid ; shih veçanërisht Sextil Pușcariu, *Kërkime dhe studime*, 1974, f. 57 §. u., studimi *Rreth ndërtimit të rumanishtes primitive*, në krahasim me rumanishten të studimit në ferngjisht të vitit 1937 dhe në gjermanisht të vitit 1910: *Zur Rekonstruktion des Urrumänisch*; detaje të tjera në Sextil Pușcariu, *Gjuha rumune*, I. *Vështrim i përgjithshëm*, Bukuresht, 1940, f. 219 §. u. dhe Al. Roseti, *Historia e gjuhës rumune*, Bukuresht, 1986, f. 328 §. u. Problematika e përgjithshme në lidhje me rumanishten primitive është paraqitur nga Ion Gheție, në „Gjuha rumune”, XXXV, 1986, 6, f. 516 §. u.

¹¹ Cf. Caragiu, *op. cit.*, f. 223.

¹² Cf. T. Papahagi, DDA, f. 20: *ă* në veri, *î* në jug në rastin e dyshes *când – când*.

Konstatime të rëndësishme, nëpërmjet së cilave del ne dritë karakteri arkaik i arumanishtes, mund të bëhen dhe në lidhje me zhvillimin e *e-së*:

a. në fillim të fjalës mungon qiellzorëzimi e *e-së*: *el, es, este* dhe, në të njëjtën mënyrë, e strukturës së diftongut ÷*a*- : ÷*arbă*, ÷*apă*, ÷*ască* (në dakorumanisht : ~*a*, zhvilluar nga një ~÷*a*, me qiellzorëzimin : ~÷*arbă* > ~*arbă*) ;

b. *e* e ruajtur pas buzoreve: *meru, peru, feta* (rallë në dakorumanisht: *beșică, beut*) dhe, në të njëjtën mënyrë, diftongu ÷*a*, i përftuar nëpërmjet metafonisë: *feată, veară, peană*.

Në arumanisht ruhet *-u* fundore, si në dakorumanishten e vjetër ose në të folme të tanishme në veriperëndim: *aducu, aușu, vindu, alavdu, bărbatu, lemnu, preftu*¹³. Tendenca e zhdukjes së *-u* nga e folura e fërsherotëve është një provë që ajo është etimologjike. Te Cavalioti, Ucuta, Daniil *-u* është e përgjithëshme¹⁴. Kishin këta studiues ndryshim midis të folurit dhe të shkruajturit?

Një veçanti arkaike e bashkëtingëlloreve të arumanishtja është prania e qiellizoreve *l', n'* (din *l, n* të ndjekura nga *ě, i*) : *l'ertu, hi l'u, călcănu, gutuine*¹⁵. Siç dihet, *n'* ruhet dhe në të folmen e Banatit.

Te arumunët, qiellizorja *l'* ruhet dhe në grupet *cl', gl'*, të shndërruara në *ć, g'* në dakorumanisht (në shekullin e XVI-të gjendet prania e *cl'*). Kjo është një karakteristikë e rëndësishme e arumanishtes.

Nga sistemi i bashkëtingëlloreve i arumanishtes kemi parasysh dhe *dz* dhe *ĝ*, të ardhura nga *d*, respektivisht *j*: *dzicu, ĝocu, ĝudicu*; këto bashkëtingëllore gjenden dhe në disa të folme më arkaike të dakorumanishtes (Moldova, Bucovina, Banat).

Shumë elemente fonetike të veçanta të regjistruara në kërkimet e mëparshme në arumanishtë janë lënë mënjanë, sepse nuk mund të vendosen me qartësi e në marrëdhënie direkte me gjegjëset e tyre të presupozuara në rumanishten e përbashkët.

Nga fusha e morfologjisë, jemi ndalur mbi disa veçanti të strukturës së formave verbale, të cilat, si dhe ato të mëparshmet, i kemi hulumtuar nga monografia e përkryer e Theodor Capidanit. Dhe nga ky pikëvështrim arumanishtja është më arkaike se sa dakorumanishtja, më e përafërt me atë që quajmë rumanishte të përbashkët.

Kështu, forma e vetës III shumës e së pakryerës shfaqet gjithmonë pa *-u* : (ei) *cănta, cădea, bătea, durnea*, si në dakorumanishten e vjetër dhe në atë popullore. Mungesa e *-u* është rezultat i zhvillimit fonetik normal të gjegjëseve latine. Rumanishtja e folur ka pasur gjithmonë tendencën e rindërtimit dhe gjeneralizimit në të gjitha kohërat e homonimisë njëjës – shumës në vetën e III-të.

E kryera e thjeshtë, një kohë shumë e përdorur në arumanisht (është e mundur që edhe influenza trake dhe shqiptare të ketë ndërhyrë këtu) ka karakteristika morfematike të njohura dhe në dakorumanishten e para disa shekujsh, si dhe në të folmet e pranishme sot në jug-perëndim, të karakterizuara nga konservatorizmi:

¹³ Th. Capidan, *op. cit.*, p. 285 §. u.

¹⁴ Shih. Papahagi, *Shkrimtarë arumunë të shekullit të XVIII-të* Bukuresht, 1909; *Fjalori*, f. 187 §. u.

¹⁵ Shembuj te Capidan, *op. cit.*, p. 338.

a. nyja *-şi* në vetën e parë njëjes të foljeve të kryer sigmatike (të fortë): *adaşu, alepşu, arşu, frāmşu, scoşu, scrişu, spuşu* etc.;

b. mungesa e nyjes të brendshme *-ră-* nga format e shumësit: *cântăm, cădzum* (dr. *cântarăm, căzurăm*, por shiko në rumanisht *cădzum*);

c. nyja *-t(u)* në vetën II shumës: *cântatu, cădzutu, bătutu, durlitu*, e shfaqur paralelisht me *-m(u)* në vetën e parë shumës: *cântamu*; për shpjegimin e mençinerii në aromână, në shqip *kënduam, kënduat*.

Arumanishtja, në mëse të kryerën përdor një formë të përbërë nga e pakryera e ndihmëses *avea* dhe pjesorja: *aveam cântată, avea durlită, avea faptă*¹⁶. Rruajtja e kesaj forme alegorike, e rrallë në dakorumanishten e vjetër, në arumanisht shpjegohet dhe nga kontakti me shqipen dhe me greqishten, të cilat kanë forma më se të kryera me strukturë identike.

Duhet shtuar gjithashtu fakti se arumanishtja ka dhe një formë të ndërtuar prej së kryerës së ndihmëses dhe pjesores, e venë re nga Capidan : *avui cântată* ; një strukturë identike në shqip: *pata kënduar*, pranë *kisha kënduar*, me variacion semantik. Një analogji me shqipen vihet re dhe në të kryerën, e cila, në arumanisht, ka lidhje dhe me forma të gjata në shumës : *avem cântată, aveți cântată* (comp. shq. *kemi (keni) kënduar*).

Si dhe në rastin e fonetikës, këto fakte të strukturës morfologjike janë të mjaftueshme për të provuar se arumanishtja është më konservatore se dakorumanishtja, më e përafërt me rumanishten e përbashkët.¹⁷

Karakterit arkaik i rumanishtes vihet re më shumë në leksik, rrafsh që i nënshtrohet vazhdimisht ndryshimeve, me zhdukje, zëvendësime, zhvillime semantike.

Fillimisht vëmë në dukje faktin se në arumanisht janë ruajtur fjalë me origjinë latine të cilat janë zhdukur nga dakorumanishtja. Timotei Cipariu¹⁸, i cili vuri re i pari fatin e këtij fondi leksikal, ndërtoi një listë me 74 fjalë të tilla, të cilat i gjeti në veprat e studiuesve arumunë në fund të shekullit XVIII. Shumë prej tyre janë fjalë thelbësore në fjalorin e përgjithshëm të dialektit: *agru* (*ager*), *auă* (*uva*), *băşare* (*basiare*), *căroare* (*calor*), *dimândare* (*demandare*), *e* (*et*), *h'ic* (*ficus*), *mesu* (*mensis*), *nearcă* (*noverca*), *poarcă* (*porca*), *viptu* (*victus*), *îngiţ* (*viginti*) etj. Pavarësisht kalimit në kllapa të disa shembujve, duhet theksuar një fakt shumë i rëndësishëm, pjesa më e madhe e fjalëve të këtij grupi, janë në fjalorin aktiv në të folmen e sotme të arumanishtes si dhe gjenden në dakorumanishten e disa teksteve të vjetra dhe në disa të folme të sotme rajonale: *arbure* (*arbor*), *marţu* (*martius*), *mărit* (*maritus*), *muşat* (**formosius*), *nămal'e* (*animalia* pl.), *neauă* (*nix*). Ky vështrim, i rimarrë vazhdimisht¹⁹ si një fakt i përbashkët në studimet historike të gjuhës rumune, është formuluar qartë nga ana e kanunit nga Blaj: «...forma dhe fjalë origjinale dhe të prejardhura, disa, të cilat dëgjohen vetëm te rumunët përtej Danubit, të

¹⁶ Al. Philippide, *Origina e rumunëve*, II, f. 426.

¹⁷ Cf. Sextil Puşcariu, *Gjuha Rumune*, I, *Vështrim i përgjithshëm*, Bukuresht, 1940, f. 218, 222 ş. u.

¹⁸ T. Cipariu, *Principia gjuhësore dhe striptore*, ed. a II-a, e riparë dhe e shumuarë, Blaj, 1866, f. 87 ş. u. Autori shpreh keqardhjen që nuk mundi të shihte dhe fjalorin në katër gjuhë të Daniil Moscopoleanul.

¹⁹ Problemi i fondit të trashëguar në arumanisht dhe me një regjim të vecantë në dakorumanisht është studiuar nga shumë kërkues historikë të gjuhës; shiko. Bibliografinë te Gr. Brâncuş, *Studime historike të gjuhës rumune*, [I], EA, Bukuresht, 2007, p. 92 ş. u.

tjera të cilat rreth vitit 1700 ishin në përdorim te ne dhe, që prej atëherë u zhdukën përfundimisht nga gjuha rumune, ose shumë rrallë degjohen ose shkruhen”²⁰. Si rrjedhojë, fjalët me origjinë latine të njohura sot vetëm në arumanisht ose në disa të folme periferike në veri të Danubit ishin të përgjithshme në rumanishten e përbashkët, një gjuhë unitare, e folur në një hapësirë të gjerë të romanizuar në veri dhe në jug të Danubit.

Historia e dialektit arumun, në lidhje sidomos me karakterin arkaik të tij, duhet parë në lidhje me historinë shoqërore të këtij grupi të rëndësishëm rumunësh ballkanikë. Tache Papahagi vëren, si shumë kërkues të tjerë, se «lëvizja, zhvendosja, pelegrimimi, është një karakteristikë e historisë së arumunëve». Ai mendohet, me një nostalgji të lehtë, në «një shuajtje gjuhësore» e determinuar nga paqëndrueshmëria e tyre, «arumuni nuk është i lidhur me tokën, por me kërkesat e jetës së tij»²¹. Agrikultura te arumunët, ishte, ashtu si thotë Papahagi, «...në akord me të gjithë specialistët e historisë së Ballkanit «anemike dhe sporadike; e praktikuan vetëm fshatrat me një popullatë të qëndrueshme dhe sigurisht shumë të vogël»²².

Karvanet, një tjetër punë e rëndësishme e arumunëve, i asimilohet fenomenit të migrimit të vazhdueshëm. Shtojmë konstatimin se ashtu si te shqiptarët edhe te arumunët ishte i përhapur, fenomeni «i largimit» (shq. *kurbet*), eksodi në vende të largëta, nga ku ktheheshin vonë, pas shumë vitesh. Th. Capidan konstatoi se «malli për largim», i lidhur në origjinë me blegtorinë, karakterizon dhe sot jetën shpirtërore të arumunëve. Por duket se «në shtëpi», pas kthimit të tyre, është asimiluar me atdheun primitiv të gjendur në veri të Danubit. Pușcariu konsideron «migrimin», të përcaktuar ose jo nga blegtoria, si një gjendje të përgjithshme të rumunëve si një mënyrë mbrojtjeje në gjithë historinë e tyre. Në një vend tjetër pohon se «migrimi» është një mënyrë ekzistence e arumunëve: «Kjo shtrirje e arumunëve është rezultati i një numri të madh migrimesh. Kemi prova historike të zhvendosjeve të tyre nga një vend në tjetrin si pasojë e persekutimeve të shumta që u janë bërë. Tradita e ruajtur nga të moshuarit dhe gjuha e tyre janë prova të gjalla për lëvizjen e kësaj popullate, e cila ka braktisur fshatrat të tëra për të ndërtuar të tjera të reja»²³.

Duhet shtuar se historia e raporteve ndëretnike në Ballkan, ka qenë jo në favor të arumunëve. Paraqisim këtu shprehjen plastike të T. Papahagi se «...kohrat historike kanë përkeqësuar pelegrimet e tij gjeografike duke e shpërndarë në eklava të izoluar» duke shtuar më pas se «Tirania feudale (turke, greke) përcaktuan shkatërrimet të cilat e çrrënjëzuan shumë popullatën arumune, duke e hedhur në drejtime të ndryshme»²⁴.

Arumunët kanë qenë në një lëvizje të vazhdueshme nga veriu në jug, për këtë arsye e folmja e tyre ka qenë më unitare dhe më pak e përplasur me ndryshimet sesa e folmja dakorumune, popullatë e qëndrueshme. Shpërndarja e një fondi të rëndësishëm fjalësh në gjuhët me të cilat kanë hyrë në kontakt shpjegohet nëpërmjet migrimit të vazhdueshëm në të gjitha zonat e Ballkanit, e ndikuar nga faktorë të ndryshëm, pra elementët më të shumtë leksikorë të cilët u

²⁰ T. Cipariu, op. cit., p. 87.

²¹ T. Papahagi, *Fjalori i dialektit arumun, i përgjithshëm dhe etimologjik*, ed. a II-a, EA, Bukureshti, 1974, f. 6.

²² *Ibid.*, f. 16.

²³ S. Pușcariu, *Gjuha rumune, I, Privire generală*, Bukuresht, 1940, f. 220, 360.

²⁴ *Id.*, f. 11

futën në greqishten e Epirit i përkasin fushës të vjetër të bariut: *bardzu, buză, cupaciu, ciucă, dașu, gălbază, groapă, grumadzu, mură, murgiu, mușcă, scrum, sumbure, țap, țarc*. Këto i përkasin nënshtresës trako-dake, të cilave ju shtohen ato me origjinë latine, të gjitha dëshmojnë vjetërsinë e kontaktit me gjuhën greke. Arumanishtja ka lënë gjurmë dhe në leksikun e popullit shqiptar²⁵, si dhe, më rallë, në të folmet sllave në Maqedoni, Bullgari, Kosovë etj.

Ritmi i ngadaltë i zhvillimit të arumanishtes, si pasojë e zhvendosjeve shoqërore të pandërprera u vu re fillimisht nga B. P. Hasdeu. Ai tregoi se dialekti i një popullate të qëndrueshme zhvillohet me ritëm normal (rasti i dakorumanishtes), ndërkohë që dialekti i popullatës e cila «migron» vazhdimisht (arumanishtja) është «i penguar dhe ndaluar» nga zhvillimi i tij normal: «Il n'est pas moins incontestable que, des deux dialectes, celui qui n'a jamais changé de place, fixé dans les mêmes conditions climatiques et de voisinage, se développe le mieux, tandis que le dialecte qui se déplace subit nécessairement des dérangements de toutes sortes. Or, le dialecte daco-roumain est de beaucoup plus normal, plus organique, plus conséquent dans son développement, qui se produit parallèlement à l'italien, que le macédo-roumain qui nous apparaît, en tout, comme entravé et arrêté dans sa marche.»²⁶. Arkaizmi i arumanishtes dhe zhvillimi normal e i pandërprerë i dakorumanishtes, të konsideruara si një reflektim i pozicionimit shoqëror (migrimi i arumunëve dhe qëndrueshmëria e dakorumunëve), janë për Hasdeu termat e hipotezës së autoktonisë rumune në veri të Danubit. Është interesant dhe konstatimi i tij në drejtimin e lëvizjeve pastoriale në Evropën jug-lindore: «Mais s'il est vrai que les Roumains étaient pasteurs, il n'est pas moins certain que les bergers roumains ne montent jamais du sud au nord ; tout au contraire, ils descendent systématiquement du nord au sud à la recherche de meilleurs pâturages»²⁷. Ai shton këtu vendet e kryeqitetit së «Țării Românești» i zhvendosur herë pas here nga veriu drejt jugut.

Karakter i arkaik i arumanishtes në raport me dakorumanishten është i ngjashëm, në një nivel tjetër, me arkaizmin e rumanishtes përballë gjuhëve të tjera romanike. Pozicioni anësor në përhapjen e Rumanisë dhe izolimi kohor nga qendrat inovatoare perëndimore janë faktorë me të cilët shpjegohet ruajtja vetëm në gjuhën rumune i një fondi leksikor të vjetër: *adjutorium* > *ajutor*, *blanditia* > *blândețe*, *languidus* > *lânged*, *lingula* > *lingură* etj.²⁸. Kësaj i shtohen një numër i rëndësishëm karakteristikash fonetike dhe gramatikore të vetë të rumanishtes, si dhe një gjurmë më e theksuar e ndërhyrjes së nënshtresës.

Pra, arumanishtja u zhvillua më ngadalë se rumanishtja, duke qënë idioma e një popullate me një histori në migrim të vazhdueshëm nga veriu në jug, pa pengesa natyrore, politike ose fetare. Sipas teorisë së Hasdeut, e folmja e arumunëve, nga enklava të ndryshme, duket më unitar, më pak i nënshtuar ndaj ndryshimeve sesa e folmja e dakorumunëve, popullatë e qëndrueshme. Në

²⁵ Vezi Th. Capidan, *Raportje gjuhësore rumuno-shqiptare*, te “Dakorumania”, II, p. 467 §. u.

²⁶ B. P. Hasdeu, *Studii de lingvistică și filologie*, edite e ingrijitura de Gr. Brâncuș, Ed. Minerva, Bukuresht, 1988, vol II, f. 453. Pasazhi i cituar këtu është marrë nga teksti i ndërhyrjes në Kongresin e VII-të të Orientalistëve mbajtur në Vjenë në vitin 1886, i botuar me titullin *Sur les éléments turcs dans la langue roumaine*.

²⁷ *Ibid.*

²⁸ Cf. Sextil Pușcariu, *op. cit.*, f. 213.

termat metodologjikë të përdorur, arumanishtja shfaqet si idiomë arkaike, e krahasueshme me dakorumanishten e shekullit të XVI-të.

SHQIPJA DHE RUMANISHTJA SI GJUHË BALLKANIKE

Prof. dr. Ali Jashari

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, UK “Fan S. Noli”

Prof. as. dr. Dhimitri Bello

Departamenti i gjuhës shqipe
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, UT

Tashmë është e njohur në Ballkan, por edhe jashtë tij, një bashkësi gjuhësore në të cilën përfshihen gjuhë që edhe pse nuk janë të afërta në aspektin gjenealogjik të saj, ato bartin në vetvete dukuri gjuhësore të ngjashme ose të afërta. Kombinimi i metodës së vjetër krahasimtare në gjuhësi, që solli edhe klasifikimin gjenealogjik të gjuhëve duke i ndarë ato në familje, me metodën relativisht më të vonë përfaqëse (kontrastive), bëri të mundur lindjen dhe konsolidimin e termit gjuhësor *Lidhje gjuhësore*, që qëndron në themelet e gjuhësisë ballkanike.

Gjuhët mund të bartin në vetvete tipare e dukuri gjuhësore të përbashkëta si rrjedhim i origjinës së njëjtë grupore, por mund të ngjasojnë edhe nga një shkak tjetër që mund të jetë pasojë e kontakteve gjuhësore historike, ose nga “trashëgimia” e një gjuhe të vjetër substratiale të përbashkët që mund të jetë folur dikur në arealin e caktuar gjuhësor. Këto tipare gjuhësore evidentohen, studiohen dhe shpjegohen më shterueshëm kur i kombinojmë të dyja metodat e sipërpërmendura, krahasimin brenda gjenealogjisë gjuhësore dhe përfaqëse-tipologjike duke depërtuar edhe në diakroni të tyre.

Termi “Lidhje gjuhësore” konsiderohet si një atribut i Rrethit linguistik të Pragës dhe është “pagëzuar” fillimisht nga N. S. Trubeckoi, në Kongresin I të linguistikës në Hagë, më 1928. Është një përkim i afërt kohor edhe me botimin e punimit të studiuesit danez Sandfeld për gjuhësinë ballkanike (1926 botimi I dhe 1930 botimi II, në Paris). Në atë kohë, Trubeckoi, si gjuhë të përfshira në këtë Lidhje të quajtur ballkanike përfshinte shqipen, rumanishten, bullgarishten dhe greqishten. Sot panorama gjuhësore në Gadishullin e Ballkanit ka ndryshuar shumë dhe ne nuk mund të themi të njëjtën gjë edhe sot, pasi kanë “lindur” edhe gjuhë të tjera, ose ato që në periudhën në fjalë të konsideruar si dialekte janë shkëputur nga e ashtuquajtura gjuhë “mëmë” për të fituar statusin e standardit. Në çdonjërin prej gjuhëve ballkanike ravijëzohen dialekte që bartin në një gradë të lartë ballkanizmi si: dialekti jugor i shqipes, të folmet jug-perëndimore të bullgarishtes, maqedonishtja në përgjithësi, dialektet veriore të greqishtes, arumanishtja dhe megleno-ruamnishtja si dhe dialekti i prizren-timokut nga serbishtja.

Elementet e përbashkëta në gjuhët bashkëkohore ballkanike, që konsiderohen si dukuri strukturore të Lidhjes gjuhësore, në pjesën dërrmuese të tyre kanë karakter morfologjik dhe morfo-sintaksor. Ato lidhen me kategori të veçanta në paradigmat eptimore të sistemit nominativ e verbal, duke prekur strukturën e vetë paradigmave edhe planin e shprehjes dhe të kuptimit gramatikor që formon edhe karakteristikën tipologjike në ndërtimin e fjalës (fleksioni, aglutinimi, izolimi etj.)

Nga gjuhët e Ballkanit një vend të rëndësishëm, si gjuhë qendrore të Lidhjes gjuhësore ballkanike, natyrisht që konsiderohen shqipja dhe rumanishtja. Po çfarë përfaqësojnë ato në vetvete dhe pse i kemi marrë në përqasje këto dy gjuhë në këtë punim modest, që natyrisht nuk është i pari në llojin e vet?

Shqipja dhe rumanishtja janë gjuhë indoevropiane me statuse të ndryshme grupore në të. E para një gjuhë e veçantë në llojin e vet që nuk ka lidhje grupore me ndonjë gjuhë tjetër, ndërsa tjetra një gjuhë neolatine, romane, por specifike edhe kjo brendapërbrenda grupit të vet, pasi bart në vetvete dukuri gjuhësore, që mungojnë tek simotrat e tjera.

Nëse do i referoheshim studiuesit të mirënjohur rumun Brënkush për këtë, do të shprehej: “Në ansambli ballkanik, rumanishtja dhe shqipja krijojnë një grup më vete, të karakterizuar përmes një shfaqjeje misterioze, prejardhja e së cilës është e vështirë për t’u parashikuar, veçanërisht në planin e afriës së tyre është i pabarabartë; njëra gjuhë romane e tjetra indoevropiane” (Brăncuș 2009: 3-4).

Bashkëpërkimet midis shqipes dhe rumanishtes janë të shumta. Por si fillim, duhen ndarë ato dukuri gjuhësore që janë; indoevropiane, tipike tek shumica e gjuhëve të familjes; mbarëballkanike, pra që i hasim edhe në gjuhë të tjera, pjesëtare të Lidhjes gjuhësore ballkanike; dhe dukuri që janë pak a shumë tipike dhe të veçanta midis shqipes dhe rumanishtes, por pa përjashtuar rastin edhe për ndonjë përkim të vogël me ndonjë gjuhë jashtë dy gjuhëve në shqyrtim.

Konkordancat i përkasin tri rrafshëve gjuhësore: leksikor, gramatikor e atij fonetik. Po përqendrohemi si fillim tek përkimet e veçanta që ekzistojnë ndërmjet këtyre gjuhëve. Natyrisht që një pjesë e mirë e këtyre dukurive janë trajtuar në mënyrë të veçantë edhe të përgjithshme edhe nga shumë studiues të tjerë shqiptarë e rumunë, por edhe të huaj, që kanë pasur interes për studimin këtyre gjuhëve, ose të njërës prej gjuhëve në veçanti, kryesisht për shqipen, meqë përbën edhe një rast unik, të veçantë në llojin e vet në familjen e madhe gjuhësore indoevropiane.

Në krye duhet theksuar edhe një fakt i rëndësishëm, fakt historik e gjuhësor që përkon tek këto gjuhë dhe na e vështirëson sqarimin e anës burimore të dukurive të ndryshme gjuhësore. Ky është dokumentimi relativisht i vonë i të dyja gjuhëve. Kjo gjithashtu na e vështirëson gjithashtu edhe përcaktimin e kohës, vendit dhe djepit të gjuhës “nënë” për çdo gjuhë në veçanti, ndërsa bashkëpërkimet e shumta që i gjejmë në të dyja gjuhët, ndoshta na e ndriçojnë sadopak këtë pjesë që na paraqitet e “mjegulluar”. Ngjashmëritë e shumta ndërmjet këtyre dy gjuhëve i kanë dhënë shkak studiuesve që t’i shohin këto me mjaft interes, të thellohen në këto hulumtime, për të dalë më pas edhe në ndonjë konkluzion përkatës.

Çabej, në ngjashmëri me konkluzionin e dikurshëm të Kopitar-it në lidhje me gjuhët e Ballkanit, të konsideruar shpeshherë edhe si një përfundim “të entuziazmuar” të tij se në Ballkan ekziston “një formë gjuhësore, por me tri lloje lënde gjuhësore”, konkludon se te shqipja e rumanishtja kemi “të njëjtën lëndë”, por me dy “forma të ndryshme” (Çabej 2008:162).

Edhe periudha kohore që mendohet si koha e formimit të shqipes dhe rumanishtes është relativisht e afërt, duke marrë për bazë vjetërsinë e saj, ose atë që mund ta quajmë si “të mesme

të përpjesshme”. Për shqipen, kjo periudhë është shekulli IV deri VI pas Krishtit, ndërsa për rumanishten është shekulli V deri në VII.

Ajo që ka tërhequr vëmendje në fillim, shkak për të bërë më pas vëzhgime edhe në rrafshet e tjera gjuhësore si atë fonetik e gramatikor, është korpusi i njëjtë i disa fjalëve të vjetra. Në krye të herës kjo dukuri leksikore identifikohet nga Miklosich, nga mesi i shek. XIX (1861), ku vëren se kemi njësi leksikore me ndërtim fonetik dhe semantik të ngjashëm. Këto përkime ai i shpjegoi se i përkasin një burimi të njëjtë, që është substrati trak, mendim të cilin e kanë përkrahur edhe studiues të tjerë. Pra siç vihet re, interesantja në këtë leksik të përbashkët është se këto fjalë nuk kanë një burim të njohur si p. sh, gjuhët klasike (latinisht ose greqishte e vjetër), dhe as ndonjë gjuhë të shtresuar relativisht vonë siç janë ato sllave dhe orientale. Në lidhje me këtë burim kemi mendime të ndryshme. Një pjesë e studiuesve kërkojnë gjuhën burimore në diakroni të thellë, në një prej gjuhëve të vjetra të Ballkanit, pra tek gjuha substrat. Një pjesë prej të cilëve janë të mendimit se ky substrat është trakishtja, ose trako- dakishtja. Këta janë edhe përkrahës të mendimit se shqipja është vazhdim ose evolucion i saj. Disa të tjerë këtë burim e lidhin me gjuhën shqipe, ose me “nënë” e saj, cilado qoftë ajo, nga e cila kanë depërtuar në rumanisht, në një kohë më të hershme, parasllave (Demiraj 1994: 176). Si përfundim mund të themi se në lidhje me burimin e këtij leksiku të përbashkët në shqip e në rumanisht, nuk kemi dhe vështirë se mund të dalë një mendim i përbashkët dhe i argumentuar qartë e saktë.

Numri i këtyre fjalëve të vjetra të studiues të ndryshëm paraqitet me shifra të ndryshme, si p. sh. sipas Russu numri i tyre është 70 fjalë (Russu 1970: 91), ndërsa Brënkush (Brâncuș 1983: 130) këtë korpus fjalësh e zgjeron edhe më tej duke dhënë rreth 90 njësi, e kështu me radhë.

Në përgjithësi pranohet (dhe duket se rrjedhimi e ka një logjikë) se numri i këtyre fjalëve të vjetra është relativisht i madh dhe dikur ndoshta edhe shumë më i madh se sa na paraqitet ky në fazën aktuale të zhvillimit të gjuhëve përkatëse, ose të shtrira këto në diakroni deri në periudhën e dokumentimit të tyre të parë (që siç u shprehëm edhe më lart, përkon). Gjithsesi, ciladoqoftë shifra e këtyre leksemave në kohën tonë, këto dëshmojnë për një marrëdhënie të shtrirë thellë në kohë me zanafillë parasllave. Përcaktimi i burimit të këtyre fjalëve është një çështje e rëndësishme e gjuhësisë ballkanike. Çabej jep tri mundësi për burimin e tyre:

1. Burimi rumun. 2. Mund të jenë fjalë të shqipes. 3. Një gjuhë e tretë, e përbashkët për dy gjuhët. (Çabej 2008: 168)

Vetë Çabej mendohet se, në përgjithësi për përkimet e vjetra leksikore midis shqipes e rumanishtes, anon nga kontaktet direkt të ndërsjella midis dy gjuhëve (Demiraj 1994: 177). Ndërsa studiuesi rumun Rosetti në lidhje me këtë problem mendon se prania e këtyre fjalëve të vjetra “nuk parakupton medoemos kontaktin midis stërgjyshërve tanë dhe të parëve të shqiptarëve, ngaqë këto fjalë shpjegohen me një kriter të përbashkët: një gjuhë aktualisht e zhdukur, trajta e sotme e së cilës është, të paktën pjesërisht, shqipja e sotme dhe që ka lënë gjurmë në fjalorin e popullsisë së romakëzuar danubiane” (citim Kyçyku 1999: 45), duke arritur në përfundimin se territori gjuhësor i pararendësve të shqiptarëve nuk është ai i sotmi, por i zhvendosur në veri të tij.

Bashkëpërkimet të veçanta midis shqipes e rumanishtes prekin edhe pjesën kryesore të gjuhës, atë që ndryshon më ngadalë në kohë, por edhe që e mban gjallë atë - rrafshin gramatikor. Po e nisim si fillim me fjalëformimin.

Ajo çka është interesante në gjuhën shqipe dhe rumune është përkimi në disa forma të mënyrës së ndërtimit të fjalëve. Këtu bëhet fjalë për mënyrën e formimit të fjalëve nëpërmjet përngjitjes dhe më konkretisht për ndërtimin e disa fjalëve të veçanta, përemra dhe ndajfolje me kuptim të pacaktuar (Demiraj 1994: 179). Janë përemra me ndërtim të ngjashëm si p. sh. me pjesën e parë të ndërtimit në shqip *kush-* në rum. *cine-*, shqip *cili-* në rum. *care-*, shqip *ku-* në rum. *unde-* dhe me element të dytë të ndërtimit në shqip *-do* dhe në rum. *-va* në format në shqip *kush-do* rum. *cine-va*, *cili-do* në rum. *care-va*, *ku-do* në rum. *unde-va*. Po kështu kemi edhe formime të tjera, por me ndryshime të pozicionit të elementeve, në njërën gjuhë në fillim dhe në tjetrën në fund, si te format e elementit të dytë në shqip *-do* në rumanisht kjo formë *ori-* e hasim si element të parë, siç janë format e përngjitura në shqip *kush-do*, *ku-do* etj., në rumanisht janë *ori-cine*, *ori-care*, *ori-unde* etj.

Me një përputhje të ngjashme, por jo të plotë paraqiten format e përngjitura përemërore të tipit *di-kush* në rum. *ne-ș-care*, *diç-ka* në rum. *ne-ș-te* (për hollësi shembujsh shih Demiraj 1994: 179- 180).

Përkim tjetër në fushën e fjalëformimit janë edhe disa forma në mënyrën e formimit të fjalëve me paranyjëzim, kur nyjat janë në përbërje të mbiemrave, numërorëve rreshtorë si dhe nyjave të rasës gjinore siç janë në shqip: *i mirë*, *i keq*, *i pari*, *i treti*, *i shokut*, *e studentit* etj. Por, veçse në rumanisht këto nyja të përparme tek mbiemrat nuk përdoren në çdo rast. Në këtë gjuhë këto nyja vendosen vetëm në rastet kur përdoren pas një emri në trajtë të shquar. Në rumanisht për mbiemrat përdoren nyjat e para *cel* (*cea*, *cei*, *cele*), që rrjedhin prej dëftorit *acel*, për rasën gjinore përdoret *al* (*a*, *ai*, *ale*) dhe *de-al dilea* tek rreshtorët. Për në mënyrën e formimit të fjalëve me pranyjëzim në shqip e në rumanisht, përveç përkimeve që përmendëm, ka edhe mjaft ndryshime (Demiraj 1994: 182).

Një dukuri gjuhësore e gramatikës që lidhet me shqipen dhe rumanishten është dhe dukuria e ndërrimit të gjinisë së emrave jofrymorë mashkullorë, që në numrin shumës kalojnë në gjininë femërore. Veçse kjo dukuri nuk mund të quhet si një veçori e kufizuar vetëm tek dy gjuhët në shqyrtim, pasi një dukuri e ngjashme (këtu ndryshimi kalon nga gjinia mashkullore te asnjanesi) ndodh edhe me greqishten, por edhe me gjuhë të tjera i. e., jashtë Lidhjes ballkanike (Demiraj 1973: 319). Këtu vihet re një prirje për të hequr kufirin midis gjinisë mashkullore dhe femërore. Bëhet fjalë për disa emra mashkullorë në njëjës, të cilët në numrin shumës në shqip marrin mbaresa femërorizuese *-ra*, *-e* dhe *-a* dhe në rumanisht mbaresat *-e* dhe *-uri*. Ndryshe njihet si dukuri e “asnjanësit” e kundërshtuar me të drejtë nga mjaft studiues (Demiraj i quan emra ambigjenë (Demiraj 1973: 322).

Ngjashmëri të veçanta midis shqipes e rumanishtes kemi edhe në sistemin foljor të tyre. Një dukuri që bie në sy është përdorimi i pjesores pas foljeve me vlerë të paskajores dhe forma të pashtjelluara të krijuara mbi bazën e pjesores me një pjesëz përpara, kryesisht me origjinë parafjalore si në shqip: *me*, *pa*, *duke*, *për* etj., dhe në rumanisht: *pentru*, *de*, *la*, *după* etj. Nuk po

qëndrojmë më gjatë këtu te format e paskajores, meqë problemi i saj i përket më shumë përkimeve mbarëballkanike.

Në përkimet gramatikore midis dy gjuhëve kemi edhe në morfosintaksë, si prapavendosja e përcaktorëve të pavetëmjaftueshëm të emrit.

Siç e përmendëm edhe në krye, midis dy gjuhëve kemi edhe përkime të tjera, të cilësuar si ballkanike, meqë dukuria shtrihet edhe në gjuhët e tjera të arealit ballkanik, ku dy gjuhët janë gjuhë qendrore të bashkësisë gjuhësore ballkanike. Po qëndrojmë në disa prej tyre, që njihen njëkohësisht edhe ballkanizmat kryesore:

Një dukuri, e quajtur tipike ballkanike edhe pse ndeshet edhe në gjuhë që nuk i përkasin bashkësisë gjuhësore, që e hasim edhe në shqip e në rumanisht është prapavendosja e formantit të shquarsisë si p. sh. në shqip: *ujk- ujk, ujë- uji* dhe në rumanisht: *lup- lupul, apă- apa*. Dukuria në fillim është konstatuar nga J. Kopitar (1829). Kjo dukuri mendohet të jetë një shfaqje relativisht e vonë. Formanti supozohet të jetë përftuar nga evolucioni i përemrave dëftorë përkatës. Një studim më të plotë për dukurinë në fjalë në gjuhët e Ballkanit jepet nga studiuesi B. Bokshi (Bokshi 2008).

Dukuri tjetër tipike ballkanike që ekziston edhe tek dy gjuhët qendrore shqip e rumanisht është edhe formimi i kohës së ardhme analitike me anë të foljes ndihmëse “dua” të trajtë të nguros. Edhe pse i quajtur ballkanik, tipari gjuhësor i kalon përmasat e këtij areali. Format analitike të së ardhmes në shqip shprehen me format e tashme të mënyrës lidhore të prira nga folja ndihmëse e nguros *do: do të punoj*. Edhe në rumanisht ndërtimi i kohës së ardhme analitike realizohet me anë të së njëjtës folje ndihmëse *dua: voi lucra*. S. Poçi në një studimin e saj jep edhe gjegjëset e këtyre formave edhe në arumanisht (Poçi 2012: 271- 272). Në një trajtim të detajuar të kësaj forme në gjuhët ballkanike, Bokshi mendon se protoshqipja ka pasur një futur sintetik me prapashtesë *-syo qysh para kontaktit të saj me greqishten (Bokshi 2012).

Përkim ballkanik midis shqipes e rumanishtes është edhe në fjalëformat e njëjta të numërorëve të përngjitur 11- 19. Midis numrit të vogël 1-9 dhe dhjetëshes ndërfitet në parafjalë *mbë< mbi* në shqip dhe *spre< super* në rumanisht si: *një-mbë-dhjetë, dy-mbë-dhjetë* etj. dhe në rumanisht: *un-spre-zece, doi-spre-zece* etj.

Kufizimi dhe zëvendësimi i paskajores në gjuhët e Ballkanit në përgjithësi me konstrukte të njëjta, është dukuri tjetër e lidhjes gjuhësore, mjaft e komentuar së fundmi në gjuhën shqipe në lidhje me statusin e përdorimit të saj. Në shqip (standard) dhe në rumanisht kjo paskajore zëvendësohet me forma identike të mënyrës lidhore (Bello 2011).

Rimarrja e kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë, është dukuria ballkanike që haset në shqip dhe në rumanisht. Pavarësisht se dukuria njihet si ballkanizëm, ajo haset edhe jashtë arealit ballkanik, në gjuhët romane perëndimore. Në rumanisht dukuria mendohet se nuk është fort e hershme (Demiraj 1994:133).

Pavarësisht asaj, që në studimet ballkanike përqendrimi më i madh i tyre ka qenë në fushë të gramatikës dhe të leksikut, nuk kanë munguar edhe ato në fushë të fonetikës. Dhe ashtu si edhe dukuritë e tjera ballkanike, i pari që ka vënë re dukuritë e përbashkëta në këtë fushë ka qenë Mikloshiç. Këtu po përmendim dukurinë më tipike ballkanike, por në veçanti në gjuhët shqip dhe

rumanisht, që është, prania e zanores ă. Në shkrimin rumun kjo dukuri dëshmohej me dy grafema ă dhe â, që përfaqësojnë përkatësisht zanoren e ngritjes së mesme dhe atë të ngritjes së lartë.

Natyrisht që përkimet ndërmjet dy gjuhëve janë edhe më shumë. Përveç evidentimit ngelet detyrë studimi edhe më i saktë i tyre, duke dhënë kronologjinë e zhvillimit të dukurisë përkatëse dhe saktësimi burimor, që për hir të së vërtetës është tepër i vështirë, referuar “mjegullnajës” që na sjell diakronia e gjuhëve të vjetra të Ballkanit.

Dukuritë e përbashkëta ndërmjet dy gjuhëve duhen parë edhe në prizmin ballkanik të tyre (ato që konsiderohen vetëm si bashkëpërkime të shqipes e rumanishtes), nëse i përkasin vetëm se dy gjuhëve, apo ekzistojnë në forma të njëjta ose të ngjashme edhe në ndonjë gjuhë ose dialekt tjetër, që të mund të bëhej edhe një klasifikim në lidhje me statusin e dukurive përkatëse.

Me interes paraqitet pjesa e bashkëpërkimeve leksikore në shqip dhe në rumanisht. Këto studime, ashtu siç janë kryer, duhen shtrirë në diakroni të thellë të historisë së gjuhëve përkatëse, duke bërë edhe një farë periodizimi të tyre në shtresa të ndryshme kohore, paralatine, latine, bizantine, sllave, turke e deri në ditët tona.

Pavarësisht studimeve të shumta që janë bërë në lidhje me konkordancat gjuhësore midis shqipes e rumanishtes, mendojmë se ato nuk janë shteruese. Studimi duhet që të shtrihet edhe në nivele dialekti, duke dhënë arealin e saktë të dukurive, për të parë edhe mundësinë e përqasjes së tyre me gjuhët e tjera të bashkësisë gjuhësore ballkanike.

Studimet që të jenë më të plota dhe të argumentuar duhen të jenë multidisiplinare, pra studimet të jenë të gërshetuara edhe me shkenca të tjera shoqërore që mund të na vijnë në ndihmë si historia, arkeologjia, etnofolklori etj.

Përcaktimi dhe saktësimi objektiv i dukurive të përbashkëta në dy gjuhët që kemi marrë në shqyrtim, do të qartësonte edhe vetë historinë e këtyre gjuhëve, që na paraqitet mjaft interesante në diskutime.

REFERIME

Bello 2011: Dh. Bello. Problemi i paskajores në kontekstin ballkanik. Studime albanologjike 2011/1. Tiranë, 2011.

Bokshi 2008: B. Bokshi. Prapavendosja e nyjës në gjuhët e Ballkanit. Tiranë, 2008.

Bokshi 2012: B. Bokshi. Format e futurit të shqipes në raport me gjuhët e Ballkanit. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Prishtinë, 2012.

Brâncuș 1983: G. Brâncuș. Vocabularul autohton al limbii române. București, 1983.

Brâncuș 2009: G. Brâncuș. Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune. Tiranë, 2009.

Çabej 2008: E. Çabej. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Tiranë, 2008.

Demiraj 1973: Sh. Demiraj. Rreth ndërrimit të emrave në shumës në gjuhën shqipe, vështuar në përqasje me rumanishten. Studime rreth historisë së gjuhës shqipe. Tiranë, 1973.

Demiraj 1994: Sh. Demiraj. Gjuhësi ballkanike. Shkup, 1994.

Gashi 2012: S. Gashi. Gjurmë të latinitetit dhe të romanitetit ballkanik në mikrotoponiminë e Kosovës. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Prishtinë, 2012.

Ismajli 2012: R. Ismajli. Shqipja dhe rumanishtja. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Prishtinë, 2012.

Kyçyku 1999: K. Kyçyku. Arumunët e Shqipërisë në kontekstin ballkanik. Bukuresht, 1999.

Poçi 2011: S. Poçi. Përkime e paralelizma te format foljore në shqipe, rumanisht, arumanisht.

Russu 1970: I. I. Russu. Elemente autohtone în limba română. București, 1970.

MOMENTI “VOSKOPOJË” NË HISTORINË E MARRËDHËNIEVE GJUHËSORE RUMUNO-SHQIPTARE

Prof. Nikolae Saramandu (PhD)

Institutul de Lingvistică “Iorgu Iordan-Al. Rosetti”
Academia Română

Të dhënat e para mbi marrëdhëniet ndërmjet gjuhës shqipe dhe asaj rumune i gjejmë në një tekst të shkurtër, i cili daton nga viti 1731 dhe për të cilin i detyrohem murgut-prift me origjinë arumune Nektarie Tërpu¹. Bëhet fjalë për një mbishkrim mbi një gravurë druri, i zbuluar në vitin 1950 në manastirin e Ardenicës pranë qytetit Fier (ar. *Fearicã*), i cili përshkruhet nga Dhimitër S. Shuteriqi, në atë kohë kryetar i Lidhjes së Shkrimtareve të Shqipërisë, në një artikull të publikuar në “Buletin për shkenca shoqërore”, III (1952:14-15). Gravura, e cila paraqet virgjëreshën Mari me foshnjën Jezus në krahë, ka në njërin nga anët një tekst në arumanisht, i cili rijepet në gjuhën shqipe, greke dhe latine, të shkruara në anët e tjera të gravurës. Teksti në arumanisht është: *Viryirã Muma-l dumneđã orã trã noi pecãtoșli* “Fecioarë, mama lui Dumnezeu, roagë-te pentru noi, păcătoși”, të cilit i korrespondon në shqip teksti: *Virgjinë Mamë e perëndis uro prë ne fajtorëte*.

Ky tekst i shkurtër është një ndihmëse shumë e mirë për të bërë krahasimin ndërmjet gjuhës shqipe dhe asaj rumune. Teksti në arumanisht dhe ai në shqip përmbajnë dy fjale, ar. *viryirã, orã*, shqip. *virgjinë, uró*, të cilat na dërgojnë tek format latine: *virgo, -nis* “fecioarë” shqip. “virgjëreshë” dhe *orare* “të lutesh”, rum. “a se ruga”. Në tekstin arumanisht gjendet edhe një term tjetër me origjinë latine, *pecãtoșli*, i ridhënë në gjuhën shqipe si *fajtorëte*. *Pecãtos* është në arumanisht një derivat i fjalës *pecat (picat)* rum. “pëcat”, e cila vjen nga lat. *peccatum* (i cili ekziston në shqip, si huazim nga latinishtja, në formën *mëkat*, me derivatin *mëkatar* “pëcãtos”). Fjalës me origjinë latine në arumanisht *pecãtoșli*, i korrespondon në tekstin shqip *fajtorëte*, e cila vjen nga folja *fajtoj* “të jesh fajtor”, rum. “a fi vinovat”, e cila rrjedh nga fjala *faj* rum. “vinë, gresealë, pëcat”, term me origjinë latine (i pranishëm në gjuhët latine perëndimore: it. *faglia*, port. *falha* < lat. **fallia*, REË 3168; cf. Çabej I: 172). Si formë derivate, shqipes *fajtoj* i korrespondon folja latine *fallere* “të mashtrosh” rum. “a înșela”. *Dumneđã* nga teksti arumanisht i korrespondon në tekstin shqip *perëndi* rum. “divinitate”, “Dumnezeu”, e cila vjen nga lat. *imperantem* “ai që komandon, komandant” rum. “care comandă, comandant” (Çabej II: 17-18; cf. dhe Vătășescu 1997: 458-459), e cila rrjedh nga lat. *imperator*.

Përmendim se të gjithë termet latine që diskutohen këtu shfaqen edhe në rumanishtën e veriut të Danubit, pra në dakorumanisht: - *vergurã (vãrgurã)*, vb. *ura, pãcãtos (pãcat), împãrat* -, çka është një konstatim për mënyrën e ndërtimit të qasjeve të vjetra ndërmjet rumanishtes dhe shqipes, të cilat bazohen mbi elementin latin.

Në më pak se katër dekada nga mbishkrimi i 1731-shit, që i detyohet murgut-prift Nektarie Tërpu del në dritë teksti i parë i shtypur, në të cilin arumanishtja është e pranishme krahas shqipes, me një korpus fjalësh shumë më të gjerë. Është fjala për shkrimin e parë të publikuar në Venecia në vitin 1770 falë edhe Theodor Anastasie Kavallioti-t (Mësimi i parë), një libër leximi

për klasat fillore, i redaktuar në greqisht, i cili shoqërohet nga një fjalor prej 1770 fjalësh, në të cilin termet greke përkthehen në arumanisht dhe shqip.

Punimi i Kavalioti-t, nga i cili nuk njihet tashmë asnjë ekzemplar, na është përcjellë nga ribotime të mëvonshme, nga të cilat më të vjetrën ia detyrojmë Johann Thunmann-it. Eruditi gjerman (me origjinë suedeze) ka ribotuar më 1774 fjalorin trigjuhësh të Kavalioti-t, duke e përfshirë në veprën e tij *Über die Geschichte und Sprache der Albaner und der Eilachen* (Leipzig, 1774)². Në punimin e Thunmann, fjalori në vetvetë zë 58 faqe (p. 181-238), pjesa tjetër e librit (f. 171-180, 239-366; në total, 138 faqe) paraqet një studim të gjerë mbi historinë dhe gjuhën e rumunëve dhe shqiptarëve, i pari i këtij lloji në literaturën e specialitetit.

Duhet të përmëndim këtu se ekzemplari i Πρωτοπειρία i cili mbërriti në dorën e Johan Thunmann-it, iu dhurua këtij nga një i ri arumun me origjinë nga Voskopoja, Konstantin Haxhi Çegani, i cili kish studiuar në universitete të huaja dhe të cilin eruditi gjerman na e paraqet plot lëvdata: „Zoti Konstantin Haxhi Çegani nga Voskopoja më ka nderuar me këtë libër të rrallë: [ai është] një njëri me njohuri të shumta, sidomos në filozofi dhe matematikë, me një mendim të ndritur dhe të denjë për një fat më të lumtur. Pasi gjatë tre viteve ka qenë dy herë në këtë universitet, vizitoi Leidenin dhe Cambrixin, ka qenë në Francë dhe Itali, u kthye në atdheun e tij që me njohuritë e mara t’u shërbejë bashkëatdhëtarëve të tij. Përtej kësaj, z. Çegani më ka dhënë shumë informacion mbi arumunët dhe shqiptarët, si emrat, shtrirjen, numrin, gjuhën e tyre etj.” (Thunmann 1774: 179-180, shënim).

Nga Johann Thunmann kemi të dhënat e para për Πρωτοπειρία dhe për autorin e saj: „Libri në të cilin shfaqet kjo listë fjalësh është shtypur në Venecia në vitin 1770 tek Antoni Bortoli. Autori i saj është Theodor Kavalioti, kryepriest ose predikuesi më në zë në Voskopoje, Maqedoni. Ai është një njëri erudit, më i mësuar në popullin e tij; ka studiuar me prokopi gjuhët, filozofinë dhe matematikën. [...] Kupton dhe flet greqisht, arumanisht dhe shqip sikur gjuhën e nënës. Ka lindur në Voskopoje dhe tani është rreth 46 vjeç. Shkencat humane i ka studiuar në qytetin e lindjes [...] ndërsa matematikën në Janinë [...]. Ka shkruar mbi të gjitha shkencat filozofike, por nuk është shtypur asgjë” (Thunmann 1774: 177-178 dhe shënimimi nga faqja 178).

Duke ribotuar fjalorin trigjuhësh të Th. Kavalioti-t, Johann Thunmann ka shtuar një kolonë shumë të rëndësishme me termet të përkthyer në latinisht, të cilat nga njëra anë theksojnë origjinën rumune të arumanishtës, ndërsa nga ana tjetër japin mundësinë e krahasimit me shqipen, mbi bazën e elementit latin. Sa i përket elementit latin, është surprizues fakti se nga 1170 fjalët e përfshira në fjalor, mbi 650 fjale arumune janë me origjinë latine, çka do të thotë një përqindje mbi 50% (afërsisht 56%). Thunmanni vetë e ka bërë këtë llogaritje mbi bazën e fjalorit të Kavalioti-t: në gjuhën e rumunëve në jug të Danubit 50% e fjalëve janë latine: “die Hälfte derselben [Sprache] (ich habe nachgezählt) ist Lateinisch” (Thunmann 1774:339). Është interesant të shenjohet fakti se një përqindje gati e njëjtë regjistrohet për fjalët me origjinë latine në arumanisht në *Lexiconul in patru limbi* (shqip. “Leksikoni në katër gjuhë”) (Λεξικόν Τετράλωσσον, i Daniil Moskopoleanu-t, i shtypur në Venecia në 1794: nga 1072 fjalët arumune, 586 janë me origjinë latine, pra afërsisht 55% (cf. Brënkush 1992:40).

Nga fjalet me origjinë latine, për të cilat Johann Thunmann jep variantin në arumanisht dhe shqip, përmëdim:

(8) ar. *sămtu*, shqip. *shent* [*i shënjtë, i shentjë*] (< lat. *sanctus*) (cf. Vëtëshesku 1997: 470); dakorumun. *sânt*.

(36) ar. *râ'ă*, shqip. *reze* [*rreze*] (< lat. **radia* [= *radius*]) (cf. Çabej II: 93; mungon tek Vëtëshesku 1997); dr. *rază*.

(46) ar. *cal*, shqip. *kalë, kali* (< lat. *caballus*; la Thunmam, s. v. *equus*) (cf. Vëtëshesku 1997: 199); dr. *cal*.

(60) ar. *nepótu* shqip. *nip* (< lat. *nepos, -tis*; la Thunmam, s. v. *consobrinus*) (cf. Vëtëshesku 1997: 106); dr. *nepot*.

(63) ar. *pûlpă*, shqip. *pulpë* (< lat. *pulpa*; la Thunmam, s. v. *sura*) (cf. Vëtëshesku 1997: 37); dr. *pulpă*.

(72) ar. *númeru*, shqip. *numur* [*numër*] (< lat. *numerus*) (cf. Çabej I: 384, Vëtëshesku 1997: 229); dr. *număr*.

(81) ar. *máscuru*, shqip. *mashkull* (< lat. *masculus*; la Thunmam, s. v. *mas*) (cf. Vëtëshesku 1997: 19); dr. *mascur*.

(106) ar. *fúndu*, shqip. *fund* (< lat. *fundus*; la Thunmam, s. v. *profunditas*) (cf. Vëtëshesku 1997: 149, 226, 271); dr. *fund*.

(169) ar. *sănătos*, shqip. *shëndoshë* (< lat. *sanitosus*; la Thunmam, s. v. *sanus*) (cf. Vëtëshesku 1997: 70); dr. *sănătos*.

Është për t'u shenjuar fakti se të gjithë termat e përmëndur gjenden edhe në dakorumanisht, më të shumtit prej tyre gjenden edhe në dialektet e tjera rumune: *cal*, *fund*, *nepot*, *număr* (në meglenorumanisht dhe istrorumanisht), *mascur*, *săm(t)* dhe *sănătos* (në meglenorumanisht), *pupă* [= *pulpă*] (në istrorumanisht).

Nga fjalët e përbashkëta të shqipës, të cilat rumanishtja i ka trashëguar nga nënshtresa autoktone, përmëdim:

(9) dr. *ghimpe*, alb. *gjep* [*gjemb*], i mbajtur vetëm në dakorumanishte; ar. *skinu* (< lat. *spinus*) (cf. Brënkush 1983: 78–79).

(109) ar. *bag* (ndoshta autokton); cf. alb. vë, gr. βάζω.

(298) ar. *băne'u* 'a trăi', alb. *banoj* (në arumanisht, ndoshta huazim nga shqip).

(520) ar. ma'ăre, alb. *modhul* (Brënkush 1983: 93–94).

(521) ar. *gruma'u*, alb. *gurmaz* (Brënkush 1983: 84–85).

ar. *gușă*, alb. *gushë* (Brënkush 1983: 84–85).

Për shqip, Thunmann dha *kiafă* [qafë], me korrespondente në dr. *ceafă*.

(522) ar. *groapă*, alb. *gropë* (Brënkush 1983: 47–48).

(546) ar. *baltă*, alb. *baltë* (Brënkush 1983: 35–37).

(707) ar. *năpărtică* 'vipëră', alb. *nepërkë* (Brënkush 1983: 104–105).

(797) ar. *bască*, 'lână tunsă de pe o oaie', alb. *bashkë* (Brënkush 1983: 40–41).

(994) ar. *țalpă* 'urdoare', alb. *gjalpë* 'unt' (cf. Saramandu 1987: 126 ş. u.).

Si në rastin e fjaleve të trashëguara nga latinishtja, konstatojmë se në rastin e termave me prejardhje nga nënshtresa, që gjenden ose në të gjitha dialektet (*baltă, groapă, gușă*), ose në disa prej tyre: në dakorumanisht, arumanisht dhe meglenorumanisht (*bască, mazăre, năpârcă*) ose në dakorumanisht dhe arumanisht (*grumaz*). Dy terma shfaqen vetëm në dakorumanisht (*ceafă* și *ghimpe*), ndërsa njëri vetëm në arumanisht (*talpă*).

Jam fokusuar në punimin e Johann Thunmann për shumë arsye. Së pari, evidentojmë faktin se, nëpërmjet tij hyn në qarkun shkencor perëndimor më i rëndësishmi nga dialektet rumune nëdanubiane, arumanishtja, për të cilën autori dëshmon se “...sipas njohurive të mia, përpara fjalorit të cilin jua prezantoj [i Th. Kavallioti-t], nuk dihej asgjë” (Thunmann 1774: 177). Arumunët, të cilët Johann Thunmann i quan *Thracische Ėlachen*, flasin të njëjtën gjuhë me vëllezërit e tyre në veri të Danubit (*Dacische Ėlachen*) (cf. Thunmann 1774:176, shënim): “Sie reden eben dieselbe Sprache, als ihre Brüder diesseits der Donau” (Thunmann 1774: 174). Përtej rëndësisë që ka për studimin e gjuhës rumune dhe për rumanistikën në përgjithësi, punimi i Johann Thunmann gjendet në themelin e studimeve të mëvonshme për nënshtresën, përputhjet gjuhësore ballkanike, elementin e përbashkët latin të rumanishtes dhe shqipës etj. Johann Thunmann formulon për herë të parë *teorinë e vazhdimësisë* të rumunëve dhe të shqiptarëve në territoret ku jetojnë, pikëpamje e cila u imponua. U imponua gjithashtu teoria e nënshtresës (gjuhësore), e bazuar mbi krahasimin ndërmjet rumanishtes dhe shqipes, në studimin e përputhjeve gjuhësore ballkanike u shtua më vonë edhe bullgarishtja (Kopitar 1829) dhe greqishtja (Miklosich 1861).

Franz Miklosich ishte i pari që paraqiti shumicën e këtyre përputhjeve nga të cilat përmëndim: (1) praninë e zanores *ă* (*ë*) në shqip, rumanisht dhe bullgarisht; (2) mbaresa lidhëse (e prapavendosur) në shqip, rumanisht dhe bullgarisht; (3) mungesa e infinitivit në shqip, bullgarisht dhe greqisht dhe zëvendësimi i saj me lidhoren (në rumanisht, pjesërisht); (4) ngatërimi i gjinore me dhanoren në shqip, rumanisht, bullgarisht dhe greqisht; (5) formimi i kohës së ardhme me ndihmësin *a vrea* (shqip. tosk. *do të*) në rumanisht, greqisht, bullgarisht dhe shqip (dialekti tosk); (6) formimi i numërorit themelor nga 11 deri në 19 sipas tipit *unus super decem* në shqip, rumanisht dhe bullgarisht. Këtyre ngjashmërive u shtohen disa veçori të përbashkëta vetëm për rumanishten dhe shqipen, ndër të cilat përmëndim rotacizmin (dialekti tosk i shqipes dhe dialekti i rumanishtes).

Një tjetër erudit arumun me prejardhje nga mjedisi kulturor voskopojar i epokës – fundi i shekullit të XVIII-të - është Danil Moskopoleanul (Danil Voskopojari) emri i plotë: Daniil Mihali Haxhi Moskopoleanul, autor i një libri leximi me përmbajtje fetare, të shkruar me greqisht, Εισαγωγική διδασκαλία [Mësime fillëstare], e shtypur në Venecia në vitin 1794, cili ka në fund të tij një liberth bashkëbisedimesh në greqisht, arumanisht, bullgarisht dhe shqip (Λεξικὸν Τετραγλωσσον)³. Vlen për t’u përmëndur fakti se arumanishtja nuk quhet Βλάχικα, ashtu siç përmëndet nga Kavallioti. Daniil saktëson që në titullin e punimit të tij se po përkthen tekstin në greqisht “τον Μοισία Βλάχικáj”, dmth në “rumanishtën e Moesias”, rum. “româna din Moesia”, çka sugjeron unitetin gjuhësor ndërmjet arumanishtes dhe dakorumanishtes, i cili përfaqëson një gjuhë të vetme. Si në rastin e punimit të Kavallioti-t, të ripublikuar më vonë, u

ripublikua edhe vepra e Daniil-it, nga anglezi Ëilliam Martin Leake, në *Researches in Greece* (Londer, 1814), nga Franz Miklosich, në *Rumunische Untersuchungen*, vol. I, 2 (Vienë, 1882) dhe nga P. Papahaxhi, në *Shkrimtarë arumune në shekullin e XVIII* (Bukuresht, 1909)⁴.

Rëndësia e punimit të Daniil Moskopoleanul është nënvizuar, ndër të tjerë, nga Th. Kapidan: “Rëndësia e punës së Daniil-it për njohjen e dialektit arumun, por edhe të gjuhëve të tjera ballkanike, shqipes dhe bullgarishtes, është shumë e madhe. Asgjëkund në shkrimet dialektale arumune nuk hasim një ndërtim frazë aq të lirë sa në librin e Daniil-it. Në cilësinë e arumunit, i cili e njihnte mirë dialektin, ai shkruante i pandikuar nga gjuhët e tjera” (Kapidan 1932: 53). Prof. Grigore Brënkush ka studiuar *Lexiconul* (shqip. Leksikonin) e Daniil Voskopojarit, duke e konsideruar “... njërin nga monumentet më të vjetër dhe më të rëndësishëm të gjuhës rumune në jug të Danubit” (Brënkush 1992: 43). Duke analizuar strukturën etimologjike të leksikut arumun, prof. Grigore Brënkush konstaton se nga 1072 njësitë leksikore që paraqiten në Leksikon, 586 (dmth. afërsisht 55%) janë me origjinë latine (përqindje e gati e njëjtë me atë që konstatuam tek Th. Kavallioti, 56%; shih më lart, f. 2).

Këtu përmendim dhe punimin e tretë që i përkët një autori me prejardhje nga mjedisi kulturor voskopojar nga gjysma e dytë e shekullit XVIII. Është fjala për Konstantin Ukuta, autorin e Νέα Παιδαγωγία [Pedagogjia e re], me nëntitullin (në origjinal, greqisht) “Abetare e kollajtë për t’u mësuar fëmijëve librin romano-vllah për përdorimin e përditshëm të romano-vllehtëve”, punim i shtypur në 1797 në Vjenë, në shtypshkronjën e markezëve Puliu, me origjinë arumune (cf. Kapidan 1932: 61). Konstantin Ukuta e shkroi abeteren me qëllimin e shpallur për t’u mësuar fëmijëve arumune gjuhën amtare: “Pranojë këtë pak dritë, për të mirën e fëmijëve tanë, se prej kohësh të kish marrë malli të shihje këtë fillesë në farën tonë, që në mënyrë sa më të lehtë të kuptojnë fëmijët tanë atë çka me plot kohë të humbur dhe me vështirësi shumë e kuptojnë në tjetër gjuhë” (cf. Papahaxhi 1909: 65; Kapidan 1932: 61). Është interesantë të pikasim që Ukuta nuk i quan më *vlahi* arumunët (ndërsa ligjerimin e tyre, *vlahica*, sikurse bën Kavallioti) apo *vlahi din Moesia* (shqip. vllehtë nga Moesia), siç i përmend Daniil, por *romano-vlahi*, emërtim nëpërmjet të cilit për të parën herë, del qartë në pah romaniteti i tyre. Në kohën kur shkroi punimin e tij K. Ukuta ishte hartofilax dhe kryepriift në Posen (Prusia Lindore) dhe presupozohet se ishte informuar nga qarqe intelektuale të Austro-Hungarisë (Ukuta shtypte punimin e tij në Vjenë, ku ekzistonte një koloni arumune) apo nëpërmjet qasjes se drejtpërdrejtë me folësit e gjuhës rumune, sa i përket unitetit të origjinës dhe gjuhës ndërmjet rumunëve veri- dhe jug-danubiane⁵. Pak kohë pas Ukuta-s, George Konstantin Rozha publikon në Pesta, në 1808-ën, në gjuhën gjermane një studim mbi historinë e arumunëve, të cilët i quan rumunë (gjerm. *Romanier*)⁶.

Në shekullin e XIX, në Rumani, grumbullimi i shpejtë i njohurive mbi historinë e dy popujve, rumun dhe shqiptar, por edhe mbi gjuhët e tyre, ndër të tjera ka ndikuar në shfaqjen e studimeve të para mbi marrëdhëniet rumuno-shqiptare. Këto studime kanë një traditë prej një shekulli e gjysmë, duke filluar me studimin e B. P. Hasdeu, në 1860-ën, të titulluar plot kuptim *Perit-au dacii?* (shqip. A humbën vallë dakët?)⁷ dhe me shumë studime të tjera të të njëjtit autor, nga të cilat përmendim *Strat și substrat* (shqip. Shtresë dhe nënshtresë), *Genealogia popoarelor*

balcanice (shqip. Gjenealogjia e popujve ballkanike, 1891-1892)⁸ ose *Cine sunt albanezii?* (shqip. *Cilët janë shqiptarët?*, 1901)⁹. Kërkimet kanë vazhduar me kontributin e shumë gjuhëtarëve dhe historianëve, ndër të cilët Ovid Densushianu, Perikle Papahaxhi, Sekstil Pushkariu, Th. Kapidan, Al. Philippide, I. -A. Kandrea, Al. Rosetti, I. I. Russu, H. Mihëesku, K. Pogirk, Gr. Brënkush, N. Saramandu, K. Vëtëshesku. Në ditët e sotme, specialist i mirënjohur është prof. Grigore Brënkush, i cili përgjatë më shumë se tre dekadave ka publikuar kontribute të rëndësishme sa i përket ngjashmërive ndërmjet gjuhës rumune dhe shqipe, duke filluar me shkrimin e njohur sintezë, *Vocabularul autohton al limbii române* (shqip. Fjalori autokton i gjuhës rumune, 1983) dhe duke vazhduar me shumë punime të tjera (artikuj, volume), nga të cilat përmendim *Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române* (shqip. Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune, 1995), *Concordanțe lingvistice româno-albaneze* (shqip. Ngjashmëri gjuhësore rumuno-shqiptare, 1999), *Studii de istorie a limbii române* (shqip. Studime mbi historinë e gjuhës rumune, I-II, 2007/2008). Vëmë re faktin se në studimet e tij, prof. Grigore Brënkush ndoqi përafrimet rumuno-shqiptare në të gjitha fushat e gjuhës: fjalor, fonetikë, morfologji, sintaksë, frazeologji. Në këtë drejtim prof. Grigore Brënkush vazhdon pazgjidhmërisht drejtimin kërkimor të inauguruar nga paraardhësi i tij i shkëlqyer B. P. Hasdeu, *Cine sunt albanezii?* (shqip. *Cilët janë shqiptarët?*, 1901) dëfton: “Identiteti gjuhësor shqiptaro-rumun është dytësor sipas meje, në krahasim me atë gramatikor. Karakteristike janë sidomos pikëpjekjet ndër rumunë dhe shqiptarë jo nëpërmjet fjalorit, por nëpërmjet veçorive fonetike, morfologjike dhe sintaksore, të cilat përkundër çdo hipotezë nuk mund të huazohen nga të huajt, nuk mund të shprishen nga rrjedha e kohës, por gjallojnë që nga vetë origjina e botës” (Hasdeu 1901; cituar nga B. P. Hasdeu, 1988: 470), Vetëm nëpërmjet një origjine të përbashkët dhe një bashkëjetese intime, gjithashtu, mund të shpjegohet natyra organike parësore e lidhjeve midis gjuhëve shqipe dhe rumune” (B. P. Hasdeu, 1988:469).

Lejomëni të përmbyll në të njëjtën mënyre, me citate nga dy autorë që gëzojnë autoritetin më të madh në Shqipëri dhe Rumani, sa u përket studimeve linguistike rumuno-shqiptare, Eqerem Çabej dhe Grigore Brënkush: “Çdo kërkim në një periudhë më të vjetër të gjuhës shqipe çon me domosdoshmëri në raportimin te gjuhët e tjera ballkanike. Midis tyre vendin e parë e zë, pa dyshim, gjuha rumune. Shqipja dhe rumanishtja dëshmojnë lidhje të ngushta në fushën e fonetikës, morfologjisë, të fjalorit, të formimit të fjalëve, të sintaksës dhe frazeologjisë, të thënieve dhe shprehjeve të urta, derisa – pa lënë menjanë ndryshimet – shumë shpesh ke ndjesinë që është fjala për të njëjtin shpirt gjuhë, që shfaqet në dy forma” (Çabej 1959: 531).

“Qëllimi ynë ka qenë të nxjerrim në dritë [...] “mrekullinë” e vëllazërisë origjinale të këtyre dy gjuhëve dhe për rrjedhojë afërsinë e lashtë shpirtërore të popullit rumun dhe shqiptar”. (Brënkush 1999: 7).

REFERIME

- Brënkush 1967 – Gr. Brënkush, *Elemente lexicale autohtone în dialectul aromân*, (shqip. *Elemente gjuhësore autoktone në dialektin arumun*), në “Studii şi cercetări lingvistice” (shqip. Studime dhe kërkime gjuhësore), XVIII, 1967, nr. 5, fq. 491–505; i republikuar në volumin *Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române* (shqip. *Kërkime mbi fondin thrako-dak të gjuhës rumune*), Bucureşti, Institutul român de tracologie (shqip. Instituti rumun i thrakologjise), 1995, f. 51–66.
- Brënkush 1982 – Gr. Brënkush, *Observaţii asupra structurii vocabularului aromân în Dicţionarul lui Daniil Moscopoleanul* (shqip. *Vëzhgime mbi strukturën e fjalorit arumun në Fjalorin e Danil Voskopojarit*), në “Studii şi cercetări lingvistice” (shqip. Studime dhe kërkime gjuhësore), XLIII, 1992, nr. 1, fq. 39–43; republikuar në vol. *Studii de istorie a limbii române* (shqip. *Studime të historisë së gjuhës rumune*), I, Bucureşti, Editura Academiei Române, 2007, p. 99–103.
- Brënkush 1983 – Gr. Brënkush, *Vocabularul autohton al limbii române* (shqip. *Fjalori autokton i gjuhës rumune*), Editura Ştiinţifică şi Enciclopedică, 1983.
- Brënkush 2003–2004 – Gr. Brënkush, *Evoluţia lexicului latin în aromână* (shqip. *Zhvillimi i leksikut latin në arumanisht*), në „Fonetikë şi dialectologie” (shqip. Fonetikë dhe dialektologji), XXII–XXIII, 2003–2004, fq. 37–45; republikuar në vol. *Studii de istorie a limbii române* (shqip. *Studime historike të gjuhës rumune*), I, Bucureşti, Editura Academiei Române, 2007, p. 91–98.
- Brënkush 2009 – Gr. Brënkush, *Raporturi lingvistice aromâno-albaneze* (shqip. *Marrëdhënie gjuhësore arumuno-shqiptare*), në vol. „Luçrările celui de al doilea Simpozion internaţional de lingvistikë” (shqip. Punime të Simpoziumit të dytë ndërkombëtar të gjuhësisë), Bucureşti, Editura Universităţii, 2009, p. 11–20.
- Brënkush 2012 – Gr. Brënkush, *Atlasul dialectal al limbii albaneze. Elemente comune cu româna*, în „Fonetikë şi dialectologie”, XXXI, 2012, p. 5–19.
- Çabej 1959 – Eqerem Çabej, *Unele probleme ale istoriei limbii albaneze* (shqip. *Disa probleme të historisë së gjuhës shqipe*), në „Studii şi cercetări lingvistice” (shqip. Studime dhe kërkime gjuhësore), X, 1959, nr. 4, p. 527–560.
- Çabej 1976 – Eqerem Çabej, *Zur aromunischen Eörtforschung* (shqip. *Kërkime mbi fjalet arumune*), în „Studii şi cercetări lingvistice” (shqip. Studime dhe kërkime shkencore), XXVII, 1976, nr. 1.
- Çabej I, II – Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, I, II, Prishtinë, Rilindja, 1976.
- Drimba 1955 – V. Drimba, *Asupra unui text aromân din anul 1731* (shqip. *Mbi nje tekst arumun të vitit 1731*), în „Studii şi cercetări lingvistice” (shqip. Studime dhe kërkime gjuhësore), VI, 1955, nr. 3–4, p. 341–345.
- Hetzer 1981 – Armin Hetzer (ed.), *Das dreisprachige Eörterverzeichnis von Theodoros Anastasiu Kavalliotis* (shqip. *Fjalori trigjuhësh i Theodor Anastasie Kavallioti*), Hamburg, Helmut Buske Verlag, 1981.
- Kapidan 1922 – Th. Kapidan, *Raporturile albano-române* (shqip. *Marrëdhëniet shqiptaro-rumune*), Cluj, Editura Institutului de Arte Grafice «Ardealul», 1922 (marrë nga „Dacoromania”, II).

- Kapidan 1931 – Th. Kapidan, *Färşeroŋii. Studiu lingvistic asupra românilor din Albania (shqip. Fërsherotët. Studim gjuhësor mbi arumunët e Shqipërisë)*, Bucureşti, Cartea Românească, 1931 (marre nga „Dacoromania”, V)
- Kapidan 1932 – Th. Kapidan, *Aromânii. Dialectul aromân (shqip. Arumunët. Dialekti Arumun)*, Bucureşti, Imprimeria Naţională, 1932.
- Kopitar 1829 – B. Kopitar, *Albanische, äalachische und bulgarische Sprache (shqip. Gjuha shqipe, vllehe dhe bullgare)*, in „Eiener Jahrbücher der Literatur” (Vjetari Vjenez i Letërsisë), vol. 46, 1829, p. 59–106.
- Lafe & Lafe 2010 – Emil Lafe, Gene Lafe, *I rapporti linguistici rumeno-albanesi nella visione di Grigore Brancu (shqip. Marrëdhëniet gjuhësore rumuno-shqiptare në vizionin e Grigore Brënkush-it)*, në vol. „Studii de limba română. Omagiu profesorului Grigore Brënkush” (shqip. Studime të gjuhës rumune. Homazh profesorit Grigore Brënkush), Editura Universităţii, Bucureşti, 2010, p. 115–120.
- Lloshi 2000 – Xhervat Lloshi, *Albanian Dictionaries and D. Moskopoulitis „Lexicon Tetraglosson” (shqip. Fjaloret shqiptare dhe „Leksikoni trigjuhësh” i D. Voskopjarit)*, în Christos Tzitzoulis, Charalambos Symeonidis (eds.), „Βαλκανική Γλωσσολογία. Συγχρονία και Διαχρονία. Balkanlinguistik. Synchronie und Diachronie” (shqip. Gjuhet ballkanike. Sinkroni dhe Diakroni), Thessaloniki, 2000, p. 151–157.
- Mihăescu 1993 – H. Mihăescu, *La romanité dans le sud-est de l’Europe (shqip. Romaniteti në jug-lindjen e Europës)*, Bucureşti, Editura Academiei Române, 1993.
- Miklosich 1861 – Franz Miklosich, *Die slavischen Elemente im Rumunischen (shqip. Elementet sllave në rumanisht)*, Viena, 1861.
- Papahaxhi 1909 – Per. Papahaxhi, *Scrîitori aromâni în secolul al XVIII-lea (Kavalioti, Ucuta, Daniil) (shqip. Shkrimtarëarumunë të shek. XVIII-të (Kavalioti, Ukuta, Daniil))*, Bucureşti, Institutul de Arte Grafice «Carol Göbl», 1909.
- Peyfuss 1974 – Max Demeter Peyfuss, *Die aromunische Frage (shqip. Pikëpyetja arumune)*, Eien/Köln/Graz, Herman Böhlau Nachf., 1974.
- Peyfuss 1989 – Max Demeter Peyfuss, *Die Druckerei von Moschopolis (shqip. Shtypshkronja e Voskopojës)*, 1731–1769, Eien/Köln, Böhlau, Verlag, 1989.
- Poghirc 1969 – Ç. Pogiric, *Influența autohtonă, în Istoria limbii române (shqip. Ndikimi autokton në Historinë e gjuhës rumune)*, II, Bucureşti, Editura Academiei, 1969, p. 313–365.
- Russu 1981 – I. I. Russu, *Etnogeneza românilor (shqip. Etnogjeneza e rumunëve)*, Bucureşti, Editura Ştiinţifică şi Enciclopedică, 1981.
- Saramandu 1972 – Nikolae Saramandu, *Cercetări asupra aromânei vorbite în Dobrogea (shqip. Kërkime mbi arumanishten e folur në Dobroxhea)*, Bucureşti, Editura Academiei, 1972.
- Saramandu 1987 – Nikolae Saramandu, *Concordanțe etimologice și lexicale româno-albaneze (shqip. Përputhje etimologjike dhe gjuhësore rumuno-shqiptare)*, în „Studii şi cercetări lingvistice” (shqip. Studime dhe kërkime gjuhësore), XXXVIII, 1987, nr. 2, p. 126–141.

Saramandu 1991 – Nikolae Saramandu, *Probleme ale studierii substratului aromânei* (shqip. *Probleme të studimit të nënshtresës arumune*), în „Studii şi cercetări lingvistice” (shqip. Studime dhe kërkime gjuhësore), XLII, 1991, nr. 3–4, p. 119–123.

Saramandu 1996 – Nikolae Saramandu, *Romano-balcanica. Flexiunea de gen a numeralului **trei** în aromână* (shqip. *Romano-ballkanika. Ndryshimi i gjinisë i numërorit **tre** në arumanisht*), în „Studii şi cercetări lingvistice” (shqip. Studime dhe kërkime gjuhësore), XLVII, 1996, nr. 1–6, p. 207–215.

Saramandu 1998 – Nikolae Saramandu, *Les rapports entre le thrace-dace et les anciennes langues européennes (sur les données de l'Atlas Linguarum Europae)* (shqip. *Marrëdhëniet thrako-dakasë dhe gjuhët e lashta europiane*), în „The Thracian Eordl at the Crossroads of Civilizations” (shqip. Bota thrakase në udhëkryqet e civilizimeve), vol. II, Bucureşti, 1998, p. 673–678.

Saramandu 2010 – Nikolae Saramandu, *Concordanțe lingvistice româno-albaneze* (shqip. *Përputhje etimologjike dhe gjuhësore rumuno-shqiptare*), në vol. „Studii de limba română. Omagiu profesorului Grigore Brâncuş” (shqip. Studime të gjuhës rumune. Homazh profesorit Grigore Brënkush), Bucureşti, Editura Universităţii, 2010, p. 203–208.

Thunmann 1774 – Johann Thunmann, *Über die Geschichte und Sprache der Albaner und der Elachen* (shqip. *Mbi historinë dhe gjuhën shqipe e atë vllehe*), în vol. „Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker” (shqip. Studime mbi popujt e Europës Lindore), 1. Theil, Leipzig, 1774, p. 169–366.

Vëtëshesku 1997 – Këtëlina Vëtëshesku, *Vocabularul de origine latină din limba albaneză în comparație cu româna* (shqip. *Fjalori me origjinë latine nga gjuha shqipe i krahasuar me rumanishtën*), Bucureşti, 1997.

SHËNIME

Është e sigurt se Nektarie Tërpu ishte arumun me origjinë nga Voskopoja” (Drimba 1955:342). Autori e merr informacionin nga Per. Papahaxhi: shumë burra të mësuar e morrën fluturimin nga ky qytet i lulëzuar [Voskopojë]” (Papahaxhi 1909: 10; shiko edhe shënimin 6 tek faqja 11).

Punimi I Johann Thunmann-it ka dalë në volumin *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker*, Erster Theil, Leipzig, 1774, p. 169–366.

Ky punim është ribotuar në vitin 1802.

Shkrimi i Daniilit, i cili u përdor si fjalor bashkëbisedimi, ka njohur edhe disa ripublikime të pjesshme në shekullin e XIX-të, për shembull vetëm të tekstit në gjuhën greke dhe bullgare (cf. Kapidan 1932:54).

Th. Kapidan konsideron se është e mundur që Ukuta të ketë pasur dijeni sa i përket punimit të Thunmann-it”Ka mundësi që zotëria e tij të marrë nën konsideratë veprën historike të Thunmann-it, në të cilën për të parën herë flitet për romanitetin e arumuneve. Kjo duket nga fakti si Ukuta nuk i quan më arumunët si “Vlahi din Misia”, , shqip. Vllehet e Misias”, por “Romano-Vlahi”, , shqip. “Romano-Vllehë”. Ky emër i ri, shfaqet sikurse e pamë që në kopertinë: femijët “Romano-Vllehë” të mësojnë “libër romano-vlleh” (Kapidan 1932: 61-63)

George Konstantin Rozha, *Untersuchungen über die Romanier order sogenannten Ëlachen, ëelche jenseits der Donau ëohnen* [Kërkime mbi rumunët ose të ashtuquajturit vllëhëe që jetojnë përtej Danubit], Pesta, 1808.

B. P. Hasdeu, *Perit-au dacii?* (shqip. *A humbën valle dakët?*), dhe në , *Flete historie dhe letërsie*”, Iash, 1860, nr. II-V (prill-korrik).

B. P. Hasdeu, *Strat și Substrat* (shqip. *Shtresë dhe Nënshtrësë*), *Genealogia popoarelor balcanice* (shqip. *Gjenealogjia e popujve ballkanike*), në , *Analele Academiei Române*”, , , shqip. *Analet e Akademisë Rumune*”, seria II, tom XIV, 1891-1892, f. 225-261.

²⁹ B. P. Hasdeu, *Cine sunt albanezii?* (shqip. *Cilët janë shqipëtarët?*), në “*Analet e Akademisë Rumune*”, seria II, tom XXIII, 1901, f. 103-113.

²⁹ Një përmbledhje të arritjeve në hulumtimin e këtij problemi ka dhënë tani së fundi Rexhep Ismajli; shih: *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Konferencë shkencore e mbajtur më 10–11 nëntor në Prishtinë*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Prishtinë, 2012, f. 185–215.

FAQE NGA BASHKËPUNIMI I GJUHËTARËVE SHQIPTARË ME GJUHËTARËT RUMUNË

Prof. dr. Emil Lafe

Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Është e njohur se Rumania ka qenë një vend mikpritës për shqiptarët, sidomos që nga shek. XIX dhe vijon të mbetet i tillë. Kjo ka krijuar një atmosferë miqësie e mirëkuptimi, që u zhvillua edhe më shumë në gjysmën e dytë të shek. XX, kur Rumania u bë atdheu universitar i qindra të rinjve shqiptarë, disa prej të cilëve janë tashmë figura të njohura të jetës intelektuale në Shqipëri. Në këtë kuadër të përgjithshëm spikatin marrëdhënie bashkëpunimi shkencor edhe në fushën e gjuhësisë. Ato janë ushqyer nga problematika shkencore komplekse dhe plot enigma e kontakteve ndërmjet shqipes e rumanishtes në shekujt e mesjetës së hershme, nga roli i tyre qendror në Lidhjen gjuhësore ballkanike, nga ngjashmëritë në strukturën fonetike e gramatikore.

Përfshirja e shqipes në rrethin e studimeve të gjuhësisë rumune lidhet edhe me një numër jo të vogël fjalësh të lashta të përbashkëta, që sipas studiuesve të ndryshëm shkojnë nga rreth 70 në rreth 100. Këto janë fjalë si *ajkë* - *alcă*, *avull* - *abur*, *bardhë* - *barză*, *flutur* - *fluture*, *gardh* - *gard*, *gropë* - *groapă*, *këlbazë* - *gălbează*, *moshë* - *moș* ("plak"), *nepërkë* - *năpîrcă*, *shkrumb* - *skrum*, *shtrungë* - *strungă* etj. Nuk do të hyj këtu në interpretimet e burimit të këtyre fjalëve dhe në dallimet e gjuhëtarëve rumunë e shqiptarë në këtë çështje.³⁰ Me rëndësi është që këto fjalë dhe disa analogji gramatikore (si nyja e prapme, që e dallon rumanishten nga gjuhët e tjera romane), do të mbeten një nyjë lidhëse e fortë ndërmjet gjuhësisë rumune dhe gjuhësisë shqiptare.

Një rol të veçantë kanë luajtur marrëdhëniet e drejtpërdrejta kolegjiale dhe fryma e një mirëkuptimi shembullor e prekës ndërmjet personaliteteve të papërsëritshme të gjuhësisë shqiptare e rumune, siç janë Aleksandër Xhuvani (188–1961), Eqrem Çabej (1908–1980), Mahir Domi (1915–2000), Shaban Demiraj (1920) dhe Iorgu Iordan (1888–1986), Alexandru Rosetti (1895–1990), Alexandru Graur (1900–1988), Emil Petrovici (1899–1968), Haralambie Mihăescu (1907–1985), Grigore Brâncuș (1929) etj.

Do ta vijoj fjalën time këtu me disa kujtime. Ishte viti shkollor 1958–1959, viti i katërt i studimeve universitare për mua në degën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Atë vit kishte ardhur në Tiranë për kualifikim në albanologji një gjuhëtar i ri rumun, Grigore Brâncuș. Ai mësonte gjuhën shqipe (nëpërmjet frëngjishtes) me prof. Lirak Dodbibën, njëkohësisht ndiqte me kursin tonë leksionet e prof. E. Çabejt (Histori e gjuhës shqipe; Fonetikë historike) dhe të prof. M. Domit (Sintaksë, Morfologji historike). Mendohej t'i kuptonte dhe të mbante shënime. Prof. Mahir Domi më ngarkoi që ta ndihmoja Grigorin për të zotëruar shqipen e folur. Dhe kështu, pasditeve rreth orës 6 takoheshim te hotel "Dajti" dhe bënim një shëtitje duke biseduar deri te sheshi i Universitetit e pastaj ktheheshim drejt sheshit "Skënderbej". Grigori kishte qejf te pinte me mua nga një raki të

³⁰ "Mbi elementet autoktone të rumanishtes" - në *Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Tiranë, 12–18 janar 1968. III*. Universiteti Shtetëror i Tiranës - Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, 1970, 127–129; shih dhe diskutimin e E. Çabejt, po aty, f. 329.

vogël te “Gastronomi” i dikurshëm në hyrje të Rrugës së Durrësit dhe aty ndaheshim e unë shkoja në mensën e studentëve aty pranë. Grigori, 9 vjet më i madh se unë, kishte kryer studimet më 1953 dhe qe asistent në katedrën e gjuhës rumune në Universitetin e Bukureshtit. Në atë kohë shef i katedrës ishte akademiku Al. Rosetti. Grigori ishte një adhurues i tij, jo vetëm për vlerat shkencore të atij dijetari. Me ato që më tregonte G. Brâncuş-i, akademiku Al. Rosetti ka qenë me të vërtetë një burrë i rrallë, vizionar, zemërgjerë, dinte t’u hapte horizont të rinjve, t’i drejtonte e t’i frymëzonte. Ishte shkencëtar me emër dhe me njohje të gjera në botën e jashtme. I vinin dendur libra nga kolegët. Al. Rosetti i kishte kaluar të gjashtëdhjetat atëherë. Bënte mbledhjen e katedrës për çështjet e zakonshme dhe pastaj u thoshte: “Më kanë ardhur këta libra, po unë tani s’kam kohë të lexoj, duhet të shkruaj. ” Librat ua ndante asistentëve sipas tematikës dhe i ngarkonte që t’i lexonin me vëmendje dhe të zhvillonin nga një informacion e diskutim në katedër. Kështu përfitonte gjithë katedra dhe këto informacione bëheshin një shkollë kualifikimi.

Akad. Al. Rosetti ka punuar shumë për ndriçimin e historisë së gjuhës rumune dhe ka botuar një varg studimesh për këtë. Në të dyja botimet e veprës së tij *Istoria limbii române* (1964–1966 në 6 vëllime dhe 1968 në një vëllim) u jep një vend të mirë lidhjeve të gjuhës shqipe me rumanishten, flet për elementet e shqipes në rumanishten, citon studime të A. Xhuvanit, E. Çabejt dhe në treguesin e fjalëve ka rreth 400 fjalë të shqipes, që i ka trajtuar gjatë veprës. Po ashtu edhe te vepra tjetër kolektive *Istoria limbii române, vëll. II* (Akademia e Shkencave e Rumanisë, 1969), ku ai është redaktor përgjegjës, krahasimet me shqipen zënë një vend të gjerë (mbi 300 fjalë). Al. Rosetti ka qenë ithtar i tezës për burimin ilir të shqipes, por edhe me një komponent trak; në këtë mes elementit ilir i njeh karakterin *kentum*, ndërsa elementit trak karakterin *satem*, duke i caktuar si shqipes, ashtu dhe rumanishtes, një vend të ndërmjetëm në këtë klasifikim dikotomik të gjuhëve indoevropiane. Në kumtesën e dërguar për Konferencën e Dytë të Studimeve Albanologjike (1968), ai shprehej për një ardhje të vonë të Shqiptarëve në viset bregdetare, nisur nga terminologjia e peshkimit dhe e lundrimit, që janë, sipas tij, të huazuara³¹; kjo i dha shkas E. Çabejt për të rishprehur qëndrimin e tij të njohur ndaj këtij argumenti dhe për të vlerësuar si më të bazuara qëndrimet e mëparshme të Al. Rosetti-t.

Ishte Al. Rosetti që e dërgoi G. Brâncuş-in në Shqipëri, ashtu siç dërgoi edhe asistentë të tjerë gjetiu, në Paris, në Padovë, në Çikago. G. Brâncuş-it i ra Tirana, por më vonë qëndroi edhe dy vjet në Amsterdam si lektor i rumanishtes. Al. Rosetti ishte me të vërtetë një “njeri gjenial”, ashtu siç e quante G. Brâncuş-i në bisedat me mua. Ai dinte mirë sa e nevojshme është njohja e shqipes dhe e gjuhësisë shqiptare, gjithashtu njohja e arumanishtes së Shqipërisë³², për një studiues të historisë së gjuhës rumune. “Investimi” i tij me G. Brâncuş-in doli mjaft i frytshëm.

G. Brâncuş-i këtu u miqësua me prof. E Çabejnë e prof. M. Domin, si dhe me prof. A. Xhuvanin. Në atë vit gjendej në Tiranë edhe një gjuhëtar gjerman, Eilfried Fiedler, asistent i M. Lambertz-it. Të dy lexonin Buzukun në transkriptimin e prof. E. Çabejt në zyrën e tij (kopja e daktilogruar për shtyp). G. Brâncuş-i qëndroi në Shqipëri deri nga fillimi i qershorit 1959; erdhi

³¹ Që më 1930 ai kishte botuar studimin *Cercetări asupra graiului românilor din Albania* (“Hulumtime mbi gjuhën e Arumunëve të Shqipërisë”). Bucureşti, 1930.

³² Shih artikullin: “Les éléments lexicaux autochtones dans le dialecte aroumain”. - *RRL* 11/1966, nr. 6, f. 549–565.

për së dyti në janar 1966, kur zhvilloi një anketim në pesë lokalitete të banuara nga arumunë, për të krahasuar elementet leksikore autoktone të arumanishtes me ato të dakorumanishtes³³.

Në shtator 1959 unë u fillova punën si asistent në katedrën e gjuhës shqipe. prof. Mahir Domi ishte në atë kohë përgjegjës i katedrës dhe përgjegjës i sektorit të gramatikës dhe dialektologjisë në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë, që zinte atëherë katin e parë të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë. Pata një fat të madh (por që nuk e kam shfrytëzuar mirë), kur prof. M. Domi, meqë nuk kishte ndonjë vend të lirë në ndonjë zyrë tjetër, më mori në zyrën ku punonte ai vetë me prof. E. Çabejnë; aty ishte edhe një tryezë me madhe e A. Xhuvanit, i cili vinte thuajse përditë dhe qëndronte rreth një orë e gjysmë (po afrohej te të 80-at atëherë). Në vitin 1955 ai kishte qenë disa javë në Rumani për pushime, si zv. kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, ishte takuar me kolegë rumunë dhe kishin lidhur miqësi e shkëmbenin përsëritje e botime. Kështu që në zyrë binte fjala për emrat e njohur të gjuhësisë rumune të asaj kohe si dhe për G. Brâncuș-in, që qe larguar me mbarimin e vitit shkollor 1958–1959.

Më 14 mars të vitit 1960 u shënu 80-vjetori i prof. A. Xhuvanit dhe me atë rast drejtorja e Institutit mori vendim që të botohej një vëllim me studime për nder të tij ose një *Festschrift*, siç quhet gjermanisht. U ngrit një redaksi dhe mua më caktuan sekretar. U përpilua një listë gjuhëtarësh nga vende të ndryshme, të cilët Instituti i ftonë që të merrnin pjesë në këtë vëllim dhe të dërgonin, mundësisht brenda tre muajsh, shkrimet e tyre. Natyrisht që pjesa më e madhe e të ftuarve do të ishin nga vendi, por meraku kryesor ishte që të sigurohej më parë bashkëpunimi i të jashtëmëve, se “ne këtu jemi!” Nga Rumania u ftuan Al. Rosetti e Al. Graur. Ata ishin edhe ndër të parët që iu përmbajtën afatit dhe dërguan artikujt e tyre frëngjisht. Artikulli i Al. Rosetit “Balcano-Romanica” bën fjalë për reflektimin e grupeve latine *ct* e *cs* në rumanishte dhe për interpretimin e fjalës *trake isko*; artikulli i Al. Graurit titullohet “Mbi një tip formulash të rimuara” (si p. sh. *cigă-migă* “lodër fëmijësh; gjë pa vlerë”, khs. shqip *xhingla-mingla*). Ky vëllim, që ishte menduar të dilte në vitin e 80-vjetorit të lindjes së A. Xhuvanit, pati një odise më vete dhe u botua pas 26 vjetësh, më 1986.³⁴ Por artikulli i parë i një gjuhëtari rumun i botuar në Shqipëri është “Lidhjet ndërmjet gjuhës rumune dhe gjuhës shqipe” i akad. Alexandru Graur³⁵ (1957), ndërsa artikulli i parë i një gjuhëtari shqiptar i botuar në Rumani i takon prof. A. Xhuvanit: “Rumänisch-albanische Übereinstimmungen”³⁶ (1958); në këtë artikull ai trajton disa shprehje frazeologjike që janë fjalë për fjalë si në shqipe dhe në rumanishte, p. sh. : *Brînză bună în burduf da cîine – Djathë i mirë në lëkurë të qenit* (thuhet për një njeri të zgjuar e të aftë, por të lig).

³³ Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të prof. dr. Aleksandër Xhuvanit. *Études philologiques et pédagogiques en l'honneur du prof. dr. Aleksandër Xhuvani*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë / Académie des Sciences de la RPS d'Albanie - Institut de Linguistique et de Litterature. Tiranë, 1986, f. 753.

³⁴ BUSHTSShSh 11/1957, 2, 215–217.

³⁵ Në *Cercetări de lingvistică*, Cluj, 1958. III, suppl., f. 461–464 (*Mélanges linguistiques offerts à Emile Petrovici par ses amis étrangers à l'occasion de son soixantième anniversaire*). Botuar dhe shqip: “Bashkëpërkime rumuno-shqiptare” (A. Xhuvani, “Vepra”, vëll. 2, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1990, f. 408–411.

³⁶ Shih: Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij (Tiranë, 2–5 korrik 1982). Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Tiranë, 1988, f. 241–250.

Një gjuhëtar tjetër me merita të shquara në studimin e lidhjeve gjuhësore shqiptare-rumune është akad. H. Mihăescu, filolog klasik dhe bizantinist. U mor kryesisht me elementet latine të shqipes, duke bërë dhe shtresimin kronologjik e klasifikimin sipas përhapjes gjeografike të tyre. Ai ka vënë re se elementi latin i shqipes ka lidhje më fort me romanitetin perëndimor dhe është rezultat i një kontakti e ndikimi tepër të gjatë e të dendur, prej disa shekujsh, me gjuhën e Romës, çka flet në të mirë të prejardhjes së shqiptarëve nga një popullsi që banonte në kohën antike në këtë pjesë të Ballkanit Perëndimor. H. Mihăescu mori pjesë në konferencën për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij (Tiranë, 2–5 korrik 1982), ku mbajti kumtesën “Linguistika dhe etnogjeneza e shqiptarëve”³⁷. Një emër tjetër që duhet përmendur lidhur me temën e kësaj kumtese është edhe Lucia Djamo-Diaconița (? – ?), gjuhëtare me origjinë nga Boboshtica e Korçës, autore e disa artikujve dhe recensioneve albanologjike.

Edhe gjuhëtarë shqiptarë kanë marrë pjesë në veprimtari shkencore në Rumani dhe kanë botuar në shtypin shkencor rumun. Në Kolokuiumin Ndërkombëtar për Qytetërimet Ballkanike (Sinaia, 9–14 korrik 1962) morën pjesë historiani Aleks Buda dhe gjuhëtarët Mahir Domi e Androkli Kostallari. Eqrem Çabej³⁸ dhe Jorgji Gjinari kanë marrë pjesë në një konferencë kombëtare të gjuhësisë rumune. Marrëdhëniet ndërmjet studiuesve shqiptarë e rumunë në përgjithësi u shtuan me formimin e Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE), në mbledhjet dhe kongreset e së cilës kanë marrë pjesë rregullisht edhe studiues shqiptarë. Një kujtim i paharruar do të mbetet për ne pjesëmarrja në Kongresin VIII të AIESEE-së në Bukuresht (24–28 gusht 1999).

Me specializimin e prof. Grigore Brâncuș-it për albanologji në Tiranë (1958–1959) dhe me punën e tij të mëtejshme e të disa gjuhëtarëve të tjerë, mund të thuhet se albanologjia në Rumani u përvijua si disiplinë shkencore më vete, d. m. th. jo gjithnjë në funksion të sqarimit të çështjeve të gjuhës rumune e të historisë së saj. Bibliografia e studimeve rumuno-shqiptare të akad. Grigore Brâncuș-it është shumë e pasur. Para katër vjetësh u botua në Tiranë një përmbledhje studimesh të tij të përkthyer në gjuhën shqipe me titullin “Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune”³⁹. Autori ka shkruar një parathënie të posaçme për lexuesin shqiptar, që është një sintezë e mendimit të tij për lidhjet gjuhësore shqiptaro-rumune. Kontribut të shquar në këtë fushë po jep prej rreth 40 vjetësh studiuesja Cătălina Vătășescu, dishepull shkencor i prof. Grigore Brâncuș-it dhe e brezit të vjetër të gjuhëtarëve rumunë, pjesëmarrëse në konferencën tonë. Ajo ka shkruar dhjetëra artikuj e studime nga fusha e ballkanologjisë dhe romanistikës, duke hulumtuar sidomos marrëdhëniet leksikore shqiptaro-rumune e shqiptaro-rumune-sllave, histori fjalësh e huazimesh, grupe fjalësh në fusha të caktuara leksikore, po edhe çështje të gramatikës e të fonetikës. Dëshiroj të përmend veçanërisht veprën e saj “Leksiku me origjinë latine i gjuhës shqipe në krahasim me

³⁷ Më 1960 E. Çabej kishte marrë një ftesë nga Iorgu Iordan për të ndjekur gjatë muajit gusht të atij viti kurset verore për gjuhën, letërsinë, historinë dhe artin e popullit rumun, që organizonte Universiteti i Bukureshtit në Sinaia (qendër klimatike në malet Karpate). Ftesa nuk u shfrytëzua.

³⁸ Grigore Brâncuș, *Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune*. Shtëpia botuese “55”. Tiranë, s. a., f. 206 recension nga Mimoza Karagjozi-Kore *SFil* 64(47)/2010, 1–2, 187–197.

³⁹ *Vocabularul de origine latină din limba albaneză în comparație cu româna*. Institutul Român de tracologie. Bibliotheca Thracologica XIX. București 1997, V + f. 545.

rumanishten”⁴⁰, një vepër sa analitike, aq dhe përgjithësuese, që ka merituar dhe meriton lavdërime të posaçme. Jashtë sferës së mirëfilltë të gjuhësisë, por me shumë rëndësi për historinë e kulturës dhe të jetës mendore shqiptare, është studimi i saj “Veprimtaria intelektuale dhe kulturore e Shqiptarëve të Rumanisë (1844–1912)”⁴¹.

Kontaktet personale që patën gjuhëtarët rumunë e shqiptarë në konferenca të ndryshme në Rumani, në Shqipëri e në vende të tjera ndihmuan në njohjen e gjuhësisë shqiptare në mjediset shkencore rumune dhe në njohjen e arritjeve të gjuhësisë rumune, e sidomos të botimeve të shumta të saj, nga gjuhëtarët shqiptarë. Prof. E. Çabej na këshillonte herë pas here: “Mos dëgjoni vetëm një palë kambana!” Kjo këshillë është veçanërisht vlefshme në diskutimet rreth marrëdhënieve të shqipes me rumanishten: duhet të njohim më mirë pikëpamjet e njëri-tjetrit për ta çuar më përpara kërkimin. Pikërisht për këtë në vëllimin homazh për prof. Grigore Brâncuș-in e kemi vënë këtë këshillë si nëntitull të kontributit tonë modest⁴² për kolegun e nderuar dhe jemi përpjekur ta mbajmë parasysht.

Lidhur me temën e kësaj konference e të kësaj kumtese dua të përmend gjithashtu se Biblioteka e Akademisë së Shkencave të Rumanisë ka pasur shkëmbim të rregullt botimesh me Bibliotekën e Akademisë sonë të Shkencave dhe u ka dërguar bujarisht shumë botime edhe studiuesve të veçantë (ndër ta edhe unë), sidomos me ndërmjetësimin e kolegut Gr. Brâncuș. Këto botime kanë qenë shumë të dobishme për ne, pasi na kanë shërbyer, nga njëra anë, për të zgjeruar horizontin tonë shkencor në përgjithësi, dhe nga ana tjetër, për të ndërmarrë dhe ne vepra e studime të ngjashme, duke përfutur nga përvoja e kolegëve rumunë. Si rezultat i këtyre mund të pohohet se lidhjet e gjuhësisë shqiptare me gjuhësinë rumune kanë qenë të qëndrueshme e të frytshme, me gjithë rrethanat politike të pafavorshme pas vitit 1961. Bibliografia e studimeve të botuara për shqipen e rumanishten nga gjuhëtarët rumunë e shqiptarë është shumë e pasur dhe rrok jo vetëm çështje të historisë së këtyre gjuhëve, por edhe të gjendjes së sotme të tyre.

Zhvillimet e gjuhësisë në Rumani janë ndjekur me vëmendje te ne dhe kanë shërbyer si shembull. Me zell të veçantë shfletonte shtypin shkencor rumun prof. Mahir Domi. Në faqet e revistave “Buletin i USHT” “Studime filologjike” ai ka botuar herë pas here informacione për veprat dhe veprimtaritë e gjuhësisë rumune. Në fillim të viteve ’60 prof. M. Domi shtronte si objektiva të sektorit tonë një gramatikë akademike përshkruese e normative, afërsisht si ajo e rumanishtes, dhe një atlas dialektologjik të gjuhës shqipe. Ai ndiqte me kujdes diskutimet dhe punën që bëhej në Rumani në këto drejtime. Më 1963 doli botimi i dytë i plotësuar e i rishikuar i gramatikës së gjuhës rumune në dy vëllime⁴³. Kemi përfutur shumë nga ajo vepër akademike, nga

⁴⁰ *Activitatea intelectuală și culturală a albanezilor din România : (1844 – 1912)*. 1984.

⁴¹ Emil Lafe; Genc Lafe, I rapporti linguistici rumeno-albanesi nella visione di Grigore Brâncuș. *Studii de limba română. Omagiu Profesorului Grigore Brâncuș*. Editori: Gh. Chivu, Oana Uță Bărbulescu. Universitatea din București Facultatea de Litere. Editura Universității din București, 2010, 115–120.

⁴² *Gramatica limbii romîne. Vol. I.*, 437 f. ; *Vol. II.* 587 f. Academia RP Romîne, București, 1963.

⁴³ S. Floqi, “Constructions tautologiques en albanais contemporain (et concordances albano-roumaines)”. - *Salb* 1/1966, 2, 129–144; “Konstrukte tautologjike në shqipen e sotme (dhe paralele shqip –rumanisht)”. - *Sfil* 22(5)/1968, 3, 3–57; Emil Lafe, “La répétition comme moyen grammatical d’expression de l’aspect et du haut degré en albanais (Considéré

ndërtimi dhe shtjellimi i kapitujve, po edhe nga kriteret teknike të saj. Kur erdhi për së dyti Gr. Brâncuș-i në Shqipëri, në janar 1966, më pyeti si më ishte dukur “Gramatika” që ma kishte dërguar. Unë kisha vënë re se në grupin e autorëve të kësaj gramatike, të hartuar nën drejtimin e akad. Al. Graur, ishin vetëm dy bura dhe një 12 gra. Prandaj iu përgjigja si me shaka: “Punë grash!”. “Prandaj është shumë e mirë!” – ma ktheu. – “Sepse gratë punojnë me më shumë kujdes se burrat.” Dhe kishte të drejtë. Edhe tek ne po vjen koha që studimet filologjike të ngrihen në një shkallë më të lartë me punën e kujdesshme të grave. Nga gramatika akademike e rumanishtes prof. Spiro Floqi dhe unë morëm idenë e kumtesave tona për Kongresin e Parë të Studimeve Ballkanike në Sofje (1966)⁴⁴, sepse këto tema, d. m. th. ndërtimet tautologjike dhe përsëritja, në atë gramatikë janë trajtuar në një nënkapitull të veçantë (vëll. II. 407–421) dhe ne kishim vënë re mjaft ngjashmëri me shqipen.

Është rasti të përmend këtu ndihmën që ka dhënë Akademia e Shkencave e Rumanisë për disa botime tonat. Më 1963 (një kohë kur marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve ishin ftohur) u shtypën në Rumani, me tirazh 3100 kopje dhe me cilësi shumë të mirë, dhjetë fjalorët e parë terminologjikë shqip-frëngjisht-rusisht të punuar në Institutin e Gjuhësisë në Tiranë, gjithsej 1018 faqe. Por nderi më i madh që Akademia e Shkencave e Rumanisë i ka bërë gjuhësisë shqiptare ka qenë shtypja e dy vëllimeve të botimit kritik të “Mesharit” të Gjon Buzukut, punuar nga prof. Eqrem Çabej. Kjo vepër që përgatitur për shtyp që më 1958. Në Shqipëri nuk ishin atëherë kushtet teknike për shtypjen e një vepre të tillë. Një përpjekje e parë për ta shtypur në RDGJ nuk doli me sukses. Me sa di unë, në ato vite drejtor i Shtëpisë botuese të Akademisë së Shkencave të Rumanisë ka qenë akademiku Al. Graur. Falë dashamirësisë së tij dhe përkrahjes edhe të akademikëve të tjerë të tjerë që kishin nderim të veçantë për kolegun e tyre shqiptar dhe ndjenja simpatie të hapur për Shqipërinë e për popullin shqiptar, dy vëllimet e Buzukut u shtypën në mënyrë të shkëlqyer dhe mbeten një përmendore miqësie rumuno-shqiptare në fushën e shkencës e të kulturës.

Të gjitha këto lidhje e marrëdhënie të mbara të së shkuarës duhet të shërbejnë për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm e të frytshëm të bashkëpunimit ndërmjet gjuhësisë shqiptare e rumune. Shenjat janë të mira. Vitin e kaluar gjuhëtarja Renata Topçiu, e njohur edhe si bashkautore e parë e fjalorit akademik shqip-rumanisht me 41 mijë fjalë, mbrojti me vlerësime të larta doktoratën nën udhëheqjen shkencore të akad. Gr. Brâncuș me temë “Frazologji rumuno-shqiptare”. Qenia e një bashkësie të gjerë arumune në Shqipëri, që ruan gjuhën dhe traditat e veta, ka qenë dhe mbetet gjithashtu një moment tërheqës, veçanërisht për studiuesit rumunë. Ekspedita në terren tek arumunët e Shqipërisë ka bërë dialektologu Nicolae Saramandu. Fatmirësisht tek Arumunët e Shqipërisë vërehet sot një këndellje e traditave të tyre kulturore dhe një dëshirë për ta mbajtur të gjallë idiomën e tyre të veçantë. Edhe në gjendjen e sotme kjo bashkësi përfaqëson një objekt

aussi par rapport au roumain)”. - *SAIb* 3/1966, 2, 113–128; “Përsëritja si mjet gramatikor i shprehjes së aspektit dhe shkallës sipërore në gjuhën shqipe e parë edhe në krahasim me rumanishten”. - *SFI* 20(3)/1966, 4, f. 119–137.

⁴⁴ Vllehtë. *Historia dhe gjuha e tyre (Vështrim historiko-gjuhësor). Monografi*. Botimet “Toena”. Tiranë, 2009, f. 228.

hulumtimi të shumëfishtë. Një provë të suksesshme për këtë na ka dhënë studiuesja Spiridhulla Poçi me një vështrim monografik historiko-gjuhësor për Vllehtë e Shqipërisë⁴⁵.

Mendoj se Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës mund të ishte një qendër e kërkimit shkencor si për trashëgiminë kulturore e shpirtërore arumune në Shqipëri, ashtu edhe për lidhjet shkencore shqiptaro-rumune në fushën e gjuhësisë, duke përfshirë mësimin cilësor të gjuhës e të letërsisë rumune. Ndër detyrat e para në këtë drejtim do të ishin përpilimi i një bibliografie dhe ngritja e një biblioteke të specializuar. Korça me qarkun e saj, siç dihet, kanë pasur historikisht lidhjet më të dendura e më të qëndrueshme me Rumaninë. Kjo traditë, që vijon edhe sot në disa fusha, mund të gjallërohet më tej edhe në fushën e studimeve e të veprimtarive gjuhësore. Organizimi i kësaj konference nga Universiteti “Fan Noli” me pjesëmarrjen aktive dhe të cilësuar të pedagoges Daniela Stoica, si dhe gatishmëria për bashkëpunim e institucioneve akademike të Rumanisë janë një shenjë premtuese. Uroj që konferenca jonë të ketë një ndikim të mëtejshëm nxitës në këtë drejtim.

Shkurtime

BUSHTSShSh = *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës Seria e shkencave shoqërore*, Tiranë, 1957–1963.

RRL = *Revue Roumaine de Linguistique*, Bucarest.

SALb = *Studia albanica*, Tirana, 1964-

SFil = *Studime filologjike*, Tiranë, 1964-

⁴⁵ Shiko N. Resusuli, *Il «Messale» di Giovanni Buzuku. Riproduzione e trascrizione*, Città del Vaticano, 1958, f. VII.

**VËREJTJE MBI LEKSIKUN E « MESHARIT » TË
GJON BUZUKUT**

Dr. Cătălina Vătăşescu

Institut i Studimeve mbi Evropën Juglindore,
Academia Română

Studimi i leksikut të krishterë të gjuhës shqipe dhe të huazimeve të vjetra që shqipja i ka marrë nga latinishtja ka shfrytëzuar sistematikisht dhe nga shumë pikëpamje veprën e parë të njohur në këtë gjuhë. Siç dihet, ka një fjalor shumë të dobishëm të këtij shkrimi, që e ka hartuar Kolë Ashta, një pasqyrë komplete në fjalorin historik të gjuhës shqipe të S. E. Mannit, një përdorim shumë të rëndësishëm e një rradhe e gjerë kontekstësh në fjalorin etimologjik të Eqrem Çabejt. Megjithatë, gjenden ende hollësira interesante mbi të cilat mund të tërheqim vëmendjen.

Të mos lëmë mënjanë informatën, që na jep Namik Ressuli, pranë E. Çabejt, një nga të dy botuesit në tërësi të veprës së Buzukut. Kështu, në historinë që bën në hyrjen e botimit të tij mbi provat e bëra para tij për botim, Namik Ressuli thotë se *Meshari* ka qenë gjetur për së dyti në arkivin e Vatikanit, nga Giuseppe Schirò, pikërrishtë më 1912⁴⁶.

Në botimin e tij, duke vënë titujt të duhur pjesëve përbërëse, duke bërë dërgimet të nevojshme në tekstin biblik dhe duke propozuar një përkthim latinisht bashkëkohor për pjesat për të cilat origjinalet nga epoka nuk janë ende të njohura, Namik Rresuli jep një ndihmë e vlefshme që lehtëson mjaft përdorimin e kësaj vepre liturgjike katolike.

Kemi zgjedhur tekstet që lexohen në ceremonitë të pagëzimit e të celebrimit të martesës, që mbajnë udhëzime që i jepen priftit t'i ndjekë në këto ceremoni dhe tekstet të lutjeve përkatëse. Ashtu si tregon Ressuli, këto tekste hyjnë në pjesën e parë të librit, *Rituale romano*; pjesa e dytë të librit e formon vetë meshari⁴⁷. *Rituale romano*, pas shpjegimeve që gjenden në *Enciclopedia cattolica*⁴⁸, është një libër liturgjik që përfshin ceremonitë rreth bekimeve dhe sakramenteve; është vendi këtu të vërejmë se fjala *sakrament*, i marrë nga italishtja, si term kishtar katolik për emërtimin të fshehtësive të shenja të fesë, e gjejmë jo vetëm te Buzuku, por edhe më 1635, në fjalorin latinisht-shqip të Frëng Bardhit (p. 138: *sacramentum: sacrament*; Bardhi ka gjithashtu, nga e njëjta familje fjalësh, huazimet të vjetra nga latinishtja, me *sh-* në fillimin e fjalës dhe jo me *s-*: folja *me shëkrue* dhe togfjalëshi *kafshë e shëkrue*, për lat. *sacrare* dhe *sacrum*. Te Buzuku, *Virgjëna e shëkrue*)⁴⁹.

⁴⁶ Shiko dhe karakterizimin e bërë *Mesharit* nga Mahir Domi : *Meshari* përmban lëndë të ndryshme kishtarë dhe pjesët kryesore të liturgjisë katolike (*Fjalori enciklopedik shqiptar*, botim i ri nën kryeredaksinë e Emil Lafe, I, Tiranë, 2008, f. 350).

⁴⁷ *Enciclopedia cattolica*, X, col. 1010.

⁴⁸ Shiko edhe S. E. Mann, *An Historical Albanian – English Dictionary*, Londra-Neë York-Toronto, 1948, f. 445, E. Çabej, *Iberoromanishtja dhe shqipja, izoglosat e tyre latine*, në “Studime filologjike”, 1976, 4, f. 70.

⁴⁹ Në tekstin latin që jep Ressuli (f. 398): *Hic explicit baptismus*.

1. Pjesa që përmban meshën e pagëzimit ka 11 shtylla dhe mban titullin latinisht *Exorcista cathecuminorum*. Emri shqip po del në mbarimin e tekstit, ku thuhet *Këtu u mbaruo Bagmi*⁵⁰. Si tregon Çabej, *bagëm* me kuptimin “pagëzim” është karakteristik për veprën e Buzukut dhe për gegërishten e vjetër veriore kishtare, duke pasur një etimologji e pasigurtë, ndoshta, megjithatë, latine⁵¹. Titulli latinisht shpjegohet duke mbajtur parasysh faktin se mesha në kishën katolike mban traditën e vjetër të pagëzimit të krishterëve të parë, në masë më të madhe për të rritur – duke qenë fjala mjaft më e vonë për fëmijë. Të rriturit pagëzoheshin pas një periudhe mjaft të gjatë përgatitjeje, në të cilën mbanin emrin *cathecumini* “ata të cilët ishin thërritur për të mësuar me qëllim të krishtërohen, duke u pagëzuar”⁵².

Një pjesë interesante në ceremoninë katolike, që gjendet përpara vetë pagëzimit, e ka emrin *bekimi i kripës*. Buzuku mban për këtë rit titullin latin, *benedictio salis*, jep lutjen ndaj Zotit me anë të së cilës i krishteri i ardhshëm merr *krypën e bekuar* që jep shijë – e ëmbël – gjithë elementeve të jetës. Kripa e Zotit (*krypa e Tinëzot*) është simbol i njohjes, simbol i urtësisë, sjell gëzim dhe shpresë në Zotin. Lutjes për bekimin e kripës i pasojnë fjalët të drejtuar atij që pagëzohet: *accipe sal sapientiae*; te Buzuku: *mer krypën e urtësë*. Në enciklopedinë katolike⁵³, është përmendur zakonin e romanëve që u jepnin kripë fëmijëve të vegjël, për të mënjeluar shpirtrat e këqij. Autorët pyetën nëse ka ndonjë lidhje midis këtij zakoni antik dhe liturgjisë katolike dhe tregojnë se të ngrënët të kripës vazhdon të ketë një vlerë simbolikë të fortë te popujt rreth Mesdheut. Një besim i ngjashëm ekziston edhe ndër rumunët. Në një mbledhje folklorike të bestytnive popullore, e dalë në fillimin e shekullit të kaluar, gjejmë zakonin që lidhet me pagëzimin, sipas të cilit, në veri të vendit, besohet se është mire të vësh kripë mbë gjoksin e foshnjës që duhet pagëzuar si shenjë të pasurisë së ardhëshme. Në të njëjtën krahinë, i jepet mamisë, pas lindjes të të porsalindurit, një grusht miell me kripë⁵⁴.

Tek arumunët dhe tek meglenorumunët, kripa zë gjithashtu një vend të posaçëm ndër zakonet popullore të lidhura me lindjen. Mamia i jep gruas së re, që është duke pritur të lindë, një kokërr kripe ta hajë. Po mamia vë kripë në ujën me të cilën lan fëmijën e porsalindur. Kripa simbolizon pasurinë, fatin e mirë dhe shëndetin⁵⁵.

Pas çastit të bekimit të kripës, në meshën katolike të pagëzimit dhe, natyrisht, dhe në librin e Buzukut, vijon ai ku prifti merr me gishtat pak pështymë me të cilën prek hundën e fëmijës që e pagëzon. Duke e bekuar fëmijën dhe duke e larguar dreqin, prifti i thotë fëmijës të hapë veshët dhe

⁵⁰ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, Tiranë, 1982, f. 128-129.

⁵¹ Për një histori e pagëzimit në botën antike dhe të periudhave përgatitore për këtë akt qenësor fetar, sidomos në kishën katolike, me krahasime me kishën ortodokse, shiko sintezën e bërë nga Eugen Jurca, *Cateheza baptismalë în antichitatea creștină*, Târgu Lăpuș, 2009, Idem, *Ritualul Sfântului Botez – destăinuiri catehetice*, Tg. Lăpuș, 2009.

⁵² *Enciclopedia cattolica*, X, shtylla 1653, 1654.

⁵³ A. Gorovei, *Credințe și superstiții ale poporului român*, botim kritik, I. Opreșan, Bukuresht, 2012, f. 51, 231.

⁵⁴ P. Baravache, *Datini de la naștere si botez*, «Lumina», Bitolia/Monastir, Liceul Român, II, 1904, 12, p. 340-344 ; D. Cosmulei, *Datini, credințe și superstiții aromânești*, București, 1909, p. 7, 8, 15 ; Emil Țârcomnicu, *Obiceiuri și credințe macedoromâne. Dicționar*, București, 2009, p. 15 (s. v. *apărarea natului*)

⁵⁵ Shiko E. Jurca, *Ritualul sfântului botez ; destăinuiri catehetice*, Tg. Lăpuș, 2009, f. 50.

hundën dhe të ndiejë embëlsirën e jetës⁵⁶. Një zakon shumë të ngjashëm të kësaj ceremonie katolike ka dhe ndër arumunët lidhur me lindjen. Fjala është jo për një pjesë të meshës (arumunët janë ortodoksë), por për një zakon laik, popullor. Nëna, ashtu si prifti tek katolikët, po merr me gishtat pështymë në gojë dhe me të lyen sytë e hundën e fëmijës, duke bërë shenjën e kryqit⁵⁷.

2. Në tekstin e Buzukut na kanë tërhequr vëmendjen gjithashtu disa aspekte semantike.

Mesha e pagëzimit është, natyrisht, para së gjithash për fëmijë. Termi i përgjithshëm për këtë nocion është ai për fëmijën mashkull, *djalë*: shumësi *djelmtë* përkthen fjalën latine *pueros*⁵⁸. Barazimet me latinishten i bëjmë me tekstin e dhënë në botimin e Namik Ressulit. *Fjalori* i Bardhit (f. 115) përkthen *puer* me emrin zvogëlues *djalëth*, dhe abstrakti *puerilitas* me *dielmënia*. Këtu mund të vëmë re dhe përdorimin e termit *njeri* me kuptimin “burrë”, ku kemi për të bërë me përdorimin e anasjelltë. Në një shembull i marrë nga mesha e martesës, *e prashtu të i bëjmë ndimë të shembëllenijë mbë n~erit n~eri* përkthen lat. *vir*. (Është fjala për Evën, që Zoti e ka bërë si ndihmë Adamit, të cilit t’i jetë e ngjashme). Siç shihet, *djalë* dhe *njeri* bashkojnë në mënyrë të ngjashme të dy kuptimet, “fëmijë” dhe “fëmijë mashkull” dhe, përkatësisht, “qenie njerëzore mashkullore” dhe “burrë”.

Folja *pyes*, në krahasim me përdorimin e sotëm, është më afër kuptimit të etimonit latin, fakt që jep, ndoshta, më shumë siguri shpjegimit nga latinishtja⁵⁹: .. *qish pyetën prej klishet shenjtë?: quid petis ab Ecclesia Dei?* (me ç’farë kërkimi drejtoheni kishës?). Te Bardhi (f. 97) gjithashtu gjejmë përkthimin: *petere: me lypunë o me pyetunë, petitio: të pyetunë*.

Termat fetarë me origjinë latine kanë, si dihet, një pozitë qenësore në fjalorin shqiptar: për shembull, palës sinonimike *shok e fqinj* për lat. *socium et proximum* (ku *fqin* vjen nga lat. *vicinus*) i rrinë pranë togfjalëshit të formuar saktësisht me anë të huazimëve latine që dalin në tekstin latin: *shpirti i mallëkuom: spiritus maledictus; shpirti shenjtë: spiritus sanctus; shenjtë e kryqsë: signum crucis; shqyt i fesë: scutum fidei; vepëratë e dreqit: opera satane* (barazimi *satana: dreq*, ku *dreq*, ashtu si rum. *drac*, vjen nga lat. *draco, -onis*, është i dendur, nga sa kemi konstatuar, i vetmi).

Një afrim më të dukshëm ndaj kuptimit të etimonit shihet edhe në rastin e foljes *kujtoj* në shembullin që vijon: *E këjo krypë shkatëroftë gjithë të kujtuom që ai i paligji kujtuom ka përmbi këtë të ri frujt: et hoc sal disperdat omne consilium quod malignus ille excogitaverit de hac nova sobole*. Njihet se Bardhi (f. 13) përkthen gjithashtu *cogitare: me kujtuem, cogitatio: të kujtuem*. Në shqipen bashkëkohore kuptimi është larguar ndaj atij të etimonit.

E kemi dhënë shembullin në tërësi sepse është interesant edhe për shkak të togut *të ri frujt* që përkthen togun latin *nova sobole*. Lat. *soboles* ka kuptimet “fëmijë” dhe “filiz, njemëz”. Buzuku përdor termin *frujt*, të marrë nga lat. *fructus*. Ky përdorim na dërgon tek fjala rumune *plod*, e marrë nga sllavishtja, që ka gjithashtu të dy kuptimet, “fëmijë” dhe “pemë”, fjalë që del në të njëjtat

⁵⁶ P. Baravache, *vep.i cit.*, f. 145.

⁵⁷ Meshari në botimin e Çabejt, II, f. 69.

⁵⁸ Meyer. *Etym. Örterbuch. des Alb.*, f. 360 : < lat. **petio* < *peto*. Fjala ka qenë spjeguar në shumë mënyra si huazim ose si term autokton. Shiko bibliografinë të Vl. Orel, *Albanian Etymological Dictionary*, Leiden, Boston, Köln, 1998, s. v. Orel vetë e quan fjalë autoktone, e lidhur me lat. *puto*.

⁵⁹ Coresi, *Tâlcul evangheliilor și Molitvenic rumânesc*, botim kritik nga Vladimir Drimba, hyrje nga Ion Gheție, Bukuresht, 1998, p. 195.

kontekste liturgjike. Është për të vërejtur se Bardhi përkthen *soboles* vetëm me *bijtë* dhe *bijatë*, pa përdorur terma nga fjalori botanik, si Buzuku. Në pjesën që i është kushtuar martesës gjejmë një afrim tjetër me rumanishten. Lat. *hic iuvenis vir* është përkthyer nga Buzuku me *ky trim*. Termi formon me fjalën *vashë*, e përdorur me kuptimin “nuse”, një çift leksikor që del shpesh në poezitë popullore. Në një tekst rumun bashkëkohor, që do të përmendim më poshtë, të dhjakut Coresi⁶⁰, në kontekstin që mban fjalën shqipe *trim* del fjala rumune *voinic*. Termi rumun, me origjinë sllave, përkton semantikisht me termin shqip dhe ka të njëjtin përdorim folklorik.

I huazuar nga lat. *pator*, *pësoj* është përdorur në shembullin që vijon me një kuptim interesant që e bën sinonim me *provoj* : *e shohënë e pësonjënë sa i amblë anshtë i mujtuni* Zot. Kuptimi del me qartësi edhe nga shoqërimi me foljen *shoh*. Në latinishten, teksti është : *et vident et gustant quam suavis est omnipotens Dominus*. Kuptimi rrjedh, ndoshta, nga ideja e të mësuarit me diçka, jo gjithmonë të keq.

Meshari vërteton se shqipja e përkthimeve të para njihte kuptimin “fjalë” të termit me origjinë sllave *bisedë*. Ky kuptim është humbur me kohën, por nuk duhet vërë në dyshim. Një shembull i sigurtë⁶¹ është ky: *tue u kujtuom anso beseadësh qi flet Shpirti shenjt për gojë të Salomonit urtë*. Teksti latin : *recordatus verborum illorum quae dicit Spiritus sanctus per os Salomonis sapientis*. Shembulli është përfocuar nga një copë që rimerr idenë, duke përdorur sinonimin *fjalë*: *E përhapë këtë fjalë flet mbë tjetërë vend* (: lat. *Et item hoc verborum dicit in alio loco*). Fjala sllave ka hyrë dhe në rumanishte. Në përkthimet të vjetra rumune, fjala *beseadă* ka shpesh herë kuptimin “fjalë” dhe më rrallë kuptimin “fjalim, kuvend”. Termi është të njohur sot vetëm në të folmet veriore, me kuptimin “fjalë”.

3. Po qëndrojmë pak në leksikun e lutjes *Pater noster*, për të cilin Buzuku saktëson: *Mbasandaj thuo prift Pater noster, qi vjen me thashunë shqip*. Ky pohim i papritur do me thënë se gjuha e lutjes do të ishte shqip në çfarëdorë rrethanë? Zakonisht, edhe në kohë të meshës në gjuhën latine, prifti thoshte shqip *Ati ynë*? Ndoshta, libri i Buzukut kishte si qëllim kryesor të ndriçojë për priftërinjtë shqiptarë tekstin latin që ata nuk merrnin më vesh dhe t’iu shpjegojë në gjuhën e tyre si duhet të shkojë mesha.

Po krahasojmë tekstin shqip me dy variante të lutjes në gjuhën rumune nga gjysma e dytë të shekullit XVI. Një variant është botuar më 1567 nga Coresi në mbledhjen e parë të lutjeve të shtypur rumanisht, *Molitvenic rumânesc*⁶². Libri rumun përfshin të njëjtën lëndë si libri shqiptar,

⁶⁰ Shembulli nuk është te E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, II, Tirana, 1976, s. v., Çabej duke dyshuar se kuptimi “fjalë” ka ekzistuar. Ai jep shembuj të tjerë që lejojnë supozimin se *bisedë* kishte kuptimin “fjalë”, edhe pse ai vetë i shpjegon ndryshe; shiko artikullin tonë *Rom. beseadă “cuvânt, convorbire”, alb. bisedë “conversație” (considerații asupra împrumuturilor slave în română și albaneză)*, në Cătălina Vătășescu, *Studii româno-albaneze. Note semantice și etimologice*, București, 2006.

⁶¹ Coresi, *Tâlcul evangheliilor și Molitvenic rumânesc*.

⁶² Teksti është botuar nga B. P. Hasdeu. Shiko B. P. Hasdeu, *Luca Stroici, părintele filologiei latino-române*, în B. P. Hasdeu, *Studii de lingvistică și filologie*, botim kritik në dy vëlime, me shënime dhe hyrje nga Gr. Brâncuș, vël. I, Bukuresht, 1988, f. 34-48, 283-285; teksti i lutjes, në f. 40, 284. Në f. 42 Hasdeu jep një variante e tjetër e lutjes që ka prapë si autor Coresi.

është një liturgji ortodokse. Lutja është pjesë në meshën e pagëzimit. Varianti tjetër rumun është nga viti 1593 dhe ka si autor një bujar nga Moldova, Luca Stroici⁶³.

Pikrisht në fillimin e lutjes, ka një ndryshim midis tekstit shqip dhe tekstit rumanisht i vështirë të shpjegohet. Është vështirë ta quajmë një ndryshim midis ortodoksëve dhe katolikëve. Teksti shqip thotë *u festoftë emënitë tat*, teksti rumun, në këto variante që kemi për krahasim, dhe në variantin e sotëm, thotë *sfînțească-se numele tău*, duke përdorur, në vend të foljes shqipe *festoj* “kremtoj”, foljen *a se sfînți*, të prejardhur nga emri *sfânt* “shenjt”. Nuk besojmë se ekzistojnë varainte rumune të cilat përfshijnë foljen e prejardhur nga *sărbătoare* “festë”⁶⁴. Përveç kësaj, as origjinalet greke dhe latine nuk kanë foljen që të shpjegojë variantin e Buzukut, por kanë një folje të prejardhur nga emri *shenjt*: gr. *ἀγιασθήτω τό όνομά σου*, lat. *sanctificetur nomen tuum*⁶⁵. Në përkthimin e Dhiatës së Re në toskërisht të botuar më 1910 në Manastir, po kemi variantin e pritur: *ushënjtëroftë emëri yt* (Matheu, VI, 9, Lluka, XI, 2). Kuptimi i ndërtimit të Buzuku duhet të jetë “lavduar të jetë emri tat”, ndërtim që pajtohet me shprehjen rumune të përdorur në çaste të tjera të meshës: *lăudat fie numele Tău*. Mendojmë se, sidoqoftë, ky fakt duhet hetuar në të ardhmen. Ndoshta, zgjidhja e Buzukut mund të funksionojë si një njoftim mbi origjinalin e përkthyer, duke ndriçuar një farë tradite. Nuk duhet lënë mënjanë fakti se fjalët që Buzuku përdor janë mjaft të reja, nga italishtja: *festë, festoj*.

Një tjetër ndryshim, i shkaktuar, me siguri këtë herë, nga ndryshimi midis traditës leksikore katolike dhe asaj ortodokse është ai midis togjeve *regjënia jote* në shqipe, *împărăția ta* në rumanishte. Shkrimtarët shqiptarë katolikë të veriut përkthejnë termin latin *regnum*, autorët rumunë ortodoksë termin *imperium*, mbas traditës bizantine. Në varianten toske, ortodokse, nga viti 1910 *arthtë mbretëria jote*.

Është vendi të tërheqim vëmendjen mbi një afrim shumë të papritur. Në leksikun me të cilin Buzuku përshkruan ceremoninë e martesës del një shprehje që i përket ritit ortodoks. Pas mbarimit të ceremonisë së pagëzimit, Buzuku shkruan: *Këtu u mbaruo Bagmi e tash zanë Kfill të vumitë e kunorës*. Teksti latin që jep Resuli thotë: *Hic explicit baptismus et nunc incipit matrimonium*. Endde kemi për të hetuar se sa i njohur dhe sa i shpeshtë është ky emërtim i lidhjes së martesës, në se mund të konsiderohet i përgjithshëm ose jo në shqipen e vjetër. Bardhi nuk e ka. Ai jep të martuemitë për *matrimonium* dhe shpjegon termin latin *iugalis* dhe togun italisht *legame dei matrimonio* me anë të togut fjalësh *të lidhunitë e gruesë e të burrit*. Një shenjë, megjithatë, se sintagma *vë kunorë* ka mundur të qarkullojë dhe në mesin katolik shqiptar është fakti se *kurorëz* është mjaft i shpeshtë në shqipen e sotme dhe se ekziston edhe antonimi *çkurorëz* si emërtim për

⁶³ Të gjithë tekstet në rumanishten kanë foljen e rrjedhur nga emri *sfânt*; shiko mbledhjen e teksteve nga shekujt XVI-XVIII që e ka bërë Eugenio Coseriu, *Limba romană în fața Ocidentului. De la Genebrardus la Hervas. Contribuții la istoria cunoașterii limbii române în Europa occidentală*, përktheu Andrei A. Avram, Cluj-Napoca, 1994.

⁶⁴ Shiko tekstin e lutjes dhe shpjegimet në *Dictionnaire d'archéologie chrétienne et de liturgie*, publié sous la direction de Fernand Cabrol et Henri Leclercq, Paris, 1935, t. XII, shtyllat 2244-2255.

⁶⁵ Prania e ky emërtimi ortodoks në një tekst katolik nuk është e vetme. Buzuku e përdor, megjithë se rrallë, dhe togun *mbretëria jote*, pranë togut i pritur, dhe i zakonshëm për tekstin katolik, *rregjënia jote*.

“të ndarët e të martuarëve” (*Fjalor*, 1954), ndarje mbi të cilin fjalori shpjegues i 1954-s thotë se ndodh në gjyq; domethënë se është fjala për një term që nuk bën më pjesë në leksikun fetar⁶⁶.

4. Më interesante se dallimet na duken disa përkime me rumanishten në leksikun me origjinë latine. Në tekstin rumun e lutjes *Ati ynë* të Luca Stroicit gjejm fjalinë *Și iartă nouă detoriile noastre cum și noi lăsăm detornicilor noștri*. Stroici nuk ka zëvendësuar fjalën e trashëguarë *detorie*, as fjalën e prejardhurë *detornic* me hauzimet sllave *greșeală* dhe *greșit*⁶⁷. Në variantet rumune që i ka mbledhur Coseriu, *datorie* dhe *datornici* dalin shumë shpesh, sidomos në trevat të veriut. Coseriu⁶⁸ është i mendimit se është fjala për një zgjedhje e kërkuar nga origjinali grek. Nga sa shihet, Buzuku ka të njëjtën zgjedhje: *E neve ne liro deturënë t'anë por-si edhe na lirojmë gjithë ata qi neve na janë detuor*. Fakti se të dy autorët veprojnë në mënyrë të ngjashme përforcon supozimin se nuk është fjala për një zgjedhje individuale, por për një traditë e gjatë që fillon me origjinën latine të leksikut fetar të dy gjuhëve. Në variantin latin të shekullit III të erës sonë që i përket Tertulianit, kemi *dimitte nobis debita nostra*. Është për të vërejtur se variantit rumun *greșeale*, *greșiilor* i pajtohet varianti tosk *fajetë*, *fajtorëve* (në tekstin e Dhiatës së re botuar në Manastir). Buzuku përdor fjalë të formuar nga bazat latine *debitor*, *debitoris*, që kanë dhënë formën e vjetër shqiptare *detuor* dhe formën e vjetër rumune *detoriu*, *dătoriu*. Nga këto fjalë shqiptare dhe rumune vijjnë trajtat e sotme, shq. *detyrë*, rum. *detorie*, *detornic*⁶⁹.

Kjo pjesë nga teksti i Buzukut na intereson këtu edhe për një shkak tjetër. *E neve na liro detyrënë tanë porsi edhe na lirojmë gjithë ata që neve na janë detuar* tregon, pra, se shqipja duhet të kishte huazuar foljen latine *liberare*. *Liroj* me kuptimin “kërkoj të falun” bën palë me foljen *a ierta* të rumanishtes që vazhdon lat. *libertare*. Në shqipen e vjetër të veriut, *liroj* del shpesh bashkë me fjalët *detyrë*, *mpkat*. Semantikisht kjo folje përkthen pikërisht etimonin latin *liberare* në togun nga latinishtja kishtarë *libera me, domine*⁷⁰. Besojmë se në tekstet të vjetra, duke filluar me atë të Buzukut, *liroj* nuk mund të vijë nga mbiemri *i lirë*, do me thënë të jetë një formim të brendshëm të shqipes. Termi shpjegohet më mirë si një huazim nga latinishtja. Lutja mbaron në shqipen si në një radhë të gjerë variantesh në rumanishte: *neve na liro K së keqi, și ne izbăvește de cel rău*. Duhet vërejtur edhe se këtu folja *liroj* ka me të vërtetë kuptimin “shpëtoj nga; largoj nga rreziku”, pra tjetër kuptim nga shembujt e lartpërmendur.

Në këtë kumtesë u përpoqëm të tërheqim vëmendjen mbi mënyrën e integritit të plotë të fjalorit fetar me prejardhje latine në strukturën e tekstit të parë që njohim në gjuhën shqipe. Tradita e përdorimit të një leksiku të pasur me prejardhje latine është e fortë dhe e dukshme. Pjesa e parë e këtij teksti liturgjik, *Rituale romanum*, jep një lëndë leksikore jashtëzakonisht interesante për

⁶⁶ Shiko vërejtjet e Hasdeut, *vep. cit.*, f. 40.

⁶⁷ *Vep. cit.*, f. 61.

⁶⁸ Shiko H. Mihăescu, *La romanité dans le sud-est de l'Europe*, București, 1993, f. 36, 43 dhe V. Orel, s. v.

⁶⁹ Shih për këtë tog A. Dauzat, J. Dubois, H. Mittérand, *Nouveau dictionnaire étymologique et historique*, ed. IV-a, Paris, 1964, f. 421.

⁷⁰ H. Pedersen, *Die guttural im Albanesischen*, KZ, 36. 1900, f. 35; E. Çabej, “Fonetika historike e shqipes”, 1960, f. 109.

mënyrën e ndërtimit të tekstit. Një kërkim të veçantë, për shembull, i duhet kushtuar tekstit dhe mbi mëkatet mortarë.

Kemi provuar, gjithashtu, të tregojmë disa përkime interesante me gjuhën rumune ashtu si dalin ato në disa tekste të së njëjtës periudhë.

Një rrugë kërkimi me interes në të ardhmen është, nga sa kemi parë deri tani, ajo e përshtatjeve midis disa elementeve të ritit që gjenden në tekstin e Buzukut dhe disa dokeve dhe zakoneve të rumuneve në veri dhe në jug të Tunës (për shembull, përdorimi i kripës për mbrojtjen e porsalindurit).

**SQARIMI I ÇËSHTJEVE GJUHËSORE TË RUMANISHTES E TË SHQIPES
KËRKON EDHE KRAHASIMIN HISTORIK TË DY GJUHËVE
(Konsiderata për librin “Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune” të G. Brâncuș)**

Prof. as. dr. Mimoza Karagjozi-Kore

Departamenti i gjuhës shqipe

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, UT

Bashkëpërkimet midis shqipes e rumanishtes janë bërë prej kohësh objekt studimesh. Në to problemi nuk mbetet vetëm në sqarimin gjuhësor por implikon edhe çështjen e rëndësishme të etnogjenezës së dy popujve. Për gjuhën shqipe, shpjegimi i formave të lashta bëhet së pari, nëpërmjet krahasimit të brendshëm dhe në vijim të tij, si një element ndihmës, vjen krahasimi i jashtëm me gjuhët e tjera e në veçanti me rumanishten. Edhe për rumanishten krahasimi me shqipen është i domosdoshëm, për të sqaruar problemin e gjenezës së gjuhës dhe të kombit rumun. Më 1968 A. Rosseti theksoi se “...mund të nxjerrim përfundimin se shqipja, vazhduese e ilirishtes, ka qenë në kontakt në një moment të caktuar të historisë së saj në Siujdhesën Ballkanike me trakishten apo dako-mezishten dhe ka qenë ndikuar nga kjo gjuhë, e cila i ka dhënë elemente të një serie termash e tiparësh gramatikore karakteristike, të cilët i gjejmë në rumanishte”

Vitet '60 -'70 të shek. XX sollën një varg studimesh në këtë fushë në Rumani. Në studimet e I. Russu, C. Poghir, A. Vraciu, G. Brâncuș u shqyrtuan probleme të etimologjisë së fondit autokton, marrëdhëniet e shqipes me rumanishten etj.

Një shtysë të mëtejshme u dhanë këtyre studimeve edhe studiuesit bullgarë, si: D. Deçev (1957), V. Georgiev (1960, 1968, 1977), I. Duridanov (1976). Ideja e tyre ishte se elementet autoktone të përbashkëta në shqipe dhe rumanishte janë trashëguar nga substrati në secilën gjuhë në mënyrë të pavarur.

Edhe studiuesit shqiptarë me në krye E. Çabejin (1959, 1975, 1976) i studiuuan në mënyrë të thelluar këto ngjashmëri. Bashkëpërkimet e gjuhës popullore të dy popujve i gjejmë edhe në veprën e A. Xhuvanit, të sintaksës të M. Domi e S. Floqi (1968, 1981).

Në vazhden e këtyre përpjekjeve të pandërprera vjen edhe libri i Grigore Brâncuș-it, “Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune”, Tiranë 2009, i cili është një përmbledhje prej nëntë artikujsh: *Transferimi në onomastikë i fjalëve të substratit; Një mënyrë fjalëformimi e përbashkët për rumanishten e shqipen; Elemente leksikore autoktone në dialektin arumun; Zanorja ã/ë; bashkëtingëllorja /h/; Bashkëtingëllorja ș/sh; Rotacizmi; Origjina e strukturës së numërorit në rumanisht; Shënime mbi prapavendosjen e nyjës së shquarsisë.*

Në hyrje të veprës autori parashtro disa parime mbi të cilat është mbështetur si dhe çështje të metodës së ndjekur. Artikujt e përfshirë në këtë vëllim prekin të gjitha nënsistemet e gjuhës, si: leksikun, gramatikën e fonetikën. Autori ka shfrytëzuar një literature të pasur e për t’u dhënë përgjigje çështjeve të mësipërme është mbështetur në trajtimin e tyre edhe tek studiuesit e mëparshëm a bashkëkohorë, të huaj ose rumunë. Të gjithë studiuesit rumunë i mbahen mendimit se trajtat që i atribuohen substratit në rumanisht, mund të studiohen me sukses vetëm përmes krahasimit historik me shqipen. Në këtë hulli vijon edhe autori (f. 9), i cili shprehet “Një ndikim i

thjeshtë (shqipja mbi rumanishten apo anasjelltas) nuk mund të shpjegojë numrin kaq të madh të ngjashmërive midis këtyre dy gjuhëve; vetëm përmes *substratit* mund të justifikohen trajtat e përbashkëta befasuese” Duke pasur për bazë “teorinë e substratit”, Grigore Brâncuș, në artikujt e mësipërm, çështjet gjuhësore të pazgjidhura, apo të diskutueshme për rumanishten përpiket t’i sqarojë përkatësisht duke i krahasuar edhe me gjuhën shqipe. I gjithë punimi (f. 6) udhëhiqet nga koncepti se “diversiteti i trajtave që i atribuohen substratit, mund të studiohet me sukses, në radhë të parë, përmes krahasimit historik me shqipen”.

Duke u ndalur në këtë pikë nuk mund të mos japim disa konsiderata që na duken të arsyeshme për këtë çështje. Teoria e substratit nuk është pranuar për shqipen, e cila vjen pa ndërmjetshëm nga një gjuhë jogreke e Ballkanit të lashtë. Që nga Pedersen⁷¹ e këtej është provuar që shqipja është vijuese e pandërprerë e një gjuhe satem të Ballkanit. G. Brâncuș (f. 9), në vijim të argumentit të tij arrin në përfundimin se “...shumë afër së vërtetës më duket hipoteza që ngjashmëritë midis dy gjuhëve shpjegohen nga një gjuhë e tretë që flitej në këtë zonë në periudhën pararomake”. Autori nuk sqaron në se për të kjo “gjuhë e tretë” është ilirishtja, apo trakishtja, apo një gjuhë tjetër. Sidoqoftë kjo ka qenë dhe pika ku studiuesit rumunë janë ndarë nga ata shqiptarë. Nëse për rumanishten mund të flasim për substrat, për shqipen nuk ka ndodhur ndërrim gjuhe. Edhe sikur për shqipen të pranohet një idiomë Trako-Dake, kjo nuk implikon ndonjë substrat.

Por, siç e thekson edhe vetë, objektiv i punës së tij nuk janë dallimet që ekzistojnë në të dyja gjuhët, por ngjashmëritë e përkimet, që janë më të pakta, por edhe më të rëndësishmet.

Në artikullin e parë: *Transferimi në onomastikë i fjalëve të substratit*, autori merr në shqyrtim rreth 83 njësi leksikore të fondit autokton të rumanishtes. Vjetërsia e këtyre njësive leksikore, nga analizat që bën autori, mund të provohet me këto argumente: ato janë të shpërndara në të gjitha dialektet e kësaj gjuhe. Këtë shpërndarje ai ia atribuon karakterit unitar të latinishtes danubiane si dhe unitetit të grupeve sociale të rumunëve në kohët e vjetra, unitet që u ruajt e u forcua edhe nën ndikimin romak. Së dyti, pjesa më e madhe e tyre janë përdorur e përdoren si antroponime e toponime. Së treti, fondi onomastik që përbëhet prej tyre gjendet në të gjitha dokumentet e vjetra të gjuhës rumune. Një tjetër veçori dalluese është se këto njësi të fondit autokton emërtojnë kryesisht fshatra, kodra, pyje, lumenj që iu përkasin, në tërësi, realiteteve pastorale, jetës së blegtorëve. Autori, për shumicën e tyre, ka dhënë edhe përgjegjësen në gjuhën shqipe, (për këtë i është dashur t’iu referohet edhe studiuesve shqiptarë⁷²), psh: rum. *Baltă* (Balteș, Bălteanu, Băltescu) - shq. si emër fshati *Beltoja* (Shkodër), *Baltëza*, *Baltë e Bardhë*; rum. *Barză* del si patronim: *Barza*, *Barză*, *Bărzoiu*, *Bărzeanu*, *Barzea* etj. Kjo fjalë në onomastikë ka një përdorim më të pakët për shkak të konkurrimit me fjalën *alb* “i bardhë” që ka hyrë në rumanisht nga latinishtja. Për shqipen sjell emrat e përveçëm: *Bardhi*, *Bardha*, *Bardhec*, *Bardhuk*, *Bardhush*, kurse në onomastikë, *Gur i Bardhë*, *Bardhaj* (fshat në Shkodër), *Bardhan* (j), *Barzanj*. Kësaj analize i janë nënshtruar të 83 njësitë që sillen nga fondi i vjetër i rumanishtes, kurse ato që i dalin si emra të përveçëm, a si toponime edhe

⁷¹ Autori citon A. Dhrimon, A. Xhuvanin, E. Çabejn, I. Ajetin, Q. Haxhihasanin

⁷² Një gjë e tillë është vërejtur edhe nga studiuesit shqiptarë. Prof. Çabej vërente: “...vihet re aty një pajtim mjaft i madh që vërehet te paralelizmi i ngushtë në shqiptimin dhe zhvillimin historik të tingujve, po shfaqet edhe në strukturën morfologjike, si në fleksion, si në fjalëformim, në sintaksë të emrit, ..”, E. Çabej, SF, 1, 1975, f. 50.

në shqipe po i paraqesim si më poshtë: *Brad* “bredh”, *Bukura* “bukur”, *Căciulă* “kësulë”, *Cătun* “katund”, *Ceafă* “qafë”, *Ciok* “sqep”, *Cioară* “sorrë”, *Ciukă* “çukë”, *Ciut* “shytë”, *Curpen* “kulpër”, *Fluture* “flutur”, *Ghimbe* “gjëmb”, *Ghiuj* “gijsh”, *Groapă* “gropë”, *Gușă* “gushë”, *Leurdă* “hudhër”, *Mal*, *Măgar* “gomar”, *Mărar* “maraj”, *Muşcoi* “mushkë”, *Pârâu* “përrua”, *Scăpăra* “shkrep”, *Țap* “cjap”, *Țeapă* “thep”, *Vatră* “vatër”, *Viezure* “vjedullë”. Autorit i është dashur të thellohet në etimologjinë e fjalëve, t’i verifikojë ato në të gjitha dialektet e rumanishtes, e të njëjtën përpjekje, me sa ka mundur, e ka bërë edhe për shqipen. Megjithatë, vështirë se për disa nga njësitë e mësipërme baza etimologjike të jetë e përbashkët. Kështu rum. *ciok* “sqep”: shq. *çok* është sqaruar për shqipen si një “fjalë e lashtë e leksikut ekspresiv, me një onomatopë” (Studime Etim. III, f. 140), pra përkimi me rumanishten a ndonjë gjuhë tjetër ballkanike është i rastësishëm. Po kështu përqasja rum. *leurdă*: shq. *hudhër* është një etimologji e përligjur vetëm semantikisht dhe jo fonetikut. Madje *leurdă* ai e lidh edhe me fjalën tjetër të rum. *urdă* së cilës i bën një përqasje me toponimin Hurdha në Mat e në Dibër, e cila përfaqëson sipas tij “variantin e vjetër të presupozuar për formën aktuale Udhos “formaggio” në shqipen e Italisë. E. Çabej për këtë fjalë në gjuhën shqipe shprehet: “Pranohet që nga G. Meyer e më parë nga Kamarda afrimi me greqishten ὀκόποδov (Stud etim. IV, f. 380).

Artikulli i dytë: *Një mënyrë fjalëformimi e përbashkët për rumanishten e shqipen*, sjell shembuj interesantë të formimit paralel⁷³ të kompozitave në gjuhën popullore rumune dhe atë shqipe, si: shq. *kokëmadh*-rum. *cap-mare*; shq. *hundëmadh*-rum. *nas-mare*; shq. *gojëmbël*-rum. *gură-dulce*; shq. *sybardhë*-rum. *ochi-albi* etj. Autori ka vënë re se formime të tilla karakterizohen nga mungesa e nyjës enklitike te emri si dhe i nyjës proklitike te mbiemri, gjë që flet për vjetërsinë e tyre. G. Brâncuș të njëjtat arsyetime i gjen edhe te studiuesit shqiptarë. Për rumanishten ka pasur vetëm ndonjë studim të veçantë në kuadrin e “shprehjeve paralele” në të dyja gjuhët (Pușcariu, 1940, f. 264). Duke i parë në plan krahasues ai arrin në përfundimin “...kompozitat e këtij tipi janë identike në këto dy gjuhë, si për nga mënyra e formimit, ashtu edhe për nga kuptimi” (G. Brâncuș, f. 91)

Tipari dallues i këtyre formimeve është topika e mbiemrit, e cila është ajo e zakonshmja, mbiemri cilësor pas emrit, edhe pse janë krijime të gjuhës afektive. Dallimi i vetëm qëndron në faktin se në rumanisht kompozita të tilla janë emra që perdoren vetëm me kuptim afektiv, kurse në shqipe, ku formimi i kompozitave të tilla është një rrugë shumë prodhimtare, janë futur edhe në gjuhën e përditshme.

Për të parë fondin e lashtë autokton të rumanishtes në një nga dialektet e saj, arumanishten, autori ka ndërmarrë edhe një udhëtim në Shqipëri më 1966. Përfundimet e nxjerra nga intervistat me arumunët e vendit tonë ai i ka dhënë në artikullin vijues: *Elemente leksikore autoktone në dialektin arumun*. Për autorin është befasuese që elementet autoktone të arumanishtes dalin më afër me dakorumanishten se sa me shqipen, me të cilën i lidh një bashkëjetësë e gjatë bilinguizmi. Nga ana tjetër ai vëren se përkimet në elementin autokton të arumanishtes përputhen më tepër me toskërishten. Për këtë jep një argument: “gjërat duhen vështuar nga perspektiva e rumanishtes së përbashkët, përpara ndarjes së saj dialektore, kur, ka shumë mundësi që toskët të banonin në një krahinë të ndodhur diku më në verilindje të Shqipërisë së sotme” (G. Brâncuș, f. 93) Në fakt

⁷³ N. Jorga, Historia V. II, 414, cituar sipas K. Kycikut, Arumunët. f. 100.

mendojmë se nuk ka ndonjë të dhënë që toskët të kenë jetuar aty ku mendon autori. Në toskërishte, ndryshe nga gegërishtja shfaqen të gjitha tiparet gjuhësore ballkanike të shqipes. Ndoshta këtu duhen kërkuar edhe afëritë me arumanishten. Në kushtet e bilinguzmit me gjuhën shqipe, arumanishtja ka pësuar edhe disa dukuri interesante. Kështu disa nga fjalët kanë humbur aspektin e hershëm fonetik duke iu përshtatur shqiptimit të shqipes, disa të tjera u zhdukën, sepse u zhdukën edhe gjegjëset në gjuhën shqipe si, *bun*, disa të tjera u zhdukën për shkak të ngjashmërisë që kishin me shqipen si: *baltă, cursă* (kurth), kurse disa të tjera shkuan drejt njëjtësimit me shqipen si *sărămă-thërrime*. Në të gjithë punimin Brâncuș e ka parë arumanishten si një nga dialektet e rumanishtes, e cila ruan ende në një masë të madhe fjalë të substatit trako-dak. Kjo përputhet me tezën e Çabejt (Hyrje ne hist e gj. II, f. 170) që e shikon arumanishten si një nga dialektet e rumanishtes së përbashkët: “Rumanishtja ndahet në katër degë dialektore: dakorumanishtja, meglenorumanishtja, *arumanishtja* dhe istrorumanishtja”. Ka studiues të tjerë, madje edhe rumunë si. N. Jorga që pohojnë se origjina e aromanëve nuk është e njëjtë me atë të rumunëve⁷⁴. Kjo tezë së fundi ka dalë edhe midis gjuhëtarëve tanë.⁷⁵

Artikujt e tjerë kanë si objekt studimi çështje të fonetikës historike të gjuhës rumune, të para, përsëri, në lidhje të ngushtë me shqipen. Në punimin *Zanorja* *ă/ ě* autori ka sjellë një varg shembujsh me të cilat kërkon të dëshmojë përafrimet e shumta të shqipes e të rumanishtes. Prania e kësaj zanoreje në shqip, bullgarisht, në disa të folme të maqedonishtes e në rumanisht, prej Miklosic-it e këtej ka tërhequr vëmendjen e ballkanologëve, por në mënyrë të veçantë ngjashmëritë që shfaqin këta tinguj në shqip e në rumanisht. Autori i është rikthyer kësaj çështjeje duke dhënë që në fillim dy rrugët kryesore të përfuturit të kësaj zanoreje në të dyja gjuhët: në mënyrë spontane nga /a/ e patheksuar e cila ka dhënë /ë/ si në fjalët: latin. *familia* > rum. *fămeie* shq. *fëmijë*; latin. *camisia* > rum. *cămeașă* shq. *këmishë*; latin. *sanitatem* > rum. *sănătate*, shq. *shëndet* etj. Rruga e dytë është lindja e kushtëzuar nga një /a/ e theksuar në pozicion hundor, psh: latin *sanctu s* > rum. *sânt*, shq. *shën* etj. Duhet të shtojmë se në gjuhën shqipe /ë/ -ja ka lindur edhe nga zanorja /e/ e theksuar para një hundoreje. Kjo është karakteristikë për dialektin e Jugut, si *mendje* > *mëndje*, *vendi* > *vëndi* etj. Në rumanisht kjo ka ndodhur edhe kur tingujt /e/ ose /i/ janë ndodhur pas një /r/ ose pas një bashkëtingëlloreje buzore, si *raŭ* “i keq” < latin. *reum*; *păr* “dardhë” < *pirum* etj. Nga ana tjetër për shqipen do mbajtur parasysh se zanorja /ë/ e patheksuar e periudhës së dokumentuar s’ka të njëjtin burim me /ë/ e theksuar të dialektit jugor.

Është i drejtë konstatimi i Brâncuș-it se në të dyja këto gjuhë “...prezenca e kësaj zanoreje në rrokje të theksuar është e kushtëzuar nga një bashkëtingëllore hundore”. Po kështu në të dyja gjuhët vihet re mungesa e /ă/, /ě/ në fillim të fjalës.⁷⁶ Problemi paraqitet më i vështirë të shfaqja e kësaj

⁷⁴ Sot ka edhe mendime se arumunët e Shqipërisë nuk janë të ardhur. Ata përfaqësojnë popullsinë e këtyre trevave që u romanizua: “Nga romanizimi gjuhësor i popullsisë në Maqedoni, Thesali, Epir lindën kucovllehtë dhe gjuha e tyre, arumanishtja. Kjo përbën bërthamën greke të latinizimit.” S. Poçi, *Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre*, Tiranë, 2009, f. 179.

⁷⁵ Në shqip ka disa fjalë me /ë/ nistore: *është, ëmë, ëmbël, ëndërr, ënjtem*.

⁷⁶ Kanë ekzistuar dy teori për formimin e nyjave në gjuhën shqipe: e para mbron idenë se nyja e përparme është më e lashtë dhe nga kjo ka dalë nyja e prapme. Përfaqësuesit e saj janë, Pedersen, Grauri, Riza, Bokshi etj. Teoria e dytë

zanoreje të patheksuar. Rugët e përfutimit në secilën gjuhë, sipas Sh. Demirajt (1996, f. 87) kanë qenë të ndryshme. Në rumanisht ajo është përfutur nga “fjalët e burimit latin qysh në periudhën e rumanishtes së përbashkët shek. VIII e. r. s”, kurse “/ë/-ja e patheksuar e shqipes është përfutur nga reduktimi i çdo zanoreje në rrokje jashtë theksit, e për më tepër në disa raste ka rënë fare” Sh. Demiraj vjen në përfutimin se /ă/ e patheksuar e rumanishtes është përfutur në mënyrë të pavarur më vonë se /ë/ e shqipes. Përfutimet G. Brâncuș-it nuk pajtohen në këtë pikë. Sipas tij “...rumanishtja në lidhje me /ă/ është më konservatore se shqipja. Kjo vërejtje mbështet idenë se në rumanisht kjo zanore është e huazuar në latinishten danubiane prej popullsisë autoktone”. Me sa duket kjo dukuri e përbashkët e këtyre dy gjuhëve duhet parë si rezultat i veprimtimit të të njëjtit faktor fonetik, shqiptimit të dobët të rrokjeve të patheksuara. Përfutimi i një /ë/ nga çdo zanore e patheksuar mund të ndodhë në çdo gjuhë (si në frëngj) për shkak të theksit dinamik.

Një artikull tjetër në këtë përmbledhje është: *Bashkëtingëllorja Ş (Sh)*. Autori duke iu referuar studiuesve të mëparshëm për këtë problem si: Mikloschic, Scuchardt, Kretschmer etj, pajtohet me ta në faktin se /ş/ e rumanishtes e ka burimin në substartin trako-dak me arsyetimin se ajo nuk ekziston në sistemin bashkëtingëllor të latinishtes dhe se në shqip kjo bashkëtingëllorë është zhvilluar shumë herët. Burimi i parë i /sh/ në gjuhën shqipe, është një /s/ e trashëguar: shteg: ie. stoig^h, shat: ie. sek-ti. Këtu duhet theksuar vërejtja e K. Topallit (2007 f. 328) se “Në rastin e parë /s/ është kthyer në /sh/ para kontakteve të shqipes me latinishten, kjo dukuri ka vepruar vetëm në fjalët e trashëguara, kurse huazimet latine, që kanë hyre në gjuhën shqipe në periudhën historike, d. m. th. kur ishte kryer ky proces, e kanë kthyer /s/ në /sh/, meqënëse shqipes i mungonte /s/-ja; si rrjedhim, ajo e zëvendësonte atë me një fonemë tjetër me veçori të përafërta nyjtimore.” Kjo është arsyeja që një reflektim të tillë e gjejmë edhe në toponimet antike të ilirishtes, p. sh: Lissus> Lesh> Lezhë, Issamnus> Ishm, Astibus> Shtip etj. Kjo ka ndodhur edhe në huazimet e vjetra nga latinishtja apo greqishtja, p. sh. qershi<greq. κερσία, shekull<lat. saeculum, G. Brâncuș duke u nisur nga gjeneza e kësaj foneme në gjuhën shqipe si dhe nga “shpjegimi përmes kritereve të gjuhës shqipe të toponimeve me /sh/ të Ballkanit veriperëndimor (sipas tij, shën ynë,) është një provë që /ş/ në strukturën fonetike të hidronimeve në veri të Danubit duhet t’i atribuohet substratit trako-dak” (G. Brâncuș, f. 154)

Mendojmë se dukuria e kthimit të /s/ > shq. /sh/, rum. /ş/ në të dyja këto gjuhë nuk duhet parë patjetër si një tipar karakteristik vetëm për këto dy gjuhë, sepse siç ka vërejtur edhe K. Topalli (2007 f. 328) kjo dukuri ka përfshirë edhe gjuhë të tjera satem, si gjuhët balto-sllave e indo-iraniene” Në vazhdim të këtij arsytimi do të shtonim në këtë grup edhe trakishten për të cilën është thënë se i takon këtij grupimi. Ky do të jetë edhe shkak që siç vëren autori (f. 158) “rumanishtja ka pasur gjatë evolucionit të saj një preferencë për tingujt shushuritës” Në të mirë të faktit, sipas mendimit tonë, që ky fenomen në të dyja këto gjuhë nuk përbën një bashkëpërkim, janë edhe një numër fjalësh të fondit të përbashkët, që siç e pranon edhe vetë autori, në shqipe dalin me /sh/ kurse në rumanisht me /s/, p. sh: rum. *bască, scăpăra, scrum* etj, shq. *bashkë, shkrep, shkrumb* etj

mbron pikëpamjen se nyja e prapme është më e hershme dhe me përsëritjen e saj ka dalë nyja e përparme. Përfaqësuesit e saj janë, La Piana, Çabej, Demiraj, Ajeti, Topalli etj.

Në artikullin vijues, *Rotacizmi*, autori shpjegon shkaqet dhe mekanizmin e njëjtë të procesit të rotacizmit në të dyja gjuhët. Edhe koha e përfundimit të këtij procesi në të dyja gjuhët është e njëjtë, para kontaktit të tyre me sllavishten. Gjithashtu, kjo dukuri fonetike është një tipar dialektor në të dyja gjuhët (rum. istrorumanishtja, dakorumanishtja shq. toskërishtja).

Autori ka vënë re edhe mjaft afëri midis shqipes e rumanishtes në sistemin e numërorëve. Ndryshe nga shumë gjuhëtarë që mënyrën e formimit të numërorit nga 11-19 ia detyrojnë veprimit të sllavishtes *jedinū na desete* (marrë si kalk në rumanisht *unsprezece*), autori mendon se kjo strukturë ka lindur si një kalk i latinishtes ballkanike *unus super decem* nga struktura e ngjashme e substratit autokton (latin. e ka pasur *undecim*). N. Jokli (1967, 3, f. 124), duke shqyrtuar këtë dukuri shprehet: “sikundër që në shqipen nocionet e numrave 11, 12 shprehen me 1 mbi 10, 2 mbi dhjetë; një-mbë-dhjetë, dy-mbi-dhjetë, ashtu edhe mënyra e numërimit të letonishtes e të sllavishtes në formën leksikore është në korrespondim të plotë me atë”. G. Brâncuș hedh idenë se ndikimi i sllavishtes mbi shqipen në fushën e numërorëve është vështirë për t’u provuar, prandaj ky mbetet një tipar i hershëm autokton, që vjen që nga indoevropianishtja. Kjo hershmëri në gjuhën shqipe e shpie autorin në përfundimin që edhe në rumanishte duhet t’i përkasë një faze të hershme të substratit autokton.

Ekzistencën e sistemit vigesimal (shq. njëzet, dyzet, rum. unsprăyngiț, doisprăyngiț) të gërshetuar në të dyja gjuhët edhe me sistemin dhjetor, autori e sheh si një tipar të ngjashëm në këto dy gjuhë, të cilin rumanishtja e mori nga latinishtja, “nëpërmjet së cilës, ndoshta ka qenë përkthyer njësia bazë e një të ashtuquajturit system vixhesimal autokton”, duke anashkaluar faktin që edhe ky është një tipar i disa prej gjuhëve i. e. Në po të njëjtin artikull Jokli thotë: “Përkimeve kelto-shq. në numërimin vigesimal nuk duhet t’u jepet shumë rëndësi, sepse e njëjta metodë numërimi (shq. dyzet= 2x20= irl. da fichit) gjendet edhe në danishten, në mbeturina edhe në dialekte të tjera gjermanike, po ashtu krejt e qartë edhe edhe në baskishten” Mendojmë se autori, në përpjekjet që bën që sistemin e numërimit të rumanishtes t’ia atribuojë substratit, duke sjellë ngjashmëri me shqipen, ka anashkaluar faktin e të parit të problemit më gjerë, në kuadrin e familjes i. e.

Në artikullin e fundit *Shënime në lidhje me prapavendosjen e nyjes shqese* G. Brâncuș qysh në fillim mbron tezën se në rumanishte, ashtu si në gjuhën shqipe prapavendosja e nyjës është një fenomen shumë i vjetër në të dyja gjuhët, që ka ndodhur para fenomenit të paravendosjes. Në këtë pikëpamje, ai shkon ndesh për rumanishten me teorinë e Al. Graurit (se prapavendosja e nyjës ka rrjedhur prej paravendosjes së saj), e cila përgjithësisht është pranuar nga rumunët. Për shqipen ai merr në shqyrtim teorinë e Pedersenit, të Çabejt e Demirajt.⁷⁷ Për të mbështetur teorinë e tij Brâncuș gjithmonë në përqasje me shqipen sjell disa argumente: -nyja shqese është tregues emërzimi, p. sh. shq. *i miri*, rum. *bunul*. Në të dyja rastet emërzimi kryhet me nyjën e prapme; -transferimi në antroponimi në të dyja gjuhët kryhet përsëri me nyjën shqese shq. *Bardhi*, rum. *Albu*. Në shqip, siç vëren autori, mbiemrat dalin gjithmonë me këtë nyjë qofshin myslimanë a të krishterë, Aliu, Dhimitri etj; - emri në të dyja gjuhët merr nyje shqese jo vetëm kur ndiqet nga një mbiemër cilësor, por nga çdo mbiemër tjetër. Kjo ndodh edhe në strukturat me gjinore, ku në shqipe shfaqet edhe nyja e përparme, por që duke iu referuar Çabejt, autori vëren se e ashtuquajtuara nyje

⁷⁷ Historia e Letërsisë Shqiptare, Tiranë 1938, f. 120.

proklitike në këtë strukturë është shumë më e vonshme, se në shqipen e vjetër dhe atë popullore kjo nyje mungonte; - edhe kur emri në të dyja gjuhët ndiqet nga një përemër pronor, situata shfaqet e njëjtë, emri është i shquar, rum. *prietenul meu* -shq. *miku im*. Në këtë pikë shfaqen edhe ngjashmëri të tjera.

Autori iu kundërvihet edhe gjuhëtarëve që kanë kundërshtuar origjinën e përbashkët të nyjës në të dyja gjuhët, veçanërisht çështjes se nyja e përparme në shqip (*i mirë*) ndryshon krejtësisht nga ajo e rumanishtes (*cel, cea*). Sipas tij ato ndryshojnë vetëm në pamje të jashtme, sepse historikisht ato ngjajnë mjaft në këto dy gjuhë.

Në gjuhësinë shqiptare, por me sa duket edhe në atë rumune, nuk është i diskutueshëm vetëm fakti se cila nyjë është më e hershme, por edhe koha e shfaqjes së saj. Për shqipen La Piana, Çabej, V. Pissani, V. Georgiev, S. Riza, J. Gjinari, Sh. Demiraj etj, mendojnë se nyja është shfaqur qysh në kohë shumë të lashta. Të tjerë si Jokli, Bokshi etj e çojnë lindjen e saj në periudhën latine a diçka më vonë. Së fundmi për K. Topallin “Mosha e nyjave të shqipes mund të vendoset në periudhën e marrëdhënieve të hershme intensive të shqipes me latinishten, jo më herët se shek IV, por jo më vonë se shek. VI”

Për G. Brâncuș-in (f. 188) mosha e shfaqjes së nyjes për rumanishten është shumë e hershme “...është i sigurt fakti se nyja që shfaqet në të gjitha dialektet, ishte bërë realitet në rumanishten e përbashkët” Këtu përsëri kërkon një bashkëpërkim me shqipen e duke u mbështetur te Pedersen I cili thotë: “...është tashmë një fakt i vërtetuar se shqipja zotëronte nyjë të prapme që nga periudha pararendëse e futjes së elementeve latinë në këtë gjuhë”

Ngjashmëria e nyjes së prapme në rumanisht e në shqip, (kur gjuhët e tjera romane kanë vetëm nyjë të përparme) në fakt prej kohësh ka tërhequr vëmendjen e studiuesve. Sandfeldi mendonte se procesi i krijimit të tyre në të dyja gjuhët ka qenë i njëkohshëm, para shek. X. Për t’i përligjur këto ngjashmëri, ndoshta është i drejtë mendimi se në të dyja gjuhët shfaqja e nyjës është e hershme. Ato s’mund të jenë zhvilluar në periudhën historike, kur marrëdhëniet e ilirëve me trako-dakët u ndërprejnë. Megjithatë edhe në këtë pikë shqipja ka ndjekur, e udhëhequr nga faktorë të brendshëm, rrugën vetjake. Problemi i vjetërsisë së nyjave është një nga problemet më të diskutueshme, prandaj kontributi i autorit është një zë më shumë që iu shtohet tezave për këtë problem.

Si përfundim, libri i G. Brâncuș-it është një libër i dobishëm dhe interesant për gjuhëtarët, e në veçanti për studiuesit e historisë së gjuhës shqipe. Ai vjen në një kohë, kur pothuajse kanë shteruar studimet në gjuhësinë tonë mbi marrëdhëniet e shqipes me rumanishten. Duke e parë me sy kritik, midis argumenteve të shumta që sjell autori, studiuesi mund të përzgjedhë e pse jo edhe të mendojë (sikurse S. Riza e M. Domi) mbi ekzistencën e një komponenteje trake në gjuhën tonë.

REFERIME

Brâncuș, G. (2009) *Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune*, Tiranë.

Çabej, E. (1962), *Karakteristikat e huazimeve latine të shqipes*, Studime filologjike, 1, 1975.

Çabej, E. (1970), *Hyrje në historinë e gjuhës dhe fonetikë historike*, Prishtinë.

Çabej, E. (1975), *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumuno-shqiptare*, Studime Filologjike, 1.

- Demiraj, Sh. (1996) *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Demiraj, Sh. (1994) *Gjuhësi ballkanike*, Shkup.
- Georgiev, V. (1963) *Thrace et illyrien, balkansko ezikoznanie*, 6, Sofia.
- Jokl, N. *Marrëdhëniet e afërisë së shqipes me gjuhët e tjera indoevropiane*, SF, 1967, 3.
- Ismajli, R. (1983), *Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten*, Rilindja, Prishtinë.
- Rosetti, A. (1968), *Istoria limbii române de la origine pînă în secolul al XVII-lea* Bucureşt.
- Topalli, K. (2007) *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Topalli, K. (2009) *Nyjat e shqipes*, Tiranë.
- Vraciu, A. (1980), *Limba daco-geţilor*, edituria Facla, Timişoara.

PUBLICISTIKA DHE LETËRSIA SHQIPE E PAVARËSISË NË KONTEKSTIN E LIDHJEVE SHQIPTARO – RUMUNE

Dr. Dion Tushi

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, UK “Fan S. Noli”

Hyrje

Që në kohërat e vjetra Moldovllahia ka qenë vendi që ka pritur emigrantë nga Shqipëria, të cilët arritën deri atje sa të drejtonin këto vende nën emërtimin e princave fanariotë. Këta princa u shquan për zhvillimin dhe emancipimin kulturor që iu dhanë këtyre principatave të Danubit.

Kështu, edhe emigrantët, kryesisht korçarë të mesit të shekullit të XIX – të që shkuan në Rumani, u ndodhën në një terren miqësor, i cili ju dha atyre më shumë se përfitimi ekonomik. Kjo është arsyeja pse poeti ynë kombëtar Lasgush Poradeci, i cili për nga formimi ishte rilindas, kur flet për këtë kapitull thotë, se shqiptarët duhet t’u jenë mirënjohës popullit rumun dhe qeverisë rumune, për ndihmën e përhershme që kanë patur në lëvizjen e tyre kombëtare.

Në vitin 1886, ajo që kurorëzon përpjekjen e patriotëve të kësaj kolonie në Bukuresht është inagurimi i shtypshkronjës së parë të ngritur me kontributet e mirëbërësve korçarë, dhe sidomos të filantropit Anastas Lakçe, me botimin e veprës së poetit tonë kombëtar Naim Frashërit “Dëshira e Vërtetë e Shqiptarëve” shkruar prej tij në gjuhën greke. Në këtë shtypshkronjë do të botoheshin më pas veprat e tjera të tij dhe të shkrimtarëve të tjerë. Në Rumani gazeta më e vjetër shqipe ishte Shqiptari, themeluar në 1888 nga N. Naço dhe që botohej njëherë në javë. E shkruar në gjuhët shqipe, rumune dhe francze, ajo doli për disa vite rresht, ndonëse me intervale të gjatë ndërprerjeje. “Ylli i Shqipërisë”, organ i Dhimitër Ilos, u botua për herë të parë në vitin 1889 në Bukuresht. “Rilindja Shqiptare” e përdyjavshmja e Thoma Avramit në shqip dhe frëngjisht, doli në vitin 1903 etj. Të gjithë këta periodikë si dhe shoqëritë Drita, Dituria, shpresa etj, u bënë tribuna të mendimit të rilindjes kombëtare, duke kontribuar njëkohësisht edhe në përhapjen e ideve të rilindjes në një masë të gjerë, por edhe duke parapërgatitur terrenin e nevojshëm për kultivimin e publicistikës dhe traditës letrare shqiptare.

Një ndër veprimtarët më në zë të Rilindjes në Rumni ka qenë dhe Nikolla Naço, me emrin e tij lidhet sidomos Krijimi i Shkollës Normale në gjuhën shqipe dhe vllaçe, në 10 Maj të vitit 1892 në Bukuresht. Kjo shkollë kishte edhe konviktin e saj, për nxënësit që vinin nga Shqipëria dhe Maqedonia. Rregullorja e kësaj shkolle u botua në formën e një libreze në gjuhën shqipe, rumune dhe frënge. Patrioti publicist i Rilindjes, Mihal Grameno, ka qenë një ndër nxënësit e parë të shkollës së N. Naços në Bukuresht.

Kështu nga sa thamë, arrijmë në konkluzionin, se ambienti i Rumanisë dhe sidomos kryeqyteti i saj Bukureshti luajtën një rol të rëndësishëm, vendimtar do të thonim, në lindjen dhe emancipimin e lëvizjes patriotike, kulturore, arsimore dhe propogandistike, e cila mundësoi rilindjen kombëtare shqiptare dhe e shprehu atë.

Tradita e marrëdhënieve midis dy vendeve

Në ringjalljen kombëtare të popujve të Ballkanit nën sundimin turk, një rol të rëndësishëm kanë luajtur kolonitë e tyre në vendet e huaja, kështu edhe Rilindja Kombëtare Shqiptare, për vetë kushtet e vendit, filloi nga jashtë, kryesisht nga kolonitë e shqiptarëve të mërguar në vende të ndryshme të Europës e më gjerë. Kjo dukuri u parapri dhe u bashkërendua nga një lëvizje e fuqishme patriotike, kulturore dhe arsimore, një ndër vendet më të para ku patriotët shqiptarë u organizuan dhe zhvilluan aktivitetin e tyre patriotik, kulturor dhe arsimor ka qenë pa dyshim edhe Rumania⁷⁸. Me këtë vend lidhjet janë shumë të hershme dhe historike.

Shqiptari, siç dihet, është më bohemi ndër ballkanasit. Kur kushtet e jetës së tij nuk kanë qenë të favorshme për të, dinamika e lindur e tejskajshme e ka shtyrë atë drejt emigrimit, dhe në kohërat e vjetra Moldovllahia⁷⁹ ka qenë për të siç është Amerika sot. Për pak kohë shqiptarët u shtrinë në të gjitha tokat pjellore, ndërkohë që nëpër qytete zhvilluan zeje të ndryshme dhe industri. Muza popullore ju ka kënduar kurajozëve duke na kujtuar se ari në Shqipëri ka erdhur nga Vllahia. Dhe më të vërtet, fati këta emigrantë i ndihmoi shumë. Gjatë kësaj periudhe në Moldovllahi u ngjiten në fronin e sunduesve një sërë Vojvodësh të shquar me origjinë shqiptare, të cilët e nderuan në një shkallë të lartë emrin e atdheut, nëpërmjet aktivitetit të tyre të shumanshëm në zhvillimin dhe rilindjen e vendit që udhëhoqën. Qysh nga mezi i shekullit të XVII – të deri në mes të shekullit të XIX – të, pothuajse për dyqind vjet, tre dinasti me origjinë shqiptare (ose më mirë të themi dy) kanë hipur në fron në mënyrë të njëpasnjëshme me pauza të vogla, duke zbukuruar fronet e Moldavisë dhe Vllahisë. Këto janë: 1. Dinastia e Vasil Lupos (dinasti e cila shfaqet më pas me emrin e djalit të Vasilit, Dukës), e cila ka dhënë tre princa (hegjemonë) dhe 2. Dinastia e Gjikeve, që konsiderohet dhe më e rëndësishmja, e cila ka nxjerrë 11 princa⁸⁰. Këta princa shqiptarë shënuan, siç janë shprehur të gjithë historianët e kësaj kohe, periudhën më të lavdishme në historinë e këtyre principatave të Danubit. Gjatë aktivitetit të tyre në këto vende, këta u kujdesën për organizimin e brendshëm të tyre dhe për arsimimin e popullatës. Bënë investime të shumta për ngritjen e akademive, shtypshkronjave dhe shkollave. Nxorrën ligje për funksionimin e shtetit dhe organizuan institucionet e kultit. Duke mos u mjaftuar vetëm me botimet e veprave të ndryshme kishtare dhe teologjike, ata u kujdesën për përkthimet e tyre në gjuhën e vendasve.

Kështu që edhe emigrantët, kryesisht korçarë të mezit të shekullit të XIX – të që shkuan në Rumani, u ndodhën në një terren miqësor, i cili ju dha atyre më shumë se përfitimi ekonomik,

⁷⁸ Moldavia dhe Vllahia, janë dy zotërime, nga ky bashkim vjen edhe fjala Moldovllahi. Historianët e vjetër kështu quanin Moldavinë, ndërsa Vllahinë Hungrovllahi, për arsye se ishte në kufi me Hungarinë. Në vitin 1859 nën sundimin e Kuzës u bashkuan dhe tani përbëjnë Rumaninë.

⁷⁹ Kourillas Evlogios, Grigorios o Argirokastitis, *Oi alvanikis katagogis igemones tis Moldovllahias*, Theologia 933, f. 200.

tashmë ishte radha e Rumanisë që të ndihmonte ata, të cilët do të punonin për zgjimin kombëtar dhe krijimin e kuturës së rilindjes në vendin e tyre. Kjo është arsyeja pse poeti ynë kombëtar Lasgush Poradeci, i cili për nga formimi ishte rilindas, kur flet për këtë kapitull thotë, se shqiptarët duhet t'u jenë mirënjohës popullit rumun dhe qeverisë rumune, për ndihmën e përhershme që kanë patur në lëvizjen e tyre kombëtare, pasi, pa mbështetjen fisnike të shtetit rumun, ngritja e shoqërive të Bukureshtit si *Drita*, *Diturija*, *Shpresa*, *Bashkimi*, etj, nuk do të kishte qenë i mundur. Dhe me të vërtetë një përkrahje të tillë, shqiptarëve të emigruar nuk iu dha në asnjë vend tjetër të Ballkanit⁸¹.

Shoqëritë shqiptare të Rumanisë dhe aktiviteti i tyre

Shoqëria e parë shqiptare është themeluar në Bukuresht në 30 shtator të vitit 1879. Ndërsa në vitin 1881 në Bukuresht vjen patrioti Jani Vreto Postenani, si përfaqësues i shqiptarëve të Stambollit, ndërkohë që kryetar i Kolonisë Shqiptare të Bukureshtit ishte Vangjel Geço. Ardhja e tij bëri që kjo shoqëri patriotike të riorganizohej dhe të intensifikonte aktivitetin patriotik. Qysh në vitin 1880 dhe madje më përpara, në Rumani lejohej të shtypeshin libra dhe gazeta në gjuhën shqipe, si dhe të hapeshin shkolla në këtë gjuhë. Përmendim këtu përpjekjen e patriotit Nikolla Naço për hapjen e një shkolle speciale me një trupë pedagogjik të përbërë nga profesorët dhe personalitetet më në zë të Rumanisë, prej të cilëve mund të përmendim V. Gr. Borgovan, teolog dhe profesor, T. Sperantia, doktor në filozofi dhe letërsi, A. Kolorian doktor në fizikë etj.⁸²

Patrioti Vissarion Dodani me një aktivitet të shquar botues në Rumani, i cili ndër të tjera ka qenë edhe botuesi i gazetës “Shqipëria” në Bukuresht, në veprën e tij “Memoriet e Mija”, botuar në shtypshkronjën Albania në vitin 1932, në Kostancë, shpjegon mjaft qartë situatën në të cilën patriotët korçarë, nën influencën e vëllezërve Frashëri, vendosën që të krijojnë në Bukuresht shoqërinë shqiptare “Drita”, emërtimi i kësaj shoqërie sipas Dodanit lidhet me periodikun “Drita” që Sami Frashëri, nëpunës i guvernës otomane në atë kohë, kishte mundur të nxirrte në Stamboll nën drejtimin e Pandeli Sotirit. Kështu, në shtëpinë e Vasil Tërpos në Bukuresht, në prezencën e shumë korçarëve, themelohet kjo shoqëri në vitin 1884, kryetar i së cilës u zgjodh filantropi milioner korçar Anastas Lakçe dhe nënkryetar Kostandin Eftimiu, ndërkohë nipi i tij Spiro Eftimiu, një avokat i njohur në atë kohë në kryeqytetin rumun, ndërton platformën ligjore të kësaj shoqërie.

Vëllezërit Frashëri e kishin kuptuar se në kryeqytetin e perandorisë turke, tashmë nuk ishte e mundur të bëheshin shumë gjëra, kështu që ambienti më i përshtatshëm për kultivimin e frymës së rilindjes për shqiptarët ishte Rumania dhe sidomos kryeqyteti i saj Bukureshti, pasi edhe kolonia më e hershme dhe më e rëndësishme ishte themeluar në Rumani. Naum Veqilarxhi, një nga pionierët e emigracionit shqiptar, u ndoq nga shumë shqiptarë nga rrethi i Korçës, pothuajse që të gjithë të krishterë ortodoksë, shumica e të cilëve të vendosur në Bukuresht. Ata nuk ishin intelektualë, shumica e tyre ishin zanatçinj dhe punëtorë, por me kalimin e viteve disa prej tyre vunë pasuri të madhe. Duke jetuar në një vend ortodoks, por jo progrek, jo vetëm për shkak të kujtimeve të papëlqyeshme të sundimit të Fanarit, por gjithashtu edhe për shkak të propagandës helenizuese ndërmjet vllahëve të Maqedonisë dhe të maleve të Pindit, emigrantët korçarë filluan ta çlironin

⁸¹ Lasgush Poradeci, *Publicistikë*, Vepra III, Tiranë 2010, f. 172.

⁸² Vieta Noua, 5 Prill 1898, f. 36.

veten nga ndikimi kulturor grek dhe ta drejtonin vëmendjen drejt gjuhës dhe kulturës shqiptare. Kështu në lidhje me sa thamë V. Dodani në kujtimet e tij shkruan: “Dëshira e shenjtë po përhapej, disa grekomanë që shtinin frikë se musullmanët e Stambollit, janë spiunë të vënë nga policia e Portës, (e) mbyllë gojën, ca të bindur së vërtetës, disa nga frika se mos i marë Rumania për grekë a fillogrekë, me të cilët Guverna rumune nuk qe kaqe mire, dhe propaganda vinte përpara mjaft.”⁸³ Më pas si rezultat i disa mosmarrëveshjeve të anëtarëve të kësaj shoqërie me Nikolla Naçon, mbas ardhjes së këtij të fundit nga Egjipti në Bukuresht, kjo shoqëri e ndërroi emrin dhe u quajt shoqëria “Dituria”, po ashtu edhe periodiku që nxirrte kjo shoqëri u quajt “Dituria”, ndërkohë që grupimi i N. Naços do ta ruante me fanatizëm emërtimin “Drita” deri vonë.

Aktiviteti patriotik dhe kulturor i shoqërive shqiptare të Rumanisë vazhdoi me intensitet edhe në fillimet e shekullit XX, kështu intelektualët e shoqërisë “Shpresa” themeluar në Bukuresht në 12 shtator të vitit 1900, por që për arsye të mungesës së fondeve, nuk mundi të fillojë nga puna deri në fillim të vitit 1902, organizonin në qytete të ndryshme të Rumanisë ku jetonin emigrantë kryesisht korçarë, konferenca të karakterit albanologjik me intelektualë shqiptarë dhe rumunë të ftuar, ku flitej për historinë e popullit shqiptar, të gjuhës shqipe dhe traditave të hershme shqiptare, me qëllim ndërgjegjësimin kombëtar të bashkatdhetarëve të tyre. Rrethi kulturor i kësaj shoqërie, i përbërë kryesisht nga studentë universitarë, me kryetar biznesmenin e pasur Kristaq Daku⁸⁴ nxorri edhe një gazetë propagandistike të quajtur “Përlindja Shqiptare”.

Në dhjetor të vitit 1906, të treja shoqëritë Dituria, Drita dhe Shpresa, që funksiononin në Rumani, u shkrinë dhe formuan një shoqëri të re, shoqërinë Bashkimi. Megjithëse neni 2 i statutit të Bashkimit, thonte se qëllimi i shoqërisë ishte që të shtypte libra, të themelonte shkolla në Bukuresht dhe në Shqipëri, si dhe të botonte ose të subvenciononte periodikë letrarë në gjuhën shqipe, ajo u angazhua kryesisht në politikë⁸⁵.

Disa nga botimet dhe periodikët shqiptarë që dilyn në Rumani

Në vitin 1886, ajo që kurorëzon përpjekjen e patriotëve të kësaj kolonie në Bukuresht është inagurimi i shtypshkronjës së parë të ngritur me kontributet e mirëbërësve korçarë, dhe sidomos të filantropit Anastas Lakçe, me botimin e veprës së poetit tonë kombëtar Naim Frashërit “Dëshira e Vërtetë e Shqiptarëve” shkruar prej tij në gjuhën greke. Në këtë shtypshkronjë do të botoheshin më pas veprat e tjera të tij, si poema “Bagëti e Bujqësi”, “Istori e Përgjithshme për Mësonjëtorët e Para” 1886, “Lulet e Verës”, 1890, “Parrajsa dhe Fjala Fluturake” 1894, “Gjithësia” 1895, “Fletore e Bektashinjve” 1896, “Iliadhë e Omerit, Kënga e Parë” 1896, “Qerbelaja” 1898 dhe “Istoria e Skënderbeut” 1898, e cila ishte vepra e tij e fundit e botuar këtu. Në këtë shtypshkronjë, me iniciativën e patriotëve korçarë do të shtypeshin mbi 12000 libra shkollorë në gjuhën shqipe⁸⁶, të cilat do të shpërndaheshin gratis anë e kënd Shqipërisë, kudo ku ishin hapur, apo bëheshin përpjekje për hapjen e shkollave shqipe.

⁸³ Vissarion Dodani, *Memorjet e Mija*, Kostancë 1932, f. 19.

⁸⁴ Stavro Skëndi, *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*, Maluka, 2000, f. 144.

⁸⁵ Po aty, f. 145.

⁸⁶ Lasgush Poradeci, *Publicistikë*, Vepra III, tiranë 2010, f. 77.

Shoqëria “Shpresa”, në të cilën ishin përfshirë anëtarët e dy shoqërive të mëparshme “Diturija” dhe “Drita”, do të merrte përsipër edhe botimin e veprës poetike “Rreze Dielli” të nënkryetarit të shoqërisë “Shpresa”, Asdrenit, i cili do të vazhdonte me sukses në Rumani traditën e vjershërimit poetik të Naim Frashërit. Kjo traditë e rëndësishme botuese ishte kontributi më i rëndësishëm i kolonisë shqiptare të Rumanisë përkundrejt Rilindjes Kombëtare Shqiptare, ndërkohë që Rumania do të kthehej në një arenë të aktivitetit patriotik shqiptar.

Në Rumani gazeta më e vjetër shqipe ishte “Shqiptari”, themeluar në 1888 nga N. Naço dhe që botohej njëherë në javë. E shkruar në gjuhët shqipe, rumune dhe francze, ajo doli për disa vite rresht, ndonëse me intervale të gjatë ndërprerjeje. “Ylli i Shqipërisë”, organ i nacionalistëve shqiptarë i Dhimitër Ilos, u botua për herë të parë në vitin 1889 në Bukuresht. “Rilindja Shqiptare”, e përdyjavshmja e Thoma Avramit në shqip dhe frëngjisht, doli në vitin 1903. Në vitin 1900, dy studentë shqiptarë nga universiteti i Stambollit, Dervish Shima dhe Jashar Erebara, filluan të nxirrnin një gazetë dygjuhëshe, shqip dhe rumanisht në Bukuresht. Kjo gazetë nuk kishte lidhje me ndonjë nga shoqëritë. Programi i saj ishte pavarësia e Shqipërisë nën një princ të huaj dhe nën mbrojtjen e fuqive të mëdha. Kjo gazetë u mbyll shpejt për shkak të mungesës së fondeve dhe të protestës së ambasadës turke në Rumani⁸⁷. Gazeta me ndikim më të madh ka qenë “Shqipëria”, e cila ishte organ i shoqërisë “Dituria” dhe dilte nën ndrejtimin e Vissarion Dodanit. Një periodik i rëndësishëm për kohën ka qenë edhe gazeta “Flamuri” i Mihail Xoxes e cila dilte në Konstancë. Të gjithë këta periodikë u bënë tribuna të mendimit të rilindjes kombëtare, duke kontribuar njëkohësisht edhe në përhapjen e ideve të rilindjes në një masë të gjerë, por edhe duke parapërgatitur terrenin e nevojshëm për kultivimin e publicistikës dhe traditës letrare shqiptare.

Nikolla Naço dhe aktiviteti i tij kulturor në kryeqytetin rumun

Një kontribut të shquar në kryeqytetin rumun në formimin e shpirtit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare ka dhënë edhe patrioti rilindas Nikolla Naço, i cili dallohej për temperamentin dhe patosin patriotik. Dy miqtë e tij të ngushtë rumunë, që do ta përkrahnin përgjatë gjithë aktivitetit të tij atje, do të ishin Konstanidin Gr. Lahovari, kryetar i shoqërisë “Ileana” dhe I. K. Petrscu, sekretar i përgjithshëm i mbretit Karol I i Rumanisë. Me emrin e N. Naço, lidhet sidomos krijimi i Shkollës Normale në gjuhën shqipe dhe vllehe, në 10 maj të vitit 1892 në Bukuresht. Kjo shkollë kishte edhe konviktin e saj për nxënësit që vinin nga Shqipëria dhe Maqedonia. Rregullorja e kësaj shkolle u botua në formën e një libreze në gjuhën shqipe, rumune dhe frënge⁸⁸. Në nenin drejtor i shkollës dhe gazetës “Albanezul”. Pasqyrimin e këtij aktiviteti patriotik në funksion të Rilindjes, N. Naço e bën edhe në Europë, nëpërmjet dërgimit të kësaj rregulloreje kryetarëve të shteteve, në Rumani, Gjermani, Austro – Hungari, Itali, Francë etj. Këtë rregullore si dhe një pasqyrë të aktivitetit të tij ai, ua dërgon edhe shumë personaliteteve të politikës dhe të kulturës në Rumani. Kështu në 24 korrik të vitit 1892, ai ia dërgon këtë rregullore Dimitrie Butculescut, kryetar nderi i shoqërisë “Drita”, deputet i parlamentit rumun dhe mik i madh i tij dhe i shqiptarëve, së bashku me një letër

⁸⁷ Aktiviteti i Shqiptarëve në Rumani, Diturija, II, 1 Shkurt 1927, f. 147.

⁸⁸ Baki Ymeri, Nikolla Naço dhe atdhetarizmi i tij pedagogjik, Tiranë 2010, f. 4.

ku i shkruan: “Shoqëria jonë e re “Drita”, pati guximin të themelonte të parën shkollë me konvikt në Bukuresht, ku njëri prej drejtorëve të saj është zgjedhur akademiku rumun B. P. Hashdeu...”.

Ndërsa në vitin 1904 ai i dërgon një raport përfaqësuesit të Austro – Hungarisë në Bukuresht, Pallaviçinit, duke i bërë të ditur se në periudhën 1892 – 1894, ai kishte subvencionuar shkollat shqipe në fshatrat e Kolonjës, duke i bërë thirrje që të ndihmonte për hapjen e atyre shkollave sërish.

Patrioti publicist i Rilindjes Mihal Grameno, ka qenë një ndër nxënësit e parë të shkollës së N. Naços në Bukuresht⁸⁹, për t’u pasuar më pas nga nxënës të tjerë që kanë kaluar nga kjo shkollë, si Ibrahim Themon, Thoma Avram, Jashar Erebara, Dervish Hima, Aleks Stavre Drenova etj. Vetëm duke gjykuar nga këta emra mund të arrijmë në përfundimin se sa i rëndësishëm ishte ambienti rumun në krijimin e frymës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Kështu, nga sa thamë, arrijmë në konkluzionin, se ambienti i Rumanisë dhe sidomos kryeqyteti i saj Bukureshti, luajtën një rol të rëndësishëm, vendi do vendimtar thonim, në lindjen dhe emancipimin e lëvizjes patriotike, kulturore, arsimore dhe propogandistike, e cila mundësoi Rilindjen Kombëtare Shqiptare dhe e shprehu atë.

REFERIME

Historia e Letërsisë Shqiptare, Tiranë 1938.

Kourillas E. G. o Ar., *Oi alvanikis katagogis igemones tis Moldovllahias*, Theologia 1933.

Poradeci, L., *Publicistikë*, Vepra III, Tiranë 2010.

Vieta Noua, 5 Prill 1898.

Aktiviteti i Shqiptarëve në Rumani, Diturija, II, 1 Shkurt 1927.

Dodani, V., *Memorjet e Mija*, Kostancë 1932.

Ymeri, B., *Nikolla Naço dhe atdhetarizmi i tij pedagogjik*, Tiranë 2010.

Grameno, M., *Patriotët e Mëdhenj...*, Koha, N. Y. 3 Shkurt 1916.

Skëndi, S., *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*, Maluka 2000.

⁸⁹ Mihal Grameno, *Patriotët e Mëdhenj...*, Koha, N. Y. 3 Shkurt 1916.

NDIKIMI I GJUHËS SHQIPE MBI LIGJËRIMIN E SOTËM TË ARUMUNËVE VOSKOPOJARË NGA ZONA E GRABOVËS (GREAVA) SË SHQIPËRISË

Konf. Univ. Dr. Nistor BARDU
Universitatea “Ovidius”, Constanța

Aspekte leksikore

Marrëdhëniet gjuhësore ndërmjet dialektit arumun që flitet në Shqipëri dhe gjuhës shqipe, gjuha që flitet nga shumica e popullsisë në këtë vend, janë hulumtuar në linguistikën rumune nga Th. Kapidan në studimin *Marrëdhëniet shqiptaro-rumune* (Dakorumania, II, 1921-1922, Kluzh, 1922: 444-454) dhe më pas në sintezën *Arumunet* (1932). Th. Kapidan përcaktoi dy dhe përkatësisht tri nivele (stade) të influencës së gjuhës shqipe mbi arumanishtën e folur në Shqipëri.

Stadi (niveli) i parë daton që nga periudha e hershme dhe lidhet me qasjet e para ndërmjet paraardhësve të rumunëve: “që në kohën kur këta nuk ishin ndarë në degëzimet e sotme”, dhe paraardhësve të shqiptarëve. Kapidan saktëson se në këtë stad kemi të bëjme me “huazimin e fjalëve shqipe” cilat janë më të shumta nga dakorumanishtja se sa nga arumanishtja (Kapidan, 1932: 190). Duke lënë menjatë faktin se në këtë periudhë nuk kemi të bëjmë me huazimin e fjaleve nga shqipja, por kemi të bëjmë me fjalë të trashëguara nga fondi i përbashkët leksikor i stërgjysherve të shqiptarëve dhe të rumunëve, problem që tashmë është qartësuar, sipas mendimit tonë, nga studimet e Gr. Brënkush (*Fjalori autokton i gjuhës rumune*, 1983, *Hulumtime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune*, 1995), Kapidan vë re se terma të tilla, si: *a se bucura* (shqip. *bukuroj*), *bunget* (shqip. tosk. *bunk*), *cursă* (shqip. *kurthë*), *gata* (shqip. *gat*⁹⁰), *ghimpe* (shqip. *gjemp*), *mugur* (shqip. *mugull*), *pârâu* (shqip. *përrua*), *strepede* (shqip. *shtrep*) “krimb djathi”, *vare si ne varecare* (shqip. *valle*), *zară* (shqip. *dhalle*), *ghiu* (shqip. *gjush*, më e vjetër *gljush*), *hămesit* (shqip. *hamës*) gjenden në dakorumanisht, por mungojnë në dialektin arumun (Kapidan 1932: 170).

Në lidhje me këtë shtresë leksikore, Th. Kapidan, vëren se “sa u përket lidhjeve të kësaj periudhë ndërmjet arumunëve dhe shqiptarëve, rumunët e Shqipërisë të njohur si *fërsherotë*, nuk shfaqin asgjë më të vjetër në ligjerim se sa arumunët e kudondodhur, për sa u përket marrëdhënieve të tyre me shqiptarët” (Ibidem: 172).

Stadi i dytë, i identifikuar nga Th. Kapidan në *Marrëdhëniet shqiptaro-rumune*, është ai i fjalëve me origjinë shqiptare në arumanisht, fjalë të cilat nuk gjenden në dakorumanisht dhe të cilat datojnë nga periudha e ndarjes së arumunëve nga dakorumunët.

Nga termat e identifikuar nga autori për këtë shtresë leksikore permendim: *ba’u* (i referohet kalit) “*cu o pată albă în frunte*” (shqip. *balj*); *bucuvală* “ushqim që përgatitet nga buka, gjalpi dhe djathi i përvëluar mirë në zjarr” (shqip. *bukuvalje*); *đală* “një lloj dhallë” (shqip. *dhallë*); *daș*, “qengj shtëpie, i cili shoqëron fëmijët” (shqip. *dash*); *g’elă* “ushqim (i gatuar) n. n. N. B.)” (shqip. *gjellë*); *g’iză* “gjizë e një cilësie më të ulët” (shqip. *gjizë*); *kîpur* „këmbore, zilkë” (shqip. *kjiprë*);

⁹⁰ Ne fakt *găti*, *gat* është një formë e krijuar paralel, (cf. Brënkush 1983:77, 78).

mușcă “mushkë që kafshon” (shqip. *mushkë*, *mushk*) etj. (Kapidan, 1922: 491-493; Idem 1932: 173).

Per stadin e tretë, Th. Kapidan flet vetëm në veprën e tij *Arumunët* (173-177), duke saktësuar se, kësaj here, gjuha shqipe e ushtron ndikimin e saj vetëm mbi ligjërimin e arumunëve të Shqipërisë, njohës të mirë jo vetëm të gjuhës amtare, por edhe të gjuhës shqipe. Shembujt që jepen janë marrë nga kategoria e njësive leksikore të marra nga shkrimet arumune të fundshekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX, sidomos nga Kodeks Dimonie, si: *cănusescu* “kërcënoj” (< shqip. *kanos*, , ~”), *coθra* “papastëri, ndyrësi” (< *kotrë*, , ~”), *fae* “mëkat, faj” (<shqip. *faj*, , ~”) etj. Shembujt të tjerë jepen nga kategoria e shprehjeve frazeologjike, *trag mǎnǎ* “heq dorë nga diçka”: *nu trǎpse mǎna di furil’e ș-ul vǎtǎnarǎ* “nuk i la hajdutllëqet dhe e vranë”: shqip. “heq dorë”, *di oarǎ* “herët, që me natë”: *nǎ sculǎm di oarǎ* “u ngritëm që me natë”: shqip. *herët dhe hershëm*, “herët, me kohë” etj. *gioc di loc* “lëviz, ik, largohet” etj.

Ky artikull ka si qëllim këtë shtresë të fundme leksikore huazimesh dhe bazohet në anketime dialektore të zhvilluara mes arumunëve voskopojarë të Shqipërisë në vitet 1989, 2003 dhe 2004, 2007, 2008. Në këto kërkime të bëra në fshatrat e pastra arumune (*rǎmǎnești*), në krahinën voskopjare (Grabovë, Niçë, Llëngë dhe Shpiskë) dhe në veçanti, tek arumunët e Grabovës kemi vënë re praninë e gjithnjë e më shumë fjalëve shqipe në ligjërimin e sotëm të tyre, por edhe të arumunëve që jetojnë në territoret e lartpërmendura. Kjo dukuri është normale dhe është pasojë e përjasjes gjuhësore arumuno-shqiptare, ose më saktë e dygjuhësisë, e cila gjallon prej shumë shekujsh. Ajo që na duket se ka një rëndësi të veçantë është se shumica e këtyre fjaleve nuk bëjnë pjesë në kategorinë e neologjizmave, siç do të ishte e natyrshme, por ato vijnë nga fondi kryesor gjuhësor, duke hyrë kështu në konkurrencë me termat e trashëguara. Kështu janë, për shembull, termat nga fusha leksiko-semantike e emrave që përcaktojnë farefisninë, si: *bábi* (< shqip. *babi* < tc. *baba*, për *tátǎ*; *dái* (< shqip. *daje*,) *gági* (shqip. *xhaxhá* “xhaxha nga ana e babait”) për *lálǎ* “xhaxha”; *nǎnǎ* (< shqip. *nënë*) për *mámǎ* etj.⁹¹

Krahas tyre në gjuhën e folur kanë hyrë gjithashtu prej shumë kohësh fjalë të tilla, si *fisǎ* “1. fis, gjini” (< shqip. *Fis* “gjini, farefis, familje”; 2. “natyrë, karakter” (greq. *fisis*), *i zóti* “në gjendje, i aftë” (< shqip. *i zoti*), *mállǎ* “pasuri, pronë, përfitim” (<gr. *μάλα*, , fort, shumë” < tc. *mal* “mall, pasuri”), *véte* “person, personalitet, pasuri” (shqip. *vetë*), duke ekzistuar sipas të gjitha gjasave prej shumë kohësh në të folurin e përditshëm, për të zëvendësuar mungesën e termave me kuptim të përafërt nga fjalori i origjinës. Ekzistenca e këtyre fjaleve gjallon prej shumë kohësh, duke marrë parasysh faktin se grabovarët që emigruan ndërmjet viteve 1926-1938⁹² në Rumani dhe u kolonizuan në krahinën e Kadrilaterit dobruxhean, në komunën Koçumar të rrethit Durostor dhe më

⁹¹ Për më shumë informacion mbi këtë subjekt cf. Bardu (2004: 703-708).

⁹² Nikolae Saramandu (2004:27) jep vitet 1928-1938 si vite të emigrimit të tyre në Rumani, por nga të dhënat e mbledhura nga ne në rradhet e Grabovarëve nga fshati Nisipari, ku mbërriten shumica e tyre pas dorëzimit të Kadrilaterit në vitin 1940, rezulton se familja Guricë (Guriță) gjendej në Rumani që prej vitit 1926, cf. Mitri Guricë (n. 1920) dhe jo me 1928, siç thote Al. Rosetti (1929:80), i cili ka intervistuar në Kadrilater *Mihali Guricën*, babain e Mitri Guricës.

pas, në vitin 1940, në fshatin Nisipari të rrethit Konstancë, i përdornin ato rëndom në komunikim e tyre të përditshëm⁹³.

2. Në qoftë se terma si ato të mësipërmet gjenden prej shumë kohësh, mbase prej shekujsh në ligjërimin e atyre që sot jetojnë në Grabovë (Greava) (një provë përbën prania e tyre edhe në ligjëratën e grevenëve (grabovarëve) nga Nisipari të intervistuar prej nesh në vitet '70 të shekullit të shkuar, mund të themi se njësitë leksikore (morfemat gjuhësore) për të cilat do të flasim në vazhdimësi, kanë hyrë në ligjëratën e grabovarëve të sotëm në dekadat e fundit. Ato bëjnë pjesë në fushën semantike të botës së fshatit dhe banesës.

BÁGO, s. f., *cășărie* “punishte djathi, *Duș*“ *lăptili la băgo* “çova qumështin në baxho”. Sot në Grabovë, pothuajse asnjëri nuk e përdor me emrin *cășărie* (<lat. *casearia*), në ndryshim nga pasardhësit e grabovarëve të vendosur në Rumani, në Nisipari, të cilët ende e vendosin atë në kontekstin e duhur: *Nea Sîma ări cășăria acăsă la el* (<shqip. “Xhaxha Sima e ka baxhon në shtëpinë e tij”).

Take Papahaxhi, DDA, regjistron *băgău* me kuptimet e mëposhtme: *baci*, me saktësimin që ky është një shqiptim i rrallë dhe i gabuar i fjalës *băcău*, 1. “baxho, punishte djathi” dhe 2. “djathë në ajkë (i ujshëm), e ruajtur në lëkurë të parregjur” (konsiderohet djathi i të varfërve).

Mund të besojmë se tashmë *băgo*, i përdorur në komunikimin e përditshëm të rritësve të deleve nga Grabova, risjell formën e vjetër *baci*, fjalë e trashëguar nga nënshtrësia dakorumune, meglenorumune (*bačiu*) dhe istrorumune (*ba^ote*). Brënkush, (1983: 31-32), konsideron se në arumanishten e folur në Shqipëri, fjala *baci* ka humbur në konkurrencë me fjalën *cășar* (<lat. *casearius*) dhe me fjalët që u referohen nënprodukteve të saj; *cașu*, *cășăre*, *cășărie*, *cășeat* etj, të cilat i ka regjistruar Rosetti (1929). Në zhdukjen e arum. *baci*, na thotë më tutje Grigore Brënkush, kanë ndikuar edhe sinonimet, si *čilinicu* (<*čelnic*, v. sl. *čelīnikū*), si *bağëgi* (<shqip. “baxhoxhi”) ky i fundit është rezultati i fjalës *bazho*.

Në shqip, *baç*, me kuptimin “baxhoxhi, ai që përpunon djathin” saktëson Brënkush, përdoret shumë rrallë pa qenë i regjistruar në FS, të shpeshta janë *djathar* (<*djathë*, “brânză”), *gjizar*, *baxhoxhi*. DARFSR regjistron fjalën *bacë*, s. M “bade, bădie, bădică, bădiță”.

Gjithsesi, mund të themi se ndërmjet fjalëve *baci* dhe *băgo* ekzistojnë lidhje që gjallojnë nga fondi me shtresë gjuhësore të përbashkët të gjuhës rumune dhe shqipe.

BÓTĂ, s. f., pa shumës, “botë”. Kjo njësi leksikore (morfem gjuhësor) zëvendëson në shqiptimin e arumunëve nga Grabova (Greava), termin që përdorej zakonisht në të shkuarën *duńăe*, të hasur nga ne në Rumani, në Nisipar edhe në variantin *duńee*, të artikuluar *duńea*. Take Papahaxhi, DDA, na jep format *duńăe* për veriun dhe *duńăvă* me kuptimin e “botës”, etimoni është turq. *doun*/o. Pyetjes sonë, subjekti TB, “*La ți spunet bótă?*”, ai iu përgjigj “*la duńă*” (dynjasë). Edhe pse nuk patëm kohë që të thellohem nëse *bótă* është fjala më e përdorur se sa *duńă* ose *duńăe*, ka shumë mundësi që si në rastin e shqiptimit të këtyre dy termave kemi të bëjmë tani për tani me një alternim të lirë, me saktësimin se brezat e rinj anojnë nga shqiptimi i *bótă*, më e

⁹³ Kemi dëgjuar personalisht shqiptimet *nănă* dhe *băbi* tek arumunët Grabovarë nga fshati Nisipari, ose emrat *găgi* dhe *dăi* bëjnë pjesë në të folurin e përditshëm të familjes tone dhe i përdorim vetë ne në diskutimet me dhe për personat që kishin këtë lidhje farefisnore me ne.

lehtë në përdorim, në krahasim me tradicionalën *duńśće* (Vjen nga shqipja *bótë*, s. f., “bota, Toka, universi”, cf. DARSFR s. v.)

AÓMĀ, shumës. *đómi*, s. f., “dhomë, odë, konak”: *Căti đómi ari casa távǎ*, “câte camere are casa ta”, “Sa dhoma ka shtëpia jote?”. Pyetja na është drejtuar shumë herë në bashkëbisedimet e lira që patëm me subjekte të ndryshme nga Grabova e sotme apo me ata me prejardhje prej andej të vendosur tashmë në Elbasan. Kur iu tërhiqnim vëmendjen të shpreheshin “pi limba noastrǎ”, atëherë të intervistuarit T.B., Dh.B., korrigjonin vetën dhe zëvendësonin në fjali *đómǎ* me *cunǎcǎ*. Në Nispari, për kuptimin e “dhomës”, termi i përdorur nga grabovarët e brezave të ardhur nga Shqipëria, ishte *cunǎcǎ*, shumës *cunǎŕi*, s. f., fjalë e cila evokon për folësit e dakorumanishtës fjalën *conac* “shtëpi pasanikësh në fshat, në një fermë, rezidencë e një prefekti apo nënprefekti” dhe kuptime të tjera që rrjedhin prej saj: ‘vendpushim, distancë ndërmjet dy vendpushimeve’ etj. Në DDA, Take Papahaxhi regjistron fjalën *cunǎke*, shumës *cunǎkŕi*, me afërsisht të njëjtat kuptime si në dakorumanisht *popas*, shqip “vendqëndrim gjatë udhëtimit, etapë, stacion; distanca që përshkojmë gjatë një ditë; rezidencë qeveritare”.

Pra, kuptimi i fjalës “dhomë, odë” nuk shënohet nga Take Papahaxhi, kjo na bën të besojmë se kjo fjalë merr këto kuptime vetëm në ligjerimin e voskopojarëve.

Etimoni, si për fjalën *cunǎcǎ*, ashtu edhe për fjalën *cunǎke*, është turq. *qonaq* (konak) (cf. DDA, DEX s. v. *conac*). Per *đómǎ*, etimoni është shqip “dhomë, odë, konak” (<lat. *Domus* “shtëpi, banesë”).

GOT, shumës *goti*, s. n. “*pahar*”, (<shqip *gotë*): *Haŕdi, bea un got d’arkŕie, cǎ viniŕ’di diparti* “hai, bea un pahar de rachiu, ca ai venit de departe”, < shqip “eja, pi një gotë raki se ke ardhur nga larg”. Njësia leksikore (morfemi gjuhësor) *got* zëvendëson në ligjërimin e moskopolenëve nga Grabova (Greava) fjalën arumune *cúpǎ*. Në Nispari, *cúpǎ* (*un cupǎ di arkŕie*) përdoret shumë rrallë dhe vetëm nga të moshuarit. Të rinjtë, të lindur në Rumani thonë më lehtë *un pahár di in^u*. Zëvendësimi i detyrohet prirjes që shfaqet rëndom tek folësit brezit të ri të arumunëve për të lënë mënjane disa shqiptime të fjalëve të caktuara nën trysninë e gjuhës zyrtare, fjalë të cilat i përdorin gjithnjë e më shpesh në komunikimin e përditshëm (Vjen nga shqipja *gotë*, s. f., me të njëjtin kuptim).

LÁG’E, pl. *lag’i* s. f., “grumbull banesash, lagje, mëhallë”: *lág’a o Ćucólári*, “lagja (mëhalla) e Ćuçollarëve (e atyre që kanë mbiemrin Ćúco)”; *acóma s-fǎŕi un lág’i návǎ*, “atje po ndërtohet (bëhet) një lagje e re”.

Tek grabovarët (grevenët) e Nisiparit, ne kemi regjistruar *mǎhǎlǎ* (< tc. méhallé), si referencë përkatëse, ndërsa *lágje* përdoret rrallë, vetëm nga ata, të cilët gjatë viteve ‘60 dhe ‘70 të shekullit të kaluar kanë qenë në Shqipëri për të vizituar vendlindjen. Në Grabovën (Greava) e sotme, fjala *mǎhǎlǎ* përdoret gjithnjë e më rrallë në kuptimin e lartpërmendur. Nga shqipja *lagje* “bashkësi, grup”, cf. DARFSR S. V. Papahaxhi, DDA, nuk e regjistron.

TAVOLINǎ, shumës *tavolini*, s. f., “tavolina”, “mobilje e formuar nga një pllakë drejtkëndore, katrore apo e rrumbullakët, që mbahet nga një apo më shumë këmbë dhe mbi të cilën hahet apo shkruhet”. Sot, kur elementet e civilizimit urban kanë depërtuar deri në fshatrat më të thella të Shqiperisë, po ashtu edhe në Grabovë (Greava) pothuajse askush nuk e përdor më termin *sófrǎ*,

shumës *sófri*⁹⁴, i përdorur shumë dekada më parë. Voskopojarët grevenë nga Nisipari përdornin që në vitet '50, '60 të shekullit të kaluar, si “tavolinë”, objektin e quajtur *sófră*, përsëri “një lloj tavolinë, zakonisht e rrumbullaket, por më e ulët, pra me këmbë më të shkurtra”, *S-bâgăm sófra s-măcăm păni* thuhej shpesh atëherë kur afrohej ora e të ngrënit në drekë apo në darkë”. Për shembuj të tjerë, cf. DDA s. v. Me kohë, mobilja e quajtur *sófră* u zëvendësua me termin e zakonshëm *tavolinë*, ndërsa njësia leksikore (morfemi gjuhësor) *sófră* u zhduk nga ligjerimi i përditshëm. Një dukuri e ngjashme duhet të ketë ndodhur edhe në jetën dhe ligjerimin e voskopojarëve të mbetur në Grabovë dhe më pas të shpërngulur në qytete, vendin e fjalës *sófră* e ka zënë neologjizmi *tavolínă*, i huazuar me shqiptim të njëjte nga shqipja (*tavolínë*, cf. DARFSR), e cila e ka huazuar nga italishtja.

Në përgjithësi, prania e fjaleve me origjinë shqiptare në ligjërimin e arumunëve të Shqipërisë, apo në veçanti prania e tyre në ligjëratën e voskopojarëve, është deri në një fare masë një dukuri e natyrshme. Duke mos lëvizur nga këto troje për qindra vjet, arumunët voskopojarë nga Grabova (Greava), si dhe ata nga fshatrat e tjerë nga zona e Voskopojes (shiko *më lart*), kanë hyrë në kontakt gjuhësor me shqiptarët, duke bërë të mundur shfaqjen e dukurisë së dygjuhësisë,⁹⁵ e cila ka sjellë ndikime të ndërsjellta, sidomos në fushën e leksikut.

Duke pasur parasysh realitetin shoqëror e gjuhësor të arumunëve të sotshëm në Shqipëri, i krijuar, midis të tjerash, nga martesat e përziera, është e mundur që dinamika e fjalorit të së folurës së tashme të arumunëve voskopojarë nga fshati Grabovë në Shqipëri, të cilët kanë ruajtur deri tani në mënyrë të veçantë veçorinë etnogjuhësore dhe kulturore, reflektohen tendenca më të theksuara drejt elementëve të sipërtrajtuar.

REFERIME

Bardu 2005 = Nistor Bardu, *Elemente gjuhësore shqiptare në ligjërimin e sotëm të arumunëve voskopojarë të Shqipërisë*, në Gabriela Pană Dindelegan (koord.), *Gjuha rumunë – struktura dhe funksionimi*. Shtëpia Botuese e Universitetit të Bukureshtit (Aktet e kolokiumit të 4-ët të Katedrës së gjuhës rumune).

Borbély 2009 = Anna Borbély, *Dygjuhësia*, në vol. *Çrregullime në komunikimin gjuhësor, letrar dhe etnofolklorik rumun dhe konteksti evropian*, Iash, Shtëpia botuese Alfa (Akademia rumune, Instituti i filologjisë Rumune “A. Filipide”).

Brënkush = Grigore Brënkush, *Fjalori autokton i gjuhës rumune*. Bukuresht, Shtëpia Botuese Shkencore dhe Enciklopedike.

Bukuresht, Shtëpia botuese e Akademisë, 1974.

DARFSR = Renata Topciu, Ana Melonashi, Luan Topciu, *Fjalor shqip-rumanisht*.

DDA = Tache Papahagi, *Fjalori i përgjithshëm dhe etimologjik i dialektit arumun*,

DEX = *Fjalori etimologjik i gjuhës rumune*, Bukuresht, Shtëpia botuese e Akademisë, 1984.

⁹⁴ Në ligjerata të tjera të arumanishtës ekziston edhe forma *sufra*, më e afërt me etimonin turk *sofra*, cf. Papahaxhi, DDA, s. v., që rregjistron edhe formën *sofra*, loc. cit.

⁹⁵ Aspekte të ndryshme të dukurisë së dygjuhësisë, të cilat mund të shpjegojnë pjesërisht gjendjen e ligjërimit të sotëm të arumunëve të Grabovës, janë prezantuar nga Anna Borbély 2009: 33-42. në artikullin *Dygjuhësia që ka dalë në vol. Çrregullime në komunikimin gjuhësor, letrar dhe etnofolklorik rumun dhe konteksti evropian* Iash, Shtëpia botuese Alfa 2009 (Akademia rumune, Instituti Filologjik Rumun, , A. Philippide”).

Dhionis Paço (DP), 42 vjeç, marangoz, bujk; jeton në Grabovë.

Dhori Bardhi (DB), 73 vjeç, murator, bujk; deri 60 vjeç ka jetuar në Grabovë; tani jeton në Elbasan. Iash, , , Polirrom”, 2003.

Kapidan 1922 = Kapidan, Th., *Marrëdhëniet Shqiptaro-Rumune*, në, , Dakorumania”, II, 1921-1922, Kluzh, fq. 444-454.

Kapidan 1931= Kapidan, Th., *Fersherotet. Studim Gjuhesor mbi arumunet e Shqiperise* ne, , Dakorumania”, VI, 1929 – 1930, Bukuresht, fq. 1-210.

Kapidan 1932 = Kapidan, Th., *Arumunet, Dialekti Arumun. Studim gjuhesor*. Bukuresht

Rosetti 1929 = Rosetti, Al., *Hulumtime mbi ligjerimin e arumunëve të Shqipërisë, në Ligjerim dhe shpirt*, vol. IV, fashik. I-II, Bukuresht 1929-1930, fq. 1-83; 377-380.

Saramandu = Saramandu, Nikolae, *Studime arumune dhe meglenorumune*, Konstancë, “Ex Ponto”.

Sigla

Subjekte

Todi Buzo (TB), 45 vjeç, tregtar; jeton në Grabovë dhe në Elbasan.

NDIKIMI I POETËVE MODERNË RUMUNË NË VËLLIMIN “PSALLME MURGU” TË ASDRENIT

Dr. Jonela Spaho

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, UK “Fan S. Noli”

Hyrje

Aleks Stavre Drenova, i njohur me pseudonimin Asdreni, është një poet vepra e të cilit paraqet interes si nga konteksti historiko – letrar i kohës kur u shkrua, ashtu dhe nga ideomatika dhe mjeshtëria artistike e saj. Asdreni hyri në historinë e kulturës dhe letërsisë shqipe me vëllimet “Reze dielli”, botuar në Bukuresht më 1904, “Ëndrra dhe lot”, botuar po në Bukuresht më 1912, “Psallme murgu”, botuar në Bukuresht më 1930 dhe vëllimin “Këmbanat e Krujës”, botuar pas vdekjes, më 1971.

Asdreni ishte një personalitet kompleks për të cilin krijimi nuk ishte vetëm një akt i shprehjes së vetvetes dhe të gjithçkaje që e mundonte, por ishte pikëpikë një nevojë për të frymëmarrje. Vlera e veprës së tij nuk mund të peshohet dhe as të klasifikohet, sepse një pjesë e poezisë së tij është atdhe, një pjesë është dashuri, një pjesë është dhimbje dhe një pjesë e veçantë dilemë. Autori i himnit të flamurit që e përshtati sipas variantit të poetit dhe kompozitorit rumun Plumbesku, himn të cilit i dha frymën e tokës ku lindi, autori i poezisë së angazhimeve të fuqishme atdhetare e sociale, do të ishte më pas poeti i paradokseve të mëdha. Asdreni ishte një autodidakt dhe erudit që boshllëkun e jetës dhe vetminë e saj e mbushte me lexim. Duke njohur mirë rumanishten dhe frëngjishten, ai do t’i hapte dritare të reja dijes, prej nga do të këndvështronte gjithë krijimtarinë e tij dhe alteregon e vet do ta shprehte në optika të reja, sa ballkanase aq edhe europiane. Duke jetuar pjesën më të madhe të jetës në Rumani, ishte e natyrshme që ai të ndikohej nga rrymat e letërsisë rumune, të cilat, veçanërisht, gjatë fundit të shek.XIX dhe fillimit të shek.XX, shfaqnin një nivel më lartë zhvillimi e mjeshtërie sesa letërsia shqiptare e asaj periudhe. Siç pohon dhe akademik Rexhep Qosja, që ka bërë monografinë më të plotë rreth jetës dhe veprës së Asdrenit, letërsia rumune, duke filluar prej romantizmit e këndeje, ka luajtur rol vendimtar në formimin e shijes, në formimin e ndjeshmërisë poetike, në orientimin e interesimit dhe në përgjithësi në ndërtimin shpirtëror të Asdrenit si krijues.⁹⁶ Dhe jo vetëm kaq. Është i pranueshëm fakti se poezia rumune ndikoi dukshëm në pjekurinë artistike të poetit dhe në formimin e mjaft elementeve të formës dhe përmbajtjes. Ndikimi i poezisë rumune të Asdreni do të vinte jo vetëm prej faktit se ai jetoi në Rumani gjatë gjithë jetës së tij, por edhe për faktin se Rumania është një vend i Ballkanit, që nga pikpamja historike ka kaluar ngjarje të krahaseshme me ato në Shqipëri. Përveç aspektit artistik i cili i intereson në mënyrë të veçantë, Asdreni do të shihej në letërsinë rumune tema që përkonin me çështjet kombëtare, sociale, politike dhe morale shqiptare. Në krijimtarinë e Asdrenit, janë vërejtur dukshëm ndikime të poetëve të periudhave të ndryshme të letërsisë rumune, por në këtë punim ne do të veçojmë disa prej tyre. Çështja e ndikimit të Asdrenit nga poezia rumune është një çështje e rëndësishme për të kuptuar Asdrenin, por edhe për të kuptuar krejt tendencat e reja të poezisë

⁹⁶ R. Qosja, Asdreni, jeta dhe vepra, Tiranë, 2002, f .278.

shqiptare në fillim të shekullit XX. Me ndikimet prej kësaj poezie Asdreni sjell një dukuri të njohur në letërsi: pasurimin e letërsive kombëtare. Në poezinë e Asdrenit pohojmë se ka ndikime, ka imitime, por ka dhe përshtatje nga poetët e njohur rumunë, por gjithmonë ai përshtat ato poezi që i shkojnë shijes dhe botëkuptimit të tij artistik dhe estetik. Po sipas prof. R. Qoses, sikur të mos kishte qenë në gjendje të përvetësonte një ndikim të tillë prej poezisë rumune, poezia e tij do të ishte një pasardhëse e zbehtë e poezisë së Naim Frashërit apo e poezisë sonë popullore.⁹⁷

Ndikimet në fazën e parë të krijimtarisë

Në poezinë e periudhës së parë të krijimtarisë së Asdrenit spikasin dukshëm elementët e romantizmit kombëtar të ndikuar nga lirikat patriotike të poetit Vasile Aleksandri. Ky ndikim duket më qartë tek “Kënga e bashkimit” e Asdrenit, e cila është një përshtatje e poezisë “Hora uniri” e Aleksandrit. Vasil Aleksandriu është një ndër korifejtë e letërsisë romantike rumune. Si gjithë romantikët ai është mbështetur gjerësisht në krijimtarinë popullore rumune, çka e vëmë re dukshëm dhe tek Asdreni në fazën e parë të krijimtarisë së tij. Tek Aleksandriu ai parapëlqeu motivin atdhetar, angazhimin social dhe politik, frymën e bashkimit dhe vllazërimit që do të përshkojnë tërësisht si mesazhe pjesën më të madhe të himnit të flamurit: Asdreni i ka veshur poezisë së Aleksandriut frymën shqiptare, duke sjellë për bashkëkombasit mesazhin e madh të bashkimit: “*Të dy jemi të një nëne, / Të një lloji dhe një fare, / Si dy pemë në një trung, / Si dy sytë në një dritë.*”(V.A) dhe : “*Prej një nane jemi lerë, / muslimanë e të krishterë, / më një diell jemi rritur, / Si dy lisa pranë ngjitur*”(Asdreni) ose: “*Të dy kemi në një emër, / Që të dy një fat në jetë, / Më je vëlla e të jam vëlla, / Tek të dy një zemër rreh*”(V.A) dhe: “*Të dy kemi një dëshirë, / se një sisë kemi pirë, / Një të qeshur një të qame, / e një zemër të pandame.*”(Asdreni)⁹⁸

Poezisë së Aleksandriut, Asdreni i ka shtuar fjalët *besë*, *burra* etj dhe fjalën *malësor* e ka zëvendësuar më fjalën *gegë* dhe, natyrisht, ka futur brenda poezisë frymën dhe psikologjinë shqiptare, që në thelb është një me atë ballkanase e respektivisht atë rumune, ndërsa vargun, strofën dhe metrikën ka ruajtur atë të poezisë së Aleksandriut.

Objekti i këtij punimi është ndikimi i poetëve modernë rumunë në vëllimin “Psallme murgu”, i cili me të drejtë është cilësuar si një nga vëllimet poetike që solli modernetin në letërsinë dhe poezinë shqiptarë të fillim shekullit XX, respektivisht duke kapërcyer traditën dhe duke sjellë risitë. E sollëm këtë shembull nga vëllimi “Ëndrra dhe lot”, për të treguar se sa e rëndësishme është çështja e ndikimeve të këtyre poetëve, veçanërisht në këtë vëllim që hapi një sipar të ri për krejt poezinë tonë të ndrojtur dhe larg ndikimeve perëndimore. Siç thekson dhe profesor Ali Xhiku: “Në vëllimin “Psallme murgu” të Asdrenit, veçanërisht me lirikën e Lasgushit në poezinë e viteve ’20-’40 nisi të shfaqej bashkë me thellimin e subjektivizmit, shumëkuptimësia, mundësia e leximeve të ndryshme, madje një lloj hermetizmi”⁹⁹. Kështu nis të marrë trajtë një shfaqje që tani nuk mund të quhet më mezi e dukshme, prirja për t’ju drejtuar një publiku më të kultivuar, duke trajtuar në

⁹⁷ Po aty, f. 298.

⁹⁸ Asdreni, Vepra 1-2, Tiranë, 1980

⁹⁹ Ali Xhiku, Letërsia shqipe si polifoni, Tiranë, 2004, f. 171

mënyrë më të rafinuar temën meditative ose duke theksuar shumë përmbajtjen filozofike të motiveve të reja. Krijimtaria e Asdrenit këtu bëhet më e vështirë për t'u kuptuar dhe shpesh ajo kthehet në një lloj jehone të vetvetes. Tani Asdrenin fillojnë ta shqetësojnë tema universale dhe kozmogonike, tema që kanë të bëjnë me shpirtin e njeriut, me njohjen e zotit, me mishërimin e shpirtit, me një shfaqje tjetër të bukurisë dhe dashurisë, të cilën nuk nguron ta quajë mallkim, mëkat, ngasje djallëzore dhe së cilës bën mirë që t'i largohesh. Për të arritur unitetin e formës me përmbajtjen ai tenton një formë të re stilistike çka ka bërë që mungesën e frymëzimit spontan dhe shpërthyes, patetizmin dhe sinqeritetin e shprehjes ta zëvendësojë me punime këmbëngulëse me anën tingullore të vargut, me metrikën dhe figuracionin.

Ndikimi nga poezia e M. Emineskut

Poeti tjetër rumun, i cili luajti një rol të ndjeshëm në krijimtarinë e Asdrenit, jo vetëm me idealizmin e tij panteist, brengën e shekullit dhe frymën bajroniane, por edhe me elementë konkretë të metrikës, vargut dhe fjalorit poetik, do të ishte poeti Mihail Eminesku. Asdreni do të frymëzohej prej Emineskut sa në motivin atdhetar dhe në atë shoqëror, po aq edhe në motivin filozofik, dashuror dhe në poezinë e natyrës. Eminesku ishte një fenomen në letërsinë rumune, i cili zëvendësoi trajtat dhe mënyrat e vjetra tradicionale të poezisë me trajta të reja të papara deri atëhere, trajta të krijuara e të nxjerra drejtpërdrejt nga thellësia mistike e psikologjisë së kombit të vet. Eminesku siç thotë Kuteli ishte si albatrosi i Bodlerit, kishte krahë të gjatë e të fortë për të fluturuar në botët e idealit, po këta krahë e bënë të mos mund të ecte në tokë.¹⁰⁰

Ndikimi i Emineskut te Asdreni, sipas prof. Vehbi Balës, duket në poezinë atdhetare, sociale dhe në poezinë e natyrës.¹⁰¹ Ndikim nga Eminesku ka pasur dhe në vjershat e vëllimeve të para të Asdrenit, si vjersha "Epigon", që është imitim i vjershës me të njëjtin titull të Emineskut "Epigonii" si dhe vjersha "Dëshira ime" që është një parafrazë e vjershës së tij "Mai amun singur dor" ("Kam një të vetmin mall"). Por, nëse i referohemi vëllimit "Psallme murgu", vjersha që është ndikuar e shkruar nën frymën emineskiane është ajo me titull "Venetiku", që qëndron pothuaj në të njëjtin nivel me vjershën "Venetia" të Emineskut. Ashtu si Eminesku edhe Asdreni, këtë vjershë e shkruan në trajtën e tingëllimës, veçse me ndryshimin se Eminesku e ka ndërtuar me 4 strofa, ndërsa Asdreni me 5 dhe me një varg të vetëm në fund të tingëllimës. Ashtu si Eminesku dhe Asdreni vjershën e ka ndërtuar nëpërmjet kontrastit mes së shkuarës së lavdishme të Venecies, shkëlqimit, krenarisë dhe madhësisë së dikurshme dhe heshtjes dhe shkretisë që sundon sot në këtë qytet dikur fatbardhë: "*S'ka jetë Venetiku, i shkretuar, / nuk ndihen këngë, s'shihen drita e valle, / mbi shkallët prej mermeri e mbi portalle, / ndrin hëna, muret duke argjenduar* (Eminesku) dhe: "*U shojt shkëlqimi i yt, o Venetik, qytet krenar nër vepra madhështore*" (Asdreni). Asdreni përdor të njëjtat detaje dhe simbole si tek poezia homologe e Emineskut: pallate, kisha e Shën Markut, gjëmimi i valëve etj: "*Shën Marku, si një murg tej motesh mbetur, / mesnatën lajmëron me zë*

¹⁰⁰ M. Kuteli, *Vepra letrare*, Tiranë, 1990, f. 249.

¹⁰¹ V. Bala, *Lidhjet kulturore shqiptaro-rumune*, Buletini shkencor i IP, Shkodër, 1996, f.12.

kambane” (Eminesku)¹⁰² dhe: “*Këmbanat e Shën Markut sot se kanë, / njatë tingëllim hyjnor që zjej qyteti*” (Asdreni)¹⁰³

Me sa duket, Asdreni përshtati ato poezi që i afroheshin shijes së tij, por i përshtati edhe për faktin se pati mundësi të krijojë figura të reja dhe pamje të reja si në rastin e vjershës në fjalë, sikur kërkon të vërë në konkurrencë vargun e gjuhës shqipe me vargun original, për të parë se cili tingëllon më bukur. Mihail Eminesku, po sipas prof V.Balës ka ndikuar që në titull, po ashtu dhe tek Asdreni është fjala *pyll*¹⁰⁴ (“Fëshfërimë pylli”, “Pse lëkundesh ti o pyll?”, “Legjenda e pyllit”) dhe tek Asdreni (“Vaje e pyllit”). Në poezitë e Asdrenit përdoret gjithashtu shpesh fjala *yll*, që është një ndër fjalët më të përdorura në leksikon emineskian: “Sa gjëmë yj”, “Gjer te ylli”, “Kush e di sa yje”, “Ylli i dritës” dhe “Ylli i zjarhtë”, “Ylli i harruar” tek Asdreni. Po ashtu, një ndër fjalët më të gjendshme te Eminesku është fjala *mall*, në kumtimin një mungesë, një dhimbje, një ndarje ose një distancimi prej dikujt dhe diçkaje, fjalë që e gjejmë shpesh të përdorur në shumë poezi të vëllimit. Sipas studiuesit R. Qosja edhe simboli i *korës* (ikonës), që aq shpesh përmendet në vjershat e Asdrenit tek vëllimi në fjalë, është i trashëguar prej Emineskut.¹⁰⁵ Ngjashmëri vërehet dhe në shfrytëzimin e simboleve mitologjike tek të dy krijuesit: *Diana*, *Glosa*, *Veneradhe Madona* (Eminesku) dhe *Argusi*, *Minerva*, *Narqisi*, *Prometeu* (Asdreni)

Ndikimi nga poezia e T. Argezit

Në vëllimin “Psallme murgu”, që konsiderohet si kulmi krijimtarisë poetike të Asdrenit, do të ndihet dukshëm ndikimi i Aleksandru Maqedonskit, babait të simbolizmit rumun dhe i Tudor Argezit, poetit të madh lirik rumun të shekullit XX. Argezi solli në letërsinë rumune një stil dhe një formë të re letrare, e cila do të ndikonte mjaft në krijimtarinë e poetëve pasardhës. Gjurmët e Argezit në poezinë e Asdrenit janë vërejtur në frymën mistike, në angazhimin moral, si dhe në elementet e simbolizmit dhe ekspresionizmit¹⁰⁶. Në poezinë e këtij autori ndihet ndikimi i Bodlerit, simbolizmit dhe ekspresionizmit. Simbolika e poezive të vëllimit “Psallme Murgu” si dhe ndikimi i fjalorit poetik, duket qartë që janë trashëguar prej poezisë së Argezit. Tudor Argezi është një prej autorëve kanonikë të letërsisë rumune dhe një nga shkrimtarët më të njohur rumunë. Asdreni do të ndikohej prej vëllimit të tij “Psallet”, të cilat trajtojnë trazimin e poetit mes pohimit dhe mohimit, mes besimit dhe mosbesimit. Shumica e psalmeve shprehin dëshirën e poetit për të fituar siguri në lidhje me zotin. Asdreni në fillim donte ta titullonte vëllimin e tij “Mure burgu”, në mënyrë që mos imitonte Argezin me psallet e tij, ndikimi prej të cilave në pjesën më të madhe të vjershave është i dukshëm. Te vëllimi “Psallme murgu”, ashtu si te psallet e Argezit bëhet një lloj jehone e vetvetes. Në këtë vëllim Asdreni, ashtu si Argesi është në kërkim të zotit, është në kundërshti me veten dhe realitetin. I munduar vazhdimisht të kuptonte ç’ ishte jeta, ç’ ishte ekzistenca, ai do të shfaqte

¹⁰² M. Eminesku, *Poezi*, Tiranë, 1999, f.111.

¹⁰³ Asdreni, *Vepra letrare, II*, Tiranë, 1980.

¹⁰⁴ V. Bala, *Lidhjet kulturore shqiptaro-rumune*, Buletini shkencor i IP, Shkodër, 1996, f.22.

¹⁰⁵ Rexhep Qosja, *Asdreni, jeta dhe vepra*, Tiranë, 2002, f. 83.

¹⁰⁶ Robert Elsi, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë – Pejë, 1997, f. 267.

mëdyshjet më të thella tek të cilat shkonte me shumë vështirësi dhe përmes shumë sprovave shpirtërore.

Ekzistojnë 16 poezi me titull “Psalm” të Argezit, të botuara në vëllime të ndryshme. Cikli argezian i poezive me titull “Psalm” hedh dritë drejt hapjes filozofike të të menduarit të poetit, gjë që i takon poezisë së dijes. Ideja qendrore e këtij cikli është se kërkimi i hyjnore dhe aventura e njohjes ka dy koordinata: një të brendshme për të zbritur në vetvete, dhe një të jashtme në kërkim të zotit, tek elementet e botës materiale që e rrethojnë. Uni lirik luhartet midis dy tendencave kontraktore: besimit dhe mohimit.¹⁰⁷ Në thelb, Argezi i përgjërohet fuqisë hyjnore që t’i shfaqet nën formën e një shenje të prekshme. Ai sjell si shembull rrëfimin e Dhiatës së Vjetër: “*Je shfaqur disa herë, / dhe gjithmonë me rroba Perandori*” (Psalmi VII).¹⁰⁸ Në mungesë të një shenjë hyjnore, Argezi dëshiron ta provokojë duke përshtatur dy qëndrime: mohimin e zotit (uni lirik shpallet Perëndia e tij, duke qënë “*kusar i qiejve që kryen mëkate të pafalshme*”), ose afirmimi dhe mbarimi shpirtëror për shkak të pamundësisë së komunikimit. Psalmi VI është konsideruar si matrica e mendimit psalmik argezian. Katër strofat e poezisë flasin për një qëndrim hezitues mes prirjeve të kundërta: rebelim ose tërheqje. Kjo sjellje del dhe nga antonimet: “*zhurmë - heshtje*”, “*besimi - mohim*”, “*të jesh - të mos jesh*” etj. Kërkimi i hyjnisë është i vështirë. Megjithatë, vargu: “*dhe nuk i lejoj vetes t’ju rrëzoj poshtë nga qielli*”, është një afirmim i besimit të fortë tek Zoti, që edhe pse është i vështirë për t’u shfaqur, ai jeton në shpirtat e njerëzve. Strofa e fundit njofton, përsëri, një sfidë: “*Vetëm, tani, në historinë tënde të madhe, / rri me ty të matem përsëri*”¹⁰⁹. Çështja që shtrohet këtu është një metaforë që përfshin historinë fetare të besimit, historinë e njerëzimit; dy “kundërshtarët” matin forcat e tyre, të cilat janë në fakt të pabarabarta. Edhe pse Argezi artikulon provokimin, është prapë ai që afirmon: “*pa dashje të dal fitimtar*”, duke qene konshtient për gjendjen e tij njerëzore të kufizuar. Konfrontimi dëshmon për një dëshirë të fortë për njohuri, jo një mosbesim që e ka origjinën në pavërtetësi. Në vargun e fundit: “*dua të të prek dhe të bërtas*”, uni lirik përsërit gjestin biblik të Thomait i cili shpreh dëshirën për të prekur plagët e Jezusit, për të besuar se ai u ngjall nga vdekja. Uni lirik kërkon dëshmi materiale të ekzistencës së Zotit edhe pse atë e kishte parë në shpirt. Psalmet e Argezit, të ndërtuara në bazë të dy tendencave të kundërta, përmbledhin (sintetizojnë) nevojën e njeriut për njohje dhe kërkim të vazhdueshëm të idealit të përsosmërisë, të mishëruar tek Zoti. E shtjelluam konceptin e Argesit tek psalmet për të bërë më të qartë çështjen e ndikimit të tij tek Asdreni, në vëllimin “Psallme murgu”. Ndikimi argezian është veçanërisht i dukshëm në këtë vëllim tek vjersha e gjatë “Paradokse”, “Hyji i harruar”, “Dëshirë pagane” dhe “Lutje e vonuar”. Në poezinë “Lutje e vonuar”, Asdreni, një besimtar i devotshëm guxon dhe ankohet ndaj zotit: “*O zot pse vojtjet nuk mi sheh, / as lutjet gjunjësh kur bie, / as herë syt e mi q’i ngreh, ndaj ty me lotë dhembshurie*”.¹¹⁰ Ai e ndjen veten si një qenie të vuajtur dhe gjen ngushëllim tek amshimi, prandaj shpesh e identifikon veten me murgun, i cili më shumë se

¹⁰⁷ Tudor Arghezi, *Intre doua nopti*, Bukuresht, 1994, f.15.

¹⁰⁸ Po aty, f. 265.

¹⁰⁹ Po aty, f. 164.

¹¹⁰ Asdreni, *Vepra letrare*, II, Tiranë, 1980.

plotësimit të epsheve të ekzistencës, ia kushton jetën pastërtisë së shpirtit. Te “Dëshirë pagane”, nën frymën argeziane ai e fton shpirtin të largohet prej trupit: “*O shpirt mos e beso atë se me mëkate vehten plot e ka*”. I vetmi ngushëllim për të është qielli, kur shpirti do të shkojë te burimi dhe do të qetësohet. Në vjershën “Mister” ashtu si Argezi edhe ai është në një gjendje mëdyshjeje ku nuk mund as të pohojë dhe as të mohojë besimin e vet. Mesa duket, nëpërmjet këtyre vjershave ai shkarkohet prej dyshimeve dhe kundërthënieve shpirtërore. Në këtë kontekst poezia “Paradoks” është një testament shpirtëror i Asdrenit. Në të zë vend një njeri i ndarë në dy persona që japin urdhëra të ndryshme, apo shfaqin dëshira të ndryshme. Edhe në lidhje me zotin, ashtu si Argezi edhe Asdreni ndihet i dyzuar, por pa humbur gjithsesi besimin: “*Marr e vëzhgoj Ungjillin e Psallterin, / s’gjej faqe mos kujtohet perëndi, / por hap do faqe dhe këndoj Volterin, / mendimet më ndryshohen për çudi*”.¹¹¹ Poezia bëhet një monolog i gjatë rreth atyre problemeve që e mendojnë koshiençën dhe subkoshiençën e tij, përmes pohimit dhe besimit ashtu si në poezinë argeziane: “*Të humbas në zhurmë dhe heshtje, / Dhe ndërsa fshihesh, si i gjojtur, / Më lejoni të shoh: je skifter im i preferuar, / Të të vras ty? Ose në gjunjë të kërkoj. / Për besimin apo për dyshim, / Të kërkoj me ngulm, por pa dobi, / Jeni ëndrra ime ajo më e bukura, / dhe nuk guxoj t’ju rëzoj poshtë nga qielli (psalmi VI)*”¹¹²

Ndikimi i Argezit vihet re dhe në poezinë erotike. Ndryshe nga poetët e tjerë bashkëkohorë, Argezi nuk u përpoq të shtjellojë shumë liriken erotike. Përkushtimi për të dhuruar, gatishmëria për dashuri janë të pranishëm në të gjithë punën e tij. Erotika argeziane përfshin qëndrime që i përkasin dy fazave: faza e vonësës, e pasigurisë, mungesës së dëshirës për të përfutur nga pasioni dhe faza e pranimit të ndjenjës erotike. Mesa duket, te vëllimi “Psallme murgu”, Asdreni është ndikuar nga faza e mungesës së dëshirës, ose e mos pranimit të ndjenjës erotike siç ndodh te poezia e Argezit “Dashuri e vonuar”, që përkon me konceptin e poezive të Asdrenit të “Lulja e zemrës” dhe “Mëkat i fshehur”. Në të parën ai është në pozitë të një murgu dhe dashuria është ajo lulja e zemrës që fare lehtë mund të shndërrohet në mallkim dhe mëkatën e shpirtit. Ajo shihet si një mallkim që duhet t’i largohesh me logjikë të kthjellët dhe t’i shmangesh me gjakftohtësi.

Ndikimi i Argezit në poezitë e vëllimit “Psallme murgu”, ndihet dhe në përdorimin e simboleve, ose vizoreve simbolike siç i quan R. Qosja. Tek ky vëllim fjalët *murgu, pendesa, kungimi mëkati, paradoksi, akulli, vala, loti, shtrëngata, pylli, helmi, gjarpëri, reja, qyqja*, janë vizore simbolike që shprehin dhe disponimin e tij të errët shpirtëror, dilemat dhe mëdyshjet e tij.¹¹³ Disponimi i Asdrenit për të shtruar te “Psallme murgu” çështje universale të shpirtit njerëzor, fatit dhe ndjenjës njerëzore, janë ndikim i drejtpërdrejtë nga Argezi. Po ashtu dhe poezia “Ekselsior” është ndikim nga vjersha me të njëjtin titull e babait të simbolizmit rumun Aleksandër Maqedonskit, gjurmët e të cilit i ndoqi dhe Argezi në krijimtarinë e tij.

¹¹¹ Asdreni, *Vepra letrare*, II, Tiranë, 1980, f. 110.

¹¹² T. Arghezi, *Intre doua nopti*, Bukuresht, 1994, f.265.

¹¹³ R. Qosja, *Asdreni, jeta dhe vepra*, Tiranë, 2002, f. 285.

Simboli më i bukur i krijuar të “Psallme murgu “është ai i vjershës “Ylberi”, ku një djalosh i mahnitur prej ngjyrave të tij dëshiron t’i kapë, por nuk mundet. Ngjyrat e ylberit kthehen kështu në simbolin e pamundësisë në jetë dhe i kalueshmërisë së çasteve të bukura që zhduken si ngjyrat e ylberit.

“Dendur, kur kujtoj Asdrenin njeri dhe Asdrenin poet me kujtohet poezia “Ylberi” e poetit Gottfrid Kallner” në të cilin përshkruan një udhëtar të përunjur, i cili shkon midis pikave të shiut që i prekin ballin ndaj perëndimit. Dhe ne të gjithë e kemi njohur përpara se ta shohim trupërisht, e kemi adhuruar përpara se t’i çmojmë edhe virtytin e xhevahirtë të përunjësisë shpirtëror” - shprehet Kuteli për Asdrenin, duke portretizuar kaq qartësisht portretin e tij artistik dhe njerëzor.¹¹⁴

Ndikimi i poezisë rumune në krijimtarinë e Asdrenit është i gjerë dhe i shumanshëm, por ky punim synoi të sillte disa shembuj konkretë përfaqësues, ndikimesh, frymëzimesh dhe imitimesh prej kësaj poezie dhe këtyre poetëve, ndikime këto tepër të rëndësishme që dimensionuan njërin prej poetëve më mëdhenj shqiptarë të fillim shek.XX.

REFERIME

- Arghezi, T., *Intre doua nopti*, Bukuresht, 1994.
Asdreni, *Poezi të zgjedhura*, Tiranë 2000.
Asdreni, *Poezi*, Tiranë 1999.
Eminesku M., *Poezi*, Tiranë 2000.
Elsi, R., *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë – Pejë, 1997.
Këlinesku, Xh., *Mihai Eminesku*, Tiranë, 1994.
Kuteli, M., *Vepra letrare 5*, Tiranë, 1990.
Qosja, R., *Asdreni, jeta dhe vepra e tij*, Tiranë, 2002.
Xhiku, A., *Letërsia shqipe si polifoni*, Tiranë 2004.

¹¹⁴ M. Kuteli, *Vepra letrare 5*, Tiranë, 1990, f.175

ASPEKTE GJUHËSORE TË KONTAKTIT TË ARUMUNËVE ME SHQIPTARËT

Dr. Manuela Nevaci

Institutul de Lingvistică "Iorgu Iordan-Al. Rosetti"
Academia Română

1. Njoftimi i parë i cili sinjalizoi eksistencën e arumunëve në Shqipëri, në territorin në të cilin janë dhe sot, vjen nga historiani gjerman Johann Thunmann, i cili në vitin 1774 publikoi në Leipzig, në gjuhën gjermane, punimin *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker (Kërkime për historinë e popujve të Evropës Lindore)*: "Vllehët përtej Danubit (rumunët në jug të Danubit) [...] janë një popull i madh dhe i shumë dhe përbëjnë gjysmën e popullsisë së Trakisë dhe treçerek të Maqedonisë dhe Thesalisë. Dhe në Shqipëri banojnë shumë. Kanë të njëjtën të folme si vëllezërit e tyre këtej Danubit, por të ngatërruar me shumë fjalë greke. [...] Prej 750 vjetësh njihen me emrin vllehë dhe gjejmë gjurmë të së folmes së tyre qysh prej shekullit VI. Ata veten e tyre e quajnë rumëni ose *rumunë*. Grekët i quajnë vllehë". Më pas, informacione në lidhje me praninë e arumunëve në Shqipëri gjejmë te historianët dhe gjuhëtarët rumunë dhe të huaj, midis të cilëve përmëdim: A. D. Ksenopol, N. Iorga, A. Philippide, Th. Kapidan, Grigore Brënkush, Nikolae Saramandu dhe të tjerë. Th. Kapidanit i detyrohemi për monografinë "*Fërsherotët*" ("Fërsherotët"), e botuar në volumn VI të veprës *Dakorumania*, në vitin 1931. Monografia ndërtohet në një udhëtim studimor prej 1 muaji të bërë në vitin 1928, kur vizitoi vendbanime të shumta arumunësh dhe botoi disa shkrime nga arumunët e zonës së Korçës. Përsa i përket situatës dialektore, përfundimi në të cilin arrin Kapidan është që në Shqipëri ka vetëm një të folme, ai fërsherot. Më pas, kërkime në terren për arumunët e Shqipërisë, të bëra nga Petru Neiesku, autori i një veprë gjeografie gjuhësore, *Atlasi i Vogël i dialektit arumun të Shqipërisë dhe të Maqedonisë*, i publikuar në vitin 1997. Gjithashtu, Nicolae Saramandu ka bërë kërkime në terren te arumunët e shteteve ballkanike, përfshi Shqipërinë, me qëllim hartimin e *Atlasit gjuhësor të dialektit arumun* (duke u shtypur). Grigore Brënkush, duke iu referuar fërsherotëve dhe origjinës së tyre, pohonte: "kjo degë rumunësh zbriti nga veriu, nga fqinjësia pranë dakorumunëve, me të cilët kishte formuar dikur një trung etnik të përbashkët" (Brënkush 1992: 42).

Në periudhën qershor – shtator 2011 shkova në Greqi, Shqipëri, Republikën e Maqedonisë, nëpërmjet kontratës pasdoktorale POSTDRU "Vlerësimi i identiteteve kulturore në proceset e globalizimit", ID 59758/2010, financuar nga Fondi Social Evropian (FSE), nëpërmjet Programit Operacional Zhvillimi i Burimeve Njerëzore 2007-2013 (POS DRU), me projektin *IDENTITET RUMUN NË KONTEKST BALLKANIK*.

Midis rumunëve në jug të Danubit, arumunët janë të vetmit që kanë ruajtur deri sot emrin etnik, duke u quajtur arumunë (*armënë, rëmënë*, njëjës. *armën, rëmën*), term i cili, si dhe dr. *rumën* (< lat. *romanus*), evidenton origjinën latine. Popujt midis të cilëve jetojnë në gadishullin Ballkanik i quajnë, në përgjithësi Vllehë¹¹⁵, term nëpërmjet të cilit emërohet popullata e romanizuar, në veri

¹¹⁵ Emri *vllah* është me origjinë keltike i futur në Ballkan nga sllavët. Termeni *vllah*, i cili përkufizon një popullatë rumune (ndoshta arumune) shfaqet në shekullin e XI-të në historiografinë Kedrenos dhe i referohet një eventit të vitit 976

dhe jug të Danubit. Grekët i quajnë dhe *kucovllehë* “vllehë çalamanë”, *karaguni* “mbajtës të kapuçit të zi” dhe *arvanitovllahi* “vllehë me origjinë nga Shqipëria”, serbët, *cincarë* ndërsa shqiptarët, *rëmëni dhe çobenë*.

Ashtu si lat. *romanus* (> rom. *rumân*) si dhe sl. *vlah*, terma të përdorura për të quajtur ashtu si në veri të Danubit si dhe rumunët në jug të Danubit, tregojnë origjinën e përbashkët të tyre, si prejardhës të drejtpërdrejtë të popullsisë së romanizuar të Perandorisë Romake të Lindjes.

Gjatë kohës së udhëtimit studimor, në muajin qershor 2011, patëm rastin të kryejmë kërkime në terren të arumunët e Shqipërisë. Me këtë rast regjistruam tekste dialektore në lokalitetet Shqepur, Stan Kabunarë, Fier, Andon Poçi, Përmet, Korçë, Voskopojë, Grabovë. Gjithashtu, bëmë një pyetsor të veçantë (për barinjtë) në Voskopojë. Theksojmë se në hyrjen e lokalitetit Andon Poçi, vizitorët priten me urimin e shkruajtur në arumanisht: “Ghini vinitu” (“Mirë se erdhët”), ndërsa në dalje me urimin “Oară bună” (“Rrugë të mbarë”).

Në lidhje me përhapjen e arumunëve, konstatuam përqëndrimin e tyre në disa zona, konkretisht: Përmet-Frashër, Korçë-Voskopojë, Fusha e Myzeqesë dhe zona Grabovë-Niçë-Llëngë në afërsi të qytetit të Pogradecit.

Na interesoi veçanërisht, përqëndrimi i grupeve dialektore, duke u nisur nga fakti se arumunët fërsherotë të ardhur nga Ballkani dhe të vendosur në Dobroxhea ndahen në dy grupe: *shopanë dhe plisotë*, me diferenca në të folme, ashtu si rezulton nga publikimet *Kërkime rreth arumanishtes së folur në Dobroxhea* (Saramandu 1972) dhe *e Folura e arumunëve fërsherotë të Dobroxheas* (Nevaçi 2011). Me rastin e kërkimeve të bëra në terren në Shqipëri konstatuam ekzistencën e këtyre dy grupeve, krahas të cilave ekzistojnë dhe të tjera: *këstrëloc, zhërkëloc, uilac, kululac, myzeqarë, mexhidol*. Midis këtyre grupeve ka disa dallime, veçanërisht fonetike.

Në publikimin tonë do të shqyrtojmë të folmen e fërsherotëve të Shqipërisë në aspektin e përputhjeve gjuhësore me shqipen.

2. Fërsherotët (njëjës. *Fërsherot*, shumës *fërsheroc*) kanë marrë emrin nga lokaliteti Frashër, nga ku rrjedhin një pjesë e tyre, pikërisht ata që e quajnë veten *fërsherotë*. Bëhet fjalë për ata të zonës së qytetit Korçë (arumanisht. *Kurçeauë*) dhe disa fshatra përreth, disa nga të cilët duke lëvizur drejt lindjes, u vendosën në anën veriore të malit Vermio (Maqedonia greke) dhe në Nizhopole (Republika e Maqedonisë). Emërimi *fërsherot* u përhap, tek të gjithë ata që e quajnë veten *rëmënji* (përkrah *armënji*, siç e quajnë veten arumunët e tjerë).

Në Shqipëri, fërsherotët gjenden në gjysmën jugore të vendit (zona e dialektit shqiptar tosk), si në pjesët malore ose më të larta të juglindjes dhe qendrës si dhe në zonën fushore të perëndimit të vendit. Fërsherotët e zonave Vlorë, Fier, Lushnja (fusha e Myzeqesë) dhe një pjese e zonës së Beratit njihen me emrin myzeqarë (arumanisht *mizukiári*). Ka dhe emërtime të tjera grupesh, sipas zonave ose lokaliteteve: *kulunjac ose kupunjac* (nga Kolonja), *zhërkënjoc* (nga Zharkani), *uinjic* (nga Uinik), *këstrënjoc* (nga Kustreci), *plisoc* (nga Plasa). Duke qenë një popullatë barinjsh,

dhe më pas në dokumentin bashkangjitur *Strategikonit* të Kekaumenos (shekulli i XII), i shkruajtur nga një arumun dhe vërteton prezencën e një popullate rumune në Greqi qysh prej shekullit X.

fërsherotët kanë njohur një shpërndarje të gjërë, sidomos në Greqi. Shumë nga ata të cilët kanë pasur vendet e dimërimit në fushën e Thesalisë, në detin Egje (ku kalonin dimrin dhe pindenët) ose në perëndim, në detin Jon, ngelën përfundimisht në këto vende. Grekët i quajnë *arvanitovllahi* (arumunë me origjinë nga trojet e banuara me shqiptarë). Ata kapin zonat më jugore të teritoreve përhapjes së arumunëve në Gadishullin Ballkanik, duke arritur deri në afërsi të Misolongut dhe golfit të Korintit.

Një pjesë e fërsherotëve të Shqipërisë janë, pjesa më e madhe, vendet e lindjes dhe shkuan me turmat deri në malin Neagush, mbi Veria. Këtu ata zunë komunën Selia e Sipërme. Një pjesë e tyre çonin turmat për dimërim në afërsi të qytetit Neagushte, ndërsa të tjerët zbrisnin turma në bregdet, duke u vendosur në afërsi të qytetit Katerini. Ata të Neagushtës, me kohë, formuan një komunë të quajtur Hurpani¹¹⁶. Më të shumtët dimëronin në Katerini, pjesa tjetër në fushën e Selanikut (ku merreshin dhe me bujqësi)¹¹⁷.

Në Rumani, fërsherotët përfaqësohen nga nëngrupi i *shopanjëve*¹¹⁸ (njëjës. *shopan*^o) dhe nëngrupi i *plisocëve*¹¹⁹ (njëjës. *plisoc*^o) të vendosur në Dobroxhea¹²⁰ – në periudhën midis luftërave botërore – krahas arumunëve të tjerë. Fërsherotët *shopanë*, me origjinë nga zona e Frashërit, u vendosën, pjesa më e madhe e tyre, në Greqi në gjysmën e dytë të shekullit XIX, nga ku, përpara Luftës së Dytë Botërore, erdhën në Rumani. Fërsherotët *plisocë* erdhën në Rumani nga Shqipëria dhe u vendosën në lokalitetin Palazu Mare, pranë Konstancës dhe në Pipera pranë Bukureshtit.

Edhe pse u botuan shumë punime rreth dialektit arumun të folur në jug të Danubit, pak prej tyre u bazuan në kërkime të drejtpërdrejta në terren. Një studim të tillë botoi Th. Kapidan në vitin 1930, me titullin *Fërsherotët*, duke u bazuar në një udhëtim studimor prej një muaji të bërë në verën e vitit 1928 në fërsherotët e Shqipërisë.¹²¹ Pas më shumë se 8 dekadash vizituar dhe në lokalitetet e përmendura nga Th. Kapidan në monografinë e tij, lokalitete në të cilat bëjnë regjistrime tekstesh. Mund të pohojmë, me këtë rast, shumë nga veçoritë dialektore të së folmes fërshërote, por vëmë re dhe fenomene (të natyrës fonetike, morfologjike dhe leksikore) të papërmendura nga Th. Kapidan, disa nga të cilat për shkak të evolucionit të tanishëm të dialektit.

¹¹⁶ Horopani, me kalimin e kohës u bë qytet. Edhe në ditët e sotme ai banohet nga – pjesa më e madhe – fërsherotë (edhe pse shumë prej tyre nuk flasin gjuhën, ata kanë koshiençën e përkatësisë në këtë të folur) ; Horopani është vendi nga ku gjyshërit e mi (sëbashku me babain tim) u nisën drejt Rumanisë në vitin 1938.

¹¹⁷ Shiko *Kapidan* 1926: 123.

¹¹⁸ Ky emërim u dha nga plisocët nëngrupit i cili nëpërmjet procesit të nomandizmit shkoi më herët në Greqi dhe i cili nuk e ka më në të folur gjurmën *r* uvular [□].

¹¹⁹ Emri i tyre vjen nga lokaliteti Pleasa në Albania.

¹²⁰ Shiko nënkaptullin *Fërsherotët në Dobroxhea*.

¹²¹ Kërkime në teren të arumunët e shteteve ballkanike të vendosur në Rumani (Dobroxhea) kanë bërë Al. Rosetti, Kërkime rreth të falurës së arumunëve të Shqipërisë (1930; nxjerë nga „E folur dhe shpirt”, IV), Nicolae Saramandu, rezultatet u publikuan në dy punime: *Kërkime rreth arumanishtes së folur në Dobroxhea* (1972), *Arumanishtja e folur në Dobroxhea. Tekste dialektore. Fjalor* (2007) dhe Manuela Nevaci, *E folura e arumunëve fërsherotë në Dobroxhea* (2007; 2011 – ed. a II-a). Nicolae Saramandu bëri kërkime në teren dhe të arumunët e vendeve ballkanike, me qëllimin e përpunimit të *Atlasit gjuhësor të dialektit arumun (ALAR)*, duke u shtypur.

3. Nga konstatimet tona, në radhët e arumunëve ekziston një interes i veçantë për ruajtjen e identitetit të tyre rumun në kontekstin e globalizimit. Në radhët e arumunëve konstatohet ashtu si koshienca e *romanitetit* ashtu dhe ajo e *rumanitetit*.

Përsa i perket *koshiencës së romanitetit*, ajo mbahet gjallë me anë të romaneve të famshme, të ruajtura, për shëmbull, në Apoloni (sot Poian, në Shqipëri), në bregun e Adriatikut, porta kryesore e hyrjes së romakëve në Ballkan, në shekullin II para Krishtit, kur Iliria, Maqedonia dhe më pas, e gjithë Greqia (viti 148 para Krishtit) bëhen provinca romake. Nga Apolonia fillonte e famshmja Via Egnatia (e quajtur deri më sot nga arumunët *Calea Mare*), arterie kryesor i qarkullimit në Ballkan në drejtimin perëndim-lindje, e cila shkonte në Salona (arumanisht. *Sërunë*; Selanik) dhe duke vazhduar deri në Konstandinopojë. Kur vizituam Apoloni, personat të cilët na shoqëronin – si dhe arumunët e lokaliteteve në afërsi të Apolonisë – shprehën bindjen se romaniteti i instaluar këtu është përjetësuar gjatë shekujve.

Përsa i përket *koshiencës rumune*, ajo është disa shekuj e vjetër, duke mos qenë rrjedhojë ekskluzive e nismës së Rumanisë, e cila, në fund të shekullit XX, hapi në territorin e Shqipërisë shkolla në gjuhën rumune. Gjithashtu, së fundmi, shteti rumun së bashku me Kishën Ortodokse rumune dhanë kontributin e tyre financiar dhe material (kambana, mobilje kishe dhe tekste kishtare) për ndërtimin e kishës arumune në Korçë, shteti rumun ka financuar dhe ndërtimin e një kishe arumune në fshatin Llëngë në Pogradec si dhe hapjen e një shkolle arumune në Divjakë.

Nëpërmjet lidhjeve tregtare me qendrat e perëndimit dhe veçantërisht me ato të ish -Perandorisë Austro-Hungareze, arumunët hynë në kontakt me vëllezërit e tyre në veri të Danubit. *Koshienca rumune* është, në këtë mënyrë, më e hershme se krijimi i diasporës rumunë në Austro-Hungari, pas shkatërrimit të Voskopojës në gjysmën e dytë shekullit XVIII. Qyteti u shkatërrua me anë të tri sulmeve të armatosura (1767, 1769, 1788), në gjysmën e dytë të shekullit XVIII. Rrënojat e qytetit të dikurshëm, zonës urbane më të madhe të jugut të Ballkanit në atë periudhë, (50. 000 banorë, 27 kisha), duken dhe sot. Në Voskopojë ka funksionuar Akademia e vetme (institut arsimor universitar) e Perandorisë Osmane dhe ka pasur gjithashtu dhe një shtypshkronjë. Fryt i aktivitetit kulturor në Voskopojë kanë qenë veprat e shkrimtarëve të parë arumunë, Theodor A. Kavallioti¹²², Daniil Moskopoleanul¹²³ dhe Konstantin Ukuta. Përmendim, në këtë drejtim, dhe përkthimin në arumanisht të teksteve fetare (*Liturgji arumune, Codex Dimonie*).

¹²² Th. A. Cavallioti publikoi në Venecia në vitin 1770, *Πρωτοπειρία* (Mësimi i parë), libër leximi për klasat fillore, shkruajtur në greqisht dhe përfshinte lutje nga Bibla. Libri ka në fund një fjalor me 1170 fjalë greke, të përkthyer në arumanisht dhe shqip. Kuptimi i këtij fjalori për njohjen e dialektit arumun u nxor në pah për herë të parë nga gjermani Johann Thunmann, profesor në Universitetin e Halles, i cili dhe e publikoi në punimin e tij, *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker* (Leipzig, 1774). Punimi i Kavalliotit përmban vetëm një tekst arumanisht (e folur fërsherote): *Hristos de morji nâstâsi cu morte morteaa câlcându, ș-a mărîntătorlor ahârzi bană harizmă* [Krishti u ngjall nga vdekja me vdekjen vdekjen shkeli dhe u dha jetë atyre në varre].

¹²³ Daniil Moskopoleanul publikoi në Venecia në vitin 1794, *Εισαγωγική διδασκαλία* (Mësim Hyrës), libër leximi, i shkruajtur në greqisht, i cili përmban në fund një gid bashkëbisedimi në katër gjuhë: greqisht, shqip, arumanisht dhe bullgarisht. Numri i parë u riprodhua nga kërkuesi anglez Eëlliam Martin-Leake în *Researches in Grece* (Londra, 1814: 383-403). Punimi i Daniil nuk është një leksikar i mirfilltë, ashtu si del dhe nga titulli, por një gid bashkëbisedimi me sintagma të përdorura në bisedimet e përditëshme. Gjuha e tekstit të Daniil Moskopoleanit u studjua nga Grigore Brënkush në *Observime rreth strukturës së fjalorit arumanisht ne fjalorin e Daniil Moskopoleanit* në „Studime dhe kërkime

Gjuha e veprave të shkrimtarëve arumunë të shekullit të XVIII-të (Daniil, Ukuta, Kavallioti) si dhe ajo e teksteve fetare të asaj periudhe paraqesin veçori të së folurës fërsherote dhe grabovare. Nga gjuha e këtyre shkrimeve ndihet një shije “arkaike”, e cila e përaftron me periudhat para evoluimit të gjuhës rumune, disa herë edhe nga rumanishtja e përbashkët.

Pas shkatërrimit të Voskopojës, shtresa e pasur e arumunëve u vendos në Austro-Hungari, duke formuar koloni në Vjenë, Buda, Pesta, Miskolc.

Kolonitë arumune të ish-Perandorisë Habsburge patën një rol të rëndësishëm në kultivimin e ndjenjës kombëtare të rumunët e Transilvanisë (dakorumunë dhe arumunë). Është e mjaftueshme të përmendim faktin se *Shkolla Normale e Kombit Rumun* në Pesta frekuentohej, në fillim të shekullit të XIX-të, nga një numër i madh nxënësish nga familje arumune të vendosur në këtë qytet. Është merita e këtyre arumunëve të ndritur që i dhanë impuls dhe mbështetjen, materialisht dhe me njerëz (nëpërmjet dërgimit të fëmijëve në shkollat rumune dhe jo në ato greke), zhvillimin e arsimit në gjuhën rumune në ish Perandorinë Habsburge.

4. Në vazhdim do të paraqesim vetëm disa veçori thelbësore të cilat veçojnë të folmen e fërsherotëve të Shqipërisë nga pjesa tjetër e të folmen arumune dhe përputhjet me dialektin tosk të gjuhës shqipe.

4. 1. Sistemi fonetik dhe fonologjik

4. 1. 1. **Vokalizmi**, i hasur pjesërisht të fërsherotët nga ana e Th. Kapidan dhe i ilustruar me shembuj të shumtë nga ana e Nikolae Saramandu (Saramandu 1972: 41, 51, 178-179) është afonizimi i zanoreve të fundit [i] dhe [ë]: *munⁱ* ‘mal’, *afl^ë* ‘gjej’ etj. Përsa i përket shprehjeve të llojit *afl^ë*, fenomeni i reduktimit të -ë (në pozicion fundor) takohet në dialektin geg të gjuhës shqipe, ashtu si thonte Gr. Brënkush. Besojmë se në të folmen e fërsherotëve *plisocë* të Shqipërisë ka një evolucion të brendshëm që përfaqësohet si dukuri në dialektin tosk, me të cilin ata janë në kontakt. Reduktimi i zanores shfaqet më tepër edhe tek -i fundore, duke u realizuar një seri e plotë [-u, -ã, -i]. Te fërsherotët e Shqipërisë shfaqet heqja e -i-së së shkurtër pas -r-së në shumësin e disa emrave femërore: *gu* ‘guri’, *mu* ‘nurori’ etj.

Dobësimi i [ë] së patheksuar në rrokje pastonike, nëpërmjet asimilimit në tingullin e zanores së shkurtër fundore përfaqëson një veçanti të fërsherotëve *plisocë*: *acúmpur^u* “blej”, *leágun^u* “lëkundës”, *tálur^u* ‘fuqi’, krahas me *acúmpăr^u*, *leágăn^u*, *tálăr^u* tek fërsherotët *shopanjë* dhe te arumunët e tjerë. Dobësimi i ë-së në rrokjen paratonike është një fenomen që haset shumë shpesh në të folmen e fërsherotëve. Pas bashkëtingëlloreve joqiellzore, kalimi i |ë| në |u| shfaqet ashtu si në fjalët e trashëguara edhe në ato të huazuara, ndërsa pas bashkëtingëlloreve qiellzore, këmbimi bëhet vetëm te fjalët e huazuara nga gjuha turke dhe shqipe (cf. Saramandu 1972: 48). Theodor Kapidan pohonte se “dobësimi i ë-së vjen nga 1. për shkak të një labialeje; 2 nën ndikimin e një u nga rrokja para ose pas” (Kapidan 1932: 221).

gjuhësore”, XLIII, 1992, nr. 1, f. 39-43, duke nxjerë në pah faktin se „në këtë vepër të adhurueshme të Daniil Moskopoleanit, dominues, në nivelin e leksikut është elementi latin” (f. 41).

Diftongëzimi i *é-së* në *á* shfaqet pas bashkëtingëlloresh jo qiellzore në disa huazime nga shqipja dhe greqishtja: *deágă* (< shqip. *degë*), *meáse* (< greqisht. $\square\acute{e}\square\square$) *mési* pët të tjerët, *purteácă* ‘nuia’ (< alb. *purtekë*) *purtécă* për të tjerët.

Te fërsherotët *i* > *ǎ* si pas *r*: *curpǎia* dhe *cuppǎia* për *cuprui* për të tjerët (< greqisht. $\square\square\square\square\square i\square$) ‘plerë’, *sǎǎmǎ*¹²⁴ (< shqip. *thërrime*).

Nga analiza e *Atlasit Dialektor të Gjuhës Shqipe*¹²⁵ (hartat 64-66), rezulton se fenomeni *ë* [ǎ] është në shqip, ashtu si dhe dihet, një realitet i dialektit tosk, ku shfaqet si në pozicion të theksuar ashtu dhe në pozicion të patheksuar. Në hapësirën e dialektit tosk hasen të folmet arumune të tipit fërsherot, ku ekziston, gjithashtu fenomeni [ë] [ǎ] (rumanisht. *ă*). Krahasiimi midis rumanishtes dhe shqipes mund të zgjerohet duke u nisur nga hartat 90 dhe 91 të vol. I të *Atlasit*, i cili na paraqet fenomenin [ë] [ǎ] në pozicion të patheksuar, qendror dhe fundor në fjalët *mëzat* ‘junc’ dhe *në rrugë* ‘pe drum’. Në dialektin tosk, [ë] [ǎ] ruhet në keto pozicione [mǎzat] dhe [në rrugë], ndërsa në dialektin geg, format e takuara janë formale [mzat] dhe [n rug], me sinkopen e zanores së patheksuar në pozicion qendror ose me zhdukjen e saj në pozicion fundor. Situata e dialektit tosk është identike me atë të së folmes fërsherote të arumanishtes, ku [ë] [ǎ] ruhen në pozicion të patheksuar qendror ose fundor: *măcare* ‘ushqim’, *nǎ feată* ‘një vajzë’.

Diftongje dhe zanore të shkurtra fundore Në të folmen fërsherote plisoce, që flitet sot në Shqipëri, diftongët *ea*, realizohen si *ɛ*, ³: *fɛtǎ* ‘fytirë’, *scɛi* ‘djell’. Përsa i përket diftongut *a*, vumë re shqiptimin e tij si *ia*: *fiátă*, fenomen i pahasur deri më sot te fërsherotët plisocë, as te ata të vendosur në Dobroxhea, gjë e cila na bën të konsiderojmë se bëhet fjalë për një evolucion të tanishëm. Befasueshëm, vumë re shqiptime me diftongun *ɔa*: *sɔari*, në variacion të lire me ³. Shqiptimet me *ɔa* nuk janë vënë re deri tani te fërsherotët e Shqipërisë; është e mundur të bëhet fjalë për një arkaizm ose një evolucion të tanishëm, një rikthim te shqiptimi me *ɔa*, nën ndikimin e fërsherotëve shopanjë, të cilët ruajtën *ɔa*, të pakaluar në³.

4. 1. 2. Bashkëtingëllorizmi¹²⁶. Fërsherotët e Shqipërisë, krahas *l*, ashtu si dëgjohet te të gjithë arumunët, paraqet një *l* (*l* velare) si në të folurën grabovene (nën ndikimin e shqipes): *alás^u* ‘le’, *cále* ‘udhë’, *lunⁱ* ‘e hënë’, *molt* ‘shumë’ krahas *alás^u*, *cále*, *lunⁱ*, *mult^u* (te fërsherotët shopanjë) (cf. Kapidan 1931: 199).

Në nivelin e sistemit bashkëtingëllor hasim një fenomen ndikimi të arumanishtes në dialektin tosk: shqiptimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *cl*, *gl* si *cl’*, *gl’*: Në të njëjtën zonë jugore, edhe grupi paralel *gl* (i shqiptuar *gl’*) evoluoi nëlloj (I, h. 59 b): grupi i vjetër *gl* në *gju* ‘genunchi’, *zgjua* ‘stup’, *i gjatë* ‘lung’. Kemi ruajtur përfaqësimin në harta të grupeve të bashkëtingëlloreve *kl*, *gl* për shkak se këto u ruajtën sidomos në fshatrat e banuara nga arumunët fërsherotë, në të folmen e të cilëve, ashtu si dihet, *cl*, *gl* shqiptohen *cl’*, *gl’*: *cl’áie*, *gl’emu*” (Brënkush 2012: 9).

¹²⁴ DDA 1096, s. v. *sǎrmǎ*.

¹²⁵ Gjinari et al. 2007.

¹²⁶ Në këtë nënkapitull do të paraqes vetëm veçoritë e natyrës fonetike dhe disa ndryshime të cilat mund të tregojnë disa ndikime në evolucionin e bashkëtingëllorizmit të kësaj të folmeje.

4. 2. Morfologji

4. 2. 1. Në të folmen fërsherote e ardhmja formohet pa lidhjen (s *va cǎnt^u*, *va cǎntǎ*, *va cǎntǎ*, *va cǎntǎm^u* *va cǎntǎt*, *va cǎntǎ*; forma e njëjtë me të folurat e tjera (me lidhjen s-) ka kuptimin “duhet të.. .,; *va va s-cǎnt^u* “duhet të këndoj”. Th. Kapidan shpjegon zhdukjen e lidhëses nëpërmjet shtimit të përemrit personal: “*va tsǐ spun*” (cf. Kapidan 1932: 466; shih dhe Saramandu 1984: 457; Saramandu 1969: 155-162; Nevaçi 2011: 148). Grigore Brënkush nxori në pah përputhjet midis të folmes së fërsherotëve dhe dialektit tosk të shqipes. Këtu përfshihet dhe formimi i të ardhmes treguese si në shqip, me eliminimin e lidhëses shq. *të*, ar. *sǎ*: alb. *do shkoj*, ar. (färş.) *va neg^o* (Brënkush 2007: 172).

Në lidhje me vjetërsinë e të ardhmes së formuar me *va* + *lidhëse* në arumanisht, Theodor Capidan konsideron se është relativisht e tanishme, gjurmë të vjetërsisë të së ardhmes, të formuar me paskajoren ruhen në ndajfoljen *vahⁱ* (**va** + *hi* < **hie* ‘fie’) “ndoshta”. Duke iu referuar strukturës së formës të së ardhmes, Nikolae Saramandu vë re analogjinë me format verbale të përbëra të gjuhëve ballkanike (greke, shqip), duke nënvizuar veçantinë e arumanishtes të idomit romanik – midis idomeve ballkanike: “Kështu, ndërsa në greqishten e re dhe në shqip forma e treguesit të ardhshëm I – θα[va] χάνω, *do të afro* - mund të analizohet në ndihmuesen *voi* + lidhëse (e eliduar në greqishten e re) + treguesin e tashëm, në arumanisht *va s-cǎntu* duhet analizuar në: ndihmësja *voi* + lidhësi i tashëm. Në mënyrë analoge duhen interpretuar dhe format e tjera verbale të përbëra për të cilat folëm më parë. Kjo veçanti e arumanishtes shpjegohet me faktin se forma lidhëse e tashme u trashëgua nga latinishtja” (Saramandu 1969: 161).

Ndihmësja e së ardhmes të fërsherotët e Shqipërisë (zona e Përmetit) është *u* (cf. dakorumanisht: *o*): *u s-cǎnt^u* “o sǎ cǎnt”, ndërsa te ata të zonës së Korçës është *a*: *a z-cǎnt^u*. Situata është e ngjashme në shqip: *do* “vreau” + lidhësja: *do të shkoj* “o sǎ merg”; *do* është i pandryshueshëm dhe, ndoshta, jopersonal, si dhe *o* (< lat. *volet*), korespondenti rumun, i cili u vendos relativisht vonë në tekstet e shkruara. Ndërtimi në shqip me *do* + lidhësen, është i përgjithshëm në të dyja dialektet kryesore. Në lidhje me formën e treguesit të ardhshëm në gjuhën rumune me ndihmësen *vr÷a* (< lat. *volere*), Grigore Brënkush e përfshin midis “veçorive gramatikore të atribuara nënshtresës” (Brënkush 2002: 47), duke nënvizuar konkordancat midis të folmes fërsherote dhe dialektit tosk të shqipes: shq. *të*, ar. *sǎ*: shq. *do shkoj*, ar. (färş.) *va neg^u* (Brënkush 2007: 172)

4. 2. 2. Të folmet grëmoshtene dhe fërsherote të arumanishtes paraqesin njëlloj si gjuhët romanike portugalishtja, spanjishtja, katalana, okcitana– një sistem ndajfoljor vendi të trefishtë përta i përket ndajfoljeve vendore: *aoá* (*aoáti*) ‘këtu’ < lat. *ac-hac*, *aí* ‘këtu’ < lat. *ecce-hic*, *acló* (*acóti*) ‘atje’ (< lat. *eccum-illoc*), njësoj si në të folurën në Oltenia (*ací* – *acía* – *acólo*); fenomeni gjendet në Iberinë romanike (portugalisht, spanjisht, katalana,) dhe në okcitanë.

Ndajfoljet me kuptim të përgjithshëm-abstrakt, të cilat tregonin vetëm distancën (në kohë ose hapësirë) përballë së folmes, si *hic*, marrin njëlloj si përemrat tregues, elemente fuqizimi të vlerës ndajfoljore vendore (lat. *eccum* + *hic* > it. *qui*, fr. *ici*, sp., pg. *aquí*; lat. *hicce* > rom. *ici*, *aci*, it. *ci* (Iordan/ Manoliu 1965: 202-203). Kjo formë është dhe një provë e lidhjes së sistemeve proemërore me ato të një kategorie ndajfoljesh, të cilat disa kërkues i konsiderojnë pro-ndajfolje, jo vetëm prej

kuptimit të tyre të përgjithshëm abstrakt, por dhe prej marrëdhëniës dhe mundësisë së rrimarjes së një rrethane.

Duke iu referuar udhëzuesve të vendodhjes, Grigore Brënkush tregon që ekziston një situatë e ngjashme dhe në shqip. Ndajfoljet paraemërore *këtu*, *aty* dhe *atje* vendosen si në rumanisht: *aici*, *aci* dhe *acolo*: *këtu* do të thotë “në vendin ku gjendemi, në këtë vënd”, *aty* “në vendin e afërt me bashkëfolësin”, ku gjendet personi me të cilin flasim, *atje* “në një vend larg nesh”, duke ju referuar personit të tretë: ***Atje*** *banonte*, ***atje*** *punonte* (Brënkush 1999: 18-19).

5. Fjalor

5. 1. Në kërkimet tona në terren te fërsherotët regjistruam dhe disa **terma të pacertifikuara** në Fjalorin e dialektit arumun të Tache Papahagi:

bi'óc^u “vënd”

bizbil^u “fyell”

călămîşte “misërishte” (ardhur nga *călâmi*)

cóţă “e/i ngushtë” (< shq. *koce*)

cutură “copë djath” (< tc. *guioeuturi*)¹²⁷

gumitică “kanë për të pire ujë” (ndoshta ardhur nga *lûmêtă*)

lafi “thashethem” (< alb. *lafe*)¹²⁸

sínea “e vet” (lat. *se+ne*)

vič^u “viç” (< alb. *viç*).

Kuptime të certifikuara në DDA

ancún^u “pi duhan” (“ngacmoj (zjarrin)” në të folmet e tjera’ < lat. **in-cunneare*)¹²⁹ ;

blánă “copë djathi” (< sl. **blana*)

parmaticó “fëmijë i zgjuar” (< gr. *πληματικός*)

*pipirîţă*¹³⁰ “spec” (ardhur nga *pipér*, în DDA); ne besojmë se vjen nga greqishtja gr. *πιπέρι* “spec”

pufkie “mrekulli” (< alb. *rrufë*)¹³¹

*sămită*¹³² “bukë e freskët” (< tc. *simit*)

sărúnă “qytet” (< *Sărună*)¹³³

dádă “gjyshe”, cf. srb. *dada*, shq. *dadë*, tc. *dady*. DDA e ka përfshirë vetëm me kuptimin “mama”, e rrualtur në të folmen e fërsherotëve shopenjë; *átă* “mama”, cf. shq. *atë* “tatë”, shumë “përinçi” është një huazim i tanishëm te fërsherotët e Shqipërisë.

¹²⁷ Cf. alb. *kuturú*.

¹²⁸ Term dialektor në shqip me kuptimin *llaf*.

¹²⁹ Etimologji e panjohur në DDA.

¹³⁰ Për *pipirîţă*, DDA nuk ka kuptimin “spec”. Del me kuptimin ‘shishkë’.

¹³¹ Kuptim i pahasur në DDA; i hasur në Saramandu 2007: 546 (s. v. *rufÖie*).

¹³² *sămită*, fillimisht kishte kuptimin “bukë e bërë me maja qiqre”.

¹³³ În DDA 1061, s. v. *sărúnă*, se afirmë “cuvânt inexistent”, cu valoare poetice. Cuvântul e prezent şi astăzi în vorbirea fărsheroţilor *şopaă* cu sensul ‘oraş’.

5. 2. Disa terma të regjistruara prej nesh paraqesin interes përse i përket *përafrimeve me shqipen*:

bánă, s. f. ‘jetë’. DDA ve nën pikpyetje origjinën të drejtpërdrejtë nga shqipja *banë*, e cila në shqip (e vjetëruar) do të thotë “vendbanim, kolibe çobani”. Në arumanisht ekziston folja *bânédz^u* ‘jetoj’ nga e cila, ndoshta, në teren arumun, u krijua një derivat *bană*, me kuptimin “jetë”.

Climeán, e regjistruat në DDA vetëm me kuptimin “djalë”, e gjetëm me kuptimin e fjalës së vjetër shqipe *çilimi* “fëmije (3-8 vjec), djalë”.

fumëy, pl. *fumëyă* “fëmija, fëmijet e një familje” < lat. *familia*. Për kuptimin e përbërë shqip *fëmijë¹³⁴* (< lat. *familia*), me ndryshimin që, në arumanisht nëpërmjet *fumëy* kuptojmë “të gjithë fëmijët e një familjeje”, në shqip kuptimi i fjalës përfshin dhe prindërit “pjestarët e familjes”.

Ġigá (i pandryshuar) < shq. *xhixha*: *Nu te--aproáki di foc^o, eásti ġigá* “mos ju afro zjarit, është shkëndijë”

úmplu “mbush (vitet)”, : *Méni umplú~ yinyiŋ an*; cf. *Unë mbusha njëzet vjet*.

noŋ, năi ka marre kuptimin ‘i ri’, duke qënë një kalk semantik (përshtatje e kuptimit) sipas fjalës shqip *i ri* ‘1. ; njësoj si në greqisht *νεος*”; termi haset dhe në sintagmën *nveástă nău* “nuse e re”

Një kategori tjetër përfaqësohet nga fjalët me origjinë latine të përbashkëta me shqipen, të pa regjistruara si forma ose kuptime në të folura të tjera; djalët janë hasur dhe komentuar për arumanishten nga ana e Këtëlina Vëtëshesku (1997: 45, 441):

cănt^u shq. *këndoj* (< lat. *cantare*), në të folura të tjera *ġivăsésçu* (< gr. *διαβάζω*)

númír^u shq. *numëroj* (< lat. *numerare*), në të folurat e tjera: *misúr^u* < lat. *mensurare*)

scrír^u shq. *shkruaj* (< lat. *scribere*), në të folura të tjera *nyrăpsésçu* (< gr. *γράφω*)

sămt^u shq. *i shentjë* (< lat. *sanctus*), në të folura të tjera *ay^u* (< gr. *ἅγιος*).

Disa terma të përbashkëta me shqipen, të regjistruara nga ne te fërsherotët e Shqipërisë u diskutuan së fundmi nga ana e Grigore Brënkush në studimin *Atlasi gjuhësor i shqipes. Përputhjet me rumanishten* (botuar në FD XXX1/ 2012: 5-19):

bardz^u “alb”, shq. *barðë*

daş^u ‘drag’, shq. *dash*; në arumanisht kemi të bëjmë me një evoluim semantik, fillimisht termeni kuptonte ‘qingjin e preferuar’

şută, shq. *shutë*.

U ruajtën, gjithashtu, shumë mirë, në dialektin arumun, termena me origjinë latine në fushën e përpunimit të leshit dhe të pëlhurave: *ţes^u* ‘punoj në vegël, end’ < lat. *texere*, *urĚăsc^u* ‘shurdhim’ < lat. *urdire*, *fus^u* “fus”, *fúrcă* “furkë” < lat. *furca*, *spată* “shpatë” < lat. *spatha*, *liţă* “tel i hollë prej bakri” < lat. *licia*, *caír^u* “shtëllungë” < lat. **caiulus*, *gl’em^u* “rrënkim” < lat. **glemus*, *torc^u* ‘tjerr leshin’ < lat. *torquere* etj, terma të përgjithshëm në arumanisht.

Dihet se arumanishtja ka ruajtur nga latinishtja disa termena, të pa hasura në dakorumanisht, të cilat i gjetëm në të folurën fërsherote: *amint^u* ‘fitim (lek); me lind’ < lat. *augmentare*; *dimănd^u* “të

¹³⁴ Vezi şi Brăncuş (1999: 84) „femeie avea, până în secolul al XVII-lea sensul *familie, casă, neam* (pop.), înţelegându-se toţi membrii unei familii, ori numai soţia şi copiii” şi Vătăşescu 1997: 17.

çosh fjalë; të thërrasësh” < lat. *demandare*; (mi) *dirín*^u “të mundoresh” < lat. *delirare*; (mi) *deápir*^u “a dispera; të shkulësh flokët” < lat. *depilare*; *săriâ* “vendi ku vendoset kripa për delet” < lat. **salinea* (pl. *salinae*), e cila haset dhe në shqip në formën *shëllirë*; *ápiră* “del dielli” < lat. **aperire*; *jeáfiră* < *cicer*, -rem; *suél*^u “lesh që qethet nga barku i deles” < *sub-illia*; *uínă* < lat. *ovina*.

Përsa i përket fjalorit, ndryshimet e prodhuara në të folmen e fërsherotëve të Shqipërisë shpjegohet nëpërmjet ndikimeve të kohëve të fundit nga shqipja: *det~urimíst*, ndajfolja. < shq. *detyrimisht*; *óse* < shq. *ose*; *vétăm* < shq. *vetëm*.

Një aspekt tjetër i jetesës së arumunëve në hapësirën ballkanike ilustruhet bindshëm nga formulat e mirësjelljes, të përbashkëta me ato të hasura në gjuhët ballkanike. Ekzistojnë përafërsi me shqipen: *mi ncl'in*^u *áli tiâie* [lit.] = shq. *faleminderit*; me greqishten: *hiratímati múlti* = gr. *πολλά χαιρετίσματα*; *cu nkérdu* ‘qoftë me fat = *με κέρδος* etc.

Në kategorinë e përafrimeve me shqipen përfshimë formula falenderimi duke pasur si qendër, fjalë, si: ar. *ambár*^o < shq. *mbarë*; ar. *Bánă* “jetë”, ndoshta një derivat ndjekës nga *bănédz*^u < *banoj*; *tiñie* “respekt, nder” < gr. *τιμή*:

ar. *Lucru-ambár*^u = shq. *Puna mbarë*;

ar. *S-țâ ímnâ lucrulu ambár*^u = shq. *Të të shkojë puna mbarë/ Të të shkojë mirë*;

ar. *Mi ncl'in*^u *áli tiñie* = shq. *Faleminderit*;

ar. *Ancl'inâcúh múlti* = shq. *Shumë të fala*;

ar. *S-țâ bâneádză fumeál'a* = shq. *Të rrofshin fëmijët*;

ar. *Ș-la tíni sâ s- toárnâ amó* = shq. *Paç të njejtin fat!/U*

gëzofsh edhe ti/ Në kokën tende/ Edhe në fëmijet tuaji;

ar. *S-ai dzúuâ búnâ* = shq. *Ditën e mirë*.

6. Zona gjeografike dhe statuti shoqëror i të folmes fërsherote, e folur nga shumë breza, si dhe karakteristika e ansamblit të fjalorit të përzgjedhur u paraqitën në këtë punim duke ju referuar shqipes, shqipja dhe rumanishtja karakterizohen, në brendësi të bashkimit gjuhësor ballkanik, nëpërmjet një lidhjeje të ngushtë. Kjo lidhje vihet re në të gjithë sistemin e këtyre dy gjuhëve, në sistemin fonetik, në strukturën morfologjike, në ndërtimin e sintaksës, në frazologji, në formimin e fjalëve dhe në fjalor. Nëpërmjet bashkëjetesës së gjatë me popujt midis të cilëve jetojnë arumunët u futën në dialektin e tyre elemente të huazuara nga grekët, shqiptarët, turqit, me të cilët nuk u identifikuan asnjëherë nga pikëpamja etnike apo gjuhësore, duke ruajtur portretin e Romës në hapësirën Ballkanike.

REFERIME

227; Blatt 41-47, 58-90 în *Jahresbericht*, V 1898, p. 192-297; Blatt 91-125 în *Jahresbericht*, VI, 1898-1899, p. 86-173.

Banfi, E., 1985, *Gjuhësia Ballkanike*, Bologna, Zanichelli. Barth Verlag.

Berényi, M., 2000, *Kultura rumune në Budapestë në shekullin e XIX-të*, Giula, Shtëpia Botuese “Noi”.

Brënkush, Gr., 1976, *Gjuha rumune bashkëkohore*, Morfologjia e foljes, Bucuresht, Shtëpia Botuese e Unv. Bukuresht.

- Brënkush, Gr., 1983, *Fjalori autokton i gjuhës rumune*, Bucuresht, Shtëpia Botuese Shkencore dhe Enciklopedike.
- Brënkush, Gr., 1992, *Observime në strukturën e fjalorit arumun në fjalorin e Daniil Moscopoleanit*.
- Brënkush, Gr., 1995, *Kërkime në fondin trako-dak të gjuhës rumune*; Bucuresht, Shtëpia Botuese Dacica.
- Brënkush, Gr., 1999, *Përputhje gjuhësore shqiptaro-rumune*, Bucureşti, Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune.
- Brënkush, Gr., 2002, *Hyrje në historinë e gjuhës rumune I*, Bucureşti, Shtëpia Botuese e Fondacionit „România de Măine.”
- Brënkush, Gr., 2003-2004, *Evolucioni i leksikut latin në arumanisht*, Fonetikë dhe dialektologji, XXII-XXIII, 37-45.
- Brënkush, Gr., 2004, *Historia e fjalëve. Unitat gjuhe dhe kulture rumune*, Bucureshti, Shtëpia Botuese e Fondacionit “România de mâine”.
- Brënkush, Gr., 2008, *Studime historie të gjuhës rumune*, II, Bucuresht, Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune.
- Brënkush, Gr., 2007, *Studime historie të gjuhës rumune*, I, Bucuresht, Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune.
- Brënkush, Gr., 2011, *Informacione rreth arumunëve në kulturën tonë të vjetër*, në Manuela Nevaci (ed.),
- Brënkush, Gr., 2012, *Atlasi dialektor i gjuhës shqipe, Elemente të përbashkët me rumanishten, Fonetikë dhe dialektologji XXXI*, 5-19.
- Dakorumania*, VI).
- DDA –Papahaxhi, T., 1974, *Fjalori i dialektit arumun, i përgjithshëm dhe etimologjik*, edicioni i dytë i argumentuar, Bucuresht, Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune.
- Gjinari, J (coord.), Beci, B., Shkurtaç G., Gosturani Sh., *Atlasi dialektologjik I gjuhës shqipe*, vol. I, Harrassoëitz Verlag.
- Kapidan, Th., 1922, *Raportet albano-romane*, në *Dakorumania*, II, 1921–1922, 444–454.
- Kapidan, Th., 1931, *Fërsherotët. Studim gjuhësor rreth arumunëve të Shqipërisë*, Cluj, 1931, (nga *Linguistique romane*, Tome 50), p. 38-59.
- Ministria e Arsimit, Instituti Rumun i Trakologjisë, Napoli, 2007.
- Neiesku, P., 1965, *Kërkime dialektore te rumunët në jug të Danubit*, Kërkime gjuhësore, X, 21–25.
- Nevaçi, M., 2006, *Folja në arumanisht. Strukturë dhe vlera*, Bucuresht, Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune.
- Nevaçi, M., 2009, *Codex Dimonie – një tekst fetar arumun i vjetër. Probleme shkrimi*, Punimet e Simpoziumit të trembëdhjetë të dialektologjisë, Cluj-Napoca, Shtëpia Botuese Mega, 269- 284.
- Nevaçi, M., 2011, *E folura e arumunëve fërsherotë të dobroxheas*, Bucuresht, Shtëpia Botuese Editura Universitare.
- Nevaçi, M., 2012, *Formula miresjelljeje në arumanisht*, në Manuela Nevaci (ed.) në “*Studia linguistica et philologica*”, “Homazh profesor Nicolae Saramandu për moshën 70 vjeç” Shtëpia Botuese e Univ. Bukuresht, Bucuresht, 2011, 629-634.

- Papahaxhi, P., 1909, *Shkrimtarë arumunë në shekullin e XVIII-të*, Bucuresht, Instit. I Arteve Grafike “Carol Göbl”.
- Rosetti, Al., 1930, “kërkime rreth të folurës së arumunëve të Shqipërisë”, *E folur dhe shpirtt*, IV, 1930, 1-83.
- Sandfeld, Kr. 1930, *Linguistique balkanique. Problèmes et resultants*, Paris, C. Klincksieck.
- Saramandu, N., 1969, *Sistemi i formave të përbëra në arumanisht*, Fonetikë dhe dialektologji,
- Saramandu, N., 1972, *Kërkime rreth arumanishtes të folur në Dobroxhea*, Bucuresht, Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune.
- Saramandu, N., 1984, *Arumanishtja*, në: V. Rusu (ed.), *Traktat dialektologjie rumune*, Craiova,
- Saramandu, N., 1996, *Romano-ballkanika. Lakimi gjinor i numëresit tre në arumanisht*, în *SCL*,
- Saramandu, N., 2007, *Arumanishtja e folur në Dobroxhea. Tekste dialektore Glosar*, Bucuresht, Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune.
- Saramandu, N., 2008, *Origiina e rumanisë dhe e dialekteve të saj* (observime kritike rreth disa botimesh të tanishme), *Philologica Jassyensia*, an IV, nr. 2, 159–164.
- Saramandu, N., 2010, *Nga uniteti i kombit në koshiençën kombëtare. Arumunët – histori dhe aktualitet*, în *CCr*, nr. 12 (278), p. 45–52.
- Saramandu, N., *Atlasul lingvistic al dialectului aromân (ALR)*, I, 189 hërqi în manuscris.
- Saramandu, N., Nevaci, M., *Dialekti arumun, Historie e gjuhës rumune*, III, Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune, Bucuresht (dorëshkrim).
- Saramandu, N., Nevaci, M., 2006, *Të folurat e arumanishtes aktuale në prespektivën hapësinore* (në bazë të ataseve gjuhësore), *Komunikim interkultural dhe integrim evropian*, Iaşi, 259-272.
- Saramandu, N., 1970 , *Considerente rreth sistemit fonologjik të së folurës arumune në Krushovë-Maqedoni*, *Studime dhe kërkime gjuhësore*, XXI, 465–471.
- Saramandu, N., 1988, *Harta e të folurave arumune dhe meglenorumune në gadishullin Ballkanik*, *Studime dhe kërkime gjuhësore*, nr. 3, 225-245.
- Saramandu, N., 2004, *Romaniteti oriental*, Bucuresht, Shtëpia Botuese e Akademise Rumune.
- Saramandu, N., 2005, *Un structuralist avant la lettre: Gheorghe Constantin Roja në Dokumentat e Kolokviumit të katërt të Katedrës së gjuhës rumune*, Bucuresht, Shtëpia Botuese e Universitetit, f. 759–763.
- Shkrimi rumun, 423–475.
- Studia linguistica et philologica. Homazh profesor Nicolae Saramandu për moshën 70 vjeç*, Shtëpia Botuese e Univ. Bukuresht, Bucuresht, 2011, 141-143.
- Studime dhe kërkime gjuhësore*, XLIII, nr. 1, 39-43.
- Thunmann, J. 1774, *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker*, 1. Theil, Leipzig,
- Vëtëshesku, C., 1997, *Fjalori me origjinë latine i gjuhës shqipe në krahasim me rumanishten*, Bucuresht, VI, 155–162.
- Ëëce, A. J. B. and Thompson, M. S., 1914, *The Nomads of the Balkan*, London. Methuen & Co., LTD.

- Ėeigand G., 1897, 1898, 1898-1899, *Der Codex Dimonie*, Blatt 11-40, în *Jahresbericht*, IV, 1897, p. 136-
- Ėeigand, G., I-II, 1894, 1895, *Die Aromunen. Etnographish-philologisch-historische Untersuchung*, Leipzig.
- Ėeinreich, U., 1953, *Languages in contact*, Neë York, Linguistic Circle of Neë York.
- Ėolf, H. J., 1986, *Çà et là, ici et nulle part. Quelques adverbes de lie en sarde (dialectes du centre)* în *Revue de linguistique*, XVII, nr. 1-6, p. 207-215.

**DUKE IU REFERUAR AKADEMIKUT HARALAMB MIHAESKU, EDHE NJË
ARGUMENT PËR AUTOKTONINË E SHQIPTARËVE NËN DRITËN E
MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO- AROMANE**

Dr. Elona Çeçe (Biba)

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, UK “Fan Noli”

I. Hyrje

I.a. Mihaesku për marrëdhëniet e shqipes me latinishten

Ashtu si shumë albanologë të tjerë pararendës, edhe akademiku Haralamb Mihaesku ka dhënë kontributin e tij të çmuar lidhur me prejardhjen ilire të gjuhës shqipe dhe autoktonisë së shqiptarëve, ai shprehej se: “Problemi i autoktonisë së shqiptarëve ka ushqyer për një kohë të gjatë diskutime të shumta në fushën e kërkimeve shkencore, por sot ai mund të shihet i zgjidhur.”

Për këtë fakt besonte që, dukuria e vazhdimësisë ilire mund të studiohet me sukses, duke shtruar si domosdoshmëri analizën në thellësi, për të cilën duhet shfrytëzuar tërësia e mundshme e burimeve: dokumentet e shkruara, arkeologjia, etnografia, folklori, historia e artit, gjuhësia, dhe në gjerësi duke e trajtuar e çështjen “të paktën në kuadrin evropian”.¹³⁵

Si metodën kryesore të këtij studimi, ai përcaktoi metodën krahasuese, e cila mundëson regjistrimin e ndryshimeve sasiore dhe cilësore, (të cilat i përkasin nivelit diakronik) dhe tipologjinë, që lidhet me nivelin sinkronik.

Mihaesku, etnogjenezën e shqiptarëve dhe rumunëve e konsideroi si një problem qendror, që lidhet me gjenezën e disa popujve të tjerë evropianë. Mihaesku arriti në përfundimin se marrëdhëniet etnike ndërmjet pushtuesve dhe autoktonëve, në periudhën e kalimit nga antikiteti në mesjetë sollën një simbiozë etnike dhe kulturore. Për këtë periudhë ai u shpreh se “zbulohet kudo një tipar i përbashkët: pushtuesit gjermanikë vendosën sundimin e tyre në Gali, Itali dhe Spanjë, por ata e humbën gjuhën e tyre dhe u asimiluan nga vendasit, protobullgarët u sllavizuan; popujt shtegtarë që erdhën në Daki u romanizuan; sllavët që depërtuan në Shqipëri dhe në Greqi u shqiptarizuan, përkatësisht u greqizuan.”¹³⁶

Për të argumentuar ekzistencën e ngulimeve me popullsi romake, ai solli si një argument shumë të rëndësishëm, faktin që në Perandorinë Romake dallimi shoqëror në fushën e bujqësisë ishte i madh, [duke ditur se veteranët arrinin të zotëronin rreth 50 ha tokë, ndërkohë që prokuratorët (fermerët e mëdhenj) shfrytëzonin pronat e mëdha shtetërore.]¹³⁷

Ai përcakton periudhat kohore të këtyre huazimeve, si dhe pikat e kontakteve gjuhësore.

Natyrisht, argumenti më i fuqishëm që sjell për autoktoninë, është argumenti gjuhësor, për huazimet që të parët e shqiptarëve kanë marrë nga grekët dhe romakët. Mihaesku mendon se

¹³⁵ A. Haxhi, T. Topalli, *Leksikon gjuhëtarë shqiptarë dhe Albanologë*, Fiorentina, Shkodër, 2012, f. 669.

¹³⁶ Po aty, f. 669.

¹³⁷ Po aty, f. 669- 670. (**Shën.** Nuk ka dokumente se si u zhvillua ky proces historik, por ka shumë material arkivale në Itali dhe Spanjë, Francë dhe në Gjermaninë e Jugut, ku ndërmjet rreshtave mund të lexosh...)

përhapja e tyre ka mundësi të jetë bërë “njëkohësisht në kontakt tokësor dhe detar në kohën e kolonizimit grek, kohën e pushtimit romak, madje edhe në mesjetën e hershme”¹³⁸

Në këtë kuadër, ai theksoi që në gjuhën shqipe kanë mbetur 602 fjalë me origjinë latine.

Këtu duhet theksuar fakti, që këto huazime ai i kategorizon¹³⁹, duke u nisur nga kriteri i përkatësisë vendore apo konservimit në shqip, rumanisht dhe gjuhët e tjera romane perëndimore.

Duhet theksuar fakti që ai veçoi elemente latine që që i përkasin vetëm shqipes, gjë e çoi në përfundimin që ndikimi i kulturës romane është bërë pothuajse në të gjitha sferat e leksikut dhe depërtimi i saj në Evropën Juglindore (përfshihet këtu bregu i detit Adriatik dhe detit Jon) gjatë shumë shekujve, gjë që ka formuar disa zona gjuhësore në kohë të ndryshme.¹⁴⁰

Për elementet latine që gjenden vetëm në gjuhën shqipe kemi edhe studime të tjera, p. sh. mund të përmendim Petar Skok, i cili kishte konstatuar se termat e florës mesdhetare, ishin të pranishme në gjuhën shqipe, por që mungonin në gjuhën rumune.¹⁴¹

Ashtu si Mihaesku, edhe Voklav Çimokovski do të konstatonte ndikim të gjuhës shqipe mbi gjuhën rumune. Ai, duke analizuar analogjitë në zhvillimin e elementeve latine në shqip dhe rumanisht, si dhe fjalët që ka marrë rumanishtja prej shqipes, vërejtë se këto dy gjuhë nuk kanë prejardhje të përbashkët. “Gjuha shqipe është një dialekt ilir, që ka shpëtuar nga romanizimi në një vend të veçantë, sigurisht në male, ku ndikimi i romakëve ka qenë vetëm i sipërfaqshëm”.

Këto konstatime e përforcojnë teorinë e Mihaesku dhe nxirrin më shumë në pah një të vërtetë të padiskutueshme, autoktoninë shqiptare.

I.b. Arumanishtja si degë e trungut të latinishtes

Duke qenë se në vazhdim ne do ta shohim arumanishten si gjuhën e romakëve të vendosur në Ballkan që në kohën e Perandorisë Romake, pra si një idiomë që rrjedh nga latinishtja, do renditim në mënyrë origjinale edhe disa fakte historike dhe gjuhësore në mbështetje të kësaj teze.

Marrëdhëniet shqiptaro- romane përbëjnë një argument të fuqishëm për autoktoninë.

Që herët, teoria e gjuhës së vllahëve nga kolonët romanë ishte përfaqësuar edhe nga kronikani bizantin Kynamos¹⁴² dhe në shekullin XIX nga francezi E. Cuzineri.

Po në fund të shekullit të 19-të, studiuesi gjerman Gustav Ewigand duke analizuar gjuhën dhe mënyrën e jetesës së një popullsie të romanizuar që jetonte në gadishullin e Ballkanit, e quajti këtë grup etnik, i cili fliste një gjuhë që i përkiste grupit lindor të latinishtes, aramani.

¹³⁸ A. Haxhi, T. Topalli, *Leksikon gjuhëtarë shqiptarë dhe Albanologë*, Fiorentina, Shkodër, 2012, f. 670.

¹³⁹ a) fjalë të burimit latin, të përdorimit të gjerë, që janë ruajtur në gjuhën shqipe, në gjuhën rumune dhe në gjuhën romane perëndimore;

b) elemente latine të ruajtura vetëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhën rumune;

c) elemente latine, që jetojnë vetëm në gjuhën shqipe.

¹⁴⁰ P. Skok dallonte dy zona të latinishtes ballkanike: njëra detare (primorski), gjatë bregdetit grek dhe ilir, dhe tjetra kontinentale (kontinentalni), në brendësi të kontinentit.

¹⁴¹ A. Haxhi, T. Topalli, *Leksikon gjuhëtarë shqiptarë dhe Albanologë*, Fiorentina Shkodër, 2012, f. 670-671.

¹⁴² Informacioni që na përcjell Kynamos flet për një fushatë perandorake kundër hungarezëve më 1167-ën, ku në ushtrinë e komanduar nga Leon Vatatzes ishin të pranishëm edhe vllahët, për të cilët thotë se janë kolonë të ardhur prej kohësh nga Italia.

Në Shqipëri, përkrahës i tezës për origjinën romane të vlllehëve është Ekrem Vlora.

Aktualisht studiuesi i mirënjohur Moikom Zeqo, te “Historia e Bujqësisë dhe Agroindustrisë Shqiptare”, shkruan se ilirët pushtohen nga romaket në vitin 168 p. e. s. dhe se sundimi romak krijoi strukturime të reja të pronave bujqësore. Ai sjell si shembull Pompon Atikun, mikun e Ciceronit në vitet 50 p. e. s, i cili zotëronte prona shumë të mëdha bujqësore në periferinë e qytetit Butrint, po kështu fisi i Prasaibëve kaonë, ishte shëndërruar në një koloni romake me karakter ushtarak dhe bujqësor, ndërsa në rrethinat e Lezhës kjo dukuri ndodhi me fisin e pirustëve. Gjithashtu, rrethinat bujqësore të Durrësit, Tiranës dhe Skampinit romakët sollën disa “kolonë italike”. Shekujt e parë të e. sonë karakterizohen nga një depërtim dhe qëndrueshmëri e kulturës romake në tërë Ballkanin, gjë që u pasua me një zhvillim ekonomik e kulturor të Ilirisë së Jugut. Gjatë sundimit të perandorit August në qytetet si Dyrrahu, Bylisi, Buthroti e Shkodra u vendosën kolonë romakë. Kolonizimi romak ushtroi një ndikim të madh mbi popullsinë vendase ilire, e në radhë të parë në qytetet, po, edhe në zonat fshatare. Elemente të qytetërimit romak hyjnë edhe në brendësi të viseve ilire. Me ndarjen e Perandorisë Romake në Perandorinë e Lindjes dhe në Perandorinë e Perëndimit më 395 e. sonë, ilirët e jugut u përfshinë në Perandorinë e Lindjes ose siç u quajt ndryshe në Perandorinë Bizantine. Kjo ndarje administrative nuk solli ndonjë ndryshim në strukturën ekonomike e shoqërore të krahinave ilire jugore, të cilat në tërësi vazhduan të ruanin veçoritë që kishin patur më parë. Por në zhvillimin historik të Ilirisë ndikuan ngjarje të rëndësishme, siç ishin dyndjet e barbarëve. Kështu mund të përmendim invazionin e vizigotëve, të cilët në fund të shek. IV e më vonë me në krye Teodorikun pushtuan Skampinin dhe Dyrrahun.”¹⁴³

Gjithashtu, për aspektin gjuhësor duhet të përmendim faktin që Tunman, u kishte kushtuar vëmendje huazimeve latine dhe konkretisht depërtimit të latinizmave në ilirishte. Ai theksonte se huazimet depërtuan edhe në zonat malore, por shumë më pak. Ai mendonte se këto zona i qëndruan romanizimit. (Në fjalorin e Kavaliotit Tunmani gjeti rreth 100 fjalë me prejardhje të padyshimtë romake dhe thekson se, me gjithë fqinjësinë e lashtë me grekët, greqizmat janë shumë më të pakta. “Romakët futën ligjet dhe zakonet e tyre kudo ku sunduan. Aty ku ngritën koloni romane, aty u bë zotëruese edhe gjuha e tyre, ose të paktën gjuha e vendit u përzie fort me të.”¹⁴⁴

Edhe profesor Çabej, te “Hyrje në histori” thekson se “Një tjetër rrethanë që ndihmoi në përhapjen e romanizmit në Ballkan e gjetkë që ajo që latinishtja, me sundimin politik e ushtarak të vendit e me rrjetin e rrugëve hyri thellë në tokë, në kundërshtim me greqishten që zotëronte më fort në bregdet.”¹⁴⁵

Këtu, duhet të theksojmë se edhe akademiku Mihaesku mbështet provat që tregojnë se të parët e shqiptarëve jetonin edhe në Maqedoni e Dardani, ku ishin fqinjë me latinofolësit e Mëzisë së Sipërme. Duke vazhduar në linjën e argumenteve gjuhësore, që lidhen me marrëdhënien e latinishtes me gjuhët e tjera të Ballkanit duhet të ndalemi në faktin që aromanishtja përbën një idiomë neolatine, që rrjedh prej “latinishtes popullore”, degës lindore të saj, dhe si e tillë ajo

¹⁴³ <http://sq.ëikipedia.org>.

¹⁴⁴ H. Tunman, *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, Tiranë, 1990, f. 55-56.

¹⁴⁵ E. Çabej, *Hyrje në histori*, II, Tiranë, 1976, f. 114

qëndron si një gjuhë më vete, paralelisht me rumanishten. Studiues, si: N jorga, A. Xenopol, I Coteanu, G. Guinglea, etj. kanë mbështetur këtë variant.

Sot “arumunët”, “aromanët”, “vllehët” (Armânji, Rrâmânji, Makidonji), të cilët ne po i konsiderojmë si pasardhës të latinëve, gjenden në të gjithë Ballkanin e jugut, sidomos në veri dhe në pjesën qendrore të Greqisë, në Shqipëri, kryesisht në jug, në Republikën e Maqedonisë, në jug-perëndim të Bullgarisë, gjithashtu, njihen si një komunitet edhe në Serbi dhe Rumani (Dobrukhia). (në fillim të viteve ‘20 të shekullit të kaluar pati një valë emigrimi të aromanëve në Rumani. Aromanët, që jetojnë në Rumani përpiqen të ruajnë gjuhën dhe kulturën e tyre.)

Në Shqipëri, sot ata gjenden në zonën qendrore dhe jugore, kryesisht në jug të vijës Durrës-Ohër, si: në Durrës, Elbasan, Tiranë, Kavajë, Rrogozhinë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Pogradec, Korçë, Gramsh, Ersekë, Përmet, Gjirokastër, Delvinë e Sarandë.¹⁴⁶

Në këtë kuadër, mund të shtojmë faktin se, meqenëse aromanët kanë qenë të pranishëm që herët në territorin shqiptar, albanologu A. Boue është munduar të evidentojë ngjashmëri leksikore shqiptaro-vllahe, (pavarësisht se profesor Jup Kastrati ka vënë në dukje se konstatimet e tij (Bouesë) nuk janë bërë në bazë të parimeve të gjuhësisë krahasimtare indoevropiane, pasi më 1840 ajo ende nuk ishte themeluar si një degë më vete e gjuhësisë). Gjithsesi, ky fakt ka rëndësi pasi dëshmon në favor të faktit të autoktonisë së shqiptarëve.

Pra, marrëdhënia midis shqipfolësve dhe latinfolësve është e hershme, por në rastin tonë kjo marrëdhënie nënkupton hershmëri marrëdhëniesh edhe me aromanishtfolësit, si folësit e variantit të “latinishtes vulgare”. Duke pasur parasysh krahun lindor të latinishtes, (koncepti i latinitetit lindor), natyrisht, mund të gjykojmë edhe për rumanishten si një idiomë që edhe sot ruan lidhjet gjenetike.

Gjithashtu, përcaktimin e profesor Çabejt, se “trajtat e gjuhëve romane, të cilat rrjedhin nga një burim i përbashkët dhe reflektojnë zhvillimet e veçanta të latinishtes në provincat e ndryshme romake të Evropës.”¹⁴⁷ mund ta quajmë të vlefshëm edhe për aromanishten. Mendohet se transformi i aromanishtes të ketë ndodhur pak më parë se shekulli X.¹⁴⁸

Edhe Mihaesku, e trajton aromanishten si një idiomë latine dhe ndërkohë, periudhën e formimit, të linjave të përbashkëta të rumanishtja dhe aromanishtja, H Mihaesku e vendos para shek. VII.¹⁴⁹

II. Konsolidimi i ndërtimit të formave të pashtjelluara të tipit “ti lukrári” dhe “una fidzéri”, dëshmi e marrëdhëniesh të hershme shqiptaro-aromane

II.a. Format e pashtjelluara të latinishtes përballë atyre të aromanishtes të zonave të ndryshme ballkanike

Duke marrë shtysë nga konstatimet e akademikut Mihaesku për:

- a. Autoktoninë e shqiptarëve, të bazuar te huazimet latine në gjuhën shqipe;
- b. Njohjen e aromanishtes si një idiomë latine;

¹⁴⁶S. Poçi, *Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre*, Tiranë, 2006, f. 59.

¹⁴⁷E. Çabejt, *Hyrje në indoerupianistikë*, Tiranë, 2008, f. 84.

¹⁴⁸S. Poçi, *Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre*, Tiranë, 2006, f. 57.

¹⁴⁹H. Mihaesku, *La langue latine dans le sud-est de l'Europe*, Paris, Bukureshti, 1978, , f. 320-327.

Në këtë çështje, që përbën edhe pjesën qendrore të kësaj kumtese, do të shqyrtojmë te aromanët, e Jugut të Shqipërisë, format pashtjelluara të foljes, si pjesë e sistemit foljor, duke i krahasuar me format e pashtjelluara që përdorin aromanët e zonave të tjera të Ballkanit. Ky krahasim bëhet me synimin që të sjellim një argument të ri për zhvillimin e aromanishtes, si një idiome neolatine, nën ndikimin e shqipes, gjuhë e shqiptarëve autoktonë.

Fillimisht, i referohemi faktit që në gjuhën latine, gjuha mëmë e aromanishtes, format e pashtjelluara janë: infinitivi (i së tashmes, me mbaresën *-ire*; i së kryerës veprorë, me mbaresën, *-isse*; i së ardhmes veprorë, me mbaresat, *-iutrus*, *-a um*, *-ese*); pjesorja (e së tashmes veprorë; e së ardhmes veprorë), gjerundivi; gjerundi; supini.

Në latinisht, paskajorja (infinitivus) ishte një trajtë (mënyrë<modus) pavetore me 3 kohë: koha e tashme, koha e ardhme dhe koha e shkuar, nga te cilët vetëm e para u mbajt (u trashëgua) në juhët neolatine. Forma e tashme veprorë ndërtohej me ndihmën e prapashtesës *-re*, p. sh.: *cantāre* (zgjedhimi I), *vidēre* (zgjedhimi II), *dicēre* (zgjedhimi III), *venīre* (zgjedhimi IV), por në latinishten popullore (latina vulgaris) kjo formë kishte filluar të zhdukej¹⁵⁰.

Për shembujt nga aromanishtja, si një material të plotë për gjuhën e aromanëve të jugut në Shqipëri, është shfrytëzuar monografia e studiueses S. Poçi “*Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre*”. Në këtë studim përfshihet edhe morfologjia (emri, mbiemri, përemri, numërori, folja, ndajfolja, parafjala, lidhëza). Gjithashtu, një burim i mirë informacioni janë njëmbëdhjetë tekstet arumanisht dhe shqip, pasi në to mund të gjejmë informacion për strukturat, si dhe për rendin e gjymtyrëve në rastet kur përdoren këto forma të pashtjelluara.

Konkretisht, këtu si forma të pashtjelluara njihen: paskajorja, *ti lukrari*; *ti agutari*; *ti disikari*; pjesorja dhe forma *una fisteri* (një të bërë).

Te “Gramatika armaneska –simpla shi praktica” e Iancu Ianachieschi-Vlahu, kemi si forma të pashtjelluara: Participlu tricut (pjesoren) me dy format për femëroren dhe për mashkulloren, si dhe infinitivlu (infinitivin).

Konkretisht, sipas tij, infinitivi formohet përkatësisht me këto prapashtesa trajtëformuese: *-re*; *-ri*, (p. sh. *lukrare- lukrari*). Sipas zgjedhimeve, kemi përzgjedhur prej kësaj gramatike nga një shembull për çdo zgjedhim të foljes.

1. *lucráre*, punoj
2. *cādeare*, bie
3. *arupire*, këput
4. *aurare*, thërres¹⁵¹,

Për secilin prej rasteve jepet edhe variant me prapashtesën *-ri*.

Achille G. Lazarou, te “*L’Aromain et ses rapports avec le grec*”, njeh si forma të pashtjelluara: -Participe passé (*Apurtátă biútă*; *arúptá hivrită*); gerondif (*apurtînda biúnda arupînda hivrinda*); infinif (*apurtáre beáre*; *arupeáre hivrire*).¹⁵²

¹⁵⁰ Istoria l imbiromîne, v. II, București, 1969, f. 112.

¹⁵¹ I. Ianachieschi-Vlahu, Gramatika armaneska –simpla shi praktica, Crushuva, 1993, f. 90- 91.

¹⁵² A. G. Lazarou, L’Aromain et ses rapports avec le grec, Institute for Balkan Studies, f. 230-231.

Lidhur me infinitivin, ajo që vërehet te aromanët që jetojnë jashtë Shqipërisë, është se ruhet forma e “infinitivum”, paskajores së tashme të latinishtes, e tipit *aedificare*.

II.b. Pak histori rreth infinitivit në kuadrin evropian

Fillimisht po i referohemi profesor Çabejt për historinë e infinitivit në gjuhët indoevropiane, trajtim të cilin ai e ka bërë në leksionet e mbajtura në universitetin e Prishtinës të përmbledhura në librin “Hyrje në indoeruropeanistikë”. Ai shprehet: “Tani t’i hedhim një sy infinitivit, paskajores. Po ta shohim historinë e infinitivit në gjuhët indoevropiane që dëshmojnë qëmoti, vihet re një gjë. Gjuhët indoevropiane nuk kanë një formë të vetme dhe të gjithmbarëshme të infinitivit.. Formimi i infinitivit te gjuhët indoevropiane në pjesën më të madhe është një dukuri që shfaqet në periodat historike të tyre. Kjo lidhet si të thuash edhe me arsye kulturore. Infinitivi gjuhësisht është një përfitim që lidhet me njëfarë përparimi kulturor, sepse ka lidhje me mendimin abstrakt. Infinitivi është forma më abstrakte e foljes, që në gjuhët primitive shpesh herë nuk del. Lidhet me një zhvillim të një mendimi, të një abstraksioni mendor. Nuk mund të thuhet se në gjuhën mëmë indoevropiane të ketë pasur një infinitiv të gjithëmbarshtëm. Domethënë çështja e infinitivit kushtëzohet nga një zhvillim i gjatë.”¹⁵³

Gjuha e sotme shqipe nuk ka infinitive siç kanë shumica e gjuhëve indoevropiane, siç ka edhe dialekti verior (gegërishtja e shqipes). Infinitivi, (paskajorja) e tipit *me ba* shpreh një proces në mënyrë të përgjithshme dhe mund shfaqet me kategorinë gramatikore të diatezës (*me ba*, *me u ba*). Paskajorja e gegërishtes që është një paskajore me kuptimin e vërtetë të fjalës, e krahasueshme plotësisht me paskajoren e gjuhëve të tjera. Kurse forma e tipit *për të bërë* është larg të qenit një paskajore e pavarur në funksion fjalie.¹⁵⁴ Pikërisht këtë formë kanë marrë për model edhe aromanët në fjalë.

II.c. Ndërtimi i paskajores aromane sipas modelit të paskajores së dytë të shqipes

Paskajorja e aromanishtes, sipas S. Poçit, është formuar duke i vendosur pjesëzën *ti* me vlerë parafjalore emrit prejfoljor, p. sh. *ti lukrári*; *ti agutári*; *ti disikári*. Në qoftë se do të shohim se çfarë tregon kjo parafjalë në gjuhën aromane, atëherë mund të hedhim dritë mbi formimin e kësaj forme të pashtjelluar, që nuk e hasim te folësit e aromanishtes në vise të tjera të Ballkanit.

Kjo parafjalë në aromanisht, tregon kohë, vend dhe qëllim. Po veçojmë rastin kur tregon qëllim p. sh. *Unidzá ti l’émi* (do të shkonin për dru). Pikërisht këtu kemi një paralelizëm të plotë në gjuhën shqipe kur një emër shoqërohet me parafjalën *për*, për të treguar treguar qëllim dhe struktura funksionon si rrethanor qëllimi, p. sh. *Do të shkonin për dru*. Duke u nisur nga këto fakte mund të themi se kjo parafjalë funksionon edhe si pjesëz gramatikore për formimin e paskajores sipas modelit të shqipes.

Lazarou, te “L’arumain”, merr në konsideratë ndikimin e gjuhës vendase mbi aromanishten “Vllehtë, duke jetuar në një territor me grekët, dhe duke qenë, dygjuhësh (aromanisht-greqisht)

¹⁵³ E. Çabej, “Hyrje në indoeruropeanistikë”, Tiranë, 2008, f. 89.

¹⁵⁴ M. Çeliku, “Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe”, Shblu, Tiranë 2006. f. 91.

përdorin elementin grek duke e përshtatur atë siaps mënyrës së të folurës së tyre”.¹⁵⁵ Ky konstatim, është i vlefshëm edhe në rastin tonë.

Konkretisht formimi me pjesëzën “ti” me vlerë parafjalore përbën argumentin kryesor për ndikimin e shqipes mbi aromanishten. Kjo formë tashmë e konsoliduar dëshmon një marrëdhënie shumë të hershme midis këtyre dy gjuhëve (P. sh. formën foljore *Vra mākāri*, të quajtur paskajore pa pjesëzën “ti” e hasim vetëm në një përdorim, pas foljes *vra* në vetën e tretë (*duhet*) të nguros, p. sh. *vra lukrāri gārdīna* (do punuar kopshti). Pra përbën një rast të cilin nuk mund ta quajmë paskajore.

Gjithashtu, këtu mund të shtohet edhe fakti që ashtu si në gjuhën shqipe, edhe për aromanishten e Jugut të Shqipërisë funksionet sintaksore të paskajores janë si: rrethanor qëllimi, përcaktor, përcaktor kallëzuesor. Gjithashtu ajo merr pjesë në ndërtimet e tipit (*për të mësuar, mësonte*). Kjo formë e pashtjelluar mund të marrë edhe një rrethanor vendi, një kundrinor të drejtë e të zhdrejtë. Shembujt.

Lidhur me këtë fakt mendojmë se, meqenëse në gjuhën shqipe ndërtimi *për të bërë* është formuar nga parafjala *për* dhe emrit prejfoljor ose (gerundit *të bërë*, sipas profesor Çelikut) *të bërë*, edhe aromanishtja ka ndjekur të njëjtën rrugë. Edhe në gjuhën standarde rumune, infinitivi ka dy forma: një formë të shkurtër (e cila është në të njëjtën kohë edhe forma standarde e foljes, kështu siç gjendet në fjalor): *a citi, a se plimba*; një formë e gjatë: *citire, plimbare* – e cila, konsiderohet sot, ka kaluar plotësisht në kategorinë e emrit. Karakteristikë për rumanishten është, që kjo formë e vjetër (e plotë) e infinitivit merr formën e një emri foljor: *cîntare* “të kënduarit, këngë”; *iubure* “dashuri” etj.¹⁵⁶ Pavarësisht se në shekullin XVI forma e plotë e infinitivit ka ende përdorim në sistemin foljor¹⁵⁷ përdorimi emëror i saj është një karakteristikë shumë e përhapur. Edhe në rumanisht, forma e shkurtër e infinitivit realizohet nëpërmjet paravendosjes së fjalës “a”: *a citi, a se plimba*, e cila është kategorizuar si parafjale nga shumica e gramatikave. Funksionet foljore takohen në format e shkurtuara të infinitivit *a cînta* “këdoj”, *a Țovorbi* “flas”. Kjo formë dallohet nga forma e gjatë për shkak të humbjes së prapashtesës *-re* (dukuri që mund të shpjegohet nëpërmjet procesit të kalimit nga gjuha latine popullore e folur në veri të Danubit në gjuhën rumune), por edhe nga parafjala ‘a’ tipike për infinitivin që gjendet para foljes (e cila mund të shpjegohet si zhvillim i infinitivit rumun në kontekstin ballkanik). Si strukturë, ky ndërtim është shumë i ngjashëm me atë të infinitivit (paskajores) në gjuhën shqipe, në dialektin geg.

Kurse, forma e gjatë *Venīre* (lat.)> *venire* (rum.), është plotësisht e trashëguar nga latinishtja bashkë me zgjedhimet e foljëve. Sipas studimeve të fundit, forma e gjatë e paskajores ka kaluar plotësisht në kategorinë emrit¹⁵⁸. Sot, në dialektet dakorumune infinitivi fillon dhe përdoret më rrallë në drejtimin veri – jug; në arumanishte nuk njihet përdorimi foljor i infinitivit, as në format lidhore të foljes, as në format e përbëra foljore. Forma e plotë e infinitivit ka vlerën e një emri; në

¹⁵⁵ S. Poçi, *Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre*, Tiranë 2009, f. 45.

¹⁵⁶ , P. Asenova, *Balkansko ezikoznanie. Osnovni problemi na balkanskija ezikovsējuz*. Sofie, 1989, f. 108.

¹⁵⁷ Al Rosetti., *Istoria l imbiromîne*, v. II, București, v. I, II, III, București, 1966, f. 254.

¹⁵⁸ N. Forascu, *Dificultati gramaticale ale limbii romane*, 2002, in <http://ebooks.unibuc.ro/filologie/NForascu-DGLR/infinitiv.htm>.

meglenorumanishte përdorimi i infinitivit është shumë i kufizuar: forma e tij e plotë shfaqet vetëm pas foljeve modale¹⁵⁹. Përdorimi i infinitivit (forma e shkurtuar, por pa *a*) në istrorumanishte shpjegohet me ndikimin nga gjuha kroate dhe italiane.¹⁶⁰ Format e pashtjelluara (edhe tek vllahët e Bullgarisë) shumë rrallë mund të përdoren në mënyrë të pavarur. Edhe kur përdoren luajnë rolin e një emri ose të një përemri. Përcjellorja (gerundi) nuk ekziston, nuk takohet në dialektet që fliten në Bullgari.

Edhe Gabinski, në rastin e gjuhës shqipe, pranon që në togun *për të bërë*, fjala *për* ruan kuptim parafjalor. Ky tog nuk është foljorizuar, nuk është substantivuar nuk është desintaksizuar.¹⁶¹ Profesor Sh. Demiraj shpreh rezerva për kalimin e togut *për të bërë* në klasën e foljeve, pasi ka dhe raste kur ky tog përdoret si plotës qëllimi.¹⁶²

II.d. Forma e pashtjelluar e tipit *una fidzëri* përballë formës së pashtjelluar *një të bërë*

Në përforcim të kësaj ideje, kemi formën *një të bërë*, si një risi tipike e aromanëve të Shqipërisë, të cilën muk e hasim të listuar në format e pashtjelluara për gjuhën e aromanëve të zonave të tjera të Ballkanit. Sistemi i konsoliduar flet për një kohë të hershme të kontakteve gjuhësore.

Togu *una fidzëri* ndërtohet nga emri prejfoljor dhe nyja *una* përpara. Ai mund të marrë një kryefjalë, një kundrinor, një rrethanor ashtu si edhe foljet e tjera të zgjedhueshme. *Únă vinéry sórsa; únă gréri a fëtiyi; ună adustëri pãna.*¹⁶³

Për rastin e shqipes po i referohemi profesor Sh. Demirajt për togjet *me të bërë* dhe *një të bërë*, i cili pranon se këto raste kanë kaluar në klasën e foljeve. Sipas tij, ato janë emra të gjinisë asnjansë të shoqëruara me parafjalë. Mendojmë se edhe në këtë rast vlen i njëjti arsyetim që bëmë edhe për formën *për të bërë*.¹⁶⁴

II.e Pjesorja në aromanisht dhe në gjuhën shqipe

Në kuadër të krahasimit, nuk po e lëmë mënjandë edhe pjesoren. Pjesorja e aromanishtes, ashtu si në latinisht (aedificatum), ndërtohet nga tema e së kryerës së thjeshtë dhe prapashtesën trajtëformuese të saj (kantata, lukrata).

Ajo shërben për të formuar kohët e përbëra të foljeve.

Në rastin kur folja është në formën veprorë pjesorja e saj është femërore dhe e pandryshueshme në të gjitha vetat. Në rastin kur folja është në formën joveprorë (pësore), pjesorja përshtatet në gjini dhe numër me kryefjalën.

¹⁵⁹ Caragiu – Marioțeanu, *Dialectologia romana*, București, 1977, f. 189, 209.

¹⁶⁰ K. Sandfeld, *Linguistique balkanique*, Problemes et resultats, Paris, 1930, f. 174.

¹⁶¹ M. Çeliku, “Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe”, Shblu, Tiranë 2006. f. 18-19.

¹⁶² Po aty, f. 21.

¹⁶³ S. Poçi, *Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre*, Tiranë, 2009, f. 169.

¹⁶⁴ M.t Çeliku, “Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe”, Shblu, Tiranë 2006. f. 18-19.

Shpesh pjesoren e gjejmë të përdorur edhe si mbiemër. Në këtë rast ajo përshtatet në gjini dhe numër me emrin. *Intrără tu únă kărăvi arúptă*.¹⁶⁵ Pjesorja e aromanishtes është plotësisht e krahasueshme me shqipen.

Për gjuhën shqipe, për formën e pashtjelluar *pjesore* po i referohemi profesor Mehmet Çelikut. Ky term, sipas tij i përgjigjet termit *particip* të gjuhëve të tjera *dhe* ka dy trajta: *punuar*, trajtë pa mbaresë dhe *(i/e/të/së punuar, trajtë* me mbaresë të përparme.¹⁶⁶

Edhe në gjuhën shqipe, trajta pa mbaresë formon kohët kohët e përbëra, në zgjedhimin vepror duke u shoqëruar nga folja ndihmese *kam* (kam bërë; kisha bërë, paskam bërë, pata bërë) dhe në zgjedhimin jovepror nga folja ndihmëse *jam* (jam larë; isha larë; qëshë larë)., kurse trajta me mbaresë të përparme funksionon si mbiemër duke u përshtatur në gjini, numër dhe rasë me kryefjalën.

III Përfundim

Ndërtimi i konsoliduar i infinitivit sipas modeli të paskajores së dytë të shqipes të tipit *për të bërë*, si dhe i formës të tipit *një të bërë*, nën ndikimin e gjuhës shqipe, te aromanishtja e jugut të Shqipërisë, përbëjnë një argument për autoktoninë shqiptare.

REFERIME

- Asenova, P., *Balkansko ezikoznanie. Osnovni problemi na balkanskija ezikovsējuz*. Sofie, 1989.
- Caragiu – Marioțeanu, *Dialectologia romana*, București, 1977.
- Çabej, E., *Hyrje në indoerupianistikë*, Tiranë, 2008.
- Çeliku, M., *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2006.
- Gëllëbov, Iv., *Bëllgarski në minaagentiskato prilagatelni v rumënski i allbanski*. BE, XVI, 4 Sofje, 1966.
- Haxhi, A., Topalli, T., *Leksikon gjuhëtarë shqiptarë dhe Albanologë*, Fiorentina, Shkodër, 2012.
- <http://ebooks.unibuc.ro/filologie/NForascu-DGLR/infinitiv.htm>.
- Ianachieschi-Vlahu, I., *Gramatika armaneska –simpla shi practica*, Crushuva, 1993.
- ILR = *Istoria l imbiromîne*, v. II, București, 1969.
- Lazarou, G. A., *L’Aromain et ses rapports avec le grec*, Institute for Balkan Studies.
- Poçi, S., *Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre*, Tiranë, 2009.
- Rosetti, Al., *Istoria l imbiromîne*, v. II, București, v. I, II, III, București, 1966.
- Sandfeld, K., *Linguistique balkanique, Problemes et resultats*, Paris, 1930.

¹⁶⁵ S. Poçi, *Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre*, Tiranë, 2009, f. 169-170.

¹⁶⁶ M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2006, f. 54.

TOPONIMIA ARUMUNE NË KOSOVË

Prof. asoc. dr. Begzad Baliu

Fakulteti i Edukimit, UP "Hasan Prishtina"

Përmbledhje

Si në të gjitha trevat e Ballkanit edhe në Kosovë, e kjo do të thotë edhe në krahinën e Gallapit (Kosova Verilindore), është dëshmuar disa herë se ka gjëlluar dha ka krijuar madje edhe vendbanime një popullsi rurale në mesin e popullsisë vendëse, duke lënë kështu edhe gjurmët e veta në fushë të ojkonimisë dhe mikrotoponimisë. Fjala është për arumunët, përkatësisht vllehtë, për të cilën tashmë gjuhëtarët vendorë dhe ata të rajonit kanë sjellë shpjegime të ndryshme, mbështetur në trashëgiminë e tyre historike, arkeologjike, gjuhësore, sociale dhe etnike. Bazë e këtij punimi kanë qenë kërkimet në terren, në dokumentet historike dhe në arritjet e gjertanishme shkencore, ndërsa synimi kryesor është tipologjia historike, gjuhësore dhe etnike e kësaj trashëgimie.

Krahina e Gallapit

Krahina e Gallapit është njëra prej krahinave etnografike dhe gjuhësore të Kosovës. Ajo shtrihet në verilindje të Kosovë, kurse një pjesë e saj hyn në të ashtuquajturën krahinë të Medvegjës, e cila, më parë sesa krahinë etnografike, do të mund të quhej krahinë politike dhe administrative dhe përfshinë më tepër se 100 fshatra të banuara kryesisht me shqiptarë, por edhe me serbë. Duke qenë një zonë kryesisht e mbyllur (gjatë kohës më të re) për komunikim me qendrat urbane, por me një trashëgimi të theksuar që nga historia e zhvillimit të Artanës (Novo Berdës) si qytezë mesjetare dhe antike, brenda kësaj krahine janë ruajtur shumë veçori të rëndësishme historike dhe veçanërisht gjuhësore, për të cilat interesimi i studiuesve nuk ka munguar.

Emri i krahinës etnografike në lindje të Kosovës, i njohur sot si Gallup, krahinë e cila, sipas të dhënave gjuhësore, arkeologjike, historike, gjeografike, etnografike, folklorike etj., është shënuar edhe në trajtat: *Gallaba*, *Gallabie*, *Gallapi*, *Gallup*, *Gollak* etj., ndërsa me lëvizjen e banorëve të saj në kohë të vjetra në vende të tjera edhe si Γάλαβροι, deri tek *Kalabria* e sotme në Italinë Jugore¹⁶⁷.

Në trojet etnike shqiptare toponimi *Gallap*, tash na paraqitet në dy trajta: së pari, një rajon i qytetit të Laçit quhet *Malësia e Gallapit*¹⁶⁸, ndërsa një rajon tjetër ndërmjet qytetit të Gjilanit dhe qytetit të Ferizajit quhet Gollaku i Zhegofcit. Në formën e tashme (Gollak), gjendet edhe në

¹⁶⁷ Më gjerësisht, shih Norbert Jokli, *Ilirët*, Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë, Tiranë, Dosja A-59, nr. 682, f. 1. Eqrem Çabej, *Emri i Dardanisë dhe izoglosat shqiptaro-kelte*, në SGJ-IV, Prishtinë, 1976, f. 386; Rexhep Doçi, *Antroponimia e Llapushës (Prekorupës)*, IAP, Prishtinë, 1983, f. 48. Shih edhe *Toponimia e fshatit Gmicë*, GJA-sshf, VI, IAP, Prishtinë, 1976, f. 173. Rexhep Doçi, «The Serbization of Kosova», «The Voice of Truth» (Zëri i së vërtetës), Vol. 10, nr. 2, P. O. Box. 742, Ridgefield, NJ. 7657, pp. 1-3. Problemin e këtij emri R. Doçi e ka trajtuar edhe në disa studime të natyrës shkencore (duke e plotësuar mendimin e tij me shembuj të rinj) apo divulgativë (duke e vënë në kontekst të përgjithshëm), por esenca e rezultateve mbetet e njëjtë; Skënder Gashi, *Mendime rreth prejardhjes së emrit të Krahinës Gollak (Gallapit)*, "Fjala", 1984, f. 16; Muharrem Carrabregu, *Gjeo dhe hartolinguistika –Hartografia II*, Prishtinë, 1985;

¹⁶⁸ *Ditari* i Radio Tiranës, më 29. 4. 1993.

“Fjalorin enciklopedik” të Sami Frashërit, ndërsa në një dokument të shekullit XV (1432-1440) në radhorin e librit të borxhlinjve të M. Llukareviqit *Gallapi* është shkruar në formën *Gulach*¹⁶⁹.

Trajtave të emrit të *Gallapit* ndër harta u është qasur gjeografi Muharrem Carabregu, i cili veç tjerash, ka theksuar se “kjo anë e Kosovës, qysh në kohërat më të vjetra historike, në kohën e zhvillimit të gjuhës ilire ose ilirishtes moderne–gjuhës shqipe (Radosllav Katiçiq), është diferencuar si vis i veçantë, ku u zhvillua dhe shtrihej areali i fisit ilir homonim *Gallap*, që shënohet edhe në hartat e vjetra: *Gallabi Dardanica Genz* (Loter, 1775), *Galavroi* (Velesanlis, 1797) etj.”¹⁷⁰, ndërsa në aspektin gjuhësor ka vënë re se “trajta *Gallap* është një përbërje ku janë shkruar dy terma gjeografikë me prejardhje parahistorike: *-ga* dhe *-llapi*. Derisa me krijimin e termit të parë mund të thuhet se ka të bëjë me përshkrimin e pozitës gjeografike, me krahasim relativ në fushën luginore të Llapit, d. m. th., terren më të lartë, termi i dytë është vetëshpjegues, meqë kemi të bëjmë me termin e njohur mirë që merr disa trajta të metatezës likuidative: *-alp*, *-llap*, *-alb*, *lab-* etj., që kanë domethënie të lartësisë, bardhësisë etj.”¹⁷¹

Studimet e gjertashme kanë dëshmuar për shtresën ilire, trake, por edhe iliro-trake të disa antroponimeve dhe patronimeve të kësaj ane; shtresën sase të një fisi gjermanik, krahas gjurmëve të dubrovnikasve, të cilët punuan në qytetin e argjendit të Artanës së sotme, të njohur me emrin antik dhe mesjetar, si: *Nouo Monte* (1546), *Nova Berda* (1812-1921), *Nova Berde* (1630), *Nouomont* (1598-1723) *Neuberger*(?), *Nova bir*(?) etj.¹⁷²; gjurmët e kumanëve, gjurmët e gjuhës romane, gjurmët e formave latine të toponimisë ilire, gjurmët e gjuhës së vjetër grekëve dhe të kohës së bizantit, gjurmët e shtegtimeve të para mesjetare sllave (bullgare e serbe); gjurmët e vllahëve dhe ndërndikimit të gjuhës së tyre me gjuhën vendëse në fushë të toponimisë, gjurmët e ndikimeve shtetërore osmane, shtresa e pasur e shqipes së sotme etj.

Emërvendet me prejardhje latino-romane

Si në gjithë trevat e Ballkanit edhe në Kosovë, e kjo do të thotë edhe në krahinën e Gallapit është dëshmuar disa herë se ka gjëlluar dha ka krijuar edhe vendbanime një popullsi (arumune) baritore, duke lënë kështu edhe gjurmët e veta në fushë të makrotoponimisë. Në Kosovë përgjithësisht janë identifikuar oikonimet: *Beçuk* (Vushtrri), *Vllahi* (Mitrovicë), *Sibofc* (Obiliq), *Turiçec*, *Magure*, *Mikushnicë* (Skënderaj), *Magure* (Lipjan), *Llajshec* (Prishtinë) etj., ndërsa në krahinën e Gallapit oikonimet dhe oronimet: *Llukar* (Prishtinë), *Makresh* (Gjilan), *Magure* (Dragancë), *Rimanishtë* (Podujevë), *Sinaninci*, *Pirushinci* *Lepqonivci* (Pejë), *Lubizhda* (Deçan), *Srjemlani* (Gjakovë), *Selishtor* (Gjilan) etj., për të cilat tashmë ka një vlerësim të përbashkët sa i përket etimologjisë së tyre, por jo edhe për prejardhjen etnike.

¹⁶⁹ S. Gashi, *Mendime...*, f. 16.

¹⁷⁰ M. Carabregu, *Gjeo dhe hartolinguistika...*, f. 123.

¹⁷¹ M. Carabregu, *Vep. e cit.*, f. 122-123.

¹⁷² M. Carabregu, *Vep. e cit.*, f. 319-320.

Le të sjellim vetëm tre nga shembujt e shumët: një oronim, një patronim (lagje) dhe një oikonim (fshat), në përmasa të një simbolike të këtyre kërkimeve, të cilat gjerësisht i kemi studiuar në monografinë tonë “Onomastika e Gallapit”¹⁷³.

Magure: oronim (Draganc - Gjilan). Etimologjia e kësaj fjale sikur dihet vjen nga latinishtja “*moyoro*, “*kodër e vogël, kodrinë*“ *shqip* “magulë, kodër, bregore”, rumanisht *măgură* me të njëjtin kuptim¹⁷⁴. Shfaqet që në dokumentet historike e gjejmë nga shek. XV. Më 1455: Maguri (OB, 45); Më 1885: Malgure (SK. 58); Shek. XIX: Magura dhe më 1896: Magura (SK, 340)¹⁷⁵. Në krahinën e Gallapit, nuk mungojnë mikrotoponimet me prejardhje arumune. Le të kujtojmë se ky oronim gjendet ndërmjet *Makreshit* (Gallap) dhe *Stanishorit* (Moravë) janë rajtur trajtat gjuhësore: *Stanistur* “kullosë” (Pepaj-Prishtinë); *Stanisur* (Hajkobillë-Prishtinë); *Stanishurë* dhe *Magure* (Moravë).

Vllasali: *Vllasali*, lagje, (Surdull: Besianë-Podujevë); *Vllasali* (Artanë). Në Kosovë nuk janë të paktë emrat e vendbanimeve dhe përgjithësisht mikrotoponimeve që lidhen me etnikun *vllah*: *Llashkobare*: *Vllashkobare*, *Llashticë*: (*V*)*llashticë* etj. Pavarësisht nga kjo, ne duke radhitur këtë oikonim në radhën e inventarit arumun të mikrotoponimisë së Gallapit, kujtojmë se ky është formim i brendshëm i një patronimi që u oikonimizua me kohë¹⁷⁶.

Makresh, -i: *Mali Makreshit*, *Dardha Makreshit* (Jasanovik); *Kisha Makreshit* (toponim i zhdukur). Vendësit thonë se diku ka qenë një kishë, por nuk e dimë. Dihet vetëm *Vorret e Moçme*; *Dardhat e Makreshit* (Busavatë). Në dokumentet e vjetra i përgjigjet lagjes së krishterë “*Mëhalla e Vuk Mërkshiqit*” dhe *Makrishi i Pashtëm*¹⁷⁷. Edhe tani kemi vendbanimet: *Makreshi i Poshtëm dhe Makreshi i Epërm*. Në radhorin e borxhlinjve të *Mihail Llukareviqit* është shënuar në formën *Macrexa* (Makresha)¹⁷⁸ etj. Në studimet onomastike, nga autorë shqiptarë dhe të huaj, janë bërë shumë përpjekje diakronike dhe sinkronike për të dhënë etimologjinë e këtij vendbanimi. Në rastet më të shpeshta ky oikonim është lidhur me oronimin e traditës bizantine *makër* “i madh”, hidronimin e prejardhjes sllave *mokra* “vend me lagështi” etj¹⁷⁹. ; ndërsa ne e konsiderojmë këtë oikonim të prejardhjes arumune, për

¹⁷³ B. Baliu, *Onomastika e Gallapit*, (tezë doctorate) Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004, f. 301.

¹⁷⁴ E. Çabej, *Studime gjuhësore*, IV, 1987, f. 265.

¹⁷⁵ Sipas Skedarit të Instituti Albanologjik të Prishtinës, dosja e Skënder Gashit.

¹⁷⁶ Për përhapjen e këtij etniku në Kosovë, shih, R. Doçi, *Iliro-shqiptarët...*, f. 99-100; Atanasije Urosheviq, *Neki detail iz proshllosti Kosova*, OP, I, Beograd, 1979, f. 30-33; Shembujt e shumtë të përhapjes së tyre janë vjelë kryesisht nga Dinić, Pulaha, J. Drançolli, M. Ternave, *Krisobula e Deçanit* etj.

¹⁷⁷ Shih S. Riza, *Novo Bërda gjetë shek. XV dhe XVI*, në “Vjetari”, nr. XX, Arkivi I Kosovës, Prishtinë, 1985, f. 111.

¹⁷⁸ J. Drançolli, *Raguzianët në Kosovë*, Prishtinë, 1990, f. 73.

¹⁷⁹ Shih E. Çabej, *Studime gjuhësore*, IV, f. 158; S. Gashi, *Antroponimia e etnosit shqiptar të viseve të Toplicës në gjysmën e parë të shekullit XV, në dritën e burimeve raguziane*, “Dituria”, nr. 1-2, Prishtinë, 1978, f. 131; dhe *Prania e etnosit shqiptar në Kosovë gjatë shekujve XIII-XIV*, në “Onomastika e Kosovës”, IAP, 1979, f. 67, 87; Recension për vëllimin “Konferenca e IV e Onomastikës”, në GJA-sshf, nr. XIII-1983, Prishtinë, 1984, f. 319-320; R. Doçi, *Antroponimia paraislame e Llapushës*, “Onomastika e Kosovës”, IAP, 1979, f. 138-140; Dhimitër S. Shuteriqi, *Fjalë të shqipes para Buzukut*, “Gjurmime albanologjike – seria e shkencave filologjike”, nr. XIX, IAP, 1989, f. 314; Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Prishtinë, 1989, f. 219; Voislav Dançetoviç, *Sufiksi deminutiv i emrave të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1960, f. 71; Marinko Mitkov, *Forma e brendshme e toponimeve dhe disa hulumtime*, në OK, 1979, f. 206.

vetë faktin se kjo është trevë e ndikimit arumun të toponimisë dhe zbërthehet me rum. *macris* “lëpjetë, uthull” (bot. *Rumex acetosa*).

Etnia apo ndërdija

Duke sjellë një listë mjaft të pasur të oikonimeve në Kosovë, studiuesi i njohur i fushës së onomastikës, i quante ato simbiozë shqiptaro-vllahe. Fjala është për toponimet dhe oikonimet: *Katuni Barel, Ponesh, Ponorc, Pijanci, Sushiqan, Grosheta, Blatqan* etj.¹⁸⁰. Shtrirja e tyre në gjithë hapësirën e Kosovës sillte atë koncept që ka mbretëruar përgjithësisht edhe në tekstet pak a shumë edhe zyrtare se vllahët në Kosovë, madje si edhe latinët (një popullatë e shtrirë kryesisht në qytezën e Janjevës) nuk janë veçse ilirët e romanizuar, të cilët në periudhën e mesjetës, përkatësisht gjatë periudhës së Bizantit u sllavizuan në serbë, gjegjësisht në ortodoksë, ndërsa në periudhën e Perandorisë Osmane u shqiptarizuan. Koncepteve të tij, kryesisht në kontekst të etnisë dhe përbërjes së popullsisë së kësaj etnie, i është kundërvënë kryesisht një numër studiuesish serbë (Atanasije Urosheviq, Vesna Jakiq-Cestariq, Pavle Iviq etj.), por as nuk është mbrojtur në mënyrë të veçantë nga dija shqiptare e kohës, përjashtoj studiuesin e brezit të tij Rexhep Doçin, i cili të gjitha këto shenja i ka parë thjesht si një vazhdimësi iliro-shqiptare.

Tash së fundi Gashi i është kthyer këtij konstatimi edhe njëherë: “Unë kujtoj se këtu kemi të bëjmë më parë me procesin e përfunduar në shek. XV të romanizimit të vllahëve, përkatësisht që pjesa e popullatës ardhëse romane e vendosur në rrëzë të Bjeshkëve të Nemuna, Sharrit, Pashtrikut dhe pjesës shqiptare të Kopaonikut u shqiptarizuan, ndërsa pjesa e vendosur në vise rrafshinore, përkatësisht rreth Rahovecit, në Rrafsh të Kosovës dhe pjesërisht në rrethina të Novo Bërdës u serbizuan”¹⁸¹.

Me këtë rast mendimi i studiuesve shqiptarë ndahet në tri linja: në ata që arumunët i shohin si pasardhës të latinëve të romanizuar, si ardhës të shekullit X-XII dhe në ata që ata i shohin vetëm si një popullatë nomade, e cila, megjithatë la disa gjurmë në këto tërthore.

Kërkimet tona në këtë linjë shkojnë përtej historisë, arkeologjisë dhe gjurmëve toponimike. Gjatë kërkimeve etno-historike dhe gjuhësore në juglindje të Novo Bërdës, në vitet ’90 të shekullit të kaluar, kam vjelë përgjithësisht edhe mendimet e një numri të konsiderueshëm oponentësh të disa fshatrave a lagjeve të kësaj zone me toponimi arumune: *Tullarë, Korçagin, Stanishor, Makresh, Magurë, Potoqan* etj., kam vënë re një numër të madh përkimesh kulturore (bestytни, legjenda, frazeologjizma dhe përbërës të tjerë etno-psikologjikë) mes popullatës shqiptare dhe serbe të kësaj zone. Kam vënë re veç të tjerash edhe për ekzistimin e një ndërdije (jo vetëdije) në popullatën e kësaj zone, sipas të cilëve “ata janë serbë, por me nënë bullgare!”, sado që nuk ishin në gjendje të shpjegojnë këtë fenomen. Sipas etnisë shqiptare ndërkaq, kjo është edhe arsyeja pse qëndrimi i kësaj popullate, të cilën ata e konsiderojnë “shqiptare ortodokse, nga Jugu i Shqipërisë dhe

¹⁸⁰ S. Gashi, *Albansko-vlashka simbioza u svjetlu onomastike*, “Onomastica jugoslavica”, nr. 10, Jugosllavenska Akademija Znanosti I Umjetnosti, Zagreb, 1982, ff. 47-62.

¹⁸¹ S. Gashi, *Gjurmë të latinitetit dhe të romanitetit ballkanik në toponiminë e Kosovës*, në Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, (Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 2012, f. 339.

Maqedonisë”, ndaj ndryshimeve politike ishte si edhe i romëve të kësaj zone! Nëse besimi se ata janë “shqiptarë ortodoksë të Shqipërisë së Jugut, sepse një lagje në jug të Novo Bërdës mbante emrin Mahalla e Korçaginve, një lagje e Makreshit të poshtëm me popullatë shqiptare quhej Mahalla e Radeceve dhe pranonte se ata kishin ardhur nga Manastiri i Maqedonisë”.

Për këtë konstatim tonin, të vënë re më lart, me gjasë kanë qenë të njohur edhe studiuesit serbë që më parë, në mos edhe propagandues të kësaj ideje dhe këtë e mbështes në një fakt të ndërmjetsëm. Në vitin ’30 dhe më pas, etnografi serb, akademiku Atanasije Urosheviq ka bërë kërkime të veçanta në këtë zonë dhe është përpjekur të ndajë krahinën etnografike të Gallapit nga Rrafshi i Kosovës dhe Morava. Gjyshërit tanë të kësaj zone kujtojnë ende kërkimet e tij nga fshati në fshat dhe madje, nga lagjja në lagje, shoqëruar nga xhandarët dhe kryetarët e fshatrave. Ata kujtojnë njëkohësisht një prirje të tij që prejardhjen e shqiptarëve ta nxirrte me çdo kusht nga Shqipëria e Veriut, duke e arsyetuar ardhjen e shqiptarëve të shtyrë nga varfëria dhe sidomos nga gjakmarria. Studiuesi serb Urosheviq, në këtë rrjedhë është përpjekur në mënyrë të veçantë, që në zonën e Novo Bërdës, ku shtrihen një numër simbolik i fshatrave shqiptare dhe serbe me toponimi tipike arumune të krahinës etnografike të veçantë¹⁸², pavarësisht se serbët në Kosovë, më parë se brenda krahinave etnografike kanë qenë të prirë të bashkohen rreth manastireve ortodokse.

Përfundime

Pavarësisht se kërkimet e kësaj natyre nuk mund të sjellin rezultate të reja në përmasat që duam brenda një studimi konference, dëshiroj të theksoj në këtë studim se synimi ynë ishte që të shtrojmë, përkatësisht zgjerojmë fushën e kërkimit: nga historia (ardhës a pasardhës); arkeologjia (nomade a sedentare), gjuhësore (rurale a urbane); fetare (serbo-ortodokse apo shqiptare-ortodokse dhe shqiptare- myslimane), dhe identitare (vetëdija apo ndërdija) e tyre. Në këtë rrjedhë, ajo që kërkohet prej studiuesve të ardhshëm kërkon që fenomeni të mos kërkohet vetëm brenda traditës mesjetare ortodokse serbe a shqiptare, po brenda vetëdijes etno-historike dhe psikologjike shqiptare dhe serbe njëkohësisht.

REFERIME

Acta et diplomata res albaniae mediae aetatis illustrantia. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovicus de Thalloczy, dr. Constatinus Jireček et dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I-II, Ribotim, Drejtoria e përgjithshme e Arkivave - Tiranë & Ekskluzive-Prishtinë, 2002.

Ajeti, I., *Shqiptarët dhe gjuha e tyre*, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1994.

Baliu, B., *Rreth etimologjisë së toponimit Makresh*, “Shpresa”, Prishtinë, nr. 6, 1994, f. 11; nr. 7, Prishtinë, 1994, f. 14.

Baliu, B., *Çështje të studimit të onomastikës në veprën e Eqrem Çabejt*, Punim magjistrature, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Dega e Gjuhësisë, Prishtinë, 2000.

¹⁸² Shih Atanasie Urosheviq, *Novoberdska Kriva Reka* - Antropogeografski ispitivanja, Beograd, 1950.

- Baliu, B., *Jo ndryshim i emërvendeve të Kosovës, por standardizim i tyre*, «Gjuha jonë», Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë, Tiranë, nr. 1-2/2000, f. 71-80.
- Baliu, B., *Mikrotoponimia e katundit Gllogovicë*, “Shpresa”, Prishtinë, 1994, nr. 7, f. 5.
- Boretzky, N., *Der türkische einfluss auf das albanische*, Tel 2 (Eörterbuch der albanischen Turzismen), Otto Harrassoëitz – ëiesbaden, 1976.
- Çabej, E., *Studime gjuhësore I-II* (Studime etimologjike në fushë të shqipes, A-ZH), Prishtinë, 1976.
- Çabej, E., *Studime gjuhësore VIII* (Studime etimologjike në fushë të shqipes A-B, 1976), Prishtinë, 1988.
- Çavolli, R., *Gjeografia regjionale e Kosovës*, ETMMK, Prishtinë, 2001.
- Cërrabregu, M., *Gjeo dhe hartolinguistika* (Hartografia II), Universiteti i Prishtinës –Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Botoi, ETMM Kosovës, Prishtinë 1980, f. 86.
- Deftëri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, (Paraqitja, hyrja, transliterimi dhe komentet nga Selami Pulaha), Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë, Tiranë, 1974.
- Doçi, R., *Antroponimia shqiptare e Kosovës I*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1986.
- Doçi, R., *Ilirio-shqiptarët dhe serbët në Kosovë (sipas onomastikës)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1994.
- Doçi, R., *Antroponimia e Llapushës (Prekorupës)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1983.
- Doçi, R., *Etnonimia dhe toponimia e fshatit Gmicë*, në Gjurmime albanologjike – seria e shkencave filologjike, nr. 6, 1976, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1977, f. 173-189.
- Doçi, R., *The Serbization of Kosova*, «The Voice of Truth» (Zëri i së vërtetës), Vol. 10, nr. 2, P. O. Box. 742, Ridgefield, NJ. 7657, pp. 1-3.
- Elezoviq, G., *Reçnik kosovsko-metohijskoj dijalekta*. Beograd 1932-1935
- Gashi, S., *Antroponimia e shqiptarëve në Kosovë gjatë shek. XV në dritën e burimeve onomastike turko-osmane (I)*, në GJA-sshf, 7, 1977
- Gashi, S., *Antroponimia e shqiptarëve në Kosovë gjatë shek. XIII-XIV në dritën e burimeve kishtarë serbe*, “Onomastika e Kosovës”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1979.
- Gashi, S., *Antroponimia e shqiptarëve të krahinës së Gallapit, Moravës e të Serbisë Jugore gjatë shek. XV në dritën e burimeve onomastike raguzase të shek. XV*, në “Gjurmime albanologjike – seria e shkencave filologjike“, nr. 6, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1976.
- Gashi, S., *Harta arkeologjike e krahinës së Gallapit në dritën e onomastikës*, “Fjala”, 9, 1977, f. 9 e 20.
- Gashi, S., *Rreth lokalizimit të katër vendbanimeve të Gallapit*, “Fjala”, 6, 1976, f. 20.
- Katiçiq, R., *Antroponimia ilire dhe etnogjeneza e shqiptarëve*, “Studime ilire”, I, II, Prishtinë, 1978
- Krasniqi, M., *Gjurmë e gjurmime*, Tiranë, 1982
- Kristal, D., *Kembriçka enciklopedija jezika*, Beograd, 1996
- Kryeziu, B., *Onomastika e Hashanisë*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2000.
- Munishi, Z., *E folmja e Gollakut të Kamenicës (Fonetikë-morfologji)*, Punim magjistrature,

Universiteti i Prishtinës –Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 1978.

Murati, Q., *Toponimet – vedat shqiptare të Ballkanit*, në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. XVIII, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë dhe Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë – Tiranë, 1997.

Murati, Q., *Shqiptarët dhe Ballkani ilirik*, Tetovë, 1999.

Oblast, B., Titulli i origjinalit: *Defter-i Mufassal-i Vilayet-i Vlk*, viti 859, sipas *Oblast Brankovića* (opširni katastarski popis iz 1455. godine), Orientalni Institut u Sarajevu. Priredili: Hamidžibegić, Adam Handžić, Ešref Kovačević. Sarajevo, 1972.

Papazoglu, F., *Srjednobalkanska plemena u predrimsko doba*, Sarajevë, 1969.

Patsch, K., *Ilirët*, Tiranë, 1923.

Pulaha, S., *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVII*, (Studime dhe dokumente), Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë dhe “8 Nëntori”, Tiranë, 1984.

Pulaha, Selami, *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1974

Rexha, Ilaz, *Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novobërdës sipas Defterit të fundshekullit XV*, “Vjetari”, Arkivi i Kosovës, nr. XXVII, 2002, Prishtinë, 2003.

Ristiç, Kosovka, *Malo Kosovo*, Prishtinë, 1971.

Sejdiu, Shefki, *Fitonomia shqipe e Kosovës – lënda, ndarja, etimologjia*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1972.

Sejdiu, Sh., *Sisteme, struktura, raporte (etnolinguistikë)*, “Era”, Prishtinë, 2002

Sejdiu, Sh., *Sprova etimologjike*, “Era”, Prishtinë, 2002

Shkurtaç, Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2001.

Simeon, Ri., *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva*, I, II, Zagreb, 1969

Skënder, R., *Novo Bërda gjatë shek. XV dhe XVI*, në “Vjetari”, nr. XX, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1985

Tërrnava, M., *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë 1995, f. 57.

Urosheviq, At., *Kosovo - Naselje i stanovništvo*, Beograd 1965

Urosheviq, A., *Toponimi Kosova*, Beograd 1975

Urosheviq, A., *Novobërdëska Kriva Reka - Antropogeografski ispitivanja*, Beograd, 1950

Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, (Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 2012.

VËSHTRIM PËRQASËS E SISTEMIT ZANOR TË SHQIPES DHE RUMANISHTES

Dr. Anyla Saraçi (Maxhe)

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, UK “Fan S. Noli”

Gjuhësisht, rumanishtja dhe shqipja u përkasin degëve të ndryshme të familjes së gjuhëve indoevropiane. Rumanishtja i përket degës romane me lidhje të forta leksikore, gramatikore dhe fonologjike me italishten, frëngjishten, spanjishten, portugalishten dhe gjuhë të tjera romane. (Renëick, M. E. L., 2012). Ajo konsiderohet vazhdim i latinishtes lindore që flitet në Rumani provincat dake dhe territoret përreth të kolonizuara nga romakët në kohën e perandorit Trajan (viti 106 pas Krishtit) (Brian, K. & Ogilive, S., 2009: 898).

Shqipja është një gjuhë e veçantë në këtë familje, e cila shtrihet në territorin brenda shtetit shqiptar, në Kosovë dhe në disa territore në shtetin maqedonas.

Shqipja, ashtu si dhe rumanishtja konsiderohet si një nga gjuhët e Lidhjes Gjuhësore Ballkanike (Brian, K., & Ogilive, 2009: 22). Pavarësisht se shqipja, si një degë e veçantë brenda familjes së gjuhëve indoevropiane, nuk ka lidhje trashëgimie me asnjë nga gjuhët e familjes, kjo nuk përjashton përkimet leksikore-gramatikore e fonetiko-fonologjike me rumanishten. A. Rosetti përmend rreth 88 terma indoevropiane paralatine, të cilat ekzistojnë në të dyja gjuhët, si: *barză -bardhë, bucurie-bukuri mǎnz- mëz, moș- moshë*; (Brian, K., & Ogilive, S., 2009: 22).

Në një këndvështrim të tillë, jemi fokusuar në një vështrim kontrastiv të sistemit zanor të shqipes dhe rumanishtes standarde.

Dy gjuhët e Ballkanit, si gjuhë bazë të Lidhjes Gjuhësore Ballkanike, kanë mjaft veçori të përbashkëta që i lidhin me gjuhët e tjera ballkanike.

Pavarësisht debateve mbi vlerën e disa prej këtyre veçorive, të para si tipare specifike të kësaj lidhjeje gjuhësore, shumë prej tyre janë pranuar nga një pjesë e madhe studiuesish. Këtu bëjnë pjesë dhe disa tipare fonologjike të vlerësuara si të përbashkëta për një pjesë të mirë të gjuhëve ballkanike, por që gjenden dhe jashtë gjuhëve të këtij gadishulli. Historia e shfaqjes dhe zhvillimit të tyre është e ndryshme, por gjithsesi ato paraqesin interes si ndikim i gjuhëve te njëra-tjetra në një vështrim sinkronik.

Feuillet (1986) ka vënë në dukje një sërë tiparësh të përbashkëta fonologjike ballkanike, një pjesë e të cilave lidhen me sistemin zanor të këtyre gjuhëve, ato shfaqen edhe në shqip, edhe rumanisht. Këtu përfshihen:

- mungesa e pozicionit në bazë të tiparit të gjatësisë së zanoreve,
- mungesa e opozicionit në bazë të tiparit të rrumbullakimit për zanoret e përparme,
- mungesa e opozicionit zanore gojore/zanore hundore,
- një nënsistem i përbashkët prej pesë zanoresh /i/, /e/, /a/, /o/, /u/,
- prania e zanoreve qëndrore të parrumbullakuara,
- reduktimi i zanoreve në të patheksuara, për pasojë një alternim midis një forme të theksuar dhe të patheksuar.

Praninë e këtyre veçorive e ka vënë në dukje dhe B. Josefi si dukuri që gjenden në një pjesë të mirë të të gjitha gjuhëve të Ballkanit (Joseph, B., 1994:154).

Nëse i referohemi sistemit zanor të shqipes dhe rumanishtes si tipare të përbashkëta, vëmë re se:

- Te të dy gjuhët kemi një sistem prej 7 zanoresh gojore, të cilat karakterizohen nga tri tipare themelore, radha e formimit, shkalla e hapjes dhe buzorëzimi. Si të tilla, në shqipe dhe në rumanisht, gjashtë prej fonemave zanore janë të njëjta, [a] si qendrore, e hapur dhe jobuzore; [u] si e prapme, e mbyllur dhe buzore; [o] si e prapme, gjysmë e mbyllur, buzore; [e] e përparme, gjysmë e mbyllur, jobuzore; [i] e përparme e mbyllur jobuzore;

- Nga pikëpamja fonetike zanoret *ĩ, ă, â*, në rumanishte janë zanore qendrore (Avram, A., 1970), por nga pikëpamja fonologjike ato mund të trajtohen si zanore të prapme jo të rrumbullakosura. (Herslund, M., 1973: 1-2)

- Sistemi zanor i shqipes dhe i rumanishtes kanë trashëguar dy zanore latine të zhvilluar në të njëjtën mënyrë. Kjo vlen për zanoren *u* të latinishtes që në të dy gjuhët ka ruajtur të njëjtat tipare:

Latinisht	Shqip	Rumanisht
<i>Furca</i>	<i>furka</i>	<i>furcă</i>

- Po kështu zanorja e patheksuar *a* e latinishtes është zhvilluar në *schëa* në të dy gjuhët:

Latinisht	Shqip	Rumanisht
<i>camisia</i>	<i>këmishë</i>	<i>cămeasa</i>

(1964: 19-20).

Zhvillimi i kësaj zanoreje është trajtuar dhe në aspektin akustik, këto dy zanore paraqesin të njëjtën prirje të ndryshimit vlerave të formantit F2 (Granser, Th & Moosmüller, S. 2003).

- Në sistemin zanor të shqipes dhe rumanishtes zanorja e përbashkët qendrore [ə] në shqipe paraqitet me grafemën *ë*, kryesisht në trup dhe në fund të fjalës; në rumanishte paraqitet me grafemën *ă*, kryesisht në trup të fjalës. Prania e kësaj zanoreje është parë si një veçori e zakonshme e gjuhëve ballkanike (Saëicka, I., 1995: 396-398). Në shqipe ajo është pozicionuar si një zanore e patheksuar e cila, sipas studimeve akustike, ka të njëjtën prirje të të qenit një zanore e mesme qendrore (Boriçi, 1977: 73-94, Dodi, A., 2004: 56, Memushaj, R., 2009: 53-54, Granser, Th. & Moosmüller, S., 2003). Në raport me zanoret themelore [ə]-ja e rumanishtes konsiderohet pak më rrumbullakuar (Cojocar, D., 2003).

Si veçori specifike të sistemit zanor të dy gjuhëve vihen re një sërë tiparesh fonologjike:

- Të dy gjuhët dallojnë për një zanore të veçantë në sistemin e tyre vokalik, në shqipe kemi fonemën zanore [y] si zanore e përparme e mbyllur buzore, ndërsa në rumanisht kemi dy variante fonemore të fonemës [y] në varësi të pozicionit në fjalë, grafema *â* përdoret kryesisht në trup të fjalës, grafema *î* përdoret kryesisht në pozicion nistor dhe fundor të fjalës si dhe në fillim të gjymtyrës së dytë të një fjale të përbërë. Ky tingull në shqiptim paraqitet si një tingull midis [i] dhe [u] dhe është një zanore qendrore, e mbyllur, jobuzore.

Përveç 7 zanoreve, disa gjuhëtarë dallojnë në rumanishte 4 gjysmëzanore: (1) [ɛ]: *deal, gheață, dimineața*; (2) [i]: *fier, cai*; (3) [ɔ]: *coasă, broască*; (4) [u]: *ziua, leu*; zanorja [ɨ], e devocalizuar dhe jorrokjeformuese (asilabike), që shpesh identifikohet me zanoren [i] në pozicion

fundor në fjalë të tipit: *rupi, moşi, dormi, banpi*. A. Avram thekson se në rumanishten letrare ka një sistem prej 7 zanoresh, ndërsa /ɨ/, /ʉ/, i konsideron si gjysmëzanore, /y/, /ë/ i përcakton si gjysmëbashkëtingëllore (Avram, A., 1976:598)

- Në shqipe Bevington (1974) njih 38 fonema, nga të cilat shtatë zanore, tri *glide*. Ai i klasifikon si tri zanoret e përparme *i, y, e*, tri zanore e prapme *u, o, a* dhe një zanore qendrore *ë*. Zanoret *y, u, o* janë të rrumbullakuara, për rrjedhojë të buzorëzuara.

- Nga ana tjetër ai konsideron dy prej glideve si gjysmëzanore, [ɨ] si një gjysmëzanore e përparme e mbyllur jobuzore, josilabike dhe /ë/ si gjysmëzanore e prapme e mbyllur e rrumbullakuar e cila korrespondon me [u]. (Bevington, 1974: 15).

- Neëmark, duke qenë në të njëjtin mendim në lidhje me numrin e fonemave zanore, ndan njëzet e shtatë bashkëtingëllore dhe dy *glide*, ku [ɨ] konsiderohet si gjysmëbashkëtingëllore (Neëmark, L 1982: 11). Sa u takon studiuësve të tjerë, numri dhe klasifikimi i zanoreve mbetet i njëjtë, por ndryshojnë nga dy të parët për sa u takon bashkëtingëlloret. Megjithë diskutimet për praninë e gjysmëzanoreve në shqip, ato nuk përbëjnë një kategoritë veçantë fonemash. (Jubani, A., 2011:84). Kjo vlen dhe për R. Memushajn (2009) dhe A. Dodin (2004), të cilët argumentojnë se [j] funksionon si një bashkëtingëllore, përveç rasteve kur ajo përftohet si variant i fonemës /i/ në realizimin e diftongjeve të shqipes si pasojë e ndryshimit të trajtave gramatikore të disa fjalëve.

- Në ndryshim nga shqipja, rumanishtja karakterizohet si gjuhë me diftongje. Shqipja ka shumë pak diftongje të vetat, ato janë më të pranishme në të folme dialektore (Dodi, A. 2004; Memushaj, R. 2009). Përgjithësisht ato janë formuar si rrjedhim i ndryshimit të një kategorisë gramatikore të një fjale, si: *ndiej-ndjeva, bie-të bjerë, shpie-shpjer*. Gjuha standarde karakterizohet kryesisht nga togjet e zanoreve.

- Në rumanisht ka një prani karakteristike të diftongjeve dhe zanoret e mbyllura *i; e; u*; gjenden dhe në variantet e gjysmëzanoreve. [e] gjendet në variantin gjysmëzanore parazanor josilabike [eʲ]; [u] gjendet [uʲ] parazanore dhe paszanore, josilabike, e ngjashme me shqiptimin e ë-së anlgisht; [o] gjendet [oʲ] gjysmëzanore parazanore; [i] gjendet në dy variante, [iʲ] gjysmëzanore e shqiptuar gati [iʲ] në pozicion nistor para një zanoreje dhe në pozicion fundor pas një zanoreje, si gjysmëzanore e shkurtër që paraqet karakterin palatal ose të palatalizuar të bashkëtingëllores paprijëse (Cojocaru, D., 2003). Rumanishtja karakterizohet edhe nga një sistem triftongjesh.

Si përfundim mund të themi se këto veçori të sistemit zanor që i përafrojnë këto dy gjuhë ballkanike mund të kenë ardhur si rrjedhim i bashkëjetesës së gjatë të këtyre dy bashkësive gjuhësore në territore afër njëra-tjetrës, por dhe si rrjedhim i ndikimeve të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit të njëra-tjetra, pavarësisht se cilës degë të familjes së gjuhëve indoevropiane i përkasin.

Një vështrim i tillë bëhet burim jo vetëm studimeve diakronike mbi substratin gjuhësor ballkanik, por ndriçojnë shumë aspekte për të zbuluar lidhjet dhe për të kuptuar natyrën e gjuhëve në kontakt ose jo në Ballkan. Kjo do të çonte në njohjen e mëtejshme të Universaleve Gramatikore, që dalin si rrjedhim i përqasjes gjenetike, gjeografike dhe tipologjike të këtyre dy gjuhëve ballkanike (Brian D. J., 1999:5)

REFERIME

- Avram, A., (1970), *Sur la structure acoustique des voyelles neutres du roumain*, Revue Romane, numéro spécial 4: Problèmes de linguistique roumaine, Copenhague.
- Avram, A., (1990), *Sur les voyelles neutres en Roumain, en Albanais et dans les Langues Romanes Occidentales*, Revue Roumaine de Linguistique, XXXV(1):19-27.
- Bevington, L. G., (1974), *Albanian Phonology*, Otto Harrassoëitz, Eibaden, 1974.
- Boriçi, L., (1977) *Kontribut mbi aspektin akustik të zanoreve të shqipes e të disa zanoreve të frëngjishtes*, Studime filologjike, XXXI (XIV):73-94
- Brian D. J., (1992), *The Balcan Languages*, International Encyclopedia of Linguistics, ed. by E. Bright Oxford University Press, Volume 1, pp. 153-155.
- Brian D. J., (1999), *Romanian and the Balkans: Some Comparative Perspectives*, The Ohio State University, <http://ëëë.ling.ohio-state.edu/~bjoseph/publications/1999roma.pdf>.
- Brian, K., Ogilvie, (2009), *Concise encyclopedia of languages of the world*, Elsevier Ltd. Oxford.
- Cojocaru, D., (2003), *Romanian grammar*, SEELRC, Bucharest.
- Defense Language Institute Foreign Language, (1964), *A survey of Albanian Language*, Area Background Studies. Monterey, Calif.
- Dodi, A., (2004), *Fonetika dhe fonologjia e shqipes*, botim i IGJH, ASHSH,
- Feuillet, J., (1986), *La linguistique balkanique*, Cahiers balkaniques, n.10: INALCO, Paris.
- Herslund, M., (1973), *Morphonologie du nom roumain*, Revue Romane, Bind 8, 1-2.
- Joseph, B., (1992), *International Encyclopedia of Linguistics*, ed. by E. Bright Oxford University Press, Volume 1, pp. 153-155.
- Jubani, A., (2011), *Karakterizimi funksional i sistemit bashkëtingëllor të shqipes*, Buletin i Universitetit Planetar të Tiranës, nr. 1, f. 77-86.
- Memushaj, R., (2009), *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë.
- Moosmüller, S., Granser, T. (2003), *The Voëls of Standard Albanian*, in: Proceedings of the 15th International Congress of Phonetic Sciences. pp. 659-662
- Neëmark, L., Hubbard, Ph., Prifti, P., (1982), *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students*, Standford University Press, California.
- Renëick, M. E. L., (2012), *Voëls of Romanian: Historical, Phonological and Phonetic Studies*, A Dissertation Presented to the Faculty of the Graduate School of Cornell University..
- Saëicka, I., (1995), *The Balkan Sprachbund in the light of phonetic features*, Proceedings of the XIIIth International Congress of Phonetic Sciences, Vol. 3:386-388.

ASPEKTE TË NDIKIMIT TË SHQIPES MBI TË FOLMEN E ARUMUNËVE TË KORÇËS NË RRAFSHIN LEKSIKOR DHE MORFOLOGJIK

Msc. Daniela Carmen Stoica

Departamenti i gjuhëve të huaja

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, UK "Fan S. Noli"

Artikulli synon të evidentojë disa aspekte të fenomenit të dygjuhësisë të komuniteti arumun nga zona e Korçës, duke u nisur nga një korpus i kufizuar tekstesh të mbledhur në periudhën shtator 2011- qershor 2012. Arumunët e Korçës u përkasin grupit e fërshërotëve¹⁸³ dhe janë bilingjë, të cilët përdorin arumanishten (kryesisht në shtëpi, në mjedisin e familjes dhe brenda në komunitet) dhe shqipen në marrëdhënie me komunitetin, por edhe në komunikimin zyrtar. Mendojmë se këto teste reflektojnë të folmen e sotme të arumuneve që jetojnë në këtë zonë, duke vënë në pah ndryshimet në idiomën e tyre si pasojë e interferencës me gjuhën shqipe. Këto ndryshime u përkasin kryesisht rrafshit leksikor, morfologjik, por edhe fonetik, sintaksor.

Në rrafshin leksikor, do të analizojmë huazimet dhe ndryshimet e kodeve, duke bërë diferencimin (jo gjithmonë i lehtë), midis këtyre dy formave të interferencës leksikore, duke u nisur nga: niveli i përshtatjes fonetike, morfologjike ose sintaksore; frekuenca dhe denduria e përdorimit në vepra leksikografike të specializuara, të cilat fiksojnë përdorimin e fjalës, domethënë për të parë sa e integruar është ajo fjalë në sistemin leksikor në shqyrtim.

Vepra leksikografike e përdorur në këtë punim është fjalori thesar i Tache Papahaxhit, *Dicționarul dialectului aromân, general și etimologic*, ediția a doua, București, Editura Academiei, 1974 (*Fjalori arumun, i përgjithshëm dhe etimologjik*, botimi i dytë, Bukureshti, Shtypshkronja e Akademisë Rumune). Në analizën tonë do të marrim parasysh dhe një seri faktorësh jashtëgjuhësorë si:

- gjinia, mosha
- niveli i arsimimit të informatorit, profesioni
- me kë flet arumanisht në familje etj.

Numri i njerëzve të intervistuar është 20, të cilët u përkasin grupmoshave të ndryshme, me nivele të ndryshme arsimimi. Grupmoshat e indenfikuar janë nga 60 deri në 75 vjeç, pensionistë (shumica e tyre kanë punuar në kooperativa bujqësore në periudhën e sistemit komunist, sistem para të cilit kishin një jetesë më shumë shtegtare, bashkë me familjet e tyre. Shumë përfaqësues të këtyre grupmoshave nuk kanë bërë fare shkollë ose kanë bërë vetëm shkollën fillore). Një tjetër grupmoshë është përfaqësuar nga të rritur me moshë nga 35 deri në 46 vjeç, të cilët janë aktivë nga pikëpamja profesionale, që kanë mbaruar qoftë gjimnazin, qoftë universitetin dhe që punojnë në sektorin privat ose shtetëror. Folësit me moshë nga 18 deri në 25 vjeç janë shumë pak, sepse ata nuk flasin më arumanisht, sidomos ata që jetojnë në zonat urbane ose që kanë emigruar në shtete si Greqia ose shtete të tjera evropiane. Grupmosha e fundit e identifikuar është ajo e fëmijëve me

¹⁸³ Për ndarjen e grupeve/degëzimeve të arumuneve, shiko Nevaci M., *Graiul aromânilor fărșeroși din Dobrogea*, București 2011, f. 17.

moshë nga 7 deri në 15 vjeç. Duam të theksojmë faktin se grupmoshat e reja kanë prirjen ta braktisin arumanishten dhe të përdorin shqipen në marrëdhëniet me komunitetin, por edhe me familjen, sidomos në periudhën e arsimimit.

I. Huazime leksikore të vjetra

Theodor Capidan (1932) konsideron si huazime të vjetra nga shqipja në arumanisht fjalë, si: *bănă* (<banoj), *bănedz* (<banoj), *gélă* (<gjellë), *gíză* (<gjizë), *dhălă* (<dhallë), *cilimçani* (<çiliminj) etj.

II. Huazime kulturore

Këtu kemi përfshirë një seri fjalësh të cilat nga ana semantike tregojnë dukuri të reja në jetën e arumuneve, qoftë abstrakte, qoftë konkrete. Huazimet kulturore shfaqen si një nevojë, sidomos në rastin e komuniteteve rurale të arumuneve, të cilat filluan një stil të ri jetese, sidomos kur kaluan nga jeta shtegtare në jeten sedentare. Pas rënjes së sistemit komunist, shumë nga anëtarët e komunitetit arumun kanë filluar të jenë aktivë edhe në sektorin privat, kanë filluar të zhvillojnë aktivitetet e tyre private në mjedise rurale, por edhe urbane.

Nga tekstet e mbledhura, të cilat kanë tema relativisht bashkëkohore (në shkollë, në punë, në doktor, në pazar, në kooperativë) dhe tradicionale (si bëhet djathi, si përpunohet leshti, si organizohen fejesat, pagëzimet, dasmat, varimet etj.) kemi përkufizuar këto fusha semantike:

- **Profesione ose kategori shoqërore:** *mecanic* (<mekanik), *pensionîşti* (<pensionistë), *racsionári* (<reaksionarë), *acsonári* (<aksionarë), *pasonari* (<të pasur), *magazinér* (<magaznier), *krúe-veterinér* (<kryeveteriner), *eurodeputét* (<eurodeputet), *architéctu* ' (<arkitekti), *idraulíc* (<hidraulik), *electric* (<elektrik), *tecnic* (<teknik), *marangóz* (<marangoz).

- **Elemente të jetës moderne:** *makínă* (<makinë), *fabrică* (<fabrikë), *locál* (<lokal), *club* (<klub), *coperatívă* (<kooperativë), *poliția* (<policia), *magazină* (<magazinë), *architectúra* (<arkitekturë), *güci* (<gjyqi), *züră* (<zyrë), *ndărmarie* (<ndërmarrje), *léc* (<lekë), *pléri chimíche* (<plehra kimike), *paláte* (<palate), *taksí* (<taksi), *ndărmárie* (<ndërmarrje), *afréschi* (<afreske), *teátăr* (<teatër), *conțért* (<koncert).

- **Elemente të jetës shoqërore dhe politike:** *privatizím* (<privatizim), *economí* (<ekonomi), *partia* (<partia), *êlirími* (<çlirim), *democrația* (<demokracia), *keverí* ' (<qeveri), *politică* ' (<politikë), *puştéti* (<pushteti), *monízmi* (<monizmi), *comunízmi* (<komunizmi).

- **Elemente të arsimimit. Shkollë:** *matemátică* (<matematikë), *fizică* (<fizikë), *université* (<universitet), *anglíst* (<anglisht), *frănglíst* (<frëngjisht), *italíst* (<italisht), *cópşe* (<kopësht), *şcolă* (<shkollë), *clása* (<klasë), *gúhă* (<gjuhë), *ledzím* (<lexim), *biologí* (<biologji), *muzică* (<muzikë), *măsim* (<mësim), *letărsi* (<letërsi).

III. Midis huazimeve kulturore dhe ndryshimeve të kodit

Shpesh është e vështirë të dallojmë midis huazimeve dhe ndryshimeve të kodit, për arsye se një numër fjalësh nuk paraqesin asnjërin nga parametrat –përshtatje, frekuencë, denduri e përdorimit. Gjithsesi, disa nga këto janë me afër me konceptin e huazimeve, ndërsa disa të tjera, me konceptin e

ndryshimeve të kodit, në varësi të konteksteve ku shfaqen (Kontekstet do të jepen si shembuj, duke shënuar në kllapa momentin, në minuta dhe sekonda, kur dukuria gjuhësore në diskutim shfaqet në tekstin e regjistruar).

Më afër me konceptin e huazimeve konsiderojmë një numër fjalësh që tregojnë aspekte të jetës moderne:

- *locál* (<lokal) *tu locál*. .. (T28 2'32'')
- *paláte* (<palate), *tu paláte*.. . (T28:2'42'')
- *zũ'rá* (<zyrë), *tu zũ'rá*. .. (T32: 1'03'')
- *taksí* (<taksi), *pí taksí*.. . (T31:2'00''); *míni víni tu taksí*.. . (T31 6'16'')
- *mecaníc* (<mekanik): *bărbátu este mecaníc*.. . (T1: 2'03'')

Po kështu do të konsiderojmë si të tilla një seri fjalësh abstrakte, si:

- - *çlirími* (<çlirimi): *după çlirími*.. . (T14:28'')
- - *puştéti* (<pushteti): *surupă' puştéti popóruíui*.. . (T21:5'46'')
- - *monízmi* (<monizmi): *erá tu kairó ali monízmi*.. . (T30:1'16'')
- - *comunízăm* (<komunizëm): *periúdhă di komunízăm*. .. (T30:1'00'')
- - *privatízími* (<privatizimi): *dapoia privatízími acăţă*.. . (T1:2'13'')
- - *báza uşcimóre* (<baza ushqimore): *báza uşcimóre nă blegtorí*.. . (T21:5'09'')
- - *politică* (<politikë): *gioia di politică*.. . (T21:5'45'')
- - *théksi* (<theks): *noi aveam un théksi*.. . *nuk e di si i thonë*.. (T1:38'')

Më afër me konceptin e ndryshimt të kodeve konsiderojmë:

- - *magazinér* (<magaziner): *míni erám magazinér tu coperatívă*.. . (T21: 4'24'')
- - *krúe-veterinér* (<kryeveteriner): *krúe-veterinér tu rréthi tu Corceáua*. .. (T21:4'51'')
- - *şéf''şef''* (<shef): *si făţé şéf buiçăsie*. .. (T21:4'51'')
- *matemátică* (<matematikë), *fizică* (<fizikë), *universitét* (<universitet), *anglíşt* (<anglisht), *frângíşt* '(<frëngjisht), *italíşt* (<italisht), *şcolă* (<shkollë), *clása* (<klasë), *gúhă* (<gjuhë), *ledzím* (<lexim), *biologí* (<biologji), *muzică* (<muzikë), *măşím* (<mësim)

Këto fjale nuk mbartin asnjë shenjë që të tregojë përshtatjen dhe shfaqen në kontekste ku ndodhin edhe fenomene të tjera të ndryshimit e kodeve.

IV. Huazime bërthamore

Duke u nisur nga përkufizimi dhe terminologjia që përdor Carol Meyers-Scotton (1993), do të diskutojmë në vazhdimësi kategorinë e dytë të huazimeve, pikërisht atë të huazimeve bërthamore. Nga tekstet e mbledhura del se huazimet bërthamore janë të shumta, fakt që tregon ndikimin e gjuhës shqipe mbi arumanishten. Folësit e arumanishtes u përballën me nevojën për të pasuruar gjuhën e tyre, por, nganjëhere, edhe për të zvendësuar fjalë të vjetra me fjale të reja me një funksionalitet më të madh.

Sendë që lidhen me jetën shtëpiake dhe shoqërore të arumunëve: *víci* (<viç), *búti* (<buti), *gialpă* (<gjalpë), *gatime* (<gatime), *uşcimile* (<ushqimet), *florí* (<flori), *vărse* (<varëse), *flamúr* (<flamur).

Profesione dhe kategori shoqërore: *măsús* (<mësues), *uštár* (<ushtar), *prífti* (<prifti), *pasonári* (<të pasur), *besimtári* (<besimtarë), *mbrétárlu* (<mbrettri), *crúšci* (<krushq).

Të tjera: *štator* (<shtator), *tetór* (<tetor), *fund* (<fund), *gérili* (<gjerat), *rréth* (<rreth), *problémi* (<problemi).

V. Midis ndryshimit të kodeve dhe huazimeve bërthamore

Si në rastin e huazimeve kulturore, një numur fjalësh, të cilat nuk plotësojnë të tri kriteret e përcaktuara, mund të konsiderohen si etapa të ndërmjetme midis ndryshimit të kodeve dhe huazimeve bërthamore. Kemi përkufizuar këtu kategoritë leksiko-gramatikore të mëposhtme:

Emra:

- *puším* ''zi liberă'' (<pushim): *am puším*. .. (T32:1'44'')
- *cănačesí* ''plăcere'' (<kënaqësi): (T32)
- *mănü'ra* ''modul, felul'' (<mënyra) (T30)
- *ngü'rá* ''culoare'' (<ngjyrë): *cu ngü'rá*.. (T14:4'44'')
- *nevóia* ''nevoie'' (<nevojë): *nu'i nevóia*.. (T14: 1'57'')
- *cuidés* ''grijă'' (<kujdes): *cu cuidés*. .. (T2:3'03'')
- *prífti/príftu/prift* ''preotul'' (<prifti): *un prift*.. (T31: 3'24'')
- *rásti* (<rasti): *un rásti*.. (T30:5'42'')
- *rrămúie* (<rrëmujë): *aşé rrămúie*.. (T31: 2'27'')

Mbiemra:

- *ngúšti* (<ngushtë): *sóři ngúšti*.. (T10)
- *detüirită* ''obligată'' (<e detyruar) (T1)
- *angărcată* (<e ngarkuar)
- *čdo* ''fiecare'' (<çdo) (T24)

Folje:

- *fillěšti* ''încep'' (<filloj) (T5)
- *ietă'm* ''trăiam'' (<jetoja): *mini ietă'm*.. (T11)
- *šočerá* ''însoŭea'' (<shoqëronte): *mă shočerá*. .. (T14: 3'44'')
- *vajduěscu* ''continui'' (<vazhdoj)

Ndajfolje:

- *castíle* ''special'' (<kastile) *le făŭea castíle*.. (T15:6'57'')
- *kót* ''degeaba'' (<kot): *kót ásti*.. (T27: 3' 31'')
- *detürimišt* ''în mod obligatoriu'' (<detyrimisht) (T1:1'02'')
- *větăm êe* ''doar că'' (<vetëm që): *větăm êe iam depárte*.. (T15:1'50'')
- *atére* ''atunci'' (<atëhere) (T28)
- *domăthă'n* ''adică'' (<domëthënë) (T1, T2, T11)

Duke analizuar shembujt që kemi dhënë mund të arrijmë në përfundimin se huazimet, qoftë kulturore, qoftë bërthamore, shfaqen në të gjitha moshat, pavarësisht nga gjinia. Te meshkujt që u përkasin grupmoshave 60 deri në 75 vjeç, me një nivel të ulët të arsimimit (zakonisht 4 klasa fillore), por që kanë qenë aktive nga ana profesionale, përqindja e huazimeve kulturore është më e

madhe se në rastin e femrave me të njëjtën moshë dhe me nivel të ngjashëm arsimimi, po që kanë qenë gjatë gjithë jetës shtëpiake. Te këta meshkuj vërejmë gjithashtu fenomenin e ndryshimit e kodeve (*code sitching*), sidomos kur ata flasin për rolet shoqërore dhe profesionale që kanë pasur në të shkuarën. Interes paraqet edhe dukuria e ndryshimit të kodeve që vërehet edhe te femrat që u përkasin grupmoshave 60 deri 75 vjeç, shenjë që tregon se disa praktika gojore veprojnë në mënyrë konstante dhe imponohen si variant i preferuar në disa kontekste të caktuara.

Femrat shëpiake, edhe shumë te reja, me një nivel të ulët arsimimi dhe që jetojnë në një mjedis rural, tregojnë një tendencë për ta konservuar idiomën, në kuptimin se nuk përdorin shumë shpesh huazime ose ndryshimin e kodeve.

Te femrat dhe meshkujt që u përkasin grupmoshave 30 deri në 50 vjeç, që jetojnë në zonën urbane dhe një me nivel arsimimi më të lartë (gjimnaz ose studime në universitet dhe që kanë një jetë më aktive nga pikëpamja profesionale, vërehet shumë shpesh dukuria e ndryshimit të kodeve).

I njëjti fenomen vërehet edhe te fëmijet e grupmoshave 7 deri në 15 vjeç, vajza dhe djem, që studiojnë në shkollat publike në gjuhën shqipe, pavarësisht nga mjedisi, rural apo urban, të cilët kanë tendencën të mos e përdorin arumanishten sepse nuk dëshirojnë të jenë diskriminuar nga popullsia shqipfolëse. Sipas personave të intervistuar që jetojnë në mjedise urban, fëmijët e tyre vazhdonin të flisnin arumanisht në kohën kur gjyshërit e tyre ishin ende gjallë, sepse fëmijet flisnin ma ata arumanisht brenda në familje.

RREFERIME

Capidan, Th., 1922, *Raporturile albano-romîne*, extras din DR, 2, Cluj.

Capidan, Th., 1931, *Fărșeroșii. Studiu lingvistic asupra românilor din Albania*, extras din DR, 6, București.

Capidan, Th., 1932, *Aromânii. Dialectul aromân*, București, Academia Română.

Capidan, Th., 1941, *Le Bilinguisme chez les roumains*, în „Langue et Littérature”, vol. I-II, p. 73.

Capidan, Th., 1943, *Limbă și Cultură*, Fundația Regală pentru Literatură și Artă.

Ionescu-Ruxăndoiu, 1997, *Codesitching and Borroëing. Remarks on an Aromanian Dialect Spoken in Greece*, RRL, nr. 5-6, p. 403-408.

Ionescu-Ruxăndoiu, L., Chițoran, D., 1997, *Sociolingvistică*, București, Editura Enciclopedică.

Meyers-Scotton, C., 199b, *Social Motivation for Codesitching. Evidence from Africa*, Oxford, Claredon Press, 1993.

Meyers-Scotton, C., 1993 a, *Duelling Languages-Grammatical Structure in Codesitching*, Oxford, Claredon Press

Papahagi, T., 1974, *Dicționarul dialectului aromân, general și etimologic*, ediția a doua augmentată, București.

Récatas, B., 1934, *L'état actuel du bilinguisme chez les macédo-roumains du Pinde et le rôle de la femme dans le langage*, Paris, Librairie E. Droz.

Romaine, S., 1989, *Bilingualism*, New York: Basil Blackwell.

Sala M., *Limbi în contact*, 1997, Editura Enciclopedică, București.

Saramandu, N., 2004, *Romanitatea orientală*, București.

- Saramandu, N., 2005, *Structura aromânei actuale. Graiurile din Dobrogea. Texte dialectale*, București.
- Saramandu, N., *Les dialectes roumains au nord et au sud du Danube*, în „Revue des études sud-est européennes”, XLI, 2003, nr. 1-4, p. 138-148.
- Saramandu, N., Nevaci, M., *The South Danubian Romanian Dialects in Spatial Perspective* in ‘RESEE’ 1-4/ 2006, p. 430-445.
- Stoica 2003-2004 = Stoica G., 2003-2004, *Împrumut și schimbare de cod într-un grai aromân din Grecia*, în *Fonetică și dialectologie*, XXII-XXIII, 2003-2004, Ed. Academiei Române.
- Einreich, U., 1954, *Languages in contact, Findings and Problems*, New York.

KOLONIA SHQIPTARE E BUKURESHTIT-VATRA E FORMIMIT LETRAR TË INTELEKTUALËVE NË VITET '30 TË SHEKULLIT XX

Msc. Ilir Shyta

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, UK "Fan S. Noli"

Një Shqipëri e re, e ngritur jo vetëm politikisht, besohet se del nga trupi i Shqipërisë së mëparshme. Këtë e ka dëshmuar edhe prania e shqiptarëve në Koloninë e Bukureshtit dhe më gjerë në vende të tjera anembanë globit. Politika bashkohet me artin dhe bëhet një organizëm jo formal, në realitetin e pashmangshëm që na rrethon, në formë të riciklueshme.

Nën këtë lëvizje të natyrshme, me dëshmi historike sa edhe letrare, Shqipëria ka pasur kurdoherë prirje të brendshme për t'iu larguar mendësisë së mykur, për të marrë më të mirën nga tradita e të parëve tanë. Pa të shkuar, nuk ka të ardhme, sikundër edhe anasjella e saj pa të ardhme nuk mund të ketë kurrë të shkuar. Argumentet e përsjella më poshtë bëjnë mbrojtjen e kësaj ideje dhe fakteve që dëshmojnë se rigjallërimi i kombit, do të vazhdojë nën rrezet ndikuese të diasporës në botë dje, sot dhe nesër.

Vlerësimet e këtyre figurave tërheqin jo vetëm studiuesit, por edhe njerëzit e thjeshtë, sepse në vërtetësinë e këtyre përkimeve, gjejmë pjesë nga kontributi i tyre fare personal në shtetin rumun të cilët duhet thënë se, si bashkëatdhetarë, ruajtën me fanatizëm shqiptarizmin në Rumani dhe botë.

Kolonia Shqiptare e Bukureshtit ishte guri më i madh i themelit të ngrehinës së mërgimit shqiptar jashtë territorit të Shqipërisë së viteve '30. Misioni i saj ishte patriotizmi atdhetar, qytetërimi, bashkimi, uniteti dhe progresi. Rrënjët shpirtërore të traditës shqiptare në Rumani, sipas Lasgush Poradecit, *"qëndrojnë shumë më fllë, sesa mund të mirret me mënd. Kollonija e Bukureshtit ka qenë një Organizatë idealistësh-tregëtarë që mi themelin e lindor të jetës kishin ngritur flamurin e idealit më të pastër kombëtar"*¹⁸⁴. Nikolla Naço, Lasgush Poradeci, Dhimitër Pasko e shumë të tjerë mbetën ndër gurët kryesorë të themelit të saj, sepse një histori e lashtë mbi 400-vjeçare e Rumanisë, lidhet me kopshtin shkëmbor të Evropës Juglindore, Shqipërinë. Kanë qenë të shumtë ata që kanë jetuar aty disa breza radhazi, por edhe më shumë, ata, që së fundmi, preferuan të jetojnë në qytetin e Bukureshtit të cilin ndryshe e quanin "Parisi i vogël zëmër". Ata janë mikluar nga Harku i Triumfit francez, përmasat e të cilit janë më të vogla se ai Francës, por që për nga madhështia simbolike e tyre mbeten të njëjtë.

Nëse kthehemi në histori faktet janë kokëforta. Viti 1595 është data që saktëson vendosjen e shqiptarëve në trojet rumune. Këtë e vërteton një dokument i Simon Movilës më 1602 në lidhje me vendosjen e disa shqiptarëve në fshatin Këlinesht të rrethit Prahova dhe rolin e kësaj diaspore në zhvillimin e qytetërimit rumun të mëvonshëm. Gjithashtu në mars 1595, i dërguari i perandorit Habsburg Rudolphi II në trevat rumune, Giovanni de Marini Poli, dërgon për Bartolomeu Pezzën këshilltar perandorak në oborrin e Rudolfit II, një raport interesant në gjuhën italiane. Mes rreshtash atje thuhet që: "Shqiptarët nga Cërvena Voda dhe nga fshatrat e tjera fqinje të banuara nga

¹⁸⁴ L. Poradeci, *Korrespondencë Lasgush Poradeci-Asdreni*, Vepra V, albPAPER, Tiranë, 2012, f. 75-76.

shqiptarë, kërkojnë leje të vendosen me familjet e tyre në tokën rumune dhe t'i braktisin banesat e tyre në tokën e turqve”. Kështu, rreth 15. 000 persona me gra e fëmijë e patën këtë fat. Thuhet se të gjithë sundimtarët pas tij trashëguan të njëjtin respekt për shqiptarët në Rumani. Një histori e gjatë emërore plot shenjues të tjerë, bëhen pjesë e këtij digresioni duke vazhduar me Dora d'Istrian, Aleksandër Stavre Drenovën (Asdreni i famshëm i himnit tonë kombëtar të flamurit), Fan Nolin e shumë njerëz të shquar që kanë dhënë kontributin personal në zhvillimin e shtetit rumun.

Kolonia Shqiptare e Rumanisë, që njihet nga të gjithë si Kolonia e Bukureshtit, u bë asokohëshëm qendra kryesore e diasporës shqiptare. Aktiviteti veprimtar i kolonisë shqiptare, shtypshkrimet e shumta në gjuhën tonë kombëtare, botimet folklorike dhe letrare kanë një rëndësi të madhe në letërsinë shqiptare të mëpasshme, fakte që tregojnë në një mënyrë apo në një tjetër gjallërinë e kësaj diaspore.

Tema atdhetare do ta trajtojë këtë aktivitet patriotik dhe letrar në rafshin pasqyrues të punës së shqiptarëve në vitet '30, sepse letërsia shqiptare e tyre ka rëndësi historike në kuadër të letërsisë shqiptare në përgjithësi.

Bukureshti, kryeqyteti i rumunëve ishte kryeqendra e kolonisë shqiptare. Kuptohet se ky emërtim e ngarkoi koloninë shqiptare me një përgjegjësi historike, sepse në këtë kontekst kjo kolonia shqiptare do të ndikohej kryesisht dhe nga zhvillimet që do të ndodhnin veçanërisht në Ballkan.

Brenda kësaj ekzistence do të trajtohet edhe tipari romantik i letërsisë së diasporës së Rumanisë (romantizmi), që filloi të marrë më pas udhë në letërsinë shqiptare me zhvillimin e krijimtarisë letrare të Aleks Stavre Drenovës dhe Lllazar Gushos.

Kjo frymë evidenton edhe njëherë përpjekjet patriotike të shqiptarëve tanë në dhe të huaj, për të mirën e atdheut të tyre. Me moton “*të pikëpiqemi për kombin tonë*”, ato do të shenjojnë një kapitull të rëndësishëm në ekzistencën e kombit shqiptar.

Kështu, shqiptarët Kolonisë së Bukureshtit zhvilluan hershëm një aktivitet të dukshëm për themelimin e shoqërive të tjera në botë, më qëllim të vetëm përqëndrimin e veprimtarisë së kolonisë tyre. Në nenin numër 2 të kësaj shoqërie theksohet se: “... qëllimi i shoqërisë është përkrahja morale e çdo shqiptari që jeton në mërgim si dhe bën edukimin kombëtar të tyre. Bashkësia nuk ndërhyr as në besimin fetar dhe as në punët politike të të tjerëve”¹⁸⁵.

Për hir të së vërtetës “*Bashkësia kishte kishën e saj ku meshohej shqip dhe një bibliotekë normale me libra po në shqip*”¹⁸⁶, -thuhet në shtypin e kohës. Kjo koloni tregoi një kujdes të madh për ruajtjen dhe vazhdimësinë e gjuhës shqipe. Në kulmin e emigrimit evropian në Rumani në vitet '30, të shekullit XX, shumë shqiptarë, sidomos nga krahina e Korçës, e lanë vendin e tyre të varfër dhe u bashkuan me valën e emigrantëve që niseshin me anije nga Selaniku dhe Pireu për lundrimin e gjatë e të lodhshëm drejt Rumanisë.

Thoma Abrami (1869-1943) ose Thoma Avrami ishte gazetar e poet nga Korça, i cili luajti një rol aktiv në botimet shqipe. Bëri mjaft udhëtime nëpër ngulmimet shqiptare jashtë (Sofje,

¹⁸⁵ P. Prifti, *Mozaik shqiptar*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 69-71.

¹⁸⁶ M. Mufaku, *Shqiptarët e Egjiptit-Krijime dhe botime në gjuhën shqipe*, VII, Rilindja, Prishtinë, 1979; f. 62.

Bukuresht, Egjipt dhe Konstandinopojë) duke punuar si gazetar dhe redaktor për gazetën “Zgjimi Kombëtar”¹⁸⁷.

Milo Duçi (1870-1933), i njohur edhe me emrin Mihal N. Duçi jetoi pjesërisht në Rumani. Ai mban firmën e autorit të gjashtë pjesëve teatrale të asaj kohe. Më e mirënjohura nga këto përpjekje modeste është pjesa me tri akte “Nderi”, e botuar në Konstancë në vitet ’30 të shekullit XX.

Nikolla Naço ishte një tjetër emër që nderoi emrin shqiptar në Rumani dhe botë. Nikolla Naço-Korça ishte veprimtar i vlefshëm për atdheun dhe shoqërinë, themelues i Shoqërisë Shqiptare “Drita” dhe i gazetës “Shqiptari”.

“Ashtu e organizuar dhe futur në urdhër me flakërim, po dhe me shumë peshë dhe mençuri, shoqëria “Drita” e Bukureshtit vazhdoj e pafjetur vepërimin e saj drejt propagandës kombëtare, duke u përqëndruar kryesisht në përpjekjet konkrete”, - shkruan Lasgush Poradeci. Ndërsa për Nikolla Naçon vijon e shkruan: “Njeri me temperament, burrë me vendim dhe kuxim, dhe Shqiptar i zjarrshëm i ardhur prej pak kohe nga Mansura e Egjiptit. Personaliteti i Naços i shkrirë tërësisht për komb dhe atdhe është shprehja më e thjeshtë e racës së tij malësore, që e brumosi ashtu me natyrën e tij të fortë dhe temperamentin plot zjarr, sipas ligjeve të saj të paracaktuara. Në trurin e maleve të Mokrës, në një katund shkëmbor të qarkut të Pogradecit kishin lindur dhe shkuar burrërinë prindërit e tij.. . Dhe për të fytyruar qëllimin t’onë, zgjohmë kështu të çfaqim përpara vetëdijes së kombit fatosin e veteranërisë shqiptare, fytyrëurdhëronjëse dhe vepërimin heroik të kryeveteranit Nikoll N. Naço Korça, njeriu më tipik, personaliteti më përfaqësues i gjeniut të racës përse i përket lëshimit të çështjes shqiptare, me kurajën dhe energjinë e duhur, në botën e madhe të diplomatisë dhe në qarkun e mosafuarshëm të politikës së lartë.. .., ay, i cili, me atavizmen e fellë të gjakut, me temperamentin e flakshëm të naturës së tij, me vullnetin e patundur të një shpirti që u pat gatuar në zjarr dhe hekur përmbajti më vete në mes të ngatërimit kombëtar Themelimin e pavarur më të parë të veteranërisë shqiptare në Rumani, Shoqërinë e Mësimi Shqip “Drita” të Bukureshtit, pikërisht ay u pat sulmuar me ultësi nga ana e armiqve zemër-thatë, një fytyrë urdhëronjëse e pajisur me gjithë cilësitë e njeriut realist, që e shëkon drejt në sy, me vendim, punën për t’u vepëruar: një fytyrë shqiptari e vërtetë”¹⁸⁸.

Sipas Lasgush Poradecit, festa më e madhe e Kolonisë dhe kishës shqiptare të Bukureshtit ishte 28 Nëntori: Dita e Flamurit dhe Shën Gjergji, emri i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut. Duke bërë fjalë për korçarët e Bukureshtit dhe vlerat e komunitetit shqiptar të Rumanisë, Lasgushi thekson se: “.. me rastin e Ditës së Flamurit, pamja e jashtme e kishës ishte imponante, por edhe “përbrenda ajo shkëlqente nga uniformat dhe robat e zyrtarëve, po më shumë nga fryma shqiptare që frynte në zemra. Dhe pas Te-deumit të shërbyer në gjuhën e ëmbël nënore, vinte fjalimi i parë i rastit i mbajtur prej një personaliteti nga më të lartët e vëndit, i pasuar prej fjalimesh të shqiptarëve, të cilat kurdoherë më çdo festë, kurorëzoheshin në fund prej veteranit të madh Thanas Kantili, të zjarrit, të flaktit, të djegurit dhe të zhuriturit luftëtar të kolonisë në Rumani”.

¹⁸⁷ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë 1983, f. 417; 457-465.

¹⁸⁸ L. Poradeci. “Vepra V, korrespondencë Lasgush Poradeci-Asdreni”, albPAPER, Tiranë, 2012, f. 86.

*“Himni i Flamurit u lind në Bukuresht. Disa anëtarë të kolonisë tyre i kërkuan Asdrenit t’ju bëjë një këngë pas këngës të Çiprian Porumbeskos që ta këndojnë në rrethin e tyre. Asdreni nuk vonoj t’iu përmbushë dëshirën dhe në pak kohë iu dha një tekst shqip të adaptuar pas tekstit rumun, me disa shtesa origjinale të bëra prej tij. Udhëheqësi i korit, Jonesku, vendosi fjalët shqipe në notat e muzikës të Çiprianit dhe i mësoi anëtarët e bashkimit që t’a këndojnë. Sukses i plotë! Pa ditur qysh, në një kohë të shkurtër, kënga e bërë vetëm për anëtarët e bashkimit u përhap në gjithë Kolloninë e Bukureshtit. Disa të rinj që vajtmë në Korçë e shpumë dhe atje...”*¹⁸⁹ -kujton Lasgush Poradeci. Himni arriti të bëhej kështu Himni Kombëtar i Kolonisë së Bukureshtit, që përfaqësonte Shqipërinë në atë vend mërgimi aq të djegur për atdhe, duke u bërë zakon të këndohet rregullisht përpara dhe pas çdo ushtrimi personal të korit. Të frymëzuar nga ky spontanitet krijues i fjalëve, shqiptarët e Rumanisë i kërkuan Asdrenit që ky t’i kthente ato në vargje të mirëfillta. Asdreni i madh e pa të udhës t’u referohej ndjenjave patriotike dhe fjalëve të Bârseanu-t duke i përshtatur ato mjeshtërisht në gjuhën tonë shqipe, duke i bërë kështu kombit të munduar shqiptar nderin më të madh historik, dhuratën më të bukur që emocionon edhe sot e kësaj dite mijëra dhe miliona shqiptarë të shpërndarë kudo në botë.

Lasgush Poradeci vijon t’i thurrë brerore të artë edhe Korçës, qytetit nga vinin pjesa më e madhe anëtarëve të Kolonisë së Bukureshtit. Për të Korça është: *“... qëndër dhe zemër e kollonive kombëtare, mëma e kryevatrës së Bukureshtit”*.

Asdreni, për Poradecin poet, do ishte me tepër se idhull. Tek shkrimi i tij “Asdreni një manifest kombëtar” pikturon portretin e tij me fjalë: *“Të gjithë marrim jetë prej Flakës që ndrin; asnjë s’kujton Zjarrin që pat djegur. Sepse Vjershëtori nuk rron jetën e vdekur të vet, po jetën e pavdekur të kombit të vet.”* Madje edhe vargëzon për të:

*Burr’ i urt’ e i veçuar,
Shqipëtar më shpirt të quar,
Vjershëtor vjershë-kënduar:
Pate shkruar e punuar
Shqipen për t’a shqipëruar
Kombin për ta kombëzuar.*

Duhet thënë se kjo poezi për Aleks Stavre Drenovën (Asdrenin), patriotin që njehsohet me ngjyrimin kombëtar dhe fiton koherencë pavdekësie është një përmendore vargësh e arrirë.

Të tjerë emra shqiptarësh ishin: Grigor Zografi, Grigor Goda, Llambi Cicimiçe, Dhimitër Kakakuçi, Ilia Shupleka, Pandel Durmishi, Andrea Alilozi, Jani Danga, Zisi Andrea Stavre etj.

Shqiptarët e Kolonisë së Bukureshtit, ndërkaq mbetën një busull orientimi për anijen ballkanike që lundronte në det të trazuar kohësh. Identiteti i tyre i arratiset kontributeve personale dhe mbetet në panteonin e vlerave, shenjues i saktë kombëtar. Mirëpozicionimi i tyre tregon se kombit shqiptar asnjëherë si kanë munguar mendjet e ndritura, përpjekjet e tyre publicistike dhe letrare që i nxitin dhe i inkurajoi Kolonia Shqiptare e Bukureshtit, vatra kryesore e formimit të intelektualve në vitet ’30 të shekullit të XX-të.

¹⁸⁹ L. Poradeci. “Vepra V, korrespondencë Lasgush Poradeci-Asdreni”, albPAPER, Tiranë, 2012, f. 92.

REFERIME

ASHSH, *Mbledhës të hershëm të folkorit shqiptar 1635-1912*, vëllimi III, IGJL, Tiranë, 1962.

ASHSH, *Historia e Letërsisë Shqiptare*, IGJ L, , Tiranë 1983.

L. Poradeci, *Korrespondencë Lasgush Poradeci-Asdreni*, Vepra V, albPAPER, Tiranë, 2012.

M. Mufaku, *Shqiptarët e Egjiptit-Krijime dhe botime në gjuhën shqipe*, VII, Rilindja, Prishtinë, 1979.

P. Prifti, *Mozaik shqiptar*, Buzuku, Prishtinë, 2003.

DISA PIKA KONTAKTI TË RRËFIMIT TË MITRUSH KUTELIT ME LETËRSINË RUMUNE

Msc. Neli Naço

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, UK “Fan S. Noli”

Mitrush Kuteli është shkrimtari i tretë i rëndësishëm shqiptar që është shkolluar në gjuhën rumune dhe njëkohësisht mund të konsiderohet një nga njerëzit më të rëndësishëm që kontribuoi në ngritjen e urave kulturore që lidhin të dy kulturat tona. Ai njihet si pasues i dy shkrimtarëve të tjerë shumë të rëndësishëm, pjesë e historisë së letërsisë shqipe që kanë një përvojë të ngjashme, Asdreni dhe Lasgush Poradeci. Në Bukuresht ky shkrimtar do të mbarojë Fakultetin Ekonomik dhe do të diplomohet më 1934 me një disertacion për sistemet bankare në Ballkan. Megjithatë është tepër aktiv në fushën e ekonomisë, pasioni i tij është letërsia dhe kryesisht proza e shkurtër, në të cilën ai do të krijojë “një shkollë të tregimit dhe të prozës së shkurtër në Shqipëri”¹⁹⁰

Një fushë ku ai spikat si pak të tjerë është gjithashtu edhe fusha e përkthimit dhe këtë e ka nisur me shqipërimin e një vëllimi me poezi të zgjedhura nga Mihail Eminescu, të botuar me titullin “Vjersha” më 1939. Ai do të punojë në fushën e përkthimit edhe më vonë duke sjellë në shqip një numër të madh veprash, kryesisht nga letërsia ruse dhe ajo rumune, por edhe nga letërsi të tjera.

Një nga vepërzat e tij me përkthime, e cila ka një domethënie të rëndësishme për autorin, por edhe për studiuesin e letërsisë është “Kapedan Gardani me shokë”, shtypur në Shtypshkronjën Luarasi më 1944. Rëndësia e vëllimit të vogël me “novela dhe përralla”, siç i quan ato përkthyesi, nuk qëndron vetëm në transmetimin e vlerave letrare të përkthyer nga letërsia rumune në letërsinë shqipe, por edhe në qëndrimin letrar që autori ka ndaj sivëllezërve të tij rumunë, afërsive shpirtërore që ai gjen tek këta autorë, ndjeshmërisë që ushqen për ta dhe letërsisë së ngjashme që ai krijon duke u mbështetur në folklorin e viseve të Shqipërisë jugore, por që ka një tipologji të ngjashme me krijimtarinë e këtyre autorëve. Ai ka përkthyer kështu disa përralla dhe rrëfime nga gjuha rumune, por ka dhënë shumë për studiuesin, sepse ka ndërtuar një hartë të autorëve me të cilët ai ka një afërsi shpirtërore të ndërgjegjshme dhe të pandërgjegjshme dhe, për këtë afërsi, ai shprehet edhe në parathënien e vëllimit.

Lidhur me këtë letërsi rumune që preferon dhe që do të ndikojë në një masë të konsiderueshme në formimin e tipologjisë së prozës së vet ai do të shprehet: “Ka dy letërsi rumune: një letërsi e jetës qytetare dhe një letërsi e jetës katundare. E para, me shumë ngjyra e kozmopolite, pasqyron fort pak shpirtin e kombit. E dyta, po. E sëmthmë këtë të fundit si mburim për një varg shqipërimesh, mbasi jeta që rreh brenda saj i afrohet shumë jetës shqiptare.”¹⁹¹

Autorët që ka zgjedhur kështu për të përkthyer Mitrush Kuteli janë të një matrice kulturore, por edhe të një matrice stilistike që është e lidhur ngushtë me këtë të parën dhe që do të ketë një ndikim

¹⁹⁰ L. Topçiu, *Ndjenja e mallit tek Asdreni, Poradeci, Kuteli* (botim dygjuhësh rumanisht dhe shqip), București 1999, f. 183.

¹⁹¹ M. Kuteli, Pak fjalë për lëçitësin në *Kapedan Gardani me shokë*, shtypshkronja Luarasi, 1944, f.5.

të fuqishëm mbi prozën e tij. Këta autorë janë Ion Creangă, Petre Ispirescu, Liviu Rebreanu dhe Marcu Breza. Një nga synimet e tij për një vijimësi tjetër përkthimesh janë edhe autorët e tjerë rumunë Mihail Sadoveanu, Ioan Al. Bratescu – Voinesti, I. L. Cariagiale dhe Victor Eftimiu, siç e shpalos qartë në parathënien e përkthimit, Mitrush Kuteli. Këta autorë na paraqesin në njëfarë mënyre disa nga modelet kulturore që kanë ndikuar në formimin e prozës së Kutelit, megjithëse jo të vetmet modele, sepse i pajisur me një kulturë të gjerë edhe letërsia klasike ruse, të cilën ai e përktheu gjithashtu, mund të ketë krijuar disa modele kulturore që kanë ndikuar në rrëfimin e tij.

Theksuam modele kulturore, por përsëri fjala është tepër e varfër dhe krijon një lloj distance midis shkrimtarit dhe modelit. Ato që deri më tash i quajtëm modele kulturore janë pjesë e formimit kulturor të Mitrush Kutelit, sepse ai u zhvillua krejt natyrshëm në mjedisin kulturor dhe letrar rumun dhe ka asimiluar disa nga idetë që ishin në zhvillim e sipër në këtë truall kulturor.

Për ta përforcuar këtë ide le të bëjmë një krahasim kohor. Në veprën “Netë Shqiptare” Kuteli, në shpjegimin për kohën kur u shkrua vepra, shprehet: “Rrëfimet e mbledhura në këtë libër, me të paka shtime dhe ndryshime janë shkruar midis viteve 1925 edhe 1930.”¹⁹² I gjithë mesazhi i tij mund të na çojë në përfundimin se koha e formimit të tij si shkrimtar ka nisur edhe më herët nga këto vite, por edhe që, natyrshëm, një shkrimtar aktiv është gjithmonë në kërkim dhe zhvillim të vazhdueshëm dhe në kontakt me truallin kulturor ku ai zhvillohet. Afërsisht në këto vite në truallin kulturor rumun gjallon edhe revista letrare *Mendimi* (Gândirea) 1921 – 1944. Ileana Orlich thotë: “bashkëthemeluar nga Cesar Petrescu, Gib Mihăescu dhe Adrian Maniu, *Mendimi* (Gândirea), veçanërisht pas vitit 1926 kur Nechifor Crainic bëhet drejtori dhe botuesi i saj i vetëm, nuk pranoi “perëndimorizimin” në favor të “autoktonizimit” dhe kulturës rurale që i jepte shtysë modeleve etnocentrike të kulturës.”¹⁹³

I orientuar drejt një modeli të tillë etnocentrik është edhe shkrimtari Mitrush Kuteli, sepse ai, kur flet për rrëfimtaret rumunë dhe prozën e tyre është i bindur se “jeta që rreh brenda saj i afrohet shumë jetës shqipëtare”¹⁹⁴ dhe gjithashtu ai është i prirur që libri i tij “lipsej të përmbante, si pas dëshirës s’ahershme, dymbëdhjetë rrëfime e rrëfenja të cilat të pasqyrojnë pak a shumë vijat e para të jetës shqiptare në vise dhe kohra të ndryshme”¹⁹⁵. Kuteli e pohon ekzistencën e një tipari të përbashkët në këto vise që është ngjashmëria e jetës. Ai i ka dhënë një përgjigje çështjes së shumë diskutuar për ta parë hapësirën ballkanike si një hapësirë kulturore. Kuteli në mënyrë të ngjashme me filozofin rumun Lucian Blaga, e sheh fshatin në rrëfimin e vet “si një *centrum mundi* i përjetshëm, i pandryshueshëm nga historia.”¹⁹⁶

Në mënyrë të ngjashme me shkrimtarë të tillë si Sadoveanu ai i drejtohet traditës folklorike dhe mitologjisë anase shqiptare, përrallave dhe rrëfimit autentik gojor popullor, duke krijuar tashmë një model origjinal për letërsinë shqipe. Krijimi nga pikëpamja e narratives, trajtimi i orales dhe raporti me veprën e shkruar, nganjëherë edhe motivet rustike, të kujtojnë menjëherë modelet e

¹⁹² M. Kuteli, *Netë Shqiptare*, Tiranë, 1944, f. 157.

¹⁹³ I. Orlich, *Ideas and sentiments of the time: Theorizing the twentieth-century Romanian literature*, University of Bucharest Review, Vol. XI, no. 2, 2009, f. 54.

¹⁹⁴ M. Kuteli, Pak fjalë për lëçitësin në *Kapedan Gardani me shokë*, shtypshkronja Luarasi, 1944, f. 5.

¹⁹⁵ M. Kuteli, *Netë Shqiptare*, Tiranë, 1944, f. 157.

¹⁹⁶ L. Topçiu, *Vetmia nostalgjike në poezi*, Omsca-1, Tiranë, 2005, f. 22.

shkrimtarëve rumunë, por në procesin e shkrimit të rrëfimit kutelian vihet re edhe purifikimi, trajtimi i ambienteve tipike shqiptare, mentaliteti jo i mbajtur më në nivele ballkanike, por i rivlerësuar ose i vizatuar si tipik shqiptar, i rivizatuar sipas modeleve të baladave shqiptare ose karakteristikave nacionale.

Luan Topçiu, duke përsiatuar mbi këtë çështje thotë: “Duke jetuar në Rumani dhe duke pasur problemet e gjithë shkrimtarëve ekzilantë Kuteli ruan një linjë komunikimi me kulturën e origjinës dhe ndihet i ndërruar prej saj me dashje apo pa dashje. Mitrash Kuteli ka provuar të shkruajë dhe në rumanisht, pa arritur të bëhet bikultural, duke mbetur në varësinë dhe në shërbimin e kulturës shqipe. “Gjuha është vendi i shenjtë i qenies” ka thënë Heidegger. Të dalësh nga njëra gjuhë dhe të hysh në një gjuhë tjetër do të thotë të ndjesh thellësisht se je me të vërtetë i migruar. Ndonëse letërsia që marrim në konsideratë është produkt i krijimtarisë së shkruar në mërgim, ajo arriti të ngjitet në kuotat më të larta të kulturës kombëtare të të gjitha kohërave.”¹⁹⁷

Rikthimi mental i azilantit në atdhe, rikthimi i shkrimtarit në botën mitike të fëmijërisë, rikthimi në një hapësirë mitike të paprekur nga koha, ose rikthimi në një kohë historike, por edhe kjo e projektuar si një e largët e shkruar më afër mitit se realitetit, me personazhe thellësisht arketipalë të rrëfyera me një gjuhë të oralizuar maksimalisht, janë tipare që edhe proza rumune i ka përpunuar qëllimshëm gjatë zhvillimit të saj. Në pikëpamje gjuhësore edhe Kuteli, si shkrimtarët rumunë, krijojnë një botë arketipale shqiptare nëpërmjet një gjuhe rustike, të vjetër dhe me plot arkaizma të cilët e mbrojnë intimitetin e kësaj bote. Sipas Călinescu-t Sadoveanu ekspozon një “kapacitet të paparë të të folurit autentik”, i ngjashëm me atë të Caragiale-s dhe Ion Creangă-s.

Duke kërkuar në tekstet e autorëve rumunë, të cilët Mitrush Kuteli i ka përkthyer dhe i konsideron të rëndësishëm gjetëm një rast përkimi motivesh të prozës e “E madhe është gjëma e mëkatit” të Kutelit me rrëfimin e Petre Ispireskut “Jeta e përjetshme dhe rinia e përhershme”¹⁹⁸ ku njeriu endet në tokë pa gjetur vdekjen për një kohë të gjatë dhe, kur ajo më në fund vjen, plakët me një shpejtësi të madhe duke u kthyer në pluhur. Të dyja prozat janë ndërtuar mbi një kronotopi të ngjashme, ku hapësirë – koha dhe personazhi duket sikur u nënshtrohen ligjeve të ngjashme. Mitrush Kuteli e ka ndërtuar rrëfimin mbi dy përralla të lashta shqiptare dhe në shënimin e tij në krye të veprës thuhet se rrëfimi “E madhe është gjëma e mëkatit” është punuar pas dy legjendave të dëgjuara në Pogradec, ndërsa rrëfimi i Ispireskut është autentik rumun, por që tërthorazi na shpie në ngjashmëri të hershme folklorike që vijnë mbase nga një substrat unik kulturor. Ato ngajnë thellësisht për nga endja e personazheve që janë larguar nga vendlindja, mosgjetja e vdekjes për një kohë të gjatë dhe vuajtja për t’iu qasur, kthimi për të vdekur në vendin e lindjes, plakja e menjëhershme e personazhit me mjekrën e vetullat që i zgjaten deri tek këmbët dhe kthimi në pluhur. Sigurisht që rrëfimet reflektojnë ndryshime që janë të natyrshme, qëllimi dhe atmosfera mistike e rrëfimit kutelian janë të ndryshme nga ambienti i magjishëm i përrallës së Ispirescu-t, i cilai natyrshëm ka përdorur forma të njohura fikSIONALE të përrallës siç është humanizmi i kafshëve ose animizmi i vdekjes, megjithatë ngjashmëritë folklorike reflektojnë shumë si për të na treguar

¹⁹⁷ L. Topçiu, *Ndjenja e mallit tek Asdreni, Poradeci, Kuteli* (botim dygjuhësh rumanisht dhe shqip), București 1999, f. 231.

¹⁹⁸ Petre Ispirescu, *Eternal life and everlasting youth*, në *Plural*, Nr. 2, 2000, f. 21.

edhe një lidhje të fortë, ndonëse të rastësishme, të folklorit rumun me rrëfimin e tregimtarit shqiptar te mbështetur mbi një bazë po ashtu folklorike.

Oraliteti i letërsisë së Mitrush Kutelit, bota lokale rustike, mentaliteti tradicional fshatar, nacionalizmi i fshehur, arkaika e gjuhës nën petkun e lokales, lënda e pasur mitologjike e afrojnë prozën e Kutelit dukshëm me prozën e autorëve rumunë, ndër të cilët mund të veçonim më shumë prozën e Sadoveanu-t, por edhe të Creangă-s apo autorëve të tjerë të sipërpërmendur.

Kuteli ka përthithur natyrshëm tiparet që një letërsi ka reflektuar në tërësinë e saj, ai është formuar thuajse paralelisht me shkrimtarët rumunë, duke krijuar një letërsi e cila bart në mënyrë të padiskutueshme material folklorik, mitologjik dhe historik tipik shqiptar. Ajo që ai krijon është me një natyrë ballkanike, njëlloj si edhe proza e shkrimtarëve rumunë është mbrujtur me të njëjtin tharm.

Mund të themi se Mitrush Kuteli është një nga shkrimtarët që përbën një nga urat më të fuqishme kulturore midis dy vendeve, mjaft i rëndësishëm për përhapjen e kulturës rumune në Shqipëri dhe i pazëvendësueshëm për rolin e tij në formimin e rrëfimit autentik shqiptar dhe shkollës së tregimit modern në gjuhën shqipe.

REFERIME

M. Kuteli, *Netë Shqiptare*, Tiranë, 1944

M. Kuteli, *Kapedan Gardani me shokë*, shtypshkronja Luarasi, Tiranë, 1944.

Plural Magazine, Nr. 2, 2000.

L. Topçiu, *Vetmia nostalgjike në poezi*, Omsca-1, Tiranë, 2005.

L. Topçiu, *Ndjenja e mallit tek Asdreni, Poradeci, Kuteli* (botim dygjuhësh rumanisht dhe shqip), București 1999.

University of Bucharest Review, Vol. XI, no. 2, 2009.

ARUMUNËT DHE SHQIPTARËT NË DRITËN E KORRESPONDENCËS SË IOAN D. KARAXHIANI

Prof. Nicolae-Şerban TANAŞOCA

Instituti i Studimeve Jug-Lindor Evropiane
Academia Română

Një bazë arkive e çmuar në lidhje me mardhëniet shqiptaro-rumune në periudhën e zgjimit kombëtar shqiptar (Rilindja Kombëtare)

Në bibliotekën e Akademisë Rumune ruhen, midis të tjerash, nga korrespondenca e akademikut Ioan D. Karaxhiani, njeri i kulturës dhe eksponent i lëvizjes kombëtare makedorumune, 54 letra të vyera të viteve 1877-1897, në lidhje marrëdhëniet rumuno-shqiptare. Nga këto, 15 letra janë dërguar nga ana e akademikut Ioan D. Karaxhiani nga Jashi, ku punonte si pedagog universitar i gjuhës dhe litaraturës helene, drejtuar burrit të shtetit liberal, shkrimtarit dhe publicistit Ion Gika në Bukuresht (1816-1897), militant i bashkimit politik dhe modernizimit të botës rumune, ish-kryeministër i Rumanisë (1866-1867, 1870-1871), agjent diplomatik në Konstandinopojë i Qeverisë të Përkohshme (1848) dhe ministër i plotfuqishëm në Londër (1881-1891), ish-bej i Samos (1854), disa herë president i Akademisë Rumune. Këto letra kanë shumë lidhje nga përmbajtja me 39 letra të tjera të dërguara nga Apostol Margariti, inspektor i i përgjithshëm i shkollave rumune të Perandorisë Osmane, nga qytete të ndryshme të Maqedonisë, Epirit, Thesalisë dhe Konstandinopojës, për Ioan Karaxhianin. Edhe pse u përmënd dhe u përdor nga ana e Pericle Papahagi (editor postum i Ioan Karaxhiani), si burim për biografinë e autorit, kjo korrespondencë e pasur as nuk u publikua dhe as nuk u përdor në vlerën e saj të vërtetë, si burim historik i dorës së parë, i rëndësishëm për historinë e Evropës Jug-Lindore. Para shumë vitesh kjo gjë m'u tha nga i ndjeri Victor Papacostea (1900-1962), por vetëm tani munda ta rishkruaj dhe ta studioj me qëllimin e botimit dhe shfrytëzimit si burim historik.

Ky botim ka si qëllim të tërheqë vëmendjen, nëpërmjet këtyre dokumenteve, rreth disa aspekteve të haruara ose të anashkaluara nga evolucioni i “çështjes arumune” në kontekstin e ngritjes dhe konsolidimit të shteteve kombëtare moderne në Juglindje të Evropës mbi rrënojat e perandorive të mëdha dhe sidomos në marrëdhënie me lëvizjen e ringjalljes kombëtare shqiptare.

Personaliteti dhe jeta e Ioan D. Karaxhianit

Kush ishte Ioan Karaxhiani? I lindur në një familje barinjsh shtegtarë arumunë nga Avdela e Pindit, në Dëmash, vendi i tyre i dimërimit në Thesali, Ioan Karaxhiani (1840-1921) ka qenë nxënës i Apostol Margaritit (1832-1903) në Gureancë dhe Vlahoclisura. Studimet universitare i bëri në Athinë, ku pati rastin të njohë shumë prej armatolëve arumunë, pjesëmarrës në revolucionin grek të vitit 1821, të zhgënjyer sipas tij nga triumfi i nacionalizmit ekskluziv helen, i një linje romantike moderne mbi shpirtin e traditës bizantine, romeike, perandoreske dhe të krishtere, mbi të cilën ata ndërtuan emancipimin e turkocracisë. Në këtë kohë vendoset në Rumani, duke u bërë profesor i gjuhëve klasike në gjimnaz, më pas në Univeristetin e Jashit. Historian dhe filolog, anëtar themelues i Shoqërisë Literare Rumune, e shndërruar në Akademinë Rumune, në cilësinë e

përfaqësuesit të rumunëve të Maqedonisë, anëtar i shoqërisë “Junimea”, kontribuoi në mënyrë vendimtare në progresin e kërkimeve të arumunistikës– shiko për shembull, studimet e tij historike rreth rumunëve të Gadishullit Ballkanik, I-II, 1929-1941 – si dhe organizimin e shkollave rumune në Perandorinë Osmane. Ishte një nga protagonistët e lëvizjes të zgjimit kombëtar makedorumun, nisur nga revolucionarët rumunë në vitin 1848, me akord të plote dhe bashkëpunim me “vëllezërit përtej Danubit” të cilët, duke arritur të njohin nëpërmjet kolegëve të diasporës së Evropës Qendrore dhe Rumanisë, gjuhën literare dhe kulturën moderne rumune, rifituan vetëdijen e rumanitetit të tyre dhe u mbushën nga dëshira e riafirmimit të saj, duke hequr dorë nga helenizmi, të cilin kishin përqaftuar deri në atë moment.

Po Apostol Margariti?

Personazhi i tretë i përfshirë në korrespondencën e diskutuar këtu, Apostol Margarit, ishte bashkëpunëtori më i afërt i Ioan D. Karaxhiani në “çështjen arumune”. Evoluimi i vetëdijes identitare të arumunët në shekullin XIX mund të ndiqet më qartë në biografinë e tij: mësues i shquar në shkollën greke, nga ku u largua nga eforia laike dhe hierarkike nën akuzën se apeloj në gjuhën amtare për t’i mësuar më lehtë nxënësit arumunë, ai arrin të bëhet faktori më dinamik i lëvizjes së ringjalljes kombëtare makedorumune në ditët e afirmimit të saj më të madh. I vlerësuar si i tillë nga politika e Rumanisë me në krye mbretin Carol I, Apostol Margariti ka qenë dy herë objekt i atentateve nga disa mbështetës fanatikë të helenizmit. Në cilësinë e inspektorit të përgjithshëm të shkollave rumune të Perandorisë Osmane, ai kontribuoi në mënyrë të dukshme në përhapjen e mahnitshme të rrjetit të shkollave dhe kishave rumune në Ballkan dhe krijoi marërdhënie të dobishme për çështjen e arumunëve me misionarët katolikë dhe rrethet diplomatike perëndimore. U manifestua edhe si publicist për temën e “çështjes arumune” në shtypin rumun dhe evropian. Por, sidomos në vitet e pleqërisë, karakteri i tij autoritar, i kombinuar me zakonet e ekzekutimit të fuqisë administrative në sistemin shkollor dhe vetëdija e meritave të tij të padiskutueshme si lider politik, i krijoi konflikte të pakthyeshme me arumunët me prestigj, motiv për të cilin e nxorën në pension në vitin 1902.

Domethënia politike dhe vlera historike e korrespondencës së Ioan Karaxhianit me Ion Gikën dhe Apostol Margaritin

Edhe pse në virtytin e lidhjeve të vjetra shoqërore dhe fisnore, në letrat e Apostol Margaritit drejtuar Ioan Karaxhianit kalohen disa herë referime për ndodhi nga jeta personale dhe e familjes, shaka, ironi dhe thashetheme, përmbajtja dominante e korrespondencës së tyre është zyrtare. Kjo gjë mund të thuhet edhe më shume për korrespondencën e Ioan Karaxhianit me Ion Gikën. Letrat për të cilat po flasim kanë, mbi të gjitha, dobishmërinë e tyre në politikë: krijimin e mundësive për të ndërlidhur përpjekje e shtetit rumun në lidhje me ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit rumun të arumunëve, të të drejtave të tyre kulturore, nga njëra anë, me përpjekjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në drejtimin e ndërtimit të një entiteti kombëtar politik, qoftë në formën e një strukture autonome në kuadër të Perandorisë Osmane, qoftë në atë të një shteti të pavarur. Pasi, në verën e vitit 1880, Ioan Karaxhiani dhe Apostol Margariti kryen një udhëtim të gjatë dhe të rrezikshëm në

vendbanimet e arumunëve të Maqedonisë, Thesalisë dhe Epirit, ku ngjallën dyshimet e autoriteteve osmane të paralajmëruara fshehtësisht nga denoncimet e hierarkëve grekë, të dhënë pas helenizmit dhe kundërshtues të afirmimit të identitetit etnik të arumunëve, ata u takuan në Janinë me udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare me të cilët ranë dakort për krijimin e një aleance kundër bashkëngjites së Epirit dhe Thesalisë me Greqinë, e miratuar parimisht në Kongresin e Berlinit. Aleanca shqiptaro-rumune kishte si qëllim organizimin e rezistencës së armatosur të përbashkët kundër hyrjes së ushtrisë greke në territoret e lartpërmendura të banuara masivisht nga shqiptarë dhe arumunë. E mbështetur deri në një moment nga Perandoria Osmane, e cila u angazhua të furnizonte me armë dhe mbështetje logjistike shqiptarët dhe arumunët, aleanca humbi shanset për mbështetje pasi turqit u informuan se disa elementë radikalë të Lidhjes llogarisnin dhe një revoltë të armatosur kundër vetë Perandorisë, me qëllimin e krijimit jo të një vilajeti shqiptar, por të një shteti shqiptar të pavarur. Të mirëinformuar për tratativat shqiptaro-arumune, turqit filluan të tremben atëherë dhe nga pjesëmarrja mundshme e arumunëve në revoltën anti-osmane dhe ndaluan t'i furnizonin me armë për rezistencën e tyre anti-greke, ashtu si dukeshin ta bënin më parë. Arrestimi i udhëheqësve të Ligës shqiptare përfundoi këtë kapitull historie të përbashkët.

Veprimtaria e arumunëve ishte e kontrolluar dhe e mbështetur nga shteti rumun, fakt i cili do të krijonte një krizë të rëndë diplomatike midis Rumanisë dhe Greqisë. Njohja më e mirë e kësaj krize, e analizuar nga Constantin Velichi dhe Max-Demeter Peyfuss, mund të bëhet me ndihmën e të dhënave të përfshira në korrespondencën e përmendur këtu. Apostol Margariti vepronte në vendgjarje, në Thesali, Maqedoni dhe Epir, ai mbante kontaktin direkt me autoritetet osmane, me udhëheqësit shqiptarë dhe, së fundmi, me përfaqësuesit fuqive evropiane të cilët vepronin në Berlin dhe më pas në Konstandinopojë. Nëpërmjet letrave të ruajtura nga ai, por dhe nga udhëheqës të tjerë militantë shqiptarë dhe arumunë, Karaxhiani informohej për ecurinë e punëve. Ai informonte në radhë të tij Ion Gikën, ndërsa ky i fundit mbretin Carol I, i cili mbështeste gjithë veprimtarinë dhe informohej për gjithçka. Korrespondenca kishte karakter konfidencial, ndoshta dhe sekret, një pjesë e saj është e koduar (p. sh. mbreti Carol I ishte “aga”), ndërsa dërgimi i letrave bëhej me njerëz të besuar, për të shmangur rënien e tyre në dorën e autoriteteve osmane, por më tepër në duart e mbështetësve të ekspansionizmit grek dhe të shtetit grek në Ballkan.

Objektivat e arumunëve, të përshkruara nga Karaxhiani dhe Margariti në konkordancë dhe me shtetin rumun, i cili i mbështeste dhe materialisht, ishin: 1° Caktimi i një delegacioni arumun në Konstandinopojë, i zgjedhur në bazë të votës universale të arumunëve të Maqedonisë, Epirit dhe Thesalisë, i cili t'i kundërvihej, nëpërmjet memoriumeve dhe përpçapjeve diplomatike, bashkëngjites me Greqinë të këtyre provincave historike, të banuara nga një numër i madh arumunësh. 2° Transformimin e këtij delegacioni në një përfaqësi të përhershme në Konstandinopojë të arumunëve të Perandorisë Osmane, për t'iu mbrojtur të gjitha të drejtat kombëtare. 3° Organizimi i rezistencës së armatosur të përbashkët të arumunëve dhe shqiptarëve kundër bashkëngjites me Greqinë të Thesalisë dhe Epirit, gjë e cila do të shpinte pashmangshëm drejt ndalimit të përdorimit të gjuhës rumune në kisha dhe shkolla dhe së fundmi, do të çromanizonte dhe greqizonte arumunët. 4° Krijimin e një eksarkati ortodoks të arumunëve, i cili të mund të siguronte, nëpërmjet përpjekjeve të varura prej tij, praktikimin e gjuhës rumune në shkolla

dhe kisha. 5° Ndërtimi i një strukture politike, e cila të siguronte në të ardhmen stabilitetin e solidaritetit të rumunëve dhe shqiptarëve, ndoshta në një shtet federal shqiptaro-rumun.

Për të përballuar shpenzimet e lidhura me organizimin e zgjedhjeve të përfaqësuesve dhe kryerjes së përçapjeve diplomatike, Karaxhiani dhe Margarit kishin nevojë për fonde. Por ata refuzuan ndihmën e nga ana e autoriteteve osmane si dhe të Lidhjes Shqiptare, duke dashur të ruajnë lirinë e plotë të veprimit. Kërkuan dhe arritën të marrin, jo shumë lehtë, subvencione nga ana e shtetit rumun, të cilat i donin të mbuluara, në mënyrë që Rumania të mos dukej e përfshirë direkt në ngjarjet ballkanike. Karaxhiani propozoi në një moment që t'i jepeshin çështjes shqiptaro-arumune, me një urdhër ad-hoc mbretit Carol I, fonde të tërhequra në heshtje nga buxheti i shkollave rumune të Perandorisë Osmane.

Për të marrë mbështetje ndërkombëtare në favor të objektivave të aleancës rumuno-shqiptare, rezistenca kundër bashkëngjites me Greqinë të Thesalisë dhe Epirit dhe krijimit të një strukture autonome për solidarizimin e arumunëve dhe shqiptarëve, Ioan Karaxhiani bëri në vitin 1880 një udhëtim në Itali. Në Romë ai u mundua të merrte mbështetje nga ana e qeverisë italiane, por kryeministri Crispi kundërshtoi planet e paraqitura, duke konsideruar si prioritare çështjen e dëbimit të turqve nga evropa dhe me këtë qëllim dhe mbështetjen e zmadhimit të shtetit helen. Në Vatikan, Ioan Karaxhiani, në përputhje me projektin e imagjinuar bashkë me Apostol Margaritin sipas shembullit të bullgarëve të Trakisë, pati negociata për kalimin e arumunëve në katolicizëm. Përçapjet e Ioan Karaxhiani në Vatikan për bashkimin e arumunëve me kishën roamko-katolike, për të cilën jam marrë në një komunikim të gjendur në shtyp, u analizuan në bazë të burimeve të tjera nga ana e Max-Demeter Peyfuss. Por ato ishin vetëm të imagjinuara, sepse si autoritetet rumune të kohës, ashtu dhe hierarkia katolike i kontestuan ose i minimizuan. Korrespondenca e vyer e Ioan Karaxhiani konfirmon, si burim i dorës së parë, realitetin e këtyre përçapjeve dhe mbështetjen e tyre nga shteti rumun nëpërmjet mbretit Carol I, i cili ishte në dijeni dhe plotësisht dakord me to. Oferta e Karaxhianit u përqaftua me ngrohtësi nga udhëheqja papnore dhe monsinjor Vanutelli, i dërguari papnor në Konstandinopojë, u ngarkua për bashkimin e arumunëve me kishën romako-katolike. Tentativa e Karaxhianit dhe Margaritit për kalimin e arumunëve në katolicizëm vetëm një mënyrë presioni për Patriarkanën greke në Konstandinopojë, për marrjen e lejës nga kjo e fundit për ngritjen e një aksarkati arumun dhe përdorimin e gjuhës rumune nga ana e arumunëve në shkolla dhe kisha. Dëshira e të dërguarit Vanutelli në përmbushjen e misionit të ngarkuar i vendosi dy udhëheqësit arumunë në një situatë delikate, ku dukej se arumunët mund të përmbushnin aspiratat për ruajtjen e identitetit të tyre gjuhësor dhe kulturor në kuadër të kishës ortodokse.

Pas dështimit të veprimtarisë të përbashkët shqiptaro-rumune dhe shtypjes të Lidhjes shqiptare nga autoritetet osmane, Ioan Karaxhiani u përpoq, pa shumë sukses, të merrte mbështetjen e Ion Gikës dhe, nëpërmjet tij, të shtetit rumun, për strehimin dhe mbajtjen e udhëheqësve shqiptarë Jani Vreto dhe Pandeli Spiro, refugjatë në Konstancë, të merrte dhe pranimin e Ion Gikës për një takim me Vreton në Bukuresht, të pasuar nga një udhëtim i burrit të shtetit rumun në Konstandinopojë, ku gëzonte shumë besim nga ana e autoriteteve osmane, për të marrë mbështetje në favor të çështjes së shqiptarëve, të cilët vendosnin gjithë besimin dhe shpresën te ai, duke evokuar dhe origjinën shqiptare të familjes së tij.

Disa përfundime.

Nga korrespondenca e vyer e Ioan Karaxhianit me Ion Gikën dhe Apostol Margaritin dalin me qartësi disa çështje.

Lëvizja për ringjalljen kombëtare të arumunëve nuk ishte në kundërshtim me lëvizjen e rringjalljes kombëtare të shqiptarëve, ashtu si nuk ishte kundër asnjërës prej lëvizjeve legjitime të ringjalljes kombëtare të popujve ballkanikë, por ka qene e njëkohshme dhe e ngjashme me to. Ambicja për afirmimin e identitetit rumun nuk i pengoi arumunët të asocioeshin me ndershmëri me popujt ballkanikë midis të cilëve jetonin. Shteti rumun, i angazhuar në mbështetjen e identitetit rumun të arumunëve, nuk kontestoi, por, përkundrazi, mbështeti të drejtat dhe aspiratat e këtyre popujve si në Ballkan, ashtu dhe në territorin e Rumanisë ku u vendosën dhe në kohën që militantët e këtyre të drejtave dhe aspiratave nga radhët e të gjithë ballkanikëve (grekë, bullgarë, shqiptarë) kishin nevojë.

Afirmimi i identitetit rumun të arumunëve dhe marrja nga ana e shtetit rumun e misionit për ruajtjen e këtij identiteti është vetëm aspekti i veçantë i tendencës së përgjithshme, të përbashkët të gjithë popujve ballkanikë, për të ndërtuar dhe afirmuar një identitet kombëtar modern, politik dhe kulturor, përtej territoreve politike të shteteve të tyre. Duke qenë se konfigurimi gjeografik dhe etnik mozaikal i Gadishullit Ballkanik është i qartë, përhapja e territoreve politike nuk mund të koincidojë asnjëherë me territoret etnike dhe gjuhësore, për këtë arsye procesi i zëvendësimit të strukturave politike perandorake, në esencë kozmopolite, me shtete kombëtare u shoqërua me tensione dhe dhunë, ndërsa në plan historiografik me fshehje dhe shtrembërime kombëtare të së vërtetës.

Zhvillimi i “çështjes arumune” dhe i “çështjes shqiptaro-rumune” në periudhën pas luftës ruso-rumuno-turke dhe Kongresit të Berlinit reflekton dhe shpjegon opsinin e Rumanisë për mbajtjen e Perandorisë Osmane si faktor ekulibri në Ballkan dhe Evropë. Një nga motivet për të cilat Rumania e Carol I mbështeti mbijetesën e Perandorisë Osmane ishte bindja, e vërtetuar nga zhvillimet historike të mëpasme, se ajo ishte më e gatshme se shtetet kombëtare ballkanike t’u jepnin të drejta arumunëve për kultivimin e identitetit të tyre etnik, gjuhësor dhe kulturor nën tutelën dhe mbështetjen e pranuar të shtetit rumun.

KRONOLOGJIA E NGJARJEVE DHE REZUMATET E LETRAVE

Data: 1878, e diel 4 qershor

Burimi: Margariti për Karaxhianin, Bukuresht, 21 qershor 1878

Margarit në pritje nga Carol I, me ftesën e këtij të fundit, i cili ka lexuar Memoriumin e dërguar nëpërmjet Chițu. Princi kërkon informacione për Karaxhianin i cili është i afërt dhe me Margarit.

“Lartmadhësia e tij Vodă duke lexuar memoriumin tim, të cilin j’a tregoi zotit Chițu kërkoi të më takojë. Dhe kështu, të diel (në datën 4) isha në Cotroceni (pallati mbretëror) si ruguciar¹⁹⁹ dhe më priti shumë mirë. Dhe pasi më shprehu falenderimin për mënyrën si paraqis dhe mbroj të drejtat e rumunëve maqedonas, më lavdëroi për luftat e mia dhe vuajtjet që kam hequr për rruajtjen e çështjes rumune nga anët tona të cilat Lartmadhëria e Tij i njihte sepse i kishte shkruajtur – më tha – Agjenti i tij në Konstandinopojë, gjenral Ioan Gika. Bisedova me Lartmadhërinë e Tij rreth 20 minuta, më pyeti për shumë gjëra dhe vura re se ishte i gatshëm kashi nesh dhe njerzve tanë. Më foli dhe për ju dhe më tha që jemi të afërm, kur të takohemi do ju tregoj të gjithë bisedën”.

Data: 1878, 6 qershor

Burimi: Margarit drejtuar Karaxhianit, Bukuresht, 21 qershor 1878

Margarit redakttoi dhe i dërgoi Kongresit të Berlinit një Memorium të makedon-armenëve, të paraqitur dhe mbretit Carol I. Bëhej fjalë të shkonte në Berlin ta dorëzonte.

*“Ju dërgoj së bashku me këtë letër dhe një kopje të Memoriumit të përgatitur nga ana e rumunëve transdanubjanë për Kongresin dhe i cili pasi u shtyp dhe u përkthye në fërngrjisht, u dërgua në destinacion, para rreth 15 ditësh. Bëhej fjalë të shkoja dhe unë për ta dorrëzuar së bashku me një nga *Ἡπειρο-Θεσσαλο-Μακεδόνας*. Por nga andej na u shkrua të dërgonim disa kopje dhe të mos shkoja, por të prisja këtu deri sa të më thonë ata cfarë të bëj sepse as ata nuk i kishin punët mirë dhe tremben të mos komplihoen më shumë gjërat me ngacmimin e një çështje të re. Nuk e dimë akoma cfarë kanë bërë me Memoriumin por Z. Gika më tha që nuk duhet të largohem nga Bukureshti dhe më kërkoi dhe adresën. Duhet të dini që gjithë këto që ju them nuk i di njeri tjetër, sic e shikon prandaj nuk mund të lëviz prej këtu dhe prandaj nuk shkova me Katerinën në Bîsca. Besoj se pas katër-pesë ditësh do më thuhet në qoftë se duhet të shkoj në Berlin apo të kthehem; dhe në këtë mënyrë të mund të shkoj në Mizil në datën 30 të këtij muaji, kur besoj se do shkoni dhe ju, takohemi dhe shkojmë bashkë në”*

¹⁹⁹ arumanizm: “*călușar mascat*” cf. Papahagi, Fjalori, s. u. *aruçučear*, v. *și rugučeár, arugučeár. liyučeár* dhe sinonimi *bubučeár*. Aluzion, ndoshta, te veshja për pritje te mbreti. Është interesante për t’u vënë re se, një kundërshtar i madh i Apostol Margarit, George Murnu karakterizonte veten me të njëjtën fjalë, duke evokuar pjesëmarrjen, me veshje të përshtatshme dhe medalje ne gjoks, në një pritje zyrtare të bërë nga mbreti Ferdinand. Informacionin e kam nga e ndjera Znj. Lia Murnu, vajza e shkrimtarit.

Data: 1878, 13 qershor

Burimi: Margarit drejtuar Karaxhianit, Bukuresht, 1878, 13 qershor

Margarit foli me Kogălniceanu i cili i tha se të plotfuqishmit turq treguan, në Berlin, se mbështesin çështjen e rumunëve të Epirit, Thesalisë dhe Maqedonisë. Do të mari nga Kogălniceanu ditën pasardhëse një letër rekomandimi drejtuar vezirit të madh Savfet Pasha.

“Sot isha te Z. Cogălniceanu dhe më tha se në Berlin foli me të plotfuqishmit turq rreth rumunëve ‘Ηπειρο-Θεσσαλο-Μακεδόνες, dhe çështja jonë shihet mirë dhe mbështetet nga qeveria turke. Nesër do të shkoj te ai që të më japë një letër rekomandimi për vezirin e madh Savfet Pasha dhe në datën 18 ose 20 të këtij muaji do të shkoj me Kolën dhe Cosmescu”.

Data: 1878, 31 gusht

Burimi: Margarit drejtuar Karaxhianit, nga Vlahoclisura, 31 gusht 1878

Margariti e kurajon Karaxhianin të kuptohet me V. A. Urechia, Orăscu, D. Brătianu, Treb. Laurian dhe princin D. Gika në lidhje me krijimin e Shoqërisë Kulturore Makedorumune.

“Gjithashtu përshëndeteni nga ana ime Z. Urechia, me të cilin të bini dakort për krijimin përfundimtar të Shoqërisë Kulturore Makedorumune, e cila duhej të krijohet që kur isha une në Bukuresht dhe projekti i Statutit i së cilës i përpiluar nga ana e tij ja lashë Z. Orăscu dhe D. Brătianu nga një kopje secilit. Meruni vesh në lidhje me këtë Shoqëri me princin Gikës, si dhe me Z. Treboniu Laurian dhe mundohuni të realizohet për sa kohë jini atje”.

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës, 1880, 25 dhjetor nga Iashi, duke ju referuar dy letrave të Margarit për Karaxhianin të dërguara nga Janina.

Në muajin gusht 1880, në Konstandinopojë por më shumë në Janinë, Karaxhiani dhe Margarit përgatitën bazën e bashkimit me shefat e Lidhjes Shqiptare, duke u organizuar për rezistencën armatosur. Më pas ata ju drejtuan komitetit Makedorumun në Bukuresht, i përbërë nga Chițu, Urechia dhe Robescu, me të cilët ranë dakort të mbajnë korespondencën para largimit nga vendi, duke i kërkuar të ndërmjetësonin në Ministrinë e Kulteve marrjen e një mbështetje financiare prej 200 lira nga ana e shtetit rumun. Nga kjo shumë do të paguheshin njerëz të cilët do të shkonin në komunat arumune të mbledhnin firma të noterizuara nga kryetarët e komunave për zgjedhjen e një përfaqësie të përhershme të përbërë nga 10 persona të arumunëve në Konstandinopojë, për të shprehur aspiratat kombëtare të tyre dhe jo vetëm për tu kundërvënë bashkangjites së Thesalisë me Greqinë. Qëndrimi i Komitetit makedorumun është: Urechia tregohet i hidhëruar, ka humbur 8000 franga me gazetën „Frățilia” dhe „Albumin makedo-rumun”; Robescu deklaroi se nuk mund të bëjë asgjë, nuk kish qenë në Paris; Chițu deklaroi se nuk di asgjë, as për udhëtimin e Karaxhiani në Shqipëri, por do mundohet të bëjë dicka.

Karaxhiani propozon të kërkohet, për këtë veprimtarinë aktuale rumune, nga Ministria e Kulteve, një shumë prej 4000 – 8000 franga, të ngelura nga moshapja e liceut pilot në Bitola.

Keqkuptimet midis Vasile Conta, nga njëra anë dhe Urechia dhe Robescu, nga ana tjetër,

shtyrjet e Vasile Conta, me gjithë premtimet e Vasile Boerescu shkatërojnë shpresën për këtë ndihmë.

Të vetmit që kuptojnë rëndësinë e çështjes arumune janë mbreti Carol I, Ion Gika dhe N. Ionescu.

Karaxhiani u mundua, por nuk ja ariti, pasi shpenzoi 200 napolona, të gjente vetë 200 lira nga Evrejt e Jashit.

Pashai i Janinës vendosi ndryshimin e emrit nga „pëfaqësi” në „delegacion” i arumunëve. Pashai ju drejtua Konstandinopojës për miratim, si dhe për marrjen e shumës prej 200 lira, por nuk ka marrë akoma përgjigje (i shkruan Margarit Karagianit). Karaxhiani është i qëndrimit se nuk është oportun ngatërrimi financiar i Turqisë.

Arumunët e shikojnë si të favorshme aleancën rumuno-shqiptare si dhe projektin e një principate rumuno-shqiptare me Shqipërinë, Epirin, Thesalinë dhe Maqedoninë, plan sipas të cilit punojnë shqiptarët të cilët shikojnë më larg dhe shqiptarët të cilët Karaxhiani dhe Margarit i bënë të shikojnë më larg nëpërmjet aleancës me rumunët e atjeshëm. Prej nga Plevna ata shpresonin shtrirjen e Rumanisë, por grekërit i dekurajonin. Arumunët hoqën dorë „megali idea”.

Në Thesali, Trikalla, thotë Margarit, ka filluar mbledhja e firmave nëpërmjet një shqiptari të Ligës, Nemeti-bej, në Larisa nëpërmjet Galip-efendi. Karaxhiani nuk e njeh formularin, do të jetë një i veti, rumun, jo shqiptar apo turk.

Rezulton se ka kërkuar lek nga mbreti Carol I, „personi i cili më priti në audiencë”. I kërkon Gikës të mësojë në qoftë se do të bëhet dicka apo jo. Ioan Karaxhiani e kritikon Dumitru Brătianu dhe Shoqërinë e Kulturës Makedorumune për mosveprim dhe veprime kontraproduktive.

Karaxhiani është për mbështetje e Giampietri, redaktori i Courrier d’ Orient, mik i rumunëve, i pallogaritur nga qeveritarët.

Të dhëna për Coletti (Falmereyer dhe Zisu Sideri nëpërmjet Sergiu Hagiadi)

Data: verë 1880

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës, 1881, 21 janar, Jash, ku është dhe lista

Karaxhiani i dërgon on Gikës listën e 70 lokaliteteve të banuara me rumunë (arumunë) të Pindit, e bërë me konstatimet personale në tërësi në verën e vitit 1880, fshatra dhe qytete të paeashikuara të hyjnë në rajonin autohton rumun. Regjistroi dhe lokalitete mikste rumuno-shqiptare në Shqipëri, të shënuara „nga kurjoziteti”, pa u plotësuar lista dhe pa përfundim të dhënave statistikore. V. A. Urechia kërkon një kopje të listës për në Paris, i lutete Gikës ti jape listen për ta kopjuar. Në qoftë se lista do shkojë në Paris, v të jetë e shoqëruar me një brochure franceze e Apostol Margarit rreth arumunëve, të cilën e ka Urechia në më shumë kopje dhe nga korrpondencat nga Janina të Messenger du Midi të dërguara më pas.

Data: verë 1880

Burimi: 1881, qershor, 6, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës.

Në verën e vitit 1880, në Romë, Karaxhiani trajtoi dhe çështjen e kishës për makedorumunët. Për faktin se nuk arritën të bindin patriarkin të arrinin në një marveshje, për tu lëshuar një qrkore nëpërmjet së cilës tu jepej liria priftërinjve për të mbajtur meshën në rumanisht dhe të mos pengoheshin shkollat, u mendua së bashku me Margarit dhe arumunë të tjerë, të kalojnë ashtu si dhe bullgarët e Trakisë dhe Maqedonisë, në uniaë, por vetëm në rastin në të cilin nuk do të mirnin eksarkatin për rumunët. Përshkruan përpjeket në Romë (me Kryeministrin e Papës, ata i shkruajtën të dërguarit Vanutelli në KOnstandinopojë, u bënë letra të cilat i ka Margarit.

Mbreti Carol e dinte këtë në dimrin e vitit 1880, kur pritis në takim Karaxhiani dhe i miratoi gjithcka. Tani delegacioni u zgjodh, s ii bëhet me përpjekjet për bashkim, sepse Papa, njerzit e tij dhe Vanutelli morrën seriozisht gjithë këtë punë?

Data: para 19 tetorit 1880

J. Giampietri, redaktori i gazetës Courier d’Orient, e informon Margaritin në lidhje me takimin me Abdyl beun i cili e kuptoi rolin e arumunëve, por dhe për mungesën e vëmëndjes nga ana e Boerescu. Giampietri kërkon mbështetje financiare për Courier d’Orient dnga Shoqëria e Kulturorës Makedorumune.

Data: dhjetor 1880

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës, 1881, 6 janar, Jash

Në 23 dhjetor 1880, I. Vretu, presidenti i Komitetit kulturor shqiptar në Konstandinopojë, në përgjigje të letrës së dërguar nga ana Ioan Karaxhiani në lidhje me bashkimin arumuno – shqiptar dhe në përpjekjet e bëra prej tij për këtë qëllim në Romë. Vretu informon “dicka kurioze” : Abdyl Bej Frashëri, shefi më i rëndësishëm i Lidhjes shqiptare dhe vëllai i tij, Naim Bej Frashëri u aratisën nga Konstandinopoja ku ishin tërhequr nga sulltani nën preteksin e negocimit të aspiratave të shqiptarëve, për tu mbajtur më pas në robëri. Dy liderat u krhyen në Frashër, nga ku duhet të shkonin në Prizren për të nisur veprimtari të armatosura. Vretu do ti dërgojë Abdyl Bej Frashërit letrën e Karaxhiani për Vretu që ti bëhej e ditur atij dhe të gjithë pjesmarësve të Lidhjes në Konstandinopojë. Në lidhje me mardhëniet dhe korespondencën sekrete me liderët e Ligës shqiptare. Letra për Vretu ju adresua në sekret nga ana e Karaxhiani një ndërmjetësi nga Stambolli i cili duhet t’ja niste Vretus. Vretu i kërkon të dërgojë në Prizren Apostol Margaritin për tu marrë vesh në lidhje me veprimtarinë të cilës i ka ardhur koha. Turqia persekuton Ligën shqiptare, por nuk guxon ta sulmojë në Prizren. Vretu, si i afërt me Abdyl Bej trembet. Letra drejtuar Karaxhianit ju dërgua me një shqiptar nga Konstanca, sepse nënpunësit e postës austriake në Konstandinopojë janë në pjesën më të madhe greke dhe i hapin letrat. Në Selanik nuk gjetën asgjë, sepse letrat ishin të koduara.

Data: 7 dhjetor 1880

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës 1881, 12 janar, Jash, një rezume e letrës së Margarit, nga Ohri, të datës 17 dhjetor 1880

Me miratimine pashallëkut të Janinës u telegrafua zyrtarisht agjensisë Havas dhe në Vienë në lidhje me aleancën e vllahëve të Epiro-Thesalisë me shqiptarët kundër bashkangjijtes rajonit të tyre me Greqinë. Konsullatate Italisë, Francës dhe Austrisë morrën nga një kopje dhe ja u dërguan qeverivetë tyre ose Ambasadave në Konstandinopojë. Konsulli francez dhe ai austriak këmbëngulin që Margarit të përshpejtojë dërgimine disa përfaqësuesve zyrtarë arumunë në Konstandinopojë.

Data: 9 dhjetor 1880,

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës 1881, 12 janar, Jash, një rezume e letrës së Margarit, nga Ohri, të datës 17 dhjetor 1880

Margarit shkoi nga Janina në Shqipëri dhe Manastir. Pashai Janinës, i tha përpara se të nisej, se prët përgjigje nga Stambolli në lidhje me mandatin e 10 arumunëve dhe subvencion prej 200 lirash për ta. E falenderoi për qëndrimin besnik ndaj perandorisë Osmane të cilën ai ja rekomandoi arumunëve dhe i dha një letër rekomandimi për Veliun e Bitolës, duke e paraqitur si nën tutelën e Potrës në misionin për të inkurajuar arumunët kundër bashkangjijtes me Greqinë. I dha dhe një urdhër të hapur, të shkruajtur në greqisht dhe turqisht, të drejtuar autoriteteve osmane lokale për ti siguruar ndihmë dhe eskortë sigurie. I premtoi se ai personalisht do të mbështeste krijimin e një province të vecantë për arumunët me qëndër në Mecovo, e cila do të përfshinte ato 70 lokalitete të Pindit, qytete dhe fashatra, listen e të cilave Margarit ja kishte nisur Pashallëkut, ndërsa Karaxhiani do ja niste Chica në letrën e ardhëshme. Pasi të mare miratimin nga Stambolli, e kërkuar sërish në datën 5 dhjetor, por i cili nuk kish ardhur akoma në datën 9 dhjetor 1880, Pasha ii Janinës do ti niste Vilajit të Bitolës një dërgesë të koduar në Lidhje me kthimin në Janinë të Apostol Margarit për tu vazhduar me përzgjedhjen e përfaqësuesve arumune dhe nisjen e propagandas rumune dhe Vilaji i Bitolës do ti jepte Margarit një kopje të asaj dërgese. Duke pasur parasysh rolin shumë të rëndësishëm të rumunëve në zgjidhjen e situates konfliktuale në zone, shqiptarët dhu turqit kërkojnë ti afrojnë. Priten lekë të premtuar nga Ion Gikës nga Bukureshti në shumën prej 200 lirash. Në lidhje me dërgimin e tyre, Karaxhiani i shkruajti firmës Mao et Coco në Selanik, e cila do ja nisë Margarit së bashku me një letër për të. Margarit u prit mire në Shqipëri, dy nga shefët e Ligës shqiptare Cerciy bej dhe Ali bej, morrën përsipër të mbledhnin firmat për përfaqësinë e rumunëve (arumunëve) në veri të Maqedonisë.

Data: 1880, 31 dhjetor, Bitola, Margarit i shkruan Karaxhianit

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës 1881, 18 janar Jash

Mori nga Margarit një letër që mbante datën 31 dhjetor 1880, nga Bitola (Manastir). U prit mire nga pasha ii Manastirit, fakt i cili pati efekte të mira te banuesit. Pasha ii Janinës i mbron rumunët. Rihapi një shkollë rumune në Grevena, e iyoluar nga arhiaki grek, urdhëroi me rreptësi

të mos shqetësoheshin shkollat rumune. Dërgon gayeta franceze dhe italiane të mara nga Roma, nga diplomatët Obedenaru dhe Mitilineu, me lajme për Janinën, në lidhje me ushtrinë rumune dhe në lidhje me një vals të kompozuar nga vajza e Dr. Vegezzi Ruscala nga Turin i përkushtuar Mbretëreshës Elisabeta të Rumanisë.

Data: Ioan Karaxhiani i shkruan I. Vretu, presidentit të Komitetit të kulturës shqiptare në Konstandinopojë. Letra u dërgua në sekret nga Karaxhiani një ndërmjetësi nga Stambolli, për t'ja dhënë Vretus.

Në lidhje me përcapjet me qëllimin e bashkimit arumuno-shqiptar, tëbëra nga Karaxhiani në Janinë dhe Romë.

Data: 17 dhjetor 1880, Margarit drejtuar Karaxhiani, nga Ohri

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës 1881, 12 janar, Jash rezume e letrës së Margarit.

Me miratimin e pashallëkut të Janinës u telegrafua zyrtarisht agjensisë Havas dhe në Vjenë në lidhje me alencëne vllëhëve të Epiro-Thesalisë me shqiptarët kundër bashkangjities së rajonit të tzre me Greqinë. Konsullatat e Italisë, Francës dhe Austrisë morren nga një kopje dhe ja u dërguan qeverive ose Ambasadavetë të tyre në Konstandinopojë. Konsujt francez dhe austriak ngulin këmbë që Margarit të përshpejtojë dërgimin e disa përfaqësuesve zyrtarë arumunë në Konstandinopojë.

Data: 23 dhjetor 1880, I. Vretu president i Komitetit të kulturës shqiptare në Konstandinopojë, për Karaxhiani, letër e dërguar me një shqiptar nga Konstanca, e marrë në datën 4 janar 1881.

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës, 1881, 6 janar, nga Jashi, përgjigje për Ion Gikën drejtuar Karaxhianit , 4 janar 1881.

Në 23 dhjetor 1880, I. Vretu, presidenti i Komitetit kulturor shqiptar në Konstandinopojë, në përgjigje të letrës së dërguar nga ana Ioan Karaxhiani në lidhje me bashkimin arumuno – shqiptar dhe në përpjekjet e bëra prej tij për këtë qëllim në Romë. Vretu informon “dicka kurioze” : Abdyl Bej Frashëri, shefi më i rëndësishëm i Lidhjes shqiptare dhe vëllai i tij, Naim Bej Frashëri u aratisën nga Konstandinopoja ku ishin tërhequr nga sulltani nën preteksin e negociimit të aspiratave të shqiptarëve, për tu mbajtur më pas në robëri. Dy liderat u krhyen në Frashër, nga ku duhet të shkonin në Prizren për të nisur veprimtari të armatosura. Vretu do ti dërgojë Abdyl Bej Frashërit letrën e Karaxhiani për Vretu që ti bëhej e ditur atij dhe të gjithë pjesmarësve të Lidhjes në Konstandinopojë. Në lidhje me mardhëniet dhe korespondencën sekrete me liderët e Ligës shqiptare. Letra për Vretu ju adresua në sekret nga ana e Karaxhiani një ndërmjetësi nga Stambolli i cili duhet t'ja niste Vretus. Vretu i kërkon të dërgojë në Prizren Apostol Margarit la Prizren për tu marrë vesh në lidhje me veprimtarinë të cilës i ka ardhur koha. Turqia persekuton Ligën shqiptare, por nuk guxon ta sulmojë në Prizren. Vretu, si i afërt me Abdyl Bej trembet. Letra drejtuar Karaxhiani ju dërgua me një shqiptar nga Konstanca, sepse nënpunësit e postës austriake në Konstandinopojë janë në pjesën më të madhe greke dhe i hapin letrat. Në Selanik nuk gjetën asgjë, sepse letrat ishin të koduara.

Data: 25 dhjetor 1880

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës, 1881, 6 shkurt, Jash tregon letrën e Obedenaru nga Roma, i cili ka marrë një letër nga prifti D. Constantinescu.

Prifti D. Constantinescu nga Perivoli, profesor në Velestin, arhiarku grek i Volos e përzen dhe mbyll shkollën rumune, qytetarët nuk dëgjojnë, ndërhyjnë 25 ushtarë turq të cilët e dërgojnë në Volos, është i përhyakur, mbyllet në Mitropoli, çkishërohet, nxiret nga burgu nga rumunët, por është i detzruar të qëndrojë në Volos dhe nuk i lejohet të mbajë meshë. Rumunët mendohen të kalojnë në katolicizëm, Karaxhiani ju thotë të bëjnë durim. Hapja e shkollës dhe falja e Constantinescu kushtëzohet nga kërkimi i faljes dhe mbyllja e shkollës rumune.

Data: e mërkurë, 31 dhjetor 1880

Sursa: Mërgarit drejtuar Karaxhiani, 31 dhjetor 1880, rezume në Karaxhiani drejtuar Gikës 1881, 18 janar Jash.

Mërgarit i shkruan Karaxhiani, nga Bitola, duke i treguar se pasha ii Bitolas e prit mirë dhe se kjo pati efekt mbi banuesit. Pasha ii mori në mbrojtje rumunët. U urdhërua hapja e shkollës rumune në Grevena e shkëputur nga arhiaku grek.

Data: 12 janar 1881

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës, 1881, 6 shkurt, Jash. Përgjigje për letrën e Ion Gikës të datës 3 shkurt 1881 nëpërmjet së cilës ai kërkonte informacione në lidhje me Apostol Mërgarit dhe në lidhje me amrjen e lekëve nga ana e tij.

Mbëritur në Bukuresh, Ioan Karaxhiani i telegrafon Mërgaritet në Bitola, në terma të koduar, duke e informuar se do marrë lekët për zgjedhjen 10 përfaqësuesve. I kërkoi që, kur të përdorë lekët të ketë parasysh ato që i ka thënë në letrën e datës 13 janar 1881 në adresën e Mao et Coco në Selanik. Mërgarit mori telegramin në datën 14 janar 1881 dhe ju përgjigj duke i shprehur dhe gëzimin.

Data: 14 janar 1881 Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës 1881, 6 shkurt, Jash. Përgjigje Gikës nga ana e Karaxhianit, 3 shkurt 1881. Margariti ishte në Bitola, mori dërgesën nëpërmjet së cilës Karaxhiani e njoftonte se do të merte lekët e kërkuar për zgjedhjen e të dhjetëve. Përgatitet të shkojë në datën 20 janar në Vlahoklisurë, ku ka dhe familjen, të cilën nuk e ka parë nga muaji maj, duke u mbajtur në Bukuresht (maj – 3 gusht 1880) nga Boerescu dhe prej andej në Thesali. Turqit e pritën mirë, sepse lexuan broshurën e tij, të përkëthyer në turqisht. Pasha ii tregoi dy dërgesat e vitit 1880 njëra nëpërmjet së cilës Valiu i Selanikut kërkonte kapjen e tyre, e dyta nëpërmjet së cilës pas urdhrin telegrafik nga Konstandinopoja, i lejohej udhëtimi nëpër province dhe ju kërkohej autoriteteve lokale ti ofronin ndihmë. Constantinidis mbajti anën e interesave greke në mungesë të Valijut, Giampietrimbështeti rumunët. D. Brătianu mundohet ta intimidojë Margaritin. Al. Farra, konsulli rumunë Cpol, armean grekofil, saboton veprimin rumun. Rasti i priftit D. Constantinescu nga Perivoli.
Data: E enjte 15 janar 1881 Gikës drejtuar Karaxhianit Burimi: Karaxhiani drejtuar Ghikës 1881, 18 janar, e diel, Jash. Përgjigje e Ghikës për Karagianin, 15 janar 1881 Shkruan rreth Masim Pasha dhe Asim Pasha.
Burimi: Karaxhiani drejtuar Ghikës 1881, 18 janar, e diel, Jash. Përgjigje e Ghikës për Karagianin, 15 janar 1881 Margariti është në Bitola
Data: 20 janar 1881 Burimi: 19 shkurt 1881, Karaxhiani drejtuar Ghikës, i referohet letrës së përgjigjes së Vretut të datës 31 janar 1881. Karaxhiani i shkruan Vretut, një kopje ai ja dërgon Abdyl Beut në Prizren.
Data: 31 janar 1881 Burimi: 19 shkurt 1881, Karaxhiani drejtuar Ghikës, i referohet letrës së përgjigjes së Vretut të datës 31 janar 1881, për letrën e datës 20 janar 1881. Vretu i shkruan Caraghianit. E mori letrën e tij të datës 20 janar dhe i dërgoi një kopje Abdyl Beut, në Prizren. Lajmi se Abdyl Beu u kap është falls. E miraton përfaqësinë rumune por kërkon dhe praninë e Karagianit në Prizren për tu informuar me masat që meren atje nga shefat e Ligës dhe të marin dhe rumunët vendimin e sulmit të armatosur, si shqiptarët, në konkordancë me ata, dhe jo vetëm përçapje diplomatike me Portën si deri tani. Vretu do të shoqërojë Karaxhianin në

Prizren. Në Konstandinopojë shqiptarët shihen keq dhe spiunohen. Vretu mer me frikë lertrat e Karaxhianit dhe po me frikë ju përgjigjet. U zgjodh president nga shqiptarët myslymanë, për te treguar se nuk bëjnë diskriminime fetare. Shqiptarët interesohen nese Gika shikon me simpati levizjen e tyre. Karaxhiani nënvizon se Gikë bën propaganda në favour te ceshtjes së tyre dhe të kombit të tyre “fisnik” pranë ambasadorëve të fuqive në Bukuresht. Riprodhon letrën në greqisht të Vretut me vlerësime entuziaste për Gikën. Karaxhiani bën tifo për një udhëtim diplomatic të Gikës në Konstandinopojë ku ti ndihmojë shqiptarët duke përdorur mardheniet e tij miqësore me politikanët turq. Propozon të kalohen në buxhet rreth 200. 000 franga “për shkolla dhe kasha” por që në fakt do përdoren për çështjen rumuno-shqiptare.
Data: 1881, 21 janar Burimi: Karaxhiani për Gikën 1881, 21 janar, e diel Jash. Karaxhiani i dërgon Gikës listen e qyteteve arumune të bërë në verën e vitit 1880.
Data: 3 shkurt 1881 Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës 1881, 6 shkurt, Jash, përgjigje e Gikës për Karaxhianin, 1881, 3 shkurt. Gika kërkon informacione për Apostol Margaritin dhe për marrjen e lekëve nga ana e tij.
Data: 5 shkurt 1881 Burimi: Karaxhianji për Gikën, 1881, 19 shkurt. Margariti i shkruan Karaxhianit. Apostol Margarit morri lertrat e Ion Gikës (dhe një tjetër të dates 12 janar) në datën 2 shkurt, ndërsa në datën 5 shkurt i shkruajti një letër Karaxhianit. Letra e Gikës u dërgua nga Selaniku në Vllahoklisurë, prej andej në Kostur, nënprefekturë e pavarur e Bitolës, ku shkoi me rekomandimin e pashallëkut të Manastirit drejtuar përfaqesutit e Perandorisë Otomane të atjeshem për ti dhënë lehtësira në lidhje me zgjedhjen e deputetëve rumunë. Margariti veproi nën thirrjen e një njeriu te devotuar idesë së rumanizmit që ti jepte instruksione dhe lekët e nevojshëm për shpenzimet e hasura për mbledhjen e firmave të autorizuara nëpër fshatra. Margariti llogariti që do ishte më mire të zgjidheshin 6 deputetë në vend të 10 (2 nga Maqedonia, 2 nga Epiri, 2 nga Thesalia), por sygjeron 8 emra. E rëndësishmë është që të kryhen sa më shpejt formalitetet. Mandati i përfaqësimit është mire të shkruhet në gjuhën franceze dhe turke. Komandanti ushtarak i Thesalisë, Hidajet pashai, i dërgoi lajm Margaritit, nëpërmjet profesorit rumun në Trikala, të lerë shkollën dhe të shkojë me nxitim në Thesali, ku prania e tij është e nevojshme për shpëtimin e rumanizmit dhe muhametizmit, dhe më pas do të mund të meret me shkollimin rumunëve të Maqedonisë, të cilët do të egzistojnë gjithsesi, ndërsa ata të Thesalisë dhe Epirit do të humbin për gjithmonë. Pai të nisi njeriun e pritur në Janinë dhe Trikala, Margariti do të shkojë në Bitola për zgjedhjen e dy delegatëve nga Maqedoni dhe më pas në Thesali. Në qoftë se do arin te të krijonte dhe të dërgonte delegacionin në Konstandinopojë, i kërkon Karaxhianit të shkonte dhe ai atje, ndoshta së bashku me Nicolae Ioneskun, atje janë dhe

Bordeanu me Giampietrin të cilët do i ndihmojnë. E informoi Xhampietrin që Mbreti Carol I u vu në djeni për meritat e tij dhe to urdhërojë ti paguhen abonimet dhe sherbimet e kryera ndaj Rumanisë dhe do ti jepet një decorate, që të mos humbasi një organ publiciteti i cili ido i shërbejë shume. Margariti shkruan se rumunët gramostenë të Shqipërisë dhe Maqedonisë, një fis i numurt rumunësh që nuk janë kapur nga idetë paneleniste, të gjendur në më shumë se 60 komuna, kërkojnë professor rumun dhe përfaqesues për kishat rumune. Nga ata do të zgjidhet një delegate dhe në të njëjtën kohë pranoknë me gëzim bashkimin me shqiptarët.

Data: Karaxhiani për Gikën 1881, 6 shkurt, Jash. I përgjigjet letrës së Gikës së dates 3 shkurt 1881.

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës 1881, 6 shkurt, Jash.

Margariti mori telegramin e dates 14 janar 1881, ju përgjigj duke i shprehur gëzimin, do të nisë pas disa ditësh, në datën 20 janar 1881, në Vllahoklisurë dhe Thesali. Paria shqiptare dhe turke e Bitolës e priti mire Margaritin pasi lexuan broshurën e tij të përkthyer në Turqisht. Pasha ii tregoi dhe dy telegrame: njëra nga velaji i Selanikut nëpërmjet së cilës i kërkonte arrestimin e Margaritit dhe Karaxhianit, të cilëve nuk ju kishte firmosur pashaportat, ndërsa i dyti si urdhër telegrafik i ardhur nga Stambolli në Selanik, ti linin të lire të udhëtonin dhe tu jepej mbështetje nga ana e autoriteteve. Urdhri i arrestimit ishte dhënë nga Constantinides, një grek i cili, në mungesën e e vilajit turk, punonte në mënyrë arbitrare në mbështetje të interesave greke. Pas telegramit të pare, vilaji urdhëroi arrestime, u arrestuan për rreth 40 ditë një numër prej 40 mbledhës firmash të ardhur nga Greqia, Anatoli dhe Konstandinopoja, ata u kontrolluan, u morrën në pyetje ju lexuan letrat, pa u identifikuar as Margariti as Jani Lashliu, dhe më pas u liruan. Dërgesa e dytë u mbajt nga ana e Konstantinides, që ti pengenta ata të dy. Në favour të tyre ndërhyri Giampietri, redaktori i gazetës Courrier d'Orient, të cilin Karaxhiani ja rekomandoi V. A. Urechias si mik të rumunëve, duke kërkuar të bëheshin abonime në këtë gazetë nga fondet e Komitetit Makedorumun dhe ti paguheshin abonimet e bëra nga Ministra e Jashtme në kohën e Vasile Boereskut. Apostol Margariti u paralajmërua nga Dimitrie Brătianu nga Konstandinopoja se qëndrimi i gjatë në Epir ishte në dëm të detyrimeve të tij shkollorë. I dyshuar për ostilitet, Dimitrie Brătianu nuk u informua nga Margariti dhe Karaxhiani për detajet e udhëtimit të tyre. Margariti shteu në dorë një letër nga Bukureshti drejtur një profesori në Bitola në të cilën autori luvdohej se i kishte bindur udhëheqësit për papërshtatshmërinë e a Margaritit në pozicionin e inspektorit shkollar, por që do ta pushkatonte në qofte se nuk do arinte heqjen e tij nga ky pozicion.

Data: 1881, 18 shkurt, Bitolia, Margariti drejtuar Karaxhianit.

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës, 1881, 4 mars Jash.

Margariti morri lekët dhe thiri mbledhësit e firmave. Vendosi të zgjidheshin 8 persona: 2 nga Shqipëria, 2 nga Maqedonia, 2 nga Epiri dhe 2 nga Thesalia. Redaktimi i dokumentit të zgjedhjes ngeli object kundërshtimi me Mustafa Asim pashain, valiu i Janinës, ky i fundit kërkonte të ishte

një autorizim proteste kundër bashkangjites, Karaxhiani dhe Margariti kërkonin “të ishte një dookument nëpërmjet të cilit kombi rumun në Turqi zgjidhte 10 persona si përfaqësues së tij për të gjitha interes kombëtare të rumunëve, veprimtaria e tyre të mos kufizohej, sidomos për kërkimin e një exarhati dhe për një kërkesë të mëpasme për autonomi kulturore të përkohëshme”. Pashai insistonte që dokumenti të miratohej dhe nga ai.

Në datën 19 shkurt Margariti shkon te vilaji i Janinës me qëllimin e marrjes së letrave të rekomandimit për mbështetjen e zgjedhjeve nga ana e autoriteteve turke.

Valiul Mustafa Asim pasha i Janinës e dinte marveshjen midis shqiptarëve dhe rumunëve për t’ju kundërvënë me armë invazionit grek. Por shqiptarët kishin dëbuar nga Shqipëria e sipërme dhe nga shumë anë të tjera turqit dhe kishin hapur konflikte me qeverinë turke e cila trembej se dhe rumunët mund të infektoheshin me këtë shpirt rebel. Margariti mendohej ta bindte se rumunët nuk deshën tjetër vecse ndalimin me bashkangjitet me Greqinë.

Për arsye se Lidhjes Shqiptare ju mbaruan mënyrat paqësore pa suksese, ju thonë arumunëve të mos zgjedhin më delegate. Sido të ecin punët, beson Karaxhiani, mire do sihte të zgjidhnin delegate, “sepse nuk janë vecse rumunët e Thsalisë ata që do sakrifikohen nga grekërit. Diplomacia ngelet një numur i madh i cili duhet të mblidhet rreth një qëndre, e cila do jetë delegacioni i të tetëve”.

Margariti beson se turqit do të punojnë më shpejt pas takimit me veliun e Janinës. Margariti i thotë se do të dërgonte një telegraf menjëherë pas mbarimit të zgjedhjeve që të shkonte dhe Karaxhiani në Konstandinopojë, ku të priste delegatët. Karaxhiani i shkruajti që të shklonte dhe Margariti në konstandinopojë dhe të zgjidhej dhe se do të zbriste dhe ai në Konstandinopojë.

Margariti do të redaktonte dokumentin në Janinë së bashku me veliun, më pas do të shkojë në Thesali te Hidaet Pashai, komandanti i trupave në Thesali, i cili e thiri.

Te veliu i Bitolës pati rezultate: ariti të kthehej kryebashkiaku i Vllahoklisurës i marrë nga Patriarhia dhe persekutore e shkollave rumune, mori premtimin se do të zëvendësonte kryetarët e bashkive dhe komunave grekofilë me të tjerë me ide kombëtare rumune.

Me urdhër të D. Brătianu e vori Glodariun drejtor të shkollës fillore rumune në Bitola. Por nuk ka njuë mendim të mirë për të “zgjedhje më e mirë për tu kompromentuar rumanizmin e atjeshëm nuk mund të bëhej” beson dhe Karaxhiani i cili e ka njohur në Brashovë Glodariun dhe i cili i komunikoi mendimin ministrit V. Conta.

Margarit ankohet për pengesa nga ana e D. Brătianut, krkon ti shkruhet ta lerë të qetë deri sat ë përfundojë zgjedhja e delegacionit. Margariti nuk shkruan në qoftë se i duhen më lek apo jo, por vetëm se Gika (i koduar “Miku”) i ka shkruar se mund të bazohet dhe në shuma të tjera; nuk komunikon direkt me të për kujdesi.

Data: 1881, 19 shkurt

Burimi: Karaxhiani drejtuar Gikës, 1881, 19 shkurt

Karaxhiani mer letren e Margaritit të dates 5 shkurt. Margariti mori letrat e Gikës. Ishtë në Kostur ku shkoimpër të mbledhur firmat për delegacionin rumun. Margariti propozon të zgjidhen 6 deputetë dhe jo dhjetë (2 nga Maqedonia, 2 nga Epiri, 2 nga Thesalia). Por propozon tetë emra. Prokura duhej redaktuar sipas tij në fërngjisht dhe turqisht. Rreth dates 6 shkurt prët njeriun të cilin do t'ja rekomandonte velit të Janinës dhe komandantit ushtarak të Thesalisë i cili ta autorizonte dhe ti jepte urdhër të bënte zgjedhjet sa më shpejt. Hidaet Pashai, komndanti ushtarak i Thesalisë, i kërkoi Margaritit nëpërmjet profesorit rumun të Trikalës, të shkonte urgjentisht atje, prania e tij ishte e nevojshme për shpëtimin e rumanizmit dhe muhameti, rumunët e Epirothesalisë mund të humbisnin përgjithmonë, ata të Maqedonisë jo. Margariti do të shkonte në Bitola për zgjedhjen e delegatëve nga Maqedonia më pas në Thesdali. Margariti komunikon faktin se arumunët gramoshtenë (60 komuna në Shqipëri dhe Maqedoni) duan shkolla dhe kasha rumune, do të japin një delegate dhe aderojnë në bashkimin me shqiptarët.

Riprodhon letrën e dates 31 janar të mare nga Vretu në gjuhën greke.

Sygjeron të parashikohet në buxhet rreth 200. 000 franga si për shkollat dhe kishat rumune, porn ë të vërtetë ti përdorë për çështjen rumuno-shqiptare.

Data: 1881, 24 shkurt, Ion Gika drejtuar Karaxhianit

Burimi: Përgjigje Karxhiani drejtuar Gikës, 1881 26 shkurt.

Apostol Margarit morri letrat e Ion Gikës (dhe një tjetër të datës 12 janar) në datën 2 shkurt, ndërsa në datën 5 shkurt i shkruajti Karaxhianit nje letër.

Data: 1881, 26 shkurt, Jash, Karaxhiani drejtuar Ion Gikës
Burimi: Përgjigje 1881, 24 shkurt, Ion Gika për Karaxhianin

I kërkoi Margaritit të ishte i rezervuar në letra që mos dyshohej përfshija e shtetit rumun në çështjen makedorumune. Ndoshta për këtë arsye Margariti nuk i shkruajti direct Gikës, ashtu si i kërkoi Karaxhiani. Besoj se Margariti mori lekët e dërguara nepermjet Maos dhe Koka. E njoftoi Margaritin që V. Conta e siguroi se shuma e lekëve e disponueshme mund të shkonte deri në 35.000 franga, të cilat do të dërgohen me këste nga Gika. Ndoshta për këtë arsye Margariti nuk shkroi për sa lek ksihte nevojë. Karaxhiani mendon se është mire të jenë sa më shumë lekë, për të blerë edhe ata që i kishin blerë grekërit. Do ishte mire të kishin lekët urgjentisht sepse marja e vendimeve në Konstandinopojë përshpejtohet. Është e nevojshme dërgimi i të dhjetëve me memorium përpara mbledhjes së firmave.

Obedenaru nga Roma i ekomandon Karaxhianit që, në qoftë se nuk janë gati dhjetë delegatët, të shkojnë në Konstandinopojë disa antarë të Komitetit nga Bukurshti. Karaxhiani nuk është dakort. Konsideron se ashtu “kompromentohet më shumë çështja, duke u besuar se është lëvizur nga qeveria në Bukursht”.

Do i shkruajë po atë ditë Margaritit në Mao dhe coca, me kode, duke i thënë te nisë një memorium në Konstandinopojë, në qoftë se zgjedhja e të dhjetëve vonon.

Karaxhiani është i zhgënjyer nga inisiativa e Komitetit në Bukuresht. Ureke dhe Robesku, të paralajmëruar me më shumë ltra pas marveshjes me shqiptarët, nuk ju përgjigjën kërkesës për 200 lira të nevojshme për zgjedhjen e 10 delegatëve. I vjen keq tani që nuk pranoi propozimin e shqiptarëve që të paguanin ata dhe atë të pashait të Janinës në emër të qeverisë turke.

Është koha për zgjedhjen e një përfaqësie dhe protest ii saj mund të bëjë shumë ashtu si bëri protesta e Lidhjes Shqiptare, e cila shpëtoi një pjesë të madhe nga ajo që ishte vendosur ti jepej malit të Zi. Më pas “me zgjedhjen e të dhjetëve nis të lidhet dicka rreth së cilës mund të grupohen rumunët të cilët deri tani nuk kanë asnjë pike bashkimi kombëtar, një qëndër zyrtare aktiviteti”

Zgjedhja e përfaqësisë kombëtare nuk është bërë as deri tani sepse, sipas letrës së Margaritit të dates 5 shkurt, vetëm në 10 shkurt do të nisin mbledhësit e firmave për zgjedhje, ai beson se delegacioni do të niset për në Konstandinopojë rreth dates 15 mars 1881.

Grekët mbështesin idenë se rumunët dhe shqiptarët duan ti bashkohen Greqisë dhe se pozicioni është qëllimi i një grupi inigrantësh dhe ambiciozësh. Karaxhiani beson se as grekët e Epirothesalisë nuk duan bashkangjiten, dhe se ata habiten me dashurinë ndaj tyre të grekëve të Greqisë, duke u trembur se do të paguajnë dhe borxhet greke dhe turke.

Rumunët kanë tmer nga bashkangjitja pas popullarizimit të aleancës me shqiptarët, nuk u manifestuan sepse nuk kishte kush të merte inisiativa. Margariti është “i kujdesshëm, energjik, popular dhe shumë bindës, dhe njeri tek i cili prej shumë kohësh është vendosur idea e shpëtimit të rumunëve të jugut” Autoritetet turke do e përkrahin, ashtu që çështja greko-turke nuk do të mbyllet, beson Karaxhiani, deri sat ë mkos dëgjohen dhe aspiratat e rumunëve. “Aq sa japin turqit, nuk marrin grekërit, dhe aq sa kërkojnë grekërit, turqit nuk japin” dhe “në këtë mënyrë do të ecin punët derisa të jetë gati delegacioni”.

Data: 1881, 4 mars, Jash, Karaxhiani drejtuar Ion Gikës Burimi: Shiko më lart 1881, 18 shkurt, Margariti për Karaxhianin. Rezumat i letrave të Margaritit të datës 18 shkurt 1881, nga Bitola. Shiko më sipër Letrat e Gikës për Margaritin dhe lekët duhen dërguar te Mao dhe Coco, në Selanik, ata e dinë në cdo kohë ku është Margariti.
Data: 1881, emartë 9 mars Burimi: 1881, 4 mars, Jash, Karaxhiani për Ion Gikën Karaxhiani largohet nga Jashi për në Bukuresht për mbledhjen e Akademisë Rumune
Data: 1881, e mërkurë 10 mars Burimi: 1881, 4 mars, Jash, Karaxhiani për Ion Gikën Karaxhiani merr pjesë në Bukuresht në mbledhjen e Akademisë Rumune
Data: 1881, 27 mars, Margariti për Karaxhianin, nga Janina, marrë në Bukuresht, të hënë 12 prill. Delegatët nuk u nisën për në Konstandinopojë, sepse mandatet nuk kishin të gjitha firmat e nevojshme, ndërsa Maragarit ish thirur te Hidajet Pashai në Trikala për organizimine forcave të rezistencës të përbëra nga rumunë, shqiptarë dhe turq. Një bandë arumunësh grekomanë u treguan të gatshëm ti bashkoheshin Margaritit dhe premtojnë të konvertojnë në rumanizëm dhe banda të tjera kacakësh. Veliu Mustafa Asim Pashai mbështet këtë përpjekje. Publikimet e gazetave të Konstandinopojës dhe të huaja të cilat thonë se rumunët mbëritën në Konstandinopojë por sulltani nuk i priti por i priti Viziri i Madh dhe jut ha qe nuk kishte cfarë të bënte dhe se D. Brëtianu ka deklaruar se nuk mund të përzihet në punët e tyre nuk janë të vërteta. Delegatët ndodhen tani ndoshta në Larisa, duke pritur mbërritjen e njerëzve të dërguar në Thesali për të mbledhur firma.
Data: 1881, 27 mars, dërgesë nga Karaxhiani për Margaritin Burimi: 1881, e hënë 12 prill, Jash, Karaxhiani për Ion Gikë Karagiani i dërgon me kod (simbole) Margaritit në Janinë se i ishin dërguar edhe 5000 franga në Selanik, ndoshta ishte larguar nga Janina dhe nuk e kishte marrë atje dërgesën. Për Pashkë.
Data: 1881, 11 prill, nga Larisa, Margariti për Karaxhianin Burimi: 1881, e hënë 12 prill, Jash, Karaxhiani për Ion Gikën I thotë se delegatët do të shkojnë në Konstandinopojë pas dhjetë ditësh dhe kërkon ti dërgohen lek në Selanik, shiko më sipër

Data: 1881, e hënë 12 prill, Jash, Karaxhiani drejtuar Ion Gikës Burimi: shiko më sipër, 1881, 27 mars, Janinë, Margariti drejtuar Karaxhianit, e marrë në Bukuresht, të hënë 12 prill. Bën një rezymë të letrës së Margaritit të dates 27 mars 1881 në Janinë. Morri një dërgesë në datën 12 prill 1881 nga ana e Margaritit nga Larisa me datën 11 prill 1881, i thotë se delegatët do të shkojnë në Konstandinopojë pas dhjetë ditësh dhe i kërkon ti dërgojë lek në Selanik, shiko më sipër. D. Brëtianu duke u nisur për në Bukuresht nuk e di kush do ta zëvendësojë. Do të ishte shumë mire në qoftë se Gika do të shkonte në Konstandinopojë pas Pashke, ashtu si edhe i tha, do të dijë në qoftë se do ta bëjë një gjë të tillë, Margariti – i cili ndoshta do të shoqërojë delegacionin - do të gëzohej. Edhe në qoftë se delegacioni do të mbërinte tepër vonë, do të ngelej një protestë kundër bashkangjijtes dhe në qoftë se do të bëhej një protestë e armatosur sërish është një përkëdhelje. Por Karaxhiani në përgjithësi është pessimist, rendi si i cmendur nëpër Thesali dhe Epir në verën e vitit 1880 që ti bindte arumunët se ka ardhur moment i tyre dhe duhej të manifestonin sa më shpejt që mos shiteshin si lope etj. Urime
Data: 1881, 12 maj, Konstandinopojë, Margariti drejtuar Karaxhianit Burimi: 1881, 31 maj, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës Delegatët vizituan Servet pashain, një nga tre të plotfuqishjmit turq në Konferencë, i prit mirë, u interesua dhe u gëzua që kullotat e Thesalisë nuk janë prone e grekërve, port ë shtetit, elegatit i-au vizitat pe Server paşa, unul din cei trei plenipotențiarui turci la conferință, ju dha shpresa sidomos pasi mësoi për firmat dhe numrin e fshatrave të Thesalisë. Ju rekomandoi të takonin Vezirin e madh dhe ambasadaorët dhe ministrant e tjerë.
Data: 1881, maj, Konstandinopojë, Margariti drejtuar Karaxhianit, letra e dytë për muajin maj 1881 nga Konstandinopoja Burimi: 1881, 31 maj, Jash Karaxhiani drejtuar Gikës Delegatët përgatitën një memorium në fërngjisht të cilin ja u dhanë ambasadorëve të fuqive të mëdha me të cilët biseduan. Ambasadorët deklaruan se nuk dinin as për numrin e rumunëve dhe as për kundërshtimin e tyre për bashkangjitje dhe se ju vjen keq për ato që vendosën, por ka kohë për realizimin e shpresave të rumunëve. Çfarë kanë ndërmend të bëjnë rumunët? U përgjigjën se do të jenë të detyruar të rezistojnë në të kundërt do të zhduken. Me përjashtim të Novicoff, të gjithë ambasadorët thane se me rastin e një konflikti të vetëm greko-rumun gjatë kohës së ndarjes së kufive, do të rikthehen. Motivi i kundërshtimit të Novicoff është se arumunët thanë në Memoriumin e tyre se nuk duan të bashkangjisin asgjë nga territori i tyre as grekërve as bullgarëve, ndërsa ai beson se në qoftë se do t'i bashkëngjiten Greqisë 70 fshatra, më pas mund t'i bashkëngjiten dhe Bullgarisë. Novicoff ju kërkoi kështu të pranonin bashkëngjitjen.
Data: 1881, maj, nga Konstandinopoja, Margariti drejtuar Karaxhianit, letra e tretë e muajit maj 1881, nga Konstandinopoja

Burimi: 1881, 31 maj, Jash, karaxhiani drejtuar Gikës Të gjithë gazetarët e Konstandinopojës dhe gazetarët perendimorë të dërguar janë në favour të rumunëve (korespondenti i Times nga Londra kërkon një kopje të Momoriumit me prioritet për publikim). Të gjitha gazetat me pas riprodhuan Memoriumin. Shtupi grek, i vetmi, akuzon konsullin austriak në Janinë që ka paguar firmat me tre lira, dhe se fshatrat dhe qytetet e përmendura në Memorium nuk janë rumunë, delegatët nuk janë të zgjedhur dhe gënjeshtër të tjerë të shpifur. Grekët janë të alarmuar. Gazeta e Janinës dhe korespondencat që atje thonë se bandat rumune rriten dhe se ndër shefat e tyre është dhe një vajzë 17 vjeçare, e motra e Leonida Hagibira nga San Marina e Cilos, në vitet 1878-1880 vinte vërdallë si një revolucionare anti-osmane në Epir, Thesali dhe Maqedoni me një bandë prej 280 personash, me mbështetjen në lekë të Kumunduros dhe të komiteteve atinase. Pas vrasjes së Hagibiras, e motra militon për çështjen rumune. Gazetat greke ankohen se turqit dërgojnë kundër rumunëve krerë shqiptarë të cilët së fundmi bashkohen me ta.
Data: 1881, maj, Konstandinopojë, Margariti drejtuar Karaxhianit, letra e katërt e muajit maj 1881, nga Konstandinopoja Burimi: 1881, 31 maj, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës Nga sa kuptoi Margariti nga bisedat me ambasadorët dhe turqit, e vetmja mundësi shpëtimi është kundërshtimi me armë. Margariti e priste Gikën përpara se t'ju kërkonte turqve lejin e armatosjes së rumunëve për rezistencë. Mendohet t'ju kërkojë turqve të përfundojnë persekutimin e shqiptarëve dhe ti përdorte për rezistencë së bashku me rumunët e Pindit. I lutet Gikës të bëjë një udhëtim në Konstandinopojë dhe ti bindë turqit të lejojnë rezistencën shqiptaro-rumune, sa me këshilla aq dhe me influencën të cilën e gëzon. Rumunët refuzuan të ngrihen kundër turqve, por turqit do të dyshonin një rebelim të tillë në qoftë se rumunët do të këmbëngulnin të bashkohen me shqiptarët.
Data: 1881, maj 24, Vangheli Dimitriu Buti nga Konstanca për Karaxhianin Burimi: 1881, 31 maj, Jash, Karaxhiani për Gikën Në Kiustenge u refugjua para një jave I. Vretu, president i Komitetit të kulturës shqiptare në Konstandinopojë së bashku me Pandeli Sotirin sekretarin e këtij Komiteti. Ata u aratisën nga Konstandinopoja pa pashaporta pas kapjes së Abdyl Frashrit i cili luftoi me Dervish pashain në Shqipërinë e sipërme, në bazë të korespondencës që jug jet u bënë arestime të antarëve të Lidhjes shqiptare në Prevezë, Janinë, Berat dhe Konstandinopojë. Për këtë arsye shumë vetë të cilet ishin në korespondencë intime me komitetin ekzekutiv të Lidhjes së Prizrenit, si ata të dy, u aratisën.
Data: 1881, maj, letra e parë e marrë nga Vretu nga Konstanca nga ana e Karaxhianit në datën 24 maj Burimi: 1881, 31 maj, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës Vretu kërkon mbrojtje dhe ndihmë nga qeveria rumune nëpërmjet Karaxhianit. Deklaratë për vretun dhe Pandelin: në vitin 1881 ndihmuan Margaritin dhe Karaxhianin, i bashkangjitën në

planin e tyre secret. Shqiptarët shkruajnë me alfabetin e shpikur nga Vretu, ai është shumë i dashur nga bashkëatdhetarët e tij, është elenist i mire, di turqisht, jo gjuhët kulte evropiane. Pandeli flet dhe fërngjisht. Ju bënë shërbime të mëdha Margaritit dhe Karaxhianit në vitin 1880 dhe i bashkuan në planet e tyre secrete për të punuar sëbashku. Domethënë meritojnë ndihmë. Karaxhiani i shkruajti Dimitrie Brëteanut, i cili pranoi ti ndihmonte dhe ju përgjigj nëpërmjet Bordeanut se i kishte dhënë instruksione Opreanut në këtë drejtim, që t'ju ofronte miqve shqiptarë mikpritje dhe lehtësira.
Data: 1881, maj, letru e dytë e marë nga Vretu nga ana e Karaxhianit dërguar nga Konstanca në 30 maj Asnjënjëri nuk id ha asnjë përkëdhelje, ka ndërmënd të vijë me Pandelin në Bukuresht, të krijojë një gazette shqiptaro-francez dhe një komitet. Karaxhiani i rekomandon Gikës ti takojë në Bukuresht në mënyrë që të mare sa më shumë sqarime.
Data: 1881, maj Burimi: 1881, 31 maj, Jahs, Karaxhiani drejtuar Gikës Para se të nisej në Bukuresht, Karaxhiani takoi mbretin Carol (“aga”), i cili ishte shumë i interesuar për çështjen rumuno-shqiptare. Mbreti i kërkoi ta informonte nëpërmjet Gikës, sepse është koha të veprojmë
Data: 1881, 29 maj, Margariti drejtuar Karaxhianit Burimi: 1881, qershor, 6, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës Një turk i cili në verën e vitit 1880 i prezantoi Karaxhianin dhe Margaritit Mahmud Nedin pashait it ha Margaritit se nuk firmohet konventa sepse nuk erdhi delegacioni vllah. I kërkoi ti jepte urgjentisht Osman pashait, minister i luftës dhe marshall i oborrit, një kopje te Memoriumit në gjuhën turke.

Data: 1881, 31 maj, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës
Burimi: 1881, 31 maj, Jashi, Karaxhiani drejtuar Gikës

Ka humbur kontaktet, mendon se është në Berlin, pasi kish qënë në Konstandinopojë, ku nik kish mbëritur ende pas Margaritit dhe nuk di ku ti shkruajë.

I bën rezymenë e letrave të Margaritit “që ta niste atje ku duhej”, domethënë mbretit Carol I (letra duke filluar nga data 12 maj 1881). Në lidhje me refugjimin e Vretut dhe Pandelit në Konstancë. Në lidhje me mundësinë për ti ndihmuar. I kujton Gikës letrën e vitit të shkuar në të cilën Vretu i bënte elozhe Gikës dhe varte shpresat te ai. U ofrua t’ja prezantonte. Qëllimi kryesor i kësaj letre ishte të mësonte në qoftë se Gika kishte apo jo ndërmend të shkonte në Konstandinopojë dhe, në qoftë se po, kur, që të mund ti shkruante Margaritit të most a priste dhe të punonte vetë në qoftë se nuk shkonte, rast në të cilin do të ishte mirë që Gika ti dërgonte disa letra rekomandimi. Insiston për një përgjigje të saktë.

Mendimi i Gikës që të zgjidheshin sa më shumë rumunë që atje si agjentë për të propaganduar çështjen rumune është shumë e mire dhe është rasti për tu realizuar. Ishte moment që Gika ta bindte D. Brëtianun të ekzekutonte këtë. Disa emra mund ti furnizonte Margariti i cili i dinte më mire gjërat atje.

Fragment secret në gjuhën greke: është mire që Gika “ta bindë mbretin Carol (i koduar aga), sepse ata po vonojnë. Para se të nisej nga Bukureshti, Karaxhiani u takua me mbretin, i cili ishte shumë i interesuar për këtë çështje. Mbreti i kerkoi ta informonte nëpërmjet Gikës, sepse ishte koha të vepronim”

Data: 1881, 2 qershor, Margariti drejtuar Karaxhianit
Burimi: 1881, qershor, 6, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës

E dielë, 31 maj, delegatët arumunë i dhanë Sulltanit një petition në gjuhën turke i cili mendoj se nuk ishte mire ti priste personalisht dhe jut ha të vinin nga data 2 qershor ditën e martë për të marrë përgjigjen e Sulltanit (relation Margariti).

Në lidhje me Vanutellin i cili e kërkon c’do ditë përsa i përket çështjes së bashkimit, që nga dita kur dëgjoi për mbërritjen e delegacionit, do të takoheshin në datën 2 qershor. E lajmëroi në datën 1 qershor në redaksinë Courier d’Orient.

Data: 1881, qershor, 6, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës
Burimi: 1881, qershor, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës.

Para se të nisej nga Bukureshti, Karaxhiani u takua me mbretin, i cili ishte shumë i interesuar për këtë çështje. Mbreti i kërkoj ta informonte nëpërmjet Gikës sepse është koha të veprojmë.

Karaxhiani bën përsëri kërkesën që Gika ti komunikonte në qoftë se shkonte në Konstandinopojë në mënyrë që të informojë Margaritin dhe delegatët rumunë të cilët e presin, të bindur që ai “mund të bëjë gjithcka për çështjen tone në rrethanat aktuale”.

Të gjithë ambasadorët me përjashtim të atij moskovit ju thonë fshehtasi se Fuqitë do të ktheheshin me lehtësi në qoftë se vllahët pindenë do të arganizonin një rezistencë sado të vogël,

duke lënë një thirje dhe duke ngacmuar ushtrinë greke në atë mënyre që të shpallej në shtup dhe kështu ambasadorët do të kishin një pretekst të ktheheshin. Ambasadorët ngulin këmbë që kjo të bëhet shpejt, ndërkohë që ata presin në Konstandinopojë.

Memoriumi i drejtuar ambasadorëve dhe ministrave turq u përkthue dhe në turqisht dhe u publikua në të gjitha gazetatat turke (Osmanli, Mekit, Tergiumanui Hakikat etj.) si dhe peticioni drejtuar Sulltanit. Gazetarët turq mbështesin çështjen rumune, ndërsa turqit ezitojnë organizimin e forcave rumune dhe armatosjen e tyre për rezistencë që të mos e pësojnë si e pësuan me shqiptarët. Karaxhiani trembet se nuk do të mbështesin një rezistencë të armatosur.

Margariti shkruan se paria e Lidhjes shqiptare janë shumë të persekutuar nga qeveria osmane. U arestua dhe Mustafa beu i Janinës, shqiptari më i pasur i Epirit dhe antar i Komitetit ekzekutiv, të cilit mund ti gjinden dhe ndonjë letër nga Karaxhiani me rastin e një misioni atje, por sidomos në Krispi, por letra e pare nuk le dyshime sepse ishte në favour të idese që rumunët të ngelen nën udhëheqje turke gjatë kohës që shqiptarët dëshironin kryengritje kundër turqve së bashku me rumunët. Në qoftë se nuk do ishte kapur Abdyl Frashëri se bashku me liderët e tjerë shqiptarë, rumunët do ti mernin armët nga ata, sipas marveshjes së verës së vitit 1880, tani punët kanë ndryshuar sepse shqiptarët ngelën pa udhëheqës, disa u kapën, disa u shpërndanë. Marveshja ishte vetëm kundër bashkangjitjes por turqit e morën vesh për të dhe kishin frikë të mos transformohej në një aleancë anti-osmane. Margariti nuk mer për sipër t'ju kërkoë armë turqve që m, os dyshohet për qëllime revolucionare. Ju është shmangur marveshjeve të shkruajtura me shqiptarët

Gika mund të kish bërë dicka në Konstandinopojë, duke u mbështetur te besimi i madh dhe simpatia që kanë turqit për të.

Margariti i lutet Gikës ta këshillojë në lidhje me kë të takohet, me kë të konsultohet dhe kujt ti hapet.

Kërkon ti thuhet në qoftë se mbreti Carol këshillon apo planifikon dicka, sepse të tjerët vonohen në marrjen e vendimeve ose i marrin përgjysëm.

Karaxhiani është i mendimit se nga ato 190. 000 franga të disponueshme për kisha dhe shkolla, gjusma të përdoret për organizimin e rezistencës. Këtë mund ta bëjë vetëm “aga i madh”.

Në verën e vitit 1880, në Romë, u trajtua dhe çështja e kishës për makedonrumunët. Meqënëse nuk u arrit të njëmarveshje për tu dhënë një qrkore patriarhëve në lidhje me dhënien e lirisë të meshërimit në rumanisht dhe për tu mos penguar shkollat, u mendua së bashku me Margaritin dhe arumunë të tjerë të kalonin në katolicizëm ashtu si dhe bullgarët e Trakisë dhe Maqedonisë, por vetëm në qoftë se nuk do arinin të mernin aksarhatin për rumunët. Përshkruan përpjekjet në Romë (me kryeministyrin e Papës, ata i shkruajtën të dërguarit në Konstandinopojë Vanutelli, u përpunuan dokumenta, të cilat i ka Margariti. Mbreti Carol ishte në djeni për këtë në dimrin e vitit 1880, kur e priti Karaxhianin dhe miratoi gjithcka. Tani delegacioni u zgjodh, eksarhati do të kërkoet seshpejti, si do bëhet me tratativat për bashkim me katolikët sepse Papa, njerzit e tij dhe Vanutelli morrën gjithcka seriozisht.

Margariti nën trusninë Vanutellit. Ndoshta do ta përdorin, sepse do te jetë favour të shpresës për bashkimi. është një komedi e vërtetë, sepse duke u zgjedhur delegacioni, katolicizmi ngelet në suspension.

Kërkon sërish mbështetje për Vretun i cili pret ndihmë në Konstancë.
Data: 16 qershor 1881 Burimi: Margarit drejtuar Karaxhianit, 1881, 16 qershor, nga Konstandinopoja, përgjigje për letrën e Karaxhianit të datës 8 qershor 1881 Romunët, ish kaçakë janë gati të bëhen adeptë të çështjes rumune dhe rezistentë antigrekë. Maragriti ndërhyr te Safet dhe Servet pashai dhe ministri i jashtëm për tu kërkuar të rekomandojnë te pashai i Janinës përfaqësuesit e rumunëve dhe të organizojë rezistencën e tyre. “Nga qyteti Tăuşani Noi kam marrë letra dhe me thuhet se rumunët, ish kaçakë, kane deklaruar mbështetjen e interesave të racës dhe tokës së rumunëve të Vlahohorit, janë të gatshëm të kundërshtojnë me armët grekërit në qoftë se do vijnë t’ju marrin dhe t’ju pushtojnë vendin e tyre, por ju duhet drejtues dhe organizim, e cila nuk mund të bëhet vetëm me njerëz të dërguar nga jashtë. Gicën dhe Mihun do i nis të shtunën e ardhshme dhe do ju jap disa lek, me kushtin që të punojnë seriozisht, në qoftë se nuk do të mundet të bëjnë punë të madhe. Nesër dhe pasnesër do të kërkoj të takohem me Servet dhe Safet pashën dhe ministrin e jashtëm, që t’ju kërkoj të rekomandojnë pranë pashait të Janinës përfaqësues të cilët do të shkojnë poshtë për të drejtuar dhe organizuar rezistencën e rumunëve, dhe në qoftë se do arij të mar rekomandimin punët do të shkojnë mirë”.
Data: 1 korrik 1881 Largimi i Ion Gikës për në Londër, si i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë i Rumanisë (1 korik 1881 – 1 mars 1891)
Data: 1881, rreth datës 20 korik Burimi: 1882, 23 qershor, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës Rreth datës 20 korrik 1881, Karaxhiani dhe Margariti marin mëngjesin me mbretin Carol I të cilin e sigurojnë se do kenë lajme rreth rezistencës së arumunëve të Thesalisë, ndërsa Mbreti premton se do dërgojë ekspertë në teren. Pa e ditur ata, ”diplomacia turke në Janinë kish bërë planin për të hequr qafe Ligën shqiptare dhe marveshjen e papërfunduar të rumunëve të Pindit ”. Të dy të autorizuarit e Mbretit (?) evituan të takonin Margaritin i cili shkoi në Konstandinopojë, ku mbëriti në datën 4 gusht 1881 dhe mori vesh se çfarë kishte ndodhur.
Data: 1881, 4 gusht Burimi: 1882, 23 qershor, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës Margarit mbërin në Konstandinopojë dhe mer vesh ndryshimin negativ të qëndrimit të turqve. Pas largimit nga Konstandinopoja delegatët formuan një grup prej 1000 kaçakësh, të cilët më pare ishin grekofilë, të cilët duhet të bënin “një llojë proteste me armë” në kufijtë e rinj. I pyetur nga rumunët në lidhje me qëndrimin ndaj kësaj nisme, pashai I Janinës kërkoi

informacione nga Konstandinopoja, dhe më pas u përgjigj që qeveria osmane do të lejojë rezistencën dhe c'do veprim kundër grekëve vetëm në bazë të një marveshjeje paraprake dhe nuk do I sulmojë 1000 kacakët – të cilësuar nga ai si “grabitës” – vetëm në rastin se do I dorzoheshin autoriteteve turke dhe do ju ofrohet amnisti, që të mos krijohet përshtypja që po dërgon bigada kundër ushtrisë greke për të pushtuar teritorët e dhëna.

Por pashai I Janinës I tradhëtoi arumunët të cilët donin ti kundërviheshin me armë grekëve, turqit arestojnë rreth 180 kacakë dhe më pas vrasin një pjesë të madhe të tyre, të mbijetuarit u refugjuan te grekërit, duke dorëzuar armët autoriteteve të Greqisë dhe më pas të Thesalisë. Pashai shfajësohet duke thënë se është vepruar kundër urdhrave të tij dhe premtën se 180 kacakët nuk do pësojnë asgjë.

Data: 1881, dimër

Burimi: 1882, 23 qershor, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës

Në dimrin e vitit 1881, Karaxhiani mësoi se Mbreti Carol I është i mërzhitur që nuk pati rezisestencë, dhe në një mbledhje të Akademisë Rumune, mbreti ju tregua disi i ftohtë „sikur unë dhe Margariti, disa mësues, mund të udhëhiqim dhe ushtrinë. Kjo punë, e kam thënë, nuk është për Margaritin, as për disa mësues, por për politikanët e Rumanisë, të meren ata mekëtë punë dhe në mënyrë radikale, të lenë mësuesit me mësuesinë.”

Data: 1881, para Krishtlindjeve

Burimi: 1882, 23 qershor, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës

Para krishtlindjeve, Margariti u njoftua me telegraf nga Urechia për tu nisur nga Bitola në Bukuresht për të informuar qeverinë Rumune. Pakujdesia e kësaj thirje ishte vështirë për tu justifikuar para pashait të Bitolës të cilit Margariti i kishte mohuar vazhdimisht vartësinë e tij nga qeveria Rumune. Bëhej fjalë për një intrigë, e provokuar nga një mësuese, Antonescu, e preferuara e V. A. Urechias dhe e dashura e konsullit rumun në Selanik, burim „detaje qesharake si vepra politike”. Margariti kishte njoftuar se nuk bënte detyrën profesionale. Konsulli e akuzoi se bënte politikë austriake dhe „shumë fëmijëllëqe të tjera”. Urechia e thiri për të dhënë një raport të shkruar për tu mbrojtur. Sturdza i tha I. Brătianut i cili i transmetoi Urechias të linte të qetë Margaritin, sepse qeveria nuk ka asnjë lidhje me shkollat e Maqedonisë.

Margariti njohi në vapor, në udhëtimin e tij nga Selaniku për në Konstandinopojë, rrugës për në Bukuresht, ish ambasadorin osman në Paris, Veli Pasha Geretli Mustafa pasha, babai i të cilit ishte prej 30 vjetësh guvernatori i Kretës. Margariti i lutet Gikës të ndërhyjë për tu emëruar guvernator i Shqipërisë në vend Dervish pashait, „ky emërim do të ishte shumë avantazhos për çështjen e rumunëve të jugut”. Dhe në lidhje me këtë, thotë Karaxhiani, „i jam lutur dhe unë dhe zoti Margarit zotit Sturdza t’ju shkruajë. Shumë gjëra janë të mira, por nuk bëhet gjithcka dhe cfarë ju shkruaj janë çështje delikate dhe kam frikë mos ju krijoj ndonjë problem, duke ju shkruajtur në këtë mënyrë sepse nuk kam πράξις si të di, si thoshte i ndjeri Eliade”.

Data: 1882, 30 mars

Burimi: 1883, 19 prill, nga Jashi, Karaxhiani drejtuar Gikës

Margariti i shkruante Karaxhianit se shkolla rumune ka berë progrese të mëdha „sidomos në Krushovë, Mulovishte, Vllahoklisurë, Grebeni, la Minciu (Mecovo), Lakë, dhe gjithandej vetëm në një vit e gjysëm, aq sa dhe unë cuditem”. Ky progres i rumanizmit e detyrohet sa Apostol Margaritit, aq dhe fitores në, por dhe protestës së delegatëve në Konferencën e Konstandinopojës, nga e cila kanë nisur dhe turqit të na konsiderojnë si komb të vecantë dhe na pranojnë si antarë në këshilla dhe kërkuan nga zoti Margarit të rekomandojë nga një rumun si antar të këshilleve shkollore në Selanik, Bitola, Janinë dhe Prizren gjë të cilën e bëri”.

Data: 1882, maj

Burimi: 1882, 23 qershor, Jash, Karaxhiani drejtuar Gikës

Iani Vreto, refugjati i cili kishtë bërë një Komitet kulture në Bukuresht, shkoi në Egjipt, formoi atje një komitet, mblodhi 6000 franga dhe 600 lira turke. Në muajin maj të vitit 1882, duke u larguar nga Egjipti, ndaloi disa ditë në Dardanele, u takua me antarë të Lidhjes shqiptare të arrestuar në vitin 1881. Takoi Mustafa pashain nga Vlora, Omer be Vrionin dhe Mustafa beun nga Janina, ai i cili së bashku me Abdyl Frashrin shkoi në Romë, Paris dhe Londër për çështjen shqiptare. Karaxhiani i lutet Gikës të ndërmarë ndonjë veprim në favor të shqiptarëve të gjendur në burg në Arabi, Dardanele, Selanik, Bitola, Prizren, Janinë dhe Prevezë. Shqiptarët do të vlerësonin mbështetjen rumune, e cila „do të ishte një e mirë e madhe për rumunët e jugut”.

Data: Ion Gika drejtuar Karaxhianit 11 qershor 1882. Karaxhiani i përgjigjet nga Selaniku në 1882, 21 qershor.

Burimi: 1882, 21 qershor, nga Selaniku, Karaxhiani drejtuar Gikës, përgjigje.

Karaxhiani i gëzohet interesit të Gikës për çështjen arumuno-shqiptare dhe instruksionet që jep për t’ju hapur veshët Evropës.

I shkruajti Salim beut, vëllait të Abdyl Frashërit në Konstandinopojë, të cilin e ka njohur në udhëtimin e tij nëpër Shqipëri dhe Thesali.

I shkruajti dhe Vretut.

Margariti i shkruajti nga Janina se të afërmit e të burgosurve e rrethuan me shumë simpati kur ju shkruajti si Gika po punon për lirin e tyre.

Karaxhiani i kërkoi Sturdzas ti jepte Margaritit instruksione për të punuar në këtë drejtim, gjë të cilën Sturdza e kishte premtuar qysh prej Krishtlindjeve.

Gika është i mendimit se do të ishte mire që Omer be Vrioni, Mustafa Pashai nga Vlora, Mustafa beu nga Janina dhe Abdyl be Frashri të shkojnë në Londër ose në Paris dhe të punojnë në shtyp. Port ë gjithë janë të burgosur, tre të parët në Dardanele i katërti në Prizren ose Bitola. U joshën nga Assim pasha i janinës në Prevezë, nën pretekstin e këshillimit të një invazioni shqiptar në Greqi, dhe më pas u arrestuan dhe u dërguan në Konstandinopojë nga ku u shpërndanë në vende të ndryshme. Shqiptarët nuk kanë shumë intelektualë, belerët e pasur janë “analfabetë”.

Një ose dy në qoftë se do të lirohej nga burgu do të mund të bënte atë që më shkruani. Prandaj në qoftë se nuk do mundet të lirohen të gjithë, të paktën të punohet për të liruar ata të konsideruar më pak fajtorë nga qeveria turke.

Sipas Margaritit, i cili u miqësua me të në vapor dhe të cilin e mori në shtëpinë e tij në Konstandinopojë, Veli Pashai, i biri i Mustafa Ghiritlit, i foli seriozisht, duke i thënë se, herët a vonë, Turqia do të himbasi provincat në Evropë dhe duhen përgatitur punët që në atë moment ti pushtojnë rumunët me shqiptarët. Për të arritur këtë qëllim ai (Veli Pashai) i tha Margaritit që në qoftë se do të mund të bëhej guvernatori i Shqipërise çështje ishte e zgjidhur. Mund të përgatisë gjithcka ne pak kohë. Margariti i foli për Ju dhe behej fjalë që Margariti t'ju shkruante të punonit si dini por vetëm që mund të bëhet guvernator vetëm për këtë arsye. Astu që ai (Veli Pasha) nuk besoj të vijë në Londër ose Paris të punojë nëpërmjet shtypit; ai do të përgatisë punët në Shqipëri, si njerzit ashtu dhe të përgatisë depozita armësh dhe municionesh për një kruengritje të pastër kombëtare, jo si ajo e viteve të shkuara, kur drejtimin e kishte qeveria dhe nga e cila shqiptarët nuk ditën të marin asnjë përfitim.. Për këtë Karaxhiani foli me Margaritin, por për kujdesje nuk gjeti një mënyrë ti shkruajë Ën Gikës.

Karaxhianii komunikoi Margaritit fjalët e Gikës në lidhje me një mision në Londër dhe Paris dhe ju lut të punonte në këtë drejtim. Në lidhje me çfarë do ndodhe do i shkruaj Gikës më pas.

Data: 1883, 19 prill, nga Jashi, Karaxhiani drejtuar Gikës

Burimi: 1883, 19 prilli, nga Jashi, Karaxhiani drejtuar Gikës

Në vitin e ikjes së tij te Pashai i Janinës, Karaxhiani pati një takim me Ion Gikën në Bukuresht, në hotel. E trishtoi deklarata e Gikës sipas së cilës „Në qoftë se nuk bëhet gjë në Maqedoni dhe njerzit nuk duan të përqafojnë rumanizmin, qeveria duhet të mbyllë shkollat rumune të Maqedonisë”.

Kritika politikës shkollore rumune të Ballkanit. Karaxhiani i tregoi se ministri P. S. Aurelian dhe drejtori Tocilescu nuk ju përgjigjen raporteve të inspektorit Margarit dhe duken të ashpër me shkollat e Maqedonisë, të cilat do të ishin gati ti mbyllin. Minstra dhe drejtorë të ndryshëm nga ministria e kulteve dhe çështjeve publike nuk njohin „çështjen arumune” dhe nuk shohin vecse shpenzimet e medha të bëra me shkollat e Ballkanit, shpenzime të cilat do të ishte e preferuar, thonë ata, të bëhen për shkollat në vënd, dhe jo për „disa rumunë pas shtatë malesh dhe shtatë detesh”. Akuzon autoritetet se përpiqen ta bëjnë Margaritin të heqë dorë nga inspektorati, të paralizojnë aktivitetin e shkollave dhe të arihet drejt mbylljes së tyre, duke bërë ekonomi për vëndin ato 80. 000 franga të cilat u jepen c’do vit shkollave të Maqedonisë, Epirit dhe Thesalisë. Propozime për përmirësim. Komisioni i të treve. Prej pothuajse dy vjetësh (1881), i kërkuar nga Margariti, Karaxhiani ju adresua ministrave të Punëve publike me propozimin për tu krijuar një komision prej tre personash kopetentë, por jo politikë, të cilët të administrojnë fondin vjetor prej 80. 000 frangash, të mbajnë lidhjet me inspektorin e shkollave dhe të bëjë raporte vjetore për Ministrinë. Krijimi i komisionit do të shmangte shumë situata të pa dëshiruara:

1) karakteri i përhershëm i komisionit, në kontrast me ndryshimet e shpeshta të ministrave dhe drejtorëve, do të ofronte vazhdimësi në njohjen e çështjes dhe në aktivitet;

2) do të evitohej paraqitja e qëllimshme e lidhjeve të drejtpërdrejta, përfshi korespondencën zyrtare, midis autoriteteve shtetërore, ministrove ose diplomatike rumune dhe insepktorit shkollor, i cili ka ngjallur dyshime, duke e vënë në vështirësi Margaritin. Guvernatori i Bitolës i shprehu Margaritit në dhjetor të vitit 1882, se është i varur nga Bukureshti i cili e thëret me urdhër (incidenti Lenş, consulli në Selanik, i cili tha se bënte politikë austriake në Turqi gafa e Urechias i cili i kërkoi Lenşit ta thëriste me telegraf në ministrinë e Kulteve në Bukuresht ose inspektimi i parlamentarit Pâtârlăgeanu në shkollat e Maqedonisë i njoftuar me telegraf nga Lenş). Margariti replikoi se bëhet fjalë për shumat e lëna me testamente për shkollat dhe të administruara nga institucione (kulturore ose bamirësie) të kontrolluara nga qeveria rumune. Guvernatori u tregua i kuptueshëm por e paralajmëroi se ndonjë tjetër ndoshta nuk do të jete i tillë dhe do ta dyshojë për spiunazh.

Karaxhiani foli për komisionit e të treve si me Mbretin direkt ashtu dhe me Dimitrie Sturdza nëpërmjet i komunikonte Mbretit situatën, si dhe kohët e fundit me ministrin P. S. Aurelian, i cili vendosi të bënte një referat për Këshillin e Ministrave dhe i kërkoi propozime për njerëz. Propozoi Pencovicin, P. Rioreanu, i treti pas Aurelianit, duhej të ishte Princi Dimitrie Gika, por Karaxhiani u kundërvu, sepse „binte në sy”. Tocilescu i tha se nuk bëhet asgjë për ngritjen e komisionit dhe se kjo çështje e shënjtë do të mbetet „sërisht si një bela mbi kokën e eMinistrave dhe Drejtorëve të cilët do të vijojnë në Ministrinë e Kulteve dhe do të degjenerojë”.

Karaxhiani elozhon Ion Gikën sepse i dha një shtysë „çështjes arumune” duke bërë, nëpërmjet ndërmjetësimi të mbreti Carol I, të mundur formimin e delegacionit të përfaqësuesve të popullit rumun të Turqisë i cili protestoi kundër bashkangjijtes me Greqinë „të dy provincave rumune”, protestë e dështuar, por e cila „bëri, nëpërmjet firmave të mbledhura një fillim lëvizjeje kombëtare kolektive, e cila po jep rezultate”.

Duke kuptuar mirë „çështjen arumune” dhe „cfare rezultatesh mund të japë në të ardhmen” Ion Gika ftohet të mundohet, për sa kohë është në Bukuresht, për formimin e komisionit të të treve, i cili do të bëhet „personi moral i cili të përkujdeset nëpërmjet avokatëve të mëdhenj të Rumanisë që të marrë 260 mijë verdhushkat, të lëna me testament nga ana e shumë rumunëve maqedonas dhe të cilat përdoren për mirëmbajtjen e shkollave greke në turqi duke mos bërë asnjënjëri asgjë”.

Comitetui makedo-rumun i krijuar në Bukuresht në vitin 1880 dhe i transformuar me ligj nga parlamenti në „person moral” ishte një fiksim dhe u mbyll pasi provokoi, nëpërmjet frikës së dyshimit për invazion të fshatrave rumunë të Turqisë me profesorë dhe agjentë propagande rumune, një invazion me profesorë grekë, të paguar nga qeveria greke dhe komitetet greke, në këto fshatra (nga 2 mësues dhe 2 mësuese). Do të ishte mirë që personi moral i cili ishte Komiteti makedorumun të zëvendësohet nga komisioni i të treve i propozuar tani, duke u evituar në këtë mënyrë korespondenca e shkollave me Ministrinë.

Në mbyllje të kësaj letre, „e fundit e llojit të saj kërkuese” Karaxhiani donte të prezantonte „gjëndjen e punëve të rumunët e Turqisë”, duke bërë një histori të shkurtër të vetëdijes kombëtare dhe kulturore të arumunëve. Dashuria për culture të arumunë është shumë e madhe, për këtë arsye nuk ka më shumë se 10% analfabetë në cda fshat, të gjitha fshatrat kanë shkollat e

tyre. Në Epir, Maqedoni dhe Thesali shkollat më të mira me profesorët më të mire janë shkollat e rumunëve, por ato përdorin gjuhën greke. “Elenizmi në Turqi e mbështesin dhe e kanë mbështetur gjithmonë rumunët, dhe patriotët më të mëdhenj grekë kanë qënë dhe janë rumunë”. Deri sat ë mos nisë lëvizja rumune, patriotizmi I rumunëve të Turqisë ishte shumë I madh, por në kuptimin tradicional, grek. “Prandaj shkollat e para të hapura në Maqedoni ishin si një bombë ashtu për rumunët, si dhe për grekët, dhe kundërshtarët e pare të shkollave rumune ishin rumunët e qytetit”. Persekucionet kundër profesorëve dhe priftërinjve të rumunizuar filluan “si nga ana e rumunëve, ashtu dhe nga ana e priftërinjve, ierarhëve dhe turqve të nxitur nga ierarhët, të cilat janë akoma presidentë në këshillet e rrethit dhe të qyteteve dhe autoritetet turke u janë në dispozicion kur ju thonë se filan person duhet thirur dhe duhet arestuar”. Në mënyrë të vecantë ierarhët grekë i kanë persekutuar vazhdimisht profesorët dhe priftërinjtë rumunë, edhe pasi qeveria osmane autorizoi funksionimin e shkollave dhe kishave rumune. Karaxhiani përshkruan format e persekutimit nga ana e ierarhëve grekë: presione për pengesën e shkollave rumune për të marrë me qera ndërtesa, largimi nga kisha i prindërve të cilët cojnë fëmijët në shkollat rumune duke i konsideruar si romano-katolikë.

Bashkangjitja e Thesalisë i ndau sërish komunitetet arumune në dy kampe: konservatorët e helenizuar dhe nacionalistë rumunë. Sipas një letre të Margaritit të datës 30 maj 1882 shkolla rumune ka bërë progrese shume të mëdha “sidomos në Krushovë, Mulovishte, Vllahoklisurë, Grevena, Mecovo, Lakë dhe ngado vetëm për një vit e gjysëm, aq sa dhe unë cuditem”. Ky progres i rumanizmit i detyrohet sa Apostol Margaritit aq dhe fitorës së Plevnës dhe protestës së delegatëve në Konferencën e Konstandinopojës, nga e cila “ filluan dhe turqit të na konsiderojnë komb të vecantë dhe na pranojnë si antarë në këshilla dhe kanë kërkuar nga Z. Margarit që të rekomandojë nga një rumun si antar i këshilleve shkolllore në Selanik, Bitola, Janinë dhe Prizren, gjë të cilën dhe e bëri”.

DIJETARI NIKOLAE IORGA, LUFTËTAR KONSEKUENT PËR RINGJALLJEN DHE PAVARËSINË E SHQIPËRISË

Dr. Daniela Busha

Instituti i Kërkimeve Historike "Nicolae Iorga"

Me kalimin e kohës, interesi rumunëve për Ballkanin ka qenë konstant dhe, në këtë drejtim, historiografia na jep prova konkluduese të qasjeve në këtë fushë të Bogdan Petriceicu Hasdeut, të V. A. Urechias, të A. D. Xenopolit dhe veçanërisht, të dijetarit Nicolae Iorga, mbështetësit e njohur të popujve të Ballkanit dhe hulumtues të palodhur në drejtim të evidentimit e të drejtave të tyre historike.

Humanist i shkëlqyer, historian me famë ndërkombëtare, anëtar i Akademisë Rumune dhe organeve të tjera të ngjashme në botën e përkushtimit shkencor, profesor në Universitetin e Bukureshtit, themelues, mes tjerash, i *Institutit për Studimin e Evropës Jug-Lindore*, i *Institutit e Studimeve Bizantine*, i *Institutit e Historisë Botërore* ose i *Shkollës rumune në Francë*, redaktor i gazetave dhe revistave të ndryshme, Nicolae Iorga ishte ai që hapi një drejtim të ri hulumtues të historisë së popujve të Ballkanit, me një përmendje të veçantë të popullit shqiptar.

Nga hetimet në arkiva, libra, studime dhe artikuj të specializuar, komunikime në Akademinë Rumune, kurse universitare, konferenca, mbajtur në Athenaeum Rumun ose Salla Dalles në Bukuresht dhe në vend, Nicolae Iorga u dedikua me mirëkuptim dhe dhembshuri historisë së shqiptarëve, duke treguar shumë shpesh padrejtësitë me të cilat shqiptarët u përballen për shkak të pushtimit të huaj dhe luftën e tyre për të afirmuar identitetin e tyre kombëtar.

Në mënyrë që të thelloheshin kërkimet e së kaluarës të popujve të Ballkanit, si dhe gjithnjë e më shumë të dihej se çfarë përfaqëson kjo zona gjeografike edhe nga pikëpamja historike, Nicolae Iorga do të themelonte në vitin 1914, Institutin për Studimin e Evropës Juglindore bashkë me gjeografin Gheorghe Murgoci dhe historianin Vasile Parvan. Si një dëshmi e interesit të veçantë për Shqipërinë, pavarësia e së cilës sapo kishte qenë shpallur, dijetari rumun filloj një seri kursesh në Institutin e ri, me titull *Shqipëria dhe Rumania*. "Një kurs për historinë e Shqipërisë - nënvizonte shkencëtari që në fillim, - nuk është i pazakontë ose befasues këtu, në Bukuresht, ku lidhjet me territorin shqiptar dhe racën që banon në këtë territor dhe që në këtë moment është në gjendje të organizojë një shtet, janë nga lidhjet tona më të vjetëra. I lëmë natyrisht me një anë marrëdhëniet e gjakut që mund të ekzistojnë mes nesh dhe ata; ata, si trashëgimtarë autentikë dhe ekskluzivë, përse i përket pastërtisë së racës, të elementit ilir dhe ne, trashëgimtarë, në këtë anë të Danubit, të elementit trak dhe, përse i përket atyre përtej Danubit, që u përkasin të njëjtit element trak- një pjesë të arumuneve të përzier me një element të fortë ilir. Por, edhe në qoftë se nuk do ishte kjo përzierja rumune mes racës trake dhe racës ilire, lidhjet janë aq të forta se vetë shqiptarët nuk janë pasuesit e ilirëve, duke folur një dialekt ilir, por janë pasardhës të racës ilire, duke folur një gjuhë që rrjedh nga dialekti trak." ²⁰⁰

²⁰⁰ N. Iorga, *Rumania dhe Shqipëria. Leksion mbajtur me rastin e hapjes së Institutit për Studimin e Evropës Jug-Lindore në datën 31 januarie 1915*, Vălenii de Munte, 1915, f. 3-4.

Duke riparë një seri momentesh nga historia e përbashkët të shqiptarëve dhe rumunëve, Iorga thekson rëndësinë e qasjes së tij, si kursi i parë në historinë e Shqipërisë, objektivi i të cilit ishte për të nxjerrë në pah “lidhjet që ekzistojnë mes nesh dhe shqiptarëve gjatë periudhës kur kombësia e tyre dhe e jona ishin fiksuar plotësisht, kur, për këtë arsye, mund të thuhet se ekzistonte një popull shqiptar, megjithëse ai nuk kishte një jetë politike dhe një aktivitet letrar dhe kulturor të tij, ashtu edhe një popull rumun, i cili kishte ditur si të fitonte një jetë politike dhe kulturore vetëm të tij...”²⁰¹. Rrjedhimisht, historiani rumun përfundon: “Lidhjet tona me shqiptarët nuk janë as të reja, as të pakta, as uniforme, por shumë të vjetra, duke filluar para se të ishte specifikuar kombësia njerit ose tjetrit nga këto popuj, janë të vazhdueshme, të larmishme dhe mjaft të rëndësishme edhe për një popull edhe për tjetrin.”²⁰²

Nuk ishte hera e parë që shkencëtari rumun ishte marrë me historinë e këtij kombi. E kishte bërë edhe në vitin 1912 në një libër të titulluar *Rumania, fqinjët e saj dhe qështja e Lindjes*, ku ai shprehu mbështetjen për veprimet e shqiptarëve kundër regjimit të Konstandinopojës që do të çonin në pavarësinë e Shqipërisë një vit më vonë, por edhe në vitin 1913 në historinë e kushtuar popujve ballkanike: “Masat e pamenduara që morën turqit e rinj kundër privilegjeve të vjetra tatimore dhe ushtarake të shqiptarëve - tha Nicolae Iorga - madje edhe kundër alfabetit latin të cilin ata e përdornin prej kohësh dhe tani turqit dëshironin ta zëvendësonin me alfabetin arab, iritoi tani gegët veriorë dhe malësorët katolikë, fqinjët e tyre.”²⁰³. Problemi është diskutuar më në hollësi në punimin e botuar në vitin 1915, *Historia e Luftës Ballkanike* (leksione të mbajtur përsëri në Universitetin e Bukureshtit). Duke iu referuar përpjekjeve të turqive të rinj për të “rivendosur mbretërinë në bindjen e saj të plotë në të gjitha krahinat të varrura prej saj.”²⁰⁴ Iorga beson se ata injorojnë një realitet të rrezikshëm për stabilitetin e perandorisë dhe se “shqiptarët kurrë nuk kanë njohur/pranuar kurrë asnjë urdhër nga qendra dhe as detyrimin absolut që të binden këtyre urdhrave. Ata synonin të ishin zotërinj në tokën e tyre dhe në zakonet e tyre mijëvjeçare.”²⁰⁵. Të njëjtët turq të rinj, të cilët Iorga i akuzonte se “nuk para e njihnin zhvillimin historik”, propozonin futjen e disa “elementeve unifikuese” për të forcuar unitetin e shtetit osman - feja dhe shkrimi arab. Letërsia e re shqiptare, lindur në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ku një rol të rëndësishëm e ka patur shoqëria “Drita” në Bukuresht, e cila ka kontribuar në mënyrë vendimtare, në formimin kulturor të shqiptarëve, ka përdorur alfabetin latin, ndryshe nga veprat letrare, dokumentet dhe korrespondencat e vjetra të cilat përdornin alfabetin grek. Por pikërisht ky “aspekt” dukej “i dyshimtë” në sytë e sunduesve të Konstandinopojës, të cilët dëshironin të impononin shkrimin arab, gjë e papranueshme nga pikëpamja e shqiptarëve. Fakti se “Shqipëria ishte orientuar, nga pikëpamja gjeografike, jo drejt Lindjes, por drejt Perëndimit”²⁰⁶ duhej të ishte i qartë për ata sundues.

²⁰¹ *Ibidem*, f. 4.

²⁰² *Ibidem*, f. 9.

²⁰³ Idem, *Historia e shteteve ballkanike në epokën moderne*, Vălenii de Munte, 1913, f. 362.

²⁰⁴ Idem, *Historia e luftës ballkanike*, Bukureshti, 1915, f. 41.

²⁰⁵ *Ibidem*, f. 42.

²⁰⁶ *Ibidem*, f. 43.

Në *Historia e shteteve të Ballkanit në epokën moderne*, cikë me leksione të mbajtura në Universitetin e Bukureshtit, siç ai vete i quajti, dhe të botuar në vitin 1913 te Vălenii de Munte, Iorga hedh dritë mbi momentet më të rëndësishme të hapësirës dhe insiston në lidhjet e ngushta midis banorëve në veri dhe në jug të Danubit, pavarësisht nga fati që kanë pasur në histori dhe në luftën e përbashkët për emancipimin kombëtar nga sundimi osman. Në versionin francez të kësaj sinteze, botuar një vit më vonë në një përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin dhe për opinionin publik evropian, dhe jo vetëm në historinë e shtetit të ri, Iorga theksonte përmasat dhe rëndësinë e krizës ballkanike 1912-1913 për të ardhmen e popullit shqiptar. Ai deklaroi se në dhjetor 1912 në Konferencën e Londrës fuqitë e kanë njohur pavarësinë e Shqipërisë, duke “hedhur poshtë idenë e krijimit të një krahine shqiptare e varur nga sulltani, ide luftuar nga shqiptarët në kongresin e tyre në Trieste...”²⁰⁷.

Në vitin 1919, një kohë vendimtare për fatin dhe ekzistencën e shtetit shqiptar, Nicolae Iorga botonte edhe një punim tjetër të ri të titulluar *Brève histoire de l'Albanie*. Autoriteti, kompetenca dhe objektiviteti i shkencëtarit e njohur rumun ishin të nevojshme për të informuar edhe njëherë pjesëmarrësit në Konferencën e Paqes në Paris, por edhe publikun e gjerë mbi të drejtat historike të popullit shqiptar. Në sintezën e shkurtër, por shumë bindëse, duke sjellë si argumentë dokumentë me një vlerë të pakontestueshme historike, Iorga mbron në mënyrë shumë bindëse të drejtën e shtetit shqiptar për një ekzistencë të pavarur, pavarësi dhe sovranitet, brenda kufijve të tij. Në fakt, qëllimi i autorit, i deklaruar në Parathënie ishte “për t'i shërbyer çështjes kombëtare dhe drejtësisë me të cilën është e lidhur aq ngushtë, që çdo komb duhet të ketë vendin e tij në jetën materiale dhe shpirtërore e të gjithë njerëzimit, të qytetërimit vetë.”²⁰⁸.

Komunikimet në Akademinë Rumune - një ose dy në muaj - leksionet në Universitetin e Bukureshtit, në Shkollën e Luftës, në Akademinë Tregtare nuk janë veprimtaritë me ndikimin më të madh arsimor që kishte marrë përsipër Nikolae Iorga. Kontakti me një publik më të gjerë dhe më të larmishëm u sigurua nga konferencat në Bukuresht dhe në vend, të mbajtura në mjedise dhe rrethana të ndryshme, por edhe nga konferencat që plotësonin zakonisht udhëtimet e tij vjetore jashtë vendit, duke përfshirë këtu edhe ato që mbante rregullisht në Sorbonne që nga viti 1923. Këto ishin mundësi po aq të mira për të bërë e njohur historinë e rumunëve dhe të popujve të Gadishullit Ballkanik (për shembull, një në prill 1928-ës ishte e kushtuar historisë së Shqipërisë dhe banorëve të saj).

Dëshira e sinqertë për të shtrënguar lidhjet me shqiptarët dhe interesi për thellimin e kërkimeve në fushën e historisë së tyre formuan arsyet kryesore për të themeluar një institut dhe për të ndërtuar një vend, në Sarandë, një vendbanim të bukur në detin Jon, pranë Butrintit, që u bënë publike në konferencën e 7 dhjetorit 1934, në Sallën Dalles, konferencë që kishte titullin *Kërkime historike në Shqipëri*. Konceptuar sipas modelit të Shtëpisë Rumune në Venedik, Instituti do të ishte një vend të rëndësishëm për debate shkencore, për forcimin e lidhjeve me arumunët e Shqipërisë, por edhe një vend pritës për studentët dhe mësuesit nga Rumania, që do të vinin për të studiuar arkivat shqiptare ose gjurmët e kohës së lashtë nëpërmjet gërmimeve arkeologjike. Iorga u përfshi në mënyrë aktive

²⁰⁷ *Historia e shteteve ballkanike në epokën moderne*, f. 371.

²⁰⁸ Idem, *Brève histoire de l'Albanie*, Bucarest, 1919, f. 1.

në pasurimin e bibliotekës së institutit, duke dërguar një numur të madh prej botimeve dhe veprave të rëndësishme personale dhe të autorëve të tjerë, të cilat i kishte blerë me fondet personale në libraritë e Bukureshtit. Për fat të keq, dëshira e shkencëtarit për të bërë një udhëtim në Sarandë dhe të gjallëronte institutin kanë mbetur vetëm një qëllim dhe kjo për arsye objektive.

Shkencëtari Nicolae Iorga, “në vetvete një institucion”, siç karakterizohet nga nipi i tij, Andrei Pipidi, ishte kështu siç dëshironte vetë të ishte: një njeri i aksionit, një njeri i dinamizmit të madh, një prani e përditshme në problemet e qytetit, një mbrojtës i popujve të vogla, sidomos të atyre në Ballkan dhe një mik dhe përkrahës i popullit shqiptar.

REFERIME

Tregtia e jashtme e Rumanisë me vendet e Evropës Jug-Lindore (1878-1914), Shtëpia botuese Oscar, Bukuresht, 2009, f. 227.

Ndryshime territoriale dhe politike në Evropën jug-lindore midis Kongresit të Berlinit dhe Luftës së Parë Botërore (1878-1914), Shtëpia botuese Paideia, Bukuresht, 2003, fq. 321. "Tjetri autentik ". *Bota rumune në letërsinë e udhëtimeve (1800-1850)* (bashkë-autor), Shtëpia botuese Oscar, Bukuresht, 2010, f. 246.

Rumunët dhe gjeopolitika e fuqive të mëdha 1718-1918 (koordinatore dhe bashkë-autore), Shtëpia botuese Oscar, Bukuresht, 2009, f. 305.

Fjalor historik i lokaliteteve nga rrethi Olt. Qytete, Shtëpia botuese Alma, Craiova, 2006-2009 (bashkë-autore), vëllimi 4.

Fryma ideologjike dhe institucionet e shtetit modern- shekujt XVIII-XX. Modeli evropian dhe hapësira rumune (bashkë-autore dhe koordinatore). Shtëpia botuese Oscar, Bukuresht, 2007, f. 326.

Lufta e Krimesë - 150 vjet nga fundi i kësaj lufte (bashkëautor), Shtëpia botuese Istros, Braila, 2006, fq. 322.

Shoqëria rumune midis modernit dhe ekzotikut, e pasqyruar nga udhëtarët e huaj në fillim të shekullit XIX (1800-1847), Shtëpia botuese Oscar, Bukuresht, 2005, f. 400 (bashkëautore)

Qyteti rumun dhe bota rurale. Realitete lokale dhe perceptime e evropjane në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, Shtëpia botuese Istros, Braila, 2004 (bashkëautore), fq. 183.

Udhëtarë rumunë në Perëndim (koordinatorë Nicholas Bocsan dhe Ioan Bolovan), Instituti Kulturor Rumun, Cluj-Napoca, 2004, f. 308 (Daniela Busha - bashkë-autore)

Instaurimi i totalitarizmit komunist në Rumani (23 gusht 1944 - 24 shkurt 1948) Shtëpia botuese Cavallioti, Bukuresht, 1995, botimi i dytë, i rishikuar dhe i plotësuar, Shtëpia botuese Cavallioti Bukuresht, 2002 (bashkëautor), f. 319.

Udhëtarë të huaj rreth vendeve rumune në shekullin e XIX-të, seri e re, vëll. VII (1857 - 1861), Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune, Bukuresht, 2012, fq. 564 (koord. i vëllimit, bashkëautor)

Udhëtarë të huaj rreth vendeve rumune në shekullin e XIX-të, seri e re, vëll. VI (1852-1856), Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune, Bukuresht, 2010, f. 814 (koord. i vëllimit, bashkëautor)

Udhëtarë të huaj rreth vendeve rumune në shekullin e XIX-të, seri e re, vëll. V (1847-1851), Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune, Bukuresht, 2009, f. 752 (koord. i vëllimit, bashkëautor)

Udhëtarë të huaj rreth vendeve rumune në shekullin e XIX-të, seri e re, vëll. IV (1841-1846), Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune, Bukuresht, 2007, f. 724 (koord. i vëllimit, bashkëautor)

Udhëtarë të huaj rreth vendeve rumune në shekullin e XIX-të, seri e re, vëll. III (1831-1840), Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune, Bukuresht, 2006, f. 1020 (redaktorë vol bashkëautor)

Udhëtarë të huaj rreth vendeve rumune në shekullin e XIX-të, seri e re, vëll. II (1822-1830), Shtëpia Botuese e Akademisë Rumune, Bukuresht, 2005, f. 618 (ed. Daniela Busha, Paul Cernovodeanu)

SHQIPËRIA DHE RUMANIA NË LUFTË PËR ÇLIRIMIN E TYRE KOMBËTAR PUSHTIMI TURK I BALLKANIT

Prof. as. dr. Bashkim JAHOLLARI

Departamenti i historisë dhe i gjeografisë
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, UK “Fan S. Noli”

Ballkani, si rajon gjeopolitik dhe kulturor i Evropës Juglindore, ka qenë gjithmonë një urë lidhëse midis kontinentit të vjetër dhe Azisë. Pushtimi i tij nga Perandoria Otomane u fillua prej sulltan Muratit I në vitin 1354 dhe vazhdoi deri me përfundimin e sundimit të sulltan Mehmetit II në vitin 1481. Shkak i zgjatjes për më shumë se një shekull i periudhës së pushtimit të këtij rajoni ishin si karakteristikat gjeografike ashtu edhe ato demografike të tij.

Për shkak të trashëgimisë së hershme historike dhe formimit të saj etniko-fetar, popullsia e këtij rajoni nuk i ndërpreu asnjëherë përpjekjet e saj për t’u çliruar nga Perandoria Turke deri në fund të ekzistencës së saj. Pjesë e këtyre përpjekjeve ishin dhe luftërat për çlirim kombëtar të Rumanisë dhe Shqipërisë.

Të dy këta popuj, të përbashkët midis tyre, kanë ndodhjen në skajet e këtij rajoni të trazuar, në kufijtë e atëhershëm të Perandorisë Otomane. Si rezultat i kësaj pozite, presioni i Turqisë mbi ta ka qenë i hershëm, prandaj populli rumun dhe ai shqiptar ishin ndër të parët që e kundërshtuan zgjedhën turke.

Fillimet e qëndresës së popullit rumun dhe shqiptar kundër pushtimit turk

Që në vitin 1395, princi i Vllahisë, Mircea i Vjetri, me qëndresën e tij antipushtuese, detyroi për herë të parë një sulltan turk, Bajazitin, të kalonte Danubin dhe të ndeshej me të në fushën e Rovinës.

Në shekullin pasues, Janosh Huniadi, i quajtur për shkak të prejardhjes së tij “Kalorësi i Bardhë i Vllahisë”, vojvodë i Transilvanisë dhe mbret regjent i Hungarisë gjatë periudhës 1446-1453, së bashku me Gjergj Kastriot Skënderbeun, prijësin e arbërve, frenuan ekspansionin osman drejt perëndimit dhe mbrojtën kufijtë lindorë të kristianizmit, duke bërë që kjo periudhë të cilësohet si “kundërmësymja e Krishterimit” dhe këta prijës të njihen jo vetëm në Ballkan por më gjerë.

Gjatë kësaj periudhe, në vitin 1459, princ Vladi III i Vllahisë, u bë tmerr i turqve, ndërsa sovrani Stefani i Madh i Moldavisë u rebelua ndaj sulltan Mehmetit II duke mos i paguar haraçin.

Gjatë kësaj periudhe, pas epokës së lavdishme të Skënderbeut (1444-1468), në viset shqiptare pushtuesit osmanë, për të rifituar pozitat e humbura, filluan të ushtronin dhunë e terror të paparë. Nisi periudha e pushtimit të gjatë turk, së cilës popullsia shqiptare iu kundërpërgjigj me kryengritje të herëpashershme. Ecuria e këtyre kryengritjeve, si pjesë e lëvizjes së përgjithshme për çlirim kombëtar të popujve të Ballkanit nga armiku i përbashkët, u ndikua mjaft edhe nga faktorët e jashtëm. Në këtë mënyrë, kur Franca hyri në luftë kundër Turqisë në vitin 1494, kryengritjet shqiptare morën hov. Por, mbas një viti, me heqjen dorë të Francës nga lufta, turqit përfituan për të rritur goditjen kundër shqiptarëve. Po ashtu edhe në vitin 1499, kur në luftë kundër Turqisë hyri Venediku, në viset shqiptare shpërtheu kryengritja. Por, në vitin 1502, si pasojë e disfatave të

pësuara, venedikasit lidhën paqe me Turqinë duke i lënë shqiptarët të vetëm përballë armikut. Pas katër vjetësh, më 1506, turqit pushtuan qytetin e fundit shqiptar, Lezhën, duke i dhënë fund periudhës së luftës çlirimtare antiturke, të filluar nga koha e Skënderbeut. Megjithatë, edhe në periudhën e mëvonshme, qëndresa e armatosur shqiptare kundër sundimitarit të huaj vazhdoi. Tashmë ajo zhvillohej, përgjithësisht, në zonat malore të vendit, duke i hapur probleme jo të vogla Portës së Lartë, e cila, nga ana e saj, përdori forma të ndryshme asimiluese, siç ishte dhe politika e dështuar për islamizimin e shqiptarëve.

Egërsia e pushtimit turk dhe reagimi rumun e shqiptar

Në këtë periudhë synimi i Turqisë ishte shndërrimi i Detit të Zi në një liqen të brendshëm të saj. Për të realizuar këtë synim të saj më 1476 Vllahia, më 1538 Moldavia dhe më 1566 Transilvania u vunë nën dominimin e Portës së Lartë. Megjithatë, për shkak të pozicionit të tyre gjeografik, të ndodhura në kufijtë e perandorive më të mëdha të kohës, principatat Danubiane nuk u bënë kurrë pjesë e kësaj Perandorie. Ato u quajtën “shtete vasale të Portës”, sepse ishin të detyruara t’i paguanin haraç sulltanit, megjithëse ruanin pavarësinë e tyre në të gjitha fushat përveç asaj të jashtme.

Për shkak të pozitës së tyre gjeografike, Principatat Danubiane jo vetëm kanë qenë të përfshira në luftërat e Fuqive të Mëdha me Perandorinë Osmane, por janë bërë dhe vendtakim i kulturave të ndryshme evropiane. Prej këtyre kulturave popujt e kësaj zone, gjatë shekujve morën anë të mira dhe i kombinuan me kulturën tradicionale. Një ndikim të veçantë në ringjalljen shpirtërore kombëtare rumune pati periudha e Rilindjes Evropiane, gjatë së cilës u evokuan rrënjët romake të këtij populli. Në fillim të shekullit XVI, në manastirin e Obodit të Vllahisë filloi punën tipografia e parë e Ballkanit, e cila ishte sjellë nga Venediku. Botimet e saj ishin tekste fetare me germa cirilike; më 1508 u botua meshari dhe më 1512 Ungjilli i parë. Botimi i parë në rumanisht u bë në vitin 1604, ndërsa Bibla e Sherban Kantakuzenit, e vitit 1688, mbahet si përmendorja e parë e gjuhës rumune. Në Transilvani gjatë periudhës 1520-1600, u shtypën 364 libra. Gjurmët e periudhës së Rilindjes janë të dukshme edhe sot, sidomos në arkitekturën dhe stilin e ndërtesave, të kishave, katedraleve dhe manastireve.

Një figurë me mjaft rëndësi për historinë rumune të asaj kohe ishte Mihai Vitezaul ose siç njihet ndryshe Mihail Trimi. Në fillim të shekullit XVII, ky princ mundi të bashkonte, ndonëse për një periudhë të shkurtër, tri Principatat danubiane, duke e bërë mbretërinë e tij pararendëse të shtetit të sotëm rumun.

Gjatë këtij shekulli jeta ekonomiko-shoqërore e principatave ishte nën sundimin e bojarëve, të cilët si zotë të tokës, duke përdorur angarinë e fshatarëve fituan pasuri të mëdha, me të cilat blenë tituj dhe privilegje tek sulltani. Në këtë periudhë, si rezultat i rivaliteteve të hershme klanore, shpërthyen dy luftëra civile në Vllahi dhe ndodhën turbullira të mëdha në Moldavi. Në këto luftëra ndërklanore, një pjesë e bojarëve kërkuar ndihmën e komunitetit grek të Stambollit. Një gjë e tillë u shfrytëzua nga Porta e Lartë për të përforcuar pozitat e veta gjatë periudhës në vazhdim, kur perandoritë austriake dhe ruse po shfaqeshin si rivale kërcënues të saj në Evropë. Gjatë viteve 1711-1821 në drejtimin e Principatave, qëndruan tetëmbëdhjetë princa me prejardhje nga dymbëdhjetë

familje të ndryshme, prej të cilave vetëm dy ishin me origjinë rumune, një ishte shqiptare, ndërsa pjesa tjetër ishin familje greke nga lagja “Fanar” e Stambollit. Në këtë mënyrë kjo pjesë e historisë rumune është cilësuar si “periudha fanariote”.

Në 12 luftërat Ruso-Turke të zhvilluara deri në fund të viteve 1800, Perandoria Ruse synonte, midis të tjerash, zotërimin e Detit të Zi dhe Danubit. Trupat e saj pushtonin herë pas here përkohësisht Principatat, duke u parë nga një pjesë e bojarëve vendas si çlirimtarë, ndërsa nga të tjerët si pushtues. Për shkak të rëndësisë gjeostrategjike, Katerina e Madhe e Rusisë në bisedimet e fshehta me Jozefin II të Austrisë, në vitin 1782, vendosën të bashkonin Moldavinë dhe Vllahinë në një shtet të pavarur, që do të shërbente si zonë e ndërmjetme midis dy perandorive, por kjo nuk u realizua.

Meqenëse situata ndërkombëtare ishte bërë përsëri e favorshme për Shqipërinë, në shekullin XVII, lëvizjet çlirimtare rifilluan me hovin e mëparshëm. Fillimisht u përfitua nga lufta turko-venedikase, për çështjen e Kretës, në vitet '40, ndërsa më vonë nga lufta e Perandorisë Turke kundër koalicionit austro-veneto-polak. Por, meqenëse këto kryengritje ishin të izoluara nga njëra-tjetra dhe pa armatimin e duhur, ato nuk e realizuan dot qëllimin përfundimtar, duke bërë që fundi i shekullit XVII të përmbyllte periudhën gati 200-vjeçare të lëvizjeve çlirimtare shqiptare, kur si vatra kryesore të rezistencës ishin krahinat malore dhe forcë kryesore luftarake u bënë malësorët e krishterë, të udhëhequr nga krerët e kuvendeve lokale.

Shekulli XVIII, vazhdimi i luftërave çlirimtare

Shekulli XVIII, solli ndryshime të mëdha politike jo vetëm brenda Evropës, me revolucionin francez të 1789-1799, por edhe në kolonitë britanike përtej oqeanit, me Luftën Amerikane për Pavarësi, 1775-1783. Nën ndikimin e tyre, në këtë shekull dhe atë në vazhdim, shpërthyen një seri lëvizjesh me karakter demokratiko-liberal, që i dhanë fund sistemit të monarkive absolute dhe koloniale.

Ballkani i kësaj periudhe ishte në një gjendje mjaft të vështirë, për shkak të luftërave që zhvilloheshin në këto territore dhe krizës së përgjithshme që kishte mbërthyer Portën e Lartë.

Në mesin e shekullit XVIII, popullsia e Principatave, e sapoçliruar nga bujkrobëria, ishte thuajse tërësisht fshatare dhe në gjendje të mjeruar ekonomike. Megjithatë, që prej vitit 1774, pas paqes së Portës së Lartë me Rusinë, atje po ndjehej një frymë relative liberalizmi dhe rritje e ndërgjegjes kombëtare rumune, që gjeti shprehje në gazeta të tilla, si “Korrieri i Moldavisë”, ndërsa bojarët e rinj të Bukureshtit, e mbanin veten si pasues të Volterit dhe Rusosë.

Gjatë gjysmës së parë të shekullit XVIII, shndërrimi i pronës shtetërore të tokës në pronën feudale private dhe dobësimi i pushtetit qendror, fuqizoi çifligarët shqiptarë, që u njohën zyrtarisht nga Porta si pari (ajanë). Ata së bashku me çifligarët më të vegjël të grumbulluar rreth tyre, formuan elitën aristokrate feudale shqiptare të kohës, oxhaqet. Të parët e oxhaqeve, pasi fituan grada pashallarësh e vezirësh nga pushteti qendror, të mbështetur më tepër në fuqinë e tyre ekonomike, politike dhe ushtarake, po pushonin dalëngadalë së qeni funksionarë të Stambollit dhe po ktheheshin në qeveritarë gjysmë-autonomë në pronat e tyre të zgjeruara, të njohura si “pashallëqet e mëdha shqiptare”. Numri i këtyre pashallëqeve u rrit sidomos në kohën kur Turqia ishte e zënë me

luftërat kundër Persisë, Austrisë dhe Rusisë, duke hedhur një hap të madh drejt bashkimit politik të vendit, pas atij të shekullit XIV. Ndër pashallëqet e mëdha shqiptare më të rëndësishmit ishin ai i Bushatllinjve në Shkodër, që arriti krijonte të ashtuquajturën “Konfederatë Ilirike” dhe i Ali Pashë Tepelenës në jug, që u bë strehë e eteristëve grekë. Por, megjithatë ato nuk arritën dot të hidhnin hapin e tyre vendimtar, shkëputja nga varësia e Stambollit. Themelet e tyre jo të forta ekonomike, mungesa e unitetit brenda feudalëve shqiptarë, si dhe kushtet jo të favorshme ndërkombëtare, bënë që në fillim të shekullit XIX ato të shtypen me armë nga pushteti qendror otoman.

Nacionalizmi rumun dhe shqiptar, nxitës të lëvizjeve kombëtare

Gjatë shekullit në vijim, ndodhën ndryshimeve të mëdha në Ballkan. “Napoleoni II e quajti shekullin XIX shekulli i nacionalizmit, sepse pikërisht ai- pa të shfaqej ndjenja kombëtare te shumë popuj, për të cilët më parë as që besohej se ekzistonin.”²⁰⁹

Patriotët rumunë, të ndërgjegjësuar për pozitën e favorshme gjeografike të vendit të tyre, në tetor të vitit 1807, me anë të një memorandumit iu drejtuan pikërisht Napoleonit të Francës, për t’i mbështeste në përpjekjet e tyre kundër regjimit të fanarit dhe për krijimin e një shteti të pavarur. Rritja e mëtejshme e ndërgjegjes kombëtare bëri që gjatë viteve 1821 dhe 1848, në Moldavi dhe Vllahi, të shpërthenin kryengritje të cilat, ndonëse dështuan, luajtën një rol të rëndësishëm në përhapjen atje të pikëpamjeve nacional-liberale.

Në këtë periudhë potencialet patriotiko-intelektuale të Ballkanit ishin organizuar në shoqata të ndryshme të fshehta, të cilat synonin organizimin e lëvizjeve çlirimtare. Ndër këto shoqata më e rëndësishmja ishte “Filiki Eteria”, anëtarë të së cilës ishin kryesisht të rinj grekë të Fanarit dhe rusë, me në krye Aleksandër Ipsilantin II, pasardhës i gospodarëve të mëdhenj të Moldavisë dhe Vllahisë, të cilët kishin tentuar të krijonin që në fillim të shekullit “Mbretërinë e Dacisë”. Situata në Principatat ishte aq e favorshme, sa u mendua që kryengritja e përgjithshme e popujve të Krishterë të Ballkanit të fillonte këtu. Më 22 shkurt, 1821, Aleksandër Ipsilanti, në krye të një ushtrie të përbërë nga grekë, serbë dhe bullgarë, pushtoi Jashin kryeqytetin e Moldavisë. Ndërsa, bojari i vogël vllah Tudor Vladimiresku, në krye të një ushtrie fshatare, më 21 mars, hyri në Bukuresht. Të mbetura pa mbështetjen e premtuar të carit, dy ushtritë duke mos i koordinuar veprimet e tyre ju kundërvunë njëra-tjetrës, aq sa Teodor Vladimiresku u vra nga forcat etariste. Në korrik 1821, ushtritë turke rivendosën sundimin e tyre mbi Principatat.

Por, pavarësisht se dështoi, kjo lëvizje pati rëndësinë e saj. Ajo shënoi fundin e regjimit fanariot në këto troje dhe fillimin e të historisë së epokës moderne rumune. Një situatë e tillë, si dhe dobësimi i Portës së Lartë, bëri që Rusia të rriste ndikimin e saj mbi Principatat. Me Konventën e Akermanit, të vitit 1826, mbi ato vendosej kondominiumi ruso-turk, i cili vazhdoi deri në luftën e radhës midis dy perandorive. Pas kësaj, Moldavia dhe Vllahia u pushtuan nga ushtritë e carit dhe u bënë protektorat i Rusisë. Duke përfituar nga fryma liberale që filloi të mbizotëronte në atë periudhë, në këtë periudhë pati një arritje mjaft pozitive, u hartuan kushtetutat përkatëse të

²⁰⁹ L. Skëndo, *Rilindja shqipëtare*, revista "Popujt e Lirë", gusht-shtator 1919.

Principatave, që u quajtën “Rregullore organike”. Ato ishin shprehje e modernizimit të shtetit dhe të shoqërisë rumune.

Pinjollët e borgjezisë së vogël, e cila në këtë periudhë ishte duke lindur, të ndodhur për studime në Perëndim, u ndikuan mjaft nga idetë përparimtare perëndimore. Ata ëndërronin një shtet të bashkuar, të pavarur nga Perandoria Osmane dhe ajo Ruse. Romantizmi i tyre politik, i përhapur në mjediset qytetare, u materializua në programet e shoqërive të fshehta patriotike, më e rëndësishmja nga të cilat ishte shoqëria “Vëllazërimi” e Bukureshtit. Tribunë e ideve përparimtare u bënë e përditshmja “La Romania” e Bukuresht dhe gazeta “Dacia letrare” e Jashit, të cilat së bashku me aktivitete të ndryshme teatrale i shërbyen rritjes së ndërgjegjes kombëtare rumune.

Revolucionit i tretë francez, i shkurtit 1848, ndikoi në rritjen e lëvizjeve nacional-demokratike në mbarë Evropës, aq sa viti në fjalë ka hyrë në histori si Pranvera e Kombeve. “Por, në qoftë se jehona e tij u mirëprit nga tërësia e popujve të Ballkanit, ndikimi u reflektua në shkallë të ndryshme sipas pozitës gjeografike, strukturës sociale, nivelit të zhvillit kulturor të secilit prej tyre. Këtu e ka burimin ndryshimi në kohë i efektit revolucionar gjatë gjithë shekullit XIX.”²¹⁰

Anëtarë të “Qendrës revolucionare rumune”, në Paris, morën pjesë direkt në revolucionin francez dhe menjëherë pas këtij eventi të rëndësishëm, u kthyen në trojet e tyre për ta ndezur situatën atje. Më 27 mars, në Jashi të Moldavisë, një grup të porsa kthyerish nga Parisi, të kryesuar nga Aleksandër Joan Kuza, me anë të një peticioni drejtuar princit, kërkonin reformimin e “Rregulloreve Organike”. Ai, jo vetëm nuk i pranoi këto kërkesa por e shtypi brutalisht këtë lëvizje që zgjati vetëm tre ditë. Në Vllahi, bojarët liberalë nën drejtimin e Nikolae Bableskut, edhe ky pjesëmarrës në Revolucionin e Parisit, më 9 qershor, me anë të një proklamate, kërkonin heqjen e protektoratit të huaj dhe bashkimin e Principatave. Princi, pasi e pranoi Proklamaten abdikoi, duke e lënë qeverisjen në duart e shoqatës “Vllazërimi”. Por kjo situatë nuk vazhdoi shumë, sepse ushtritë e Turqisë dhe të Rusisë e shtypën lëvizjen. Në këtë periudhë edhe popullsia rumune e Transilvanisë, e cila ndodhej në sundimin e Perandorisë Hungareze, po organizohej në mbrojtje të të drejtave të saj kombëtare.

Mundja e Turqisë, në luftën e radhës Ruso-Turke të vitit 1877, solli nënshkrimin më 3 mars 1878, të Traktatit të Shën Stefanit. Me anë të këtij traktati, Ballkani bëhej arenë e realizimit të kompromiseve të shumta territoriale. Por, i vetmi popull që dilte i humbur nga këto kompromiseve ndër ballkanike, ishte populli shqiptar. Shqiptarët jo vetëm ngeleshin si më parë, pa asnjë të drejtë nën sundimin turk, por një pjesë e rëndësishme e territorit të tyre aneksohej nga shtetet e huaja. Më 10 qershor 1878, Kongresi i Berlinit, bëri rishikimin e Traktatit të Shën Stefanit, por pa e ndryshuar situatën për shqiptarët. Në një situatë të tillë, patriotët vendas thirrën një kuvend të madh që ka hyrë në histori si “Lidhja Shqiptare e Prizrenit”, organet e së cilës për tre vjet me radhë u bënë udhëheqëse të çështjes kombëtare për mbrojtjen e tërësisë tokësore dhe bashkimin e vilajeteve shqiptare në një shtet autonom. Me përpjekjet e shumta të patriotëve shqiptarë u bë i mundur realizimi i pjesshëm i synimit të parë, ndërsa autonomia e viseve shqiptare nuk mundi të bëhej dot realitet.

²¹⁰ G. Kastellan, *Historia e Ballkanit*, f. 254.

Në Shqipërinë e kësaj periudhe, pas rënies të Pashallëqeve, nga pushteti qendror perandorak, kishte filluar një periudhë e re centralizuese, e cilësuar si “pushtimi i dytë osman”. Të ashtuquajturat reforma të Tanzimat, të zbatuara nga Turqia, synonin forcimin e pushtetit qendror dhe rimëkëmbjen e Perandorisë të dobësuar nga prapambetja ekonomiko-shoqërore, sistemi shtetëror thellësisht shfrytëzues e parazitare dhe kryengritjet e popujve të shtypur. Por, masat shtrënguese të këtyre reformave rritën si nivelin e pakënaqësisë popullore, ashtu edhe atë të kërërve feudalë. Si rezultat, viset shqiptare u përfshinë nga kryengritje të veçuara, të cilat megjithëse penguan për një farë kohe zbatimin e reformave të Tanzimatit, nuk arritën të shndërrohen në një lëvizje të vetme mbarëkombëtare me program të përbashkët.

Një situatë e tillë kishte krijuar të gjitha kushtet kulturore, ideologjike e politike, që gjatë viteve ’30-’40 të shekullit XIX, të kalohej në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ndër detyrat kryesore të kësaj periudhe me përmbajtje të re historike, ishin lufta për çlirimin e vendit nga pushtuesit turq dhe bashkimi i viseve shqiptare në një shtet të pavarur kombëtar.

Dhjetëvjeçari i fundit të shekullit XIX, solli rritje të tensionet në Ballkan, për shkak të çështjes së autonomisë të Maqedonisë. Në janar 1899, nëpërmjet “Lidhjes së Pejës”, patriotët shqiptarë, u përpoqën ta kthenin lëvizjen e armatosura çlirimtare shqiptare, në luftë për autonominë e vendit. Pikërisht në këtë periudhë ideologu i Rilindjes Shqiptare, Sami Frashëri, nëpërmjet traktatit politik “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”, hodhi idenë e madhe se autonomia shqiptarëve nuk jepej me dëshirë nga Turqia, ajo mund të arrihej vetëm me forcën e armëve.

Pavarësia e Rumanisë dhe Shqipërisë, kurorëzim përpjekjesh të mëdha

Patriotët rumunë, në periudhën e mëvonshme, u përpoqën të shfrytëzonin përplasjen e radhës midis Perandorisë Turke dhe asaj Ruse në Luftën e Krimesë të 1853-1856. Si rezultat i përpjekjeve të tyre politiko-diplomatike, në janar 1859 u arrit krijimi “de facto” i “Principatave të bashkuara”, që përfshinte Vllahinë dhe Moldavinë. Njohja e këtij bashkimi nga Fuqitë e Mëdha dhe Porta e Lartë u bë më vonë, madje jetëgjatësia e tij, sipas fermanit të sulltanit të vitit 1861, kushtëzohej me sundimin e princit Aleksandër Ion Kuza, i cili përdori si simbol flamurin tre ngjyrësh të Mihail Trimit, për të treguar se shteti i pavarur rumun duhej t’i përfshinte të tre Principatat Danubiane. Abdikimi i tij në shkurt 1866, bëri që me ndihmën e Napoleonit III, Asamblea Kombëtare të shpallte mbret të Principatës së Rumanisë Karolin I, një princ gjerman.

Për të zgjidhur problemin e mbetur pezull të pavarësisë, Karolit I, gjatë Luftës Ruso-Turke të viteve 1877-1878, ju desh të radhitej në krah të Rusisë, duke lejuar fillimisht trupat ruse të kalonin në teritorin rumun dhe më pas t’i fuste trupat e veta në luftë direkte përkrah forcave ruse në rrethimin e qytetit Bullgar të Plevenit, ku Turqia u mund.

Në maj 1877, Dhoma e Deputetëve shpalli formalisht pavarësinë e Rumanisë, akt që u miratua më vonë nga fuqitë e mëdha. Tashmë, Rumania nga protektorat i sulltanit u bë shtet i pavarur dhe më 13 mars 1881, ajo u shpall mbretëri konstitucionale.

Në nëntor 1905, krijimi në Manastir i komitetit të fshehtë “Për lirinë e Shqipërisë”, synonte organizimin e lëvizjes për çlirimin e vendit nga zgjedha turke.

Në jug të vendit, nga janari 1906, filluan ngritja e çetave të armatosura patriotike, që do ta luftonin pushtuesin jo vetëm me pushkë, por dhe me penë. Për t'u përmendur në këtë periudhë është lufta e Mashkullorës, e cila jehoi në Shqipëri si thirrje për kryengritje çlirimtare.

Patriotët shqiptarë, duke shfrytëzuar liritë e kufizuara që jepte kushtetuta e re e xhonturqve, formuan në qytete të ndryshme klube që kishin të shpallur kryerjen e veprimtarive kulturore, por që në të vërtetë u bënë qendra të organizimit të lëvizjes kombëtare.

Në maj 1912, në viset shqiptare po fillonte një kryengritje e armatosur, e cila për shkak të pjesëmarrjes, shtrirjes territoriale, fuqisë ushtarake dhe rëndësisë politike, u shndërrua në kryengritje të përgjithshme. Më 8 gusht, qeveria turke i pranoi përgjithësisht kërkesat e kryengritësve, duke i hapur rrugë autonomisë së Shqipërisë.

Në tetor të po atij viti, duke përfutur nga pozita e dobët e Turqisë dhe gjendja e trazuar në Ballkan, Serbia, Mali i Zi dhe Greqia, lanë mënjanë kontradiktat për të formuar aleancën midis tyre dhe filluan Luftën I Ballkanike kundër Turqisë. Forcat ballkanike, pasi thyen keqas trupat e Perandorisë, hynë në territorin shqiptar duke larguar prej tij ato turke. Në këtë situatë, patriotët shqiptarë arritën në përfundimin se Turqia po e humbiste luftën. Pas kësaj, rreziku nga monarkitë ballkanike po bëhej aq i madh sa mendimi i deriatëhershëm i diplomacisë evropiane, që Shqipëria duhej të mjaftohej me autonominë e saj, nuk kishte më vlerë. Në këto kushte patriotët e quajtën të domosdoshëm thirrjen e një kuvendi kombëtar, që do të vendoste për fatet e vendit. Rezoluta e parë e pavarësisë së Shqipërisë u hartua në Bukuresht në vitin 1912. Më 28 Nëntor të po atij viti, Kuvendi Kombëtar, shpalli Shqipërinë shtet të pavarur. Ngritja nga Ismail Qemali e flamurit kuq e zi të Skënderbeut, në Vlorë, dëshmonte për rrënjët e hershme eurokristiane të këtij populli. Me këtë akt u sanksionua e drejta historike e shqiptarëve për të jetuar të lirë e të pavarur krahas popujve të tjerë të Ballkanit.

Fillimi i shekullit XX, solli ndryshime edhe për Rumaninë. Më 1 dhjetor 1914, asaj ju bashkua dhe principata e Transilvanisë, duke i dhënë formën e shtetit kombëtar modern rumun, të Rumanisë së sotme.

Përfundimi i periudhës së lëvizjeve për çlirim kombëtar dhe ndikimet reciproke rumuno-shqiptare

Si rezultat i përpjekjeve mbi pesë shekulle të popullit rumun dhe shqiptar, për çlirimin e tyre kombëtar, u krijuan dy shtete të pavarura: Rumania dhe Shqipëria. Rrugë e gjatë dhe e mundimshme për çlirim e këtyre dy vendeve, të ndodhur në të njëjtën pjesë të Evropës, në gadishullin e Ballkanit, ka bërë që fatet e tyre jo rrallë të ndërthuren.

Në fillim të periudhës së lëvizjeve për çlirim kombëtar princi i Vllahisë Janosh Huniadi, dhe prijësi i shqiptarëve Gjergj Kastriot Skënderbeu, luftuan së bashku për të penguar depërtimin turk në perëndim të Evropës. Më pas, megjithëse për shkak të kushteve specifike social-ekonomike dhe shtet formuese të secilit vend, zhvillimet historike të Rumanisë dhe Shqipërisë u sfazuan disi në kohë, ndikimet reciproke në lëvizjet për çlirim kombëtar të secilit vend kanë qenë të rëndësishme. Ndikim të madh për këtë ka luajtur kolonia e shqiptarëve të Rumanisë e themeluar në vitin 1595 në pjesën perëndimore të Vllahisë, në provincën e Oltenisë. Rreth 15 mijë shqiptarët e larguar nga

trojet e tyre për t'i shpëtuar egërsisë së pushtimit osman, të ndihmuar nga i madh Mihai Vitezaul Trimi, që mbahet si themelues i kësaj kolonie, duke u integruar plotësisht në shoqërinë rumune, gjatë periudhave të mëvonshme historike i shërbyen me besnikëri kësaj shoqërie dhe lanë gjurmë në të. Emra të shquar me prejardhje shqiptare, si Vasile Lupu, i njohur edhe si Vasile Albanezul apo pjesëtarë nga dinastia e Gjikaajve, kanë dhënë kontribut të madh në lëvizjen për çlirim kombëtar rumun. Nga ana tjetër, patriotët e kolonisë shqiptare, të frymëzuar nga lëvizja çlirimtare rumune, u bënë nxitës të ideve nacionaliste dhe udhëheqës të lëvizjes kombëtare, që çoi në bërjen e Shqipërisë shtet të pavarur.

REFERIME

Frashëri, S., *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet*, Bukuresht, 1899.

Dodoni, V., *Memoriet e mia*, Bukuresht, 1930.

Grup autorësh, *Historia e Shqipërisë*, vëllimi II, Tiranë, 1965.

Dermaku, J., *Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe Bullgari*, Prishtinë, 1983.

Castellan, G., *Historia e Ballkanit*, Tiranë.

Frashëri, K., *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tiranë, 1997.

PAVARËSIA E SHQIPËRISË NË DRITËN E DËSHMIVE RUMUNE TË EPOKËS (1912)

Konf. univ. dr. STOICA LASCU

Fakulteti i Historisë dhe Shkencave Politike

Universitatea "Ovidius", Constanța

Historia moderne e pasardhësve të ilirëve të lashtë është përqëndruar, pa dyshim, në krijimin e shtetit shqiptar ideal, që ka udhëhequr shumë breza shqiptarësh, për të cilën u flijuan shumë patriotë dhe që u materializua, simbolikisht, më 28 Nëntor 1912, ku një grup shqiptarësh shpalli lindjen e një shteti të ri evropian.

Por strukturimit institucional të Shqipërisë²¹¹ i është dashur një shtatzënësi e gjatë dhe e ndërlikuar, për shkak të kushteve të veçanta dhe, sidomos, kondicionimit të jashëm e interesave të ndryshme nga Fuqitë e Mëdha në hapësirën gjeopolitike që jetonin, nga kohët historike të vjetra dhe jo pak të rrëmbyera, shqiptarët²¹².

Lindja e Shqipërisë pati një jehonë të gjerë ndërkombëtare²¹³, e nxjerrë në pah si e tillë në historiografinë (shqiptare, evropiane dhe në atë të Amerikës së Veriut), në opinionin publik të kohës

²¹¹ Rreth historisë së Shqipërisë u botuan në gjysmën e dytë të shekullit (më shumë në Perëndim) sinteza të numurta dhe të vyesme – duke filluar nga Kristo Frashëri, *Histoire d'Albanie* (Bref Aperçu), f. e., Tirana, 1964 /373 pp. / (botuar dhe në gjuhën angleze) dhe Nicholas C. Pano, *The People's Republic of Albania*, The Johns Hopkins Press (Series *Integration and Community Building in Eastern Europe*), Baltimore, 1968 (XVI + 186 pp. ; h. /, deri te volumet e vitit jubilar 2012 për historinë e Shqipërisë – Robert Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, I. B. Tauris, London-Neë York, 2012 /480 pp. /; Nicola C. Guy, *The Birth of Albania. Ethnic Nationalism, the Great Poërs of Eorld Ear I and the Emergence of Albanian Independence*, I. B. Tauris, London-Neë York, 2012 /VI + 388 pp. ; il., h. / (dhe pothuajse njëkohshëm – Sic! –, botim në gjuhën shqipe: *Lindja e Shqipërisë, Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Shqipëroi: Krenar Hajdëri, Pegi, Tiranë, 2012 /404 pp. /); Andreas Hemming, Gentiana Kera, Enriketa Pandelejmoni (eds.), *Albania: Family, Society and Culture in the 20th Century*, LIT Verlag (Studies on South-East Europe. Bd. 9), Eien-Berlin, 2012 /224 pp. /; Ndrëim Kulla, *100 vjet pavarësi*, Plejad, Tiranë, 2012 /208 pp. ; il. /; Stoica Lascu, *Independența Albaniei în percepția opiniei publice românești (1912-1914)*, Editura Cetatea de Scaun, Târgoviște, 2012 /508 pp. /; Aleksandër Meksi, *100 vjet pavarësi kombetare*. Album historik, Uegen, Tiranë, 2012 /300 pp. ; il. /; Claudio Omiccioli, *Storia e identità del popolo albanese*, Castel Bolognese (kol. *Al cuore della storia*), Itaca, 2012 /208 pp. /; Sokol Paçukaj, *Albania. Antropografia degli anni '20*. Prefazione di Antonello Biagini, Nuova Cultura, Roma, 2012 /176 pp. /; Roberto Morozzo Della Rocca, *Nazione e religione in Albania*, Besa (kol. *Astrolabio*. Nr. 40), Nardò, 2012 /232 pp. /; Jens Oliver Schmitt, *Die Albaner. Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident*, Beck, München, 2012 /186 pp. /; Alfred Uçi, *Da un secolo all'altro. Cento anni di storia d'Albania visti con gli occhi di un protagonista*. Traduttore: Bani P., Orizzonti Meridionali, Cosenza, 2012 /216 pp. /

²¹² Shiko më shumë – Arben Puto, *Principes nationaux et internationaux dans l'organisation de l'États albanais, 1912-1914*, në „Études balkaniques”, XXIV, no. 1, 1988, pp. 49-59; Fatos Arapi, *Çështja shqiptare dhe kriza ballkanike*, Toena, Tiranë, 2001 /390 pp. /; Kristaq Prifti, *L'Indépendance et l'État Albanais*, në “Acta Studia Albanica, no. 1, 2003, pp. 1-16; e tanishme – Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*. Me parathënie nga Prof. Dr. Nevila Nika, UET Press (kol. *Scripta Manent*. 11), Tiranë, 2012 /254 pp. /.

²¹³ xxx *La crise balkanique de 1908 à 1912 et l'Indépendance de l'Albanie*. Premier colloque historique franco-albanais, Paris, 28-30 octobre 1982 (Institut national des langues et civilisations orientales. Centre d'études des civilisations de l'Europe centrale et du sud-est), Publications Langues'O, Paris, 1982 /86 pp. /; Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe*

duke e mësuar, nëpërmjet shtypit, për ekzistencën e një populli të lashtë dhe të vuajtur shumë në historinë e tij, popull nga zona ballkanike e Turqisë Evropiane, për drejtësinë e idealeve dhe aspiratave të saj kombëtare-territoriale²¹⁴. Por më shumë se në vendet e tjera evropiane – në Rumani, hapat e liderëve shqiptarë dhe lufta rebele e bashkatdhetarëve të tyrë të krishterë apo myslimanë, nuk pati vetëm një jehonë jashtëzakonëshme, por u bë, në një kohë të caktuar, dhe shqetësimet e politikës së jashtme: “Po, është e vërtetë që ne kemi një dashuri të madhe për Shqipërinë – ka theksuar, më 1914, shefi i shtetit rumun – si do të jetë për shembull dashuria midis nunit dhe fjanit”²¹⁵.

Janë ndjenja të nxitura edhe nga ekzistenca në hapësirën shqiptare të qindra e mijëra vëllezër të një gjaku, arumunët – kërcelli meridional i rumunizmit, ruajtje etno – gjuhësore e së cilës ishte e lidhur në atë periudhë, nga krijimi i një shteti demokratik shqiptar, madje dhe si formë konfederate, i tipit zviceran: “Kombi rumun, edhe ai fryt i parimit të kombësisë dhe lirisë, përshëndet përzemërisht principatën e re të Shqipërisë.”. “Me principatën e re, – shkruan një gazetë nga Bukureshti, nga nëntori i 1912, – na bashkon jo vetëm simpatia që vetëm identiteti i ngjarjeve historike i vendosën midis kombeve, madje dhe të ndryshëm, por na lidh një popullatë e madhe

diplomacia e fuqive të mëdha 1912-1914, Tiranë, 8 Nëntori, 1978 /652 pp. / (dhe në fërngrjisht: 1982 /526 pp. /); Nicolae Ciachir, *Contextul european al proclamării independenței de stat a Albaniei (1912)*, në „Revista română de studii internaționale”, XXVI, nr. 3-4, 1992, pp. 229-236; Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2010 /354 pp. ; h. /, pp. 9-231.

²¹⁴ Publikimet kryesore rreth shqiptarëve dhe “çështjes shqiptare”, të njohura në rradhët e opinionit publik evropian, të dala në vitet 1911-1912, janë si në vijim: në rradhë të parë një volum i vlerësuar i M. Edith Durham, *High Albania. A Victorian Traveller's Balkan Odyssey*, apărut în 1911 /352 pp. /, i ribotuar në ditët tona me titullin: *High Albania (Illustrated Edition)*, The Echo Library, Teddington, UK, 2009 /222 pp. /; Oreste Buono, *Rivendicazione della libertà agli Albanesi. Conferenza tenuta nel circolo Garibaldi a Saccia*, Tip. De Pasquali, Licata, 1911 /30 pp. /; Ernest Jäckh, *Im türkischen Kriegslager durch Albanien. Bekenntnisse zur deutsch-türkischen Freundschaft*, Eugene Salzer, Heilbronn, 1911 /142 pp. ; il., h. /; Lovro Mihačević, *Po Albaniji: dojmovi s puta*, Matica hrvatska, Zagreb, 1911 /144 pp. ; h. /; Eqrem Bey Vlora, *Aus Berat und vom Tomor*, D. A. Kaion (Tagebuchblätter Zur Kunde der Balkanhalbinsel I. Reisen und Beobachtungen. 13), Sarajevo, 1911 /168 pp. /; gjithashtu në vitin 1912 – Oreste Buono, *Gli albanesi di fronte ai giovani turchi*, Unione arti grafiche, Aquila degli Abruzzi, 1912 /47 pp. /; Francesco De Rada, *Il movimento albanese nel 1911 e sue vicende*, Stabilimento tipografico moderno, Roma, 1912 /64 pp. /; Émile Legrand, *Bibliographie albanaise, description raisonnée des ouvrages publiés en albanais ou relatifs à l'Albanie, du XVe siècle à l'année 1900*, par... . Oeuvre posthume, complétée et publiée par Henri Guys [Préface par Hubert Pernot], H. Eelter, Paris, 1912 /VIII + 228 pp. ; portr., pl. /; Vico Mantegazza, *Albania. Gli Albanesi. L'Appello all'Europa. Montenegro e Albania. Scutari e il suo lago. Durazzo. Valona e il suo lago. L'Epiro. Gli Avvenimenti recenti. L'Italia e l'Albania. Con 17 illustrazioni e 4 carte*, Bontempelli & Invernizzi Editori, Roma, 1912 /277 pp. ; il., h. /; Antonio Scura, *Gli Albanesi in Italia e i loro canti tradizionali*. Prefazione di A. Julia, F. Tocci, Neë York, 1912 /VIII + 344 pp. ; il. / (i rishtypur në vitin 1979, në Bologna: A. Forli) (në 1913-1914, ritmi i daljes së shkrimeve rreth problemit shqiptar dhe lindjes së shtetit të ri evropian, do të rritet).

²¹⁵ xxx *Regele Carol partizan al păcii în Balcani*. Interview cu Regele Carol. Declarațiile făcute directorului ziarului „Le Matin” [Deklarata të bëra drejtorit të gazetës „Le Matin”], d. St. Lauzanne, në „Dreptatea”, II, nr. 83, 31 mars 1914, p. 3.

arumune e cila, në shekuj dhe me lidhje të ngushta e vëllazërimi, mbajti në supe, së bashku me shqiptarët, zgjedhën e skllavërisë më të rëndë”²¹⁶.

Për udhëheqësit e lëvizjes shqiptare kombëtare, për mijëra shqiptarë që jetojnë në Rumani (afërsisht 25. 000, sipas të dhënave që qarkulluan në shtypin e Bukureshtit) – shteti që ka qenë për ta një atdhe i vërtetë, atëherë kur nuk kishin ende përkrahjen e vendit të lindjes – mbështetjen politike të *Mbretërisë* të udhëhequr nga Karol I, jo vetëm se ishte raportuar, por ishte konsideruar, në kontekstin politik dhe të pëcaktuar që: “Të gjithë shqiptarët i kanë sytë e drejtuara vetëm në këtë komb. Rumania, që në rrethanat aktuale çon një politikë aq të mençur, sa që mendoj që nuk ka për të lejuar askënd të zvogëlojë as edhe me një pëllëmbë territorin e vogël shqiptar. Dhe përveç kësaj, shpresoj gjithashtu – deklaroi, në tetor 1912, një nga themeluesit të shtetit shqiptar, Ismail Qemal Bey –, që do të na ndihmojnë të fitojmë edhe ne autonominë, ashtu siç ka ndihmuar dhe bullgarët në 1878”²¹⁷.

Nga shtetit rumun, me një të kaluar të pasur dhe të çmuar duke u nisur nga pozita e njohur si fuqi rajonale, (por dhe e fuqizuar nga lidhjet familjare midis Shtëpisë Mbretërore në Bukuresht dhe ato qendror-evropiane), “ndihma” ishte politike-diplomatike, madje në disa qarqe të opinionit publik qarkullohej edhe një ndihmë e natyrës ushtarake: “Rumania, e cila është një fuqi e madhe në Ballkan, nuk ka për të lejuar të lëvizet asnjë gur nga vendi i vet. Detyra e Rumanisë është të zgjidhë edhe çështjen shqiptare. Kryengritja shqiptare është një çështje ballkanike dhe në bazë të Marrëveshjes së Paqes nga Bukureshti, lidhja midis çështjes shqiptare dhe Paqes e Bukureshtit është e qartë. Prandaj, Rumania është e obliguar të japë mbështetjen ushtarake sundimtarit shqiptar”²¹⁸.

²¹⁶ xxx *Albania autonomă* [Shqipëria autonome], në “Ordinea”, V, nr. 1. 434, 20 nëntor 1912, p. 1.

²¹⁷ Buri, *Cauza albanezilor. Interviuul nostru cu Ismail Kemal Bey*. -Poporul albanez faqë de evenimentele din Balcani. - Revendicările acestui popor. -Toate privirile albanezilor sunt ațintite la noi. -Un congres la București [Populli shqiptar përballë eventeve në Ballkan – Kërkesat e këtij populli – Të gjitha vështrimet e shqiptarëve janë drejt nesh], në „Seara, III, nr. 997, 23 tetor 1912, p. 3 – material i përfshirë në Stoica Lascu, *Independența Albaniei (28 noiembrie 1912)* – în câteva interviuri contemporane [Pavarësia e Shqipërisë – në disa intervista bashkëkohore], në Silviu Miloju (ed.), *România în relațiile internaționale: diplomație, minorități, istorie. In Honorem Ion Calafeteanu* (Universitatea “Valahia” Târgoviște. Facultatea de Științe Umaniste. Centrul pentru Cercetarea Istoriei Relațiilor Internaționale “Grigore Gafencu”), Editura Cetatea de Scaun, Târgoviște, 2010, pp. 82-83 (janë dhe 16 intervista të tjera të vitit 1912 – fq. 75-104 –, dhe këto të bera rreth problematikës të këtij studimi); recent, Idem, *Contextul internațional al proclamării independenței Albaniei, în urmă cu 100 de ani, în percepția opiniei publice românești, [Konteksti ndërkombëtar i Pavarësisë shqiptare, 100 vjet më parë, në perceptimin e opinionit publik rumun]*, në Marusia Cîrstea, Sorin Liviu Damean (coord.), *Românii în istoria Europei (Rumunët në historinë e Evropës)*, vol. I, Editura Cetatea de Scaun, Târgoviște, 2013, pp. 551-571.

²¹⁸ Vezi – Florin Anghel, *Influente românești în Albania prințului Eilhelm de Eied, 7 martie-3 septembrie 1914* [Influenca rumune në Shqipërinë e princit Eilhelm de Eied], në “Revista istorică”, Serie nouă, V, nr. 5-6, 1994, pp. 487-494 (gjithashtu, një material dokumentar i epokës: [Mircea dela Mare], *Domnia prințului de Eied* [Sundimi i pricit të Eied-it], në “Tribuna albano-română”, I, nr. 3 dhe 4, 1916, pp. 17-21; nr. 5, 15 martie 1916, pp. 9-10; nr. 6, 15 aprilie 1916, pp. 14-17; nr. 7, 1 mai 1916, pp. 10-11; tekst i ripërpunuar në formën e broshurës dy vjet me vonë, kësaj here me firmën e autorit – Teodor Câmpianu (Mircea dela Mare), *Din Albania. Domnia Prințului de Eied* [Sundimi i pricit të Eied-it], Editura autorului. Tipografia “România”, București, 1918 /32 pp. /).

“Midis Danubit dhe Detit të Zi, por dhe midis Deti Egje dhe Adriatik – theksonte, në 1914, një gazetë influente e kohës, me lidhje të forta në qarqet politike nga Viena – mund të ndodhë vetëm çfarë dëshiron Rumania”²¹⁹.

x

Rreshtat e mëposhtëm përbëhen nga një sintezë e problemit e shprehur dhe në titull – ashtu si ajo gjendet në disa nga faqet e shtypit bukureshtian të vitit 1912, viti i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

1. Shqiptarët formojnë në Turqinë Evropiane *elementin më të vjetër etnik* (nenviz.. n.). Para ardhjes së turqve në Evropë, ata u kthyhen të gjithë në të krishterë, por një pjesë e tyr përqafoi më vonë muhamedanizmin. Me gjithë këto ndjenja kombëtare, solidariteti kombëtar nuk u ndërpre për asnjë moment, dhe as aspiratat dhe kërkesat kombëtare. Por ato, mundën të ndaloheshin dhe të prangoseshin për shumë kohë me mënyra të ndryshme, nganjëherë me forcë dhe nganjëherë me korupsion. Metoda e fundit u përdor më shumë nga sulltani Abdul Hamid. Sistemi i tij mbështetej në dhënien ndaj shqiptarëve myslymanë të disa favoreve të veçanta, duke thirrur dhe mbajtur shefat e tyre më influentë në Konstandinopojë, duke u dhënë pozicione të rëndësishme, dhe garda e tij personale, të cilën e mbante më së miri, u krijua me ushtarë shqiptarë. Nga ana tjetër guvernatorët e vilajeteve shqiptare kishin urdhëra formalë, për të mos lejuar në asnjë formë hapjen e shkollave shqipe apo botimin e ndonjë gazete në gjuhën shqipe.

Përsa u përket shqiptarëve të krishterë, ata i ishin lënë propagandës greke “Më mirë grek sesa shqiptar”, kjo ishte parrulla e regjimit hamidian. Qëllimi ishte që tek shqiptarët myslymanë të zëvendësohej ndjenja kombëtare me ndjenjën dhe fanatizmin fetar, ndërsa të krishterët të humbisnin në gjirin e greqizimit. Mund të kujtojmë shumë mirë se në fund të regjimit hamidian as nuk flitej më fare për një çështje shqiptare, aq mirë ky regjim mundi të manovronte kundër këtij kombi.

Por menjëherë pas shpalljes së Kushtetutës, çështja shqiptare u ringjall plotësisht dhe me gjithë fuqinë e saj. Me gjithë besimin, *populli shqiptar kujtoi se erdhi dhe për të dita e shpëtimit, se do të mund të kultivonte të gjitha interesat e veta me liri të plotë, se do të mund të afirmohej si një komb i vecantë*²²⁰.

2. Shqiptarët ndahen në dy fise të mëdha, Toskë dhe Gegë, të cilët në rradhë të tyre kanë nga një nëndarje tjetër, *liapuri dhe şamuri (lËapurë dhe şhamurë)*, duke formuar në këtë mënyrë të katër dialektet të cilat, edhe pse kanë një karakter të përbashkët, formojnë katër grupe me katër idoma të veçanta. Këto katër grupe, në radhën e tyre ndahen në të tjera më të vogla të cilat ndryshojnë sipas lokaliteteve, si: *mirdiçi, malesori, recalii, clementi, castrati, hoti, debreni sau dibrani, pulachiani etc. (mirditorë, malësorë, rekas, klementë, kastratas, hotas, dibranë, pullakjanë etj.*

(.. .)

²¹⁹ xxx *Intervenția M. S. Regelui Carol în favoarea principelui de Eied*. -Un articol al ziarului “Neue Freie Presse” [Ndërhyrja e Mbretit Carol në favor të të princit të Eied-it – Një artikull i gazetës “Neue Freie Presse”], në Minerva”, VI, nr. 1. 973, 15 qershor 1914, p. 5.

²²⁰ Dinu, *Chestiunea albaneză* [Dinu, çështja shqiptare], në “Minerva”, IV, nr. 1. 142, 21 shkurt 1912, p. 3 (letër datuar Konstandinopojë 18 shkurt 1912).

Krenar dhe inteligjent, i singertë dhe i përkushtuar, luftëtar dhe kavalier, por në të njëjtën kohë i zhytur në një mosdije të thellë, populli shqiptar jeton papastërtinë më të zezë: morale, intelektuale dhe ekonomike. Pre e disa supersticioneve antike, të cilat i kanë lënë pas, sidomos, ndjenjën morale, ai copëtohet vëlla me vëlla më keq se bishat e egra.

Ja pra portretin e trishtë të popullit trim shqiptar në prag të shekullit të njëzetë!²²¹ Me gjithë këto, në mes të furtunave të të gjitha llojeve, nëpër të cilat ka kaluar ky popull përgjatë shekujve, asgjë nuk mundi që ai të humbte gjuhën dhe vetëdijen e tij kombëtare. Në Itali, Greqi si dhe në të gjitha provincat turke ku e hodhi fati, jo vetëm që nuk u asimilua, por ruajti me krenari vetëdijen e identitetit të tij kombëtar. *Unë jam shqiptar!*, të përgjigjet me krenari dhe këtë krenari për emrin shqiptar nuk mundi t’ia rrëmbejë as fama e emrit turk, të cilin ushtria turke e çoi deri në muret e Vjenës.

T’i thuash një shqiptari që është turk, sepse atdheu i tij është përfshirë në perandorinë turke, *do të thotë ta fyesh*, t’i kujtosh poshtërimin të cilin ia dha fati i pamëshirshëm. Por kjo vetëdije kombëtare tek shqiptarët është shumë më instiktive; është më shumë prodhimi i shpirtit, sesa rezultati i një brengje intelektuale, e cila mund të manifestohet me një lëvizje për solidaritet etnik.

Në kohët më pas, *filloi të çmpihej ndjenja kombëtare*, sigurisht jo në masën e popullit shqiptar, por në individualitete të dëshpëruara të cilat, nëpërmjet rrethanave të ndryshme, mundën të hynin në kontakt me kulturën dhe qytetërimin perëndimor. Kjo ndjenjë kombëtare u manifestua veçanërisht te shqiptarët toskë. Qoftë fakti, që kanë jetuar në kontakt më të shpeshtë me rumunët²²², qendrat e të cilëve lulëzonin qysh kur ishin nën Ali Pashë Tepelenën, qoftë se në cilësinë e tyre si pastore zbrisnin për të dimëruar deri në Greqi, toskët prej kohësh ishin të fashinuar nga kultura moderne. Por fatkeqësisht, kultura e tyre, e marrë në gjuhën turke dhe në mënyrë të njëanshme, në qoftë se mund të ishte e dobishme për statutin dhe gërmat turke, nuk i solli përfitime të mëdha gjuhës dhe kombit shqiptar.²²³

3. Të krishterët shqiptarë u ndanë në ortodoksë dhe katolikë. Ata janë superiorë në të gjitha raportet myslymanëve.

²²¹ Një panoramë e qytetërimit shqiptar nga kohët më të vjetra deri në Luftën e Dytë Botërore – Kristo Frashëri, *Historia e qytetërimit shqiptar (Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore)* (Akademia e Shkencave), f. e., Tiranë, 2008 /364 pp. /; si dhe dy sinteza të “kohëve” osmane në historinë e popullit shqiptar – Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare*, UET Press, Tiranë, 2009 /468 pp. /; Nuray Bozbora, *Osmanlı Yonetiminde Arnavutluk Ve Arnavut Ulusculugu’nun Gelisimi*, Boyut Kitaplar, Istanbul, 1997 /304 pp. / (e shtypur dhe në gjuhën shqipe: *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. Përktheu nga origjinali në turqisht: Dritan Egro, Dituria, Tiranë, 2002 /280 pp. /); një mikrosintezë e situatës së shqiptarëve “shekulli i gjatë” i XIX-të – George E. Gaërych, *Tolerant Dimensions Of Cultural Pluralism in the Ottoman Empire. The Albanian Community, 1800–1912*, në „International Journal of Middle East Studies”, XV, 1983, pp. 519-536; de asemenea – Ian Ėhitaker, *Tribal Structure and National Politic in Albania, 1910-1950*, në I. M. Leëis (ed.), *History and Social Anthropology*, Tavistock, London, 1968, pp. 253-293; kohët e fundit – Siegfried Gruber, *Household and Family in Albania at the Beginning of the 20th century*, në Andreas Hemming, Gentiana Kera, Enriketa Pandejmonj (eds.), *op. cit.*, pp. 19-34.

²²² *Recte* – rrămăni/aromăni [rëmënet/arumunët].

²²³ C. S. Constante, *Albania și albanezii* [Shqipëria dhe Shqiptarët], në „Lucafařul”, XI, nr. 31, 29 qershor 1912, pp. 670-676.

Shqiptarët ortodoksë nuk ndiejnë fare *shqip* dhe identifikohen në aspiratat e tyre politike me grekët. Ata u afirmuan si grekë në rrethanat aktuale dhe antagonizmi midis tyre dhe shqiptarëve myslymanë është i hidhur. Këta shqiptarë ortodoksë, të ndarë në komunitete, kanë fonde të mëdha dhe mbajnë institucione filantropike dhe kulturore në të gjitha qendrat e Shqipërisë si përsëmbull: Korça, Gjirokastra, Delvina, Berat, Përmet etj. Ata kishin dhe një deputet të tyre, përkrah atyre 24 grek, të cilët i konsiderojnë të tyre.

Shqiptarët katolikë të cilët, edhe pse kanë shkollat dhe kishat e tyre, në të cilat përdoret gjuha shqipe, nuk mund të jenë solidarë me shqiptarët myslymanë, sepse sipas mendimit të tyre kryqi nuk mund të ketë të njëjtin ideal politik me gjysmehenezën.

Shqiptarët katolikë janë nën protektoratin austriak, në virtytin e këtij protektorati kanë të drejtë të ndërhyjnë në punët e brendshme të Turqisë.

Nga ky ndryshim idesh dhe aspiratash rezultoi dhe në të tashmen antagonizmi midis shqiptarëve myslymanë dhe të krishterë.

Kush nuk e di që ky antagonizëm ishte fatal për shqiptarët në vitin 1821, në pavarësinë e Greqisë! Kush nuk e di që luftat epike të bëra në Sul, ku u dalluan më shumë shqiptarët me heroizmin e tyre, që hynë në historinë e regjenerimit të Greqisë, me emërtimin “martirët e bukura”, u kryen nga shqiptarët ortodoksë kundër shqiptarëve myslymanë!

(.. .)

Që ta mbyllim, themi që të gjitha konsideratat politike na bëjnë të mos besojmë në mundësinë e një autonomie në Shqipëri, dhe më pak në Maqedoni dhe Epir, sepse në aparençë të gjithë janë drejtuar për dhënien e autonomive në favor të kombësive në Turqi, *por në realitet që të zmadhojnë territoret e tyre në dëfavor të Perandorisë Osmane*. Politikanët ballkanikë gabohen kur mendojnë nëpërmjet një lufte kolektive kundër Turqisë mund të përfitojnë diçka. Jo. Shkencërisht është catkuar se e gjitha nuk mund të hyjë në një pjesë të saj. Suksesi i tyre nuk mund të jetë tjetër përveçse të heqin gështenjat nga zjarri për të tjerët.

4. Maqedonia nuk është si Shqipëria, një territor me një unitet etnik dhe për këtë arsye kombësitë në Maqedoni prodhojnë konfuzion. Shumë grekë, bullgarë, kucovllahë mund të shqiptarizohen lehtë ose të konsiderohen si qytetarë në një shtet shqiptar, atëherë kur një shtet i tillë do të jetë i mundur.

Në qoftë se shikojmë ato që ndodhin në Lindje, në qoftë se kemi parasysh tendencat më të qarta dhe eventualitetet më të mundshme dhe në qoftë se do të dallonim një politikë rumune, do të arrinim në këto përfundime.

Rumania, në situatën e saj ka nevojë për një politikë të vendosur, paqësore dhe parashikuese. Të mos lejojmë asnjë fuqizim në dëmin tonë, duke pasur parasysh një të ardhme hipotetike.

Kur një shtet Ballkanik do të zmadhohej prej një marrje territori të Maqedonisë, të mos kënaqemi me sigurimin e një neutraliteti mirëdashës për ndodhitë e mëpasme.

Do të mashtroheshim përgjithmonë, kjo është e gjitha.

Ne duhet të parashikojmë dhe të parandalojmë.

Për momentin besojmë se Turqia do të dalë nga kriza në të cilën ndodhet. Por mund të ndodhë që Turqia, për disa arsye të brendshme dhe historike, të vazhdojë të dobësohet. Në këtë rast, interesi

ynë kërkon ngritjen e Shqipërisë dhe ekzistenca e saj si shtet ballkanik. Shqipëria e martuar, në një rast ekstrem me Maqedoninë, do të jetë një domosdoshmëri dhe në të njëjtën kohë ky shtet do të jetë një realitet historik dhe jo një trillim diplomatik²²⁴.

5. Shqipëria është një provincë e Turqisë me një popullatë prej 1.800.000 banorësh, por Shqipëria reale është shumë më e madhe dhe shtrihet deri atje ku jetojnë grupe kompakte shqiptarësh. Kjo Shqipëri etnografike përfshin, përveç Shqipërisë gjeografike dhe vilajetet rumeliote Kosovë, Selanik, Manastir. Me këtë pretendim, i cili mund të duket i ekzagjeruar, shqiptarët nuk donin të ishin më pak “kryelartë” se antagonistët e tyre, grekët të cilët konsiderojnë se Gadishulli Ballkanik është helen dhe kërkojnë, rrjedhimisht përkrah Epirit, Maqedonisë dhe Konstandinopojën; bullgarët të cilët kërkojnë një Bullgari të madhe; serbët, të cilët aspirojnë rikthimin e perandorisë së Dushanit; malazezët, të cilët duan të shtrihen deri në Shkodër.

Ne na kanë pëlqyer dhe na pëlqejnë shqiptarët (subl. n.), por, kjo nuk na ndalon të pranojmë, se ata janë tepër të prapambetur për t’u vetëqeverisur; janë më të prapambetur se kombet e tjera nën Turqinë në raport kulturor, shoqëror dhe politik²²⁵.

6. Përveç interesave të Austrisë dhe Italisë²²⁶, një Shqipëri e pavarur shfaqet që tani, si një kusht për stabilitet dhe ekuilibër në ndërtimin e ri të popujve ballkanikë.

Për ne rumunët, çështja shqiptare paraqet një interes të jashtëzakonshëm (subl. n.).

Më shumë se 100. 000 kuco-vllehë të shpërndarë thellësisht në malet e këtij rajoni, bëjnë së bashku me shqiptarët një jetë të përbashkët dhe patriarkale e karakterizuar nga harmonia më perfekte. Të dyja kombet, të vetëdijshme për prejardhjen e tyre të përzgjedhur, kanë qenë elementet më të vlefshme të Perandorisë Osmane. Midis tyre dhe botës sllave ka një humnerë.

Bashkëkombësit tanë arumunë, në hipotezën e një Shqipërie autonome, do të bënin përparime të mëdha nën dritën e zgjimit kombëtar. Marrëveshja shqiptaro-rumune, aleanca midis këtyre dy racave, ka qenë objekt i vështrimit dhe preukopimit të shumë nacionalistëve shqiptarë dhe rumunë prej shumë kohësh.

Për këtë arsye llogarisim se pikëvështrimi i Aleancës së Trefishtë në lidhje me dëshirat e mëdha serbe për Shqipërinë, përbën një nga çështjet mbi të cilat Rumania duhet të japë një vëmendje të veçantë²²⁷.

7. Në qoftë se nuk do të ishte vetëm e shkuara e përbashkët e arumunëve me shqiptarët²²⁸, lidhjet gjuhësore, aspiratat e njëjta përt të ardhmen, përsëri do të kishte mjaftueshëm arsye që sot

²²⁴ Gabriel Giurgea, *Interesele României în Balcani*. Nevoia unei Albanii independente, în cazul desmembrării Turciei [Novoja e një Shqipërie të pavarur, në rastin e copimit turk], në “Voința națională”, XXVIII, nr. 8. 099, 18 gusht 1912, p. 1.

²²⁵ N. Tacit, *Neamul albanizesc*. De la frații noștri de peste hotare [Nga vllëzërit tanë larg], në „Ilustrațiunea națională”, I, /f. nr. /, shtator 1912, p. 15.

²²⁶ Shiko në kontekst – Ennio Maserati, *Momenti della questione adriatica (1896-1914). Albania e Montenegro tra Austria ed Italia*, Del Bianco Editore (kol. *Civiltà del Risorgimento*. No 19), Udine, 1981 /176 pp. /; Alessandro Duce, *L’Albania nei rapporti italo-austriaci (1897-1913)* (Università delle studi di Parma), 1897-1913, Giuffrè, Milano, 1983 /380 pp. /; Fehari Ramadani, *Rivaliteti midis Austro-Hungarisë dhe Italisë për çështjen shqiptare (fundi i shek. XIX- fillimi i shek. XX)*, në “Universitas” /Tetovë/, 2008, pp. 7-24.

²²⁷ xxx *Prima deziluzie a coaliției. O Albanie autonomă*, në “Ordinea”, V, nr. 1. 418, 31 tetor 1912, p. 1.

arumunët dhe shqiptarët të jenë bashkë përballë reziqeve të përbashkëta, përballë shpërbërjes që ju përgatisin shtetet e krishtera ballkanike, në të ashtuquajturën luftën për crobëzim që bëjnë në Turqi.

Ashti si dhe thashë, vetëm arumunët, pasarshtësit trima të legionarëve romakë dhe shqiptarët pasarshtësit krenarë të trako-ilirëve, ju detyruan me forcë pushtuesve të Gadishullit Ballkanik, respektin ndaj vendbanimeve të tyre shekullore.

(.. .)

Nuk do të duhet vallë, në këto momente transformimi të Turqisë, që ata të cilët mbajnë në duart e tyre dhe udhëheqin fatin e kombit rumun të *mbështesin me gjithë forcë aspiratat legjitime të arumunëve dhe shqiptarëve, për tu formuar në një shtet të pavarur* (subl. n.), dhe të mos gllabërohen nga sllavët dhe grekët?²²⁹

8. (.. .)

Pushtimi, qysh prej kohërave më të vjetra, i një pjese të konsiderueshme të teritorit të ballkanik nga ana e popullit shqiptar, është një fakt historik dhe gjeografik i cili është i pamundur të mos kihet parasysh, në qoftë se dikush do të deshte që çështja e Lindjes të merte një zgjidhje të arsyeshme dhe të qëndrueshme nga pikpamja politike.

Është e qartë se Fuqitë e Mëdha, të cilat janë të lidhura midis tyre me konventa dhe traktate përsa i përket Lindjes dhe kanë atje interesa të mëdha, kanë të drejtën dhe detyrimin të ndërhyjnë për të rregulluar konfliktin aktual, aq më tepër që ky rregullim prek pika të së drejtës ndërkombëtare zbatimin e së cilës nuk mund ta neglizhojë asnjë nga këto Fuqi të Mëdha. Së fundmi pjesa njerëzore e kësaj çështjeje nuk mund ti lerë indiferentë. Në qoftë se është e drejtë që sukcesi i armëve i ofron fituesit disa privilegje, e drejta për pushtim, në vetvete, nuk parashikon të gjitha të drejtat e tjera. Të gjithë popujt që jetojnë në Gadishullin Ballkanik kanë në mënyrë të barabartë të drejtën për të ekzistuar dhe gjithsecilit duhet ti krijohen kushtet për një ekzistencë. Populli shqiptar, i njohur për lufrat e bëra në të gjitha kohërat, në të tashmen dhe në të shkuarën, për pavarësinë dhe rruajtjen e integritetit të tij, ka bindjen se meriton respektin e qeverive evropiane dhe se meriton të jetojë.

Për këtë arsye, deklarojmë se populli shqiptar nuk do të pranojë asnjë modifikim statu-quo teritorial në Turqinë e Evropës i cili do të kishte natyrë të sillte dëme të drejtave të tij.

Nuk do të lejojë asnjë ndërhyrje nga ana e shteteve ballkanike në administrimin e shtetit i cili i përkët si trashëgimi nga gjyshërit.

Ai do të mbajë zakonet e veta, të zhvillohet nga ana shoqërore dhe plotike dhe të ngelet sundimtar i fatit të vet.

²²⁸ Shiko – Gelcu Maksutovici, *Aromânii și albanezii – o soartă comună în Balcani* [Arumunët dhe shqiptarët – një fat i përbashkët në Ballkan], në “Anuar «Albanezul»”. 404. *Supliment al revistei “Albanezul”*, 1999, pp. 76-78; Idem, *Românii, aromânii și Independența Albaniei* (Rumunët, arumunët dhe Indpendenca e Shqipërisë). Duke e përforcuar kombin shqiptar, Rumania e përforcon vetveten ngase fati i kombiut rumun dhe kombit shqiptar është përjetë i përbashkët” (Dr. Shunda), në „Albanezul. Shqiptari”, Serie nouă (1993), XIII, nr. 118, 2007. *Ediție specială*, pp. 1-2.

²²⁹ Per. Papahagi, *Aromânii și albanezii*. Greșeli politice de neiertat [Arumunët dhe shqiptarët. Gabime politike të pafalshme], në “Săptămâna politică și culturală”, II, nr. 48, 3 nëntor 1912, pp. 580-582.

Dashamirës për të dhënë kontribut në progresin universal dhe të rruajë vendin e vet krahas popujve të qytetëruar ai kërkon me këmbëngulje nga Fuqitë e mëdha që ti garantohet ekzistenca e vet historike dhe politike.

(Vazhdojnë firmat.)

Apeli u paraqit dje mbasdite nga një komision i përbërë nga tre veta, nën presidencën e ish-guvernatorit Biruth Halil Paşa, ambasadave të Gjermanisë, Francës, Italisë, Austrisë, Anglisë dhe Legacionit Rumun. Një kopje ju drejtua dhe Portës së Lartë²³⁰.

9. Me të vërtetë, këto dy shtete të mëdha, prej kohësh kanë drejtuar vështirimet drejt Shqipërisë.

Italia ka shpenzuar shuma shumë të mëdha për të mbajtur shkolla dhe manastire në brigjet e Adriatikut, me shpresën se, në qoftë se nuk do të mund të merrte një pjesë të këtyre territoreve, të ruante influencën politike dhe një dalje të rëndësishme (subl. n.). Për të njëjten arsye, në të shkuarën fitimtarja e Tripolitanes mbajti një lëvizje iredentiste në Shqipëri duke dërguar armë, municione dhe lek.

Në të njëjtën mënyrë ka vepruar për disa dhjetëvjeçarë dhe Austro-Hungaria²³¹. *Shkollat dhe manastiret Austro-Hungareze mbahen me shpenzime të mëdha në këto anë të egra të Turqisë, pa asnjë arsye tjetër veçse politike dhe ekonomike (subl. n.)*²³². E dimë të gjithë, pa qenë nevoja për rikujtim, sa ndihma financiare dhe sa armë janë dërguar nga Austria në Shqipëri. Thuhet – dhe nuk kemi asnjë motiv që të mos besojmë – se të gjitha armët dhe municionet me të cilat shqiptarët rezistojnë kundër sërbeve dhe grekëve dhe me të cilat në të shkuarën luftonin kundër Turqisë, janë të dërguara nga Austria.

Dhe në qoftë se është ashtu, këto dy shtete nuk do të pranojnë kurrë ndarjen e Shqipërisë. Duke u vepruar kështu Shqipëria do shpëtonte nga influenza e Italisë dhe Austrisë Făcându-se.

²³⁰ *Apelul poporului albanez către Marile Puteri.* -Pretinsul complot contra guvernului. -Isprăvile grecilor la Salonic (*De la corespondentul nostru special*) [Apeli i popullit shqiptar drejt fuqive të mëdha], në „Universul”, XXX, nr. 309, 9 nëntor 1912, p. 3 (*corespondență datuar Konstantinopojë, 6 nëntor*).

²³¹ Rreth politikës Austro-Hungareze në „ceshtja shqiptare” dhe roli i saj në krijimin e shtetit shqiptar – Annelise Ėernicke, *Theodor Anton Ippen. Ein österreichischer Diplomat und Albanienforscher*, Harrassowitz (*Albanische Forschungen*. 7), München-Ėiesbaden, 1967 /148 pp. ; il., h. /; komunitetet tribale në veri të Shqipërisë janë studjuar në përmbajtjen e raporteve dhe punimeve me karkater shkencor të konsujve austro-hungarezë– Fatos Baxhaku, Karl Kaser, *Die Stammesgesellschaften Nordalbanien. Berichte und Forschungen österreichischer Konsuln und Gelehrter (1861-1917)*, Böhlau, Ėien, 1996 /460 pp. ; il., tab. /; Fehari Ramadani, *Qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj çështjes shqiptare gjatë vitit 1912*, në „Studime Albanologjike” /Tetovë- Shkup [Skopje]/, nr. 1, 2009, pp. 45-61; Idem, *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare 1900-1912*, Ars-za, Tetovë, 2010 /302 pp. ; il. /; Eqrem Zenelaj, *Çështja Shqiptare nga këndvështrimi i diplomacisë dhe i gjeopolitikës Austro-Hungareze (1699-1918): kultprotektorati dhe administrimi ushtarak i Austro-Hungarisë në Shqipëri*, Shtëpia Botuese Faik Konica, Prishtinë, 2010 /744 pp. ; il., h. /; kohët e fundit – Elena Kocaqi Levanti, *Si e krijoi Austro-Hungaria shtetin shqiptar*, Emal, Tiranë, 2012 /322 pp. /; Annelise Ėernicke, *Teodor Ippen dhe Shqipëria në fokusin e Perandorisë Austro-Hungareze*. Shqipëroi: Eridan Imami, Plejad, Tiranë, 2012 /226 pp. /.

²³² Më gjërë – Isa Blumi, *Austrian Strategies in Ottoman Albania. The School and the Fall of Sectarian Politics*, în Marlene Kurz, Martin Scheutz, Karl Vocelka, Thomas Ėinkelbauer (Hrsg.), *Das Osmanische Reich und die Habsburgermonarchie in der Neuzeit*. Akten des internationalen Kongresses zum 150-jährigen Bestehen des Instituts für Österreichische Geschichtsforschung, Ėien, 22. -25. September 2004 (Mitteilungen des Instituts für Österreichische Geschichtsforschung. Ergänzungsband 49), Oldenbourg Ėissenschaftsverlag, Ėien-München, 2005, pp. 595-611.

Në qoftë se dhe në të ardhmen këto do të dëshirojnë “të punojnë” në brigjet e Shqipërisë, do të hasin protestat e Serbisë dhe Greqisë, të cilat pa dysahim nesër do të jenë më efikase se sot, duke u fuqizuar më tepër pas lufte, dhe shumë më energjike se ato të Turqisë, e cila mund të themi se as nuk interesohej se çfarë ndodhte në këtë vilajet të largët.

Në kushte të tilla, Italia dhe Austria, të cilat punojnë në mirëkuptim perfekt në këtë drejtim, nuk mund të pranojnë përveçse një nga të dyja: ose Shqipëria të deklarohet principatë e pavarur, ose të ngelet në vazhdim vilajet turk. Dhe, meqënëse varianti i dytë nuk mund të ndodhë në qoftë se Turqia do të mundet plotësisht, me siguri që do të faktohet pavarësia e Shqipërisë.

Por prej këtu lind një seri e tërë vëstimesh politike dhe diplomatike. Realizimit të kësaj ideje i kundërvihen radhë së pari shtet ballkanike, të interesuara drejtpërdrejt për këtë çështje, dhe më pas shtetet e mëdha evropiane, *të cilat mbështesin politikën dhe dëshirat e shteteve të vogla ballkanike, në drejtim të përmbushjes së interesave të veta imediate ose atyre në të ardhme.* (subl. n.).

Duke pasqaruar parasysh këto, të gjithë i përfshijnë një frikë e përgjithshme jashtëballkanike. Thuhet se Austria është e vendosur të kundërshtojë me forcë të armatosur çdo tentativë copëtimi apo ndarjeje të Shqipërisë. Atëherë Rusia do t’u vinte në ndihmë të shteteve ballkanike dhe më pas Gjermania në ndihmë të Austrisë, Franca në ndihmë të Rusisë dhe kështu me radhë sipas lidhjeve evropiane.

Guxojmë të besojmë se kjo frikë është e parakohshme. Në rast konflikti, do të vendosej sërish lufta, ashtu si u vendos deri tani dhe ajo ballkanike. Një konflikt evropian do të thotë një seri të tërë fatkeqësish, një kataklizmë e vërtetë ekonomike. Grindjet dhe rivalitetet për Shqipërinë nuk kanë në bazë një ideal kombëtar, si ishte ai i luftës për çlirimin e Italisë, bashkimin e Gjermanisë apo çrëbërimit të krishterëve nga sundimi i turk.

Në Shqipëri, çdo shtet ka për të ruajtur interesa materiale, dhe në qoftë se këto interesa do të ishin më të vogla sesa sakrificat që duhen bërë për ti ruajtur ato, të jemim të sigurt se llogaria tregtare do të pengojë luftën²³³.

10. (.. .)

Autonomia e Shqipërisë

Vlorë. -Ismail Qemal Bej i cili u shpall presidenti i qeverisë së përkohëshme të Shqipërisë autonome, dërgoi këtë telegram ministrit të Punëve të Jashtme të Bullgarisë në Sofje.

Nxitoj t’i ve në dije Shkëlqesisë Suajë një fakt me rëndësi të jashtëzakonshme për jetesën kombëtare të shqiptarëve.

Delegatë nga të gjitha trojet shqiptare pa dallim feje të mbledhur sot në mbledhjen e përgjithëshme në qytetin e Vlorës, shpallën pavarësinë e Shqipërisë, dhe krijuan një qeveri të përkohëshme.

Shqiptarët përgëzohen që mund të hyjnë në familjen e popujve të Gadishullit Ballkanik, si vllazërit më të mëdhenj të tyre në bazë të origjinës.

Duke mos pasur asnjë qëllim tjetër veçse të jetojmë në paqe me shtetet e tjera fqinje, shqiptarët shpresojnë se qeveria e përkohëshme do të njihet nga qeveria bullgare, se çdo akt i dhunshëm nga

²³³ Br., *Chestiunea albaneză* (Çështja shqiptare), në “Seara”, III, nr. 1. 016, 11 nëntor 1912, p. 1.

ana e ushtrisë bullgare në tokën kombëtare shqiptare do të ndalojë, dhe se të gjitha teritoret shqiptare të pushtuara aktualisht nga ushtritë aleate do ti kthehen Shqipërisë.

(ss) *Ismail Qemal Bej*, president i qeverisë shqiptare²³⁴

11. Telegramet e ditëve të fundit na sollën lajmin e gëzueshëm se delegatët e popullit trim shqiptar, të mbledhur në Vlorë, shpallën, në mesin e një entuziazmi të papërshkrueshëm, pavarësinë e shtetit të tyre, ku e krijua dhe një qeveri e përkohshme nën presidencën e Ismail Qemalit Beut, ndërsa flamuri kombëtar pas aq shumë shekujsh shprese dhe lufte arriti së fundmi të valëvitet në të gjitha ndërtesat publike të principatës së re.

Aktet zyrtara të ndërmarra nga qeveria e re dhe njoftimet e bëra drejt Fuqive të Mëdha, nuk lënë asnjë dyshim rreth realitetit të ngjarjes.

Një Shqipëri autonome në situatën aktuale të Turqisë merr një kuptim të veçantë: është një fillim i zgjidhjes së vështirësive Ballkanike.

E gjendur midis Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë, Shqipëria do t'u shërbejë si tampon dëshirave sunduese të aleatëve. Me krijimin e kësaj principate të re, shënohen qartësisht deri diku do të shtrihen kufijtë dhe uritë e mbretërive të krishtere, të paktën në këtë pjesë të gadishullit. Përveç kësaj, sillet një lehtësim i konsiderueshëm i konfliktit serbo-austriak. Falë Shqipërisë, serbët do të kenë tani e tutje dy rrugë akses në Adriatik: ose të kuptohen me malazezët për një port përfundimtar të hekurudhës të cilën e projektojnë, ose bien dakord me shqiptarët. Në të dyja rastet, akses në Adriatik nuk mund të përmbajë përveçse interesa tregtare. Në këmbim, perspektiva e një Serbie, e cila me një pushtim të pjesshëm të Shqipërisë, të arrijë në Adriatik dhe nga pikpamja politiko-strategjike, duket e humbur, në qoftë se Shqipëria autonome do të njihet.

Shanset e njohjes definitive e principatit të ri nga ana e Fuqive të Mëdha janë të konsiderueshme. Së pari në raport me të drejtën e kombeve, Shqipëria justifikon ekzistencën në bazë të principit të kombësive, princip mbi të cilin u ngrit dhe lufta e saj kundër Turqisë. Shqipëria banohet në pjesën më të madhe nga shqiptarë, ortodoksë, katolikë dhe muhamedinë; më pas vijnë kuco-vllehët dhe në radhë të tretë dhe të pakët radhiten serbë, bullgarë dhe grekë. Nga pikëpamja historike, shqiptarët janë banorët më të vjetër të Gadishullit Ballkanik. Pushtimet helene, romane dhe sllave i kanë gjetur prej kohësh banues të trojeve të cilat i kanë sot. Gjuha e tyre është e ndërtuar në një bazë trake e pasur me fjalë latine, italiane turke dhe sllave. Karakteri mbizotërues të kombit e përbën zjarri i pavarësisë dhe krenarisë. Nga ai kanë dalë Aleksandri dhe Gjergj Kastrioti, dhe shumë të tjerë, të gjithë njerëz të së njëjtit gjak dhe gen. Një poezi e shëndetëshme ju ngjyros shpirtin dhe vlerat, ndërsa këngët e tyre të kujtojnë ato të Homerit, i cili si dhe Akili, përzejnë ritmin, këngën, vallzimin dhe luftën. Për aq kohë sa ishin nën sundimin e idesë fetare, gjeniu i tyre i la të pavendosur midis kryqit dhe gjysmëhënës, duke përzjerë doktrinat dhe duke kaluar nga një besim te tjetri. Por, sapo ndjenja kombëtare zëvendësoi atë fetare, i shikojmë duke punuar për bashkimin kombëtar, i cili sot është realizuar.

(.. .) Kombi rumun, dhe ai frut i principit të kombësisë dhe lirisë, përshëndet nga thellësia e zemrës principatën e re të Shqipërisë.²³⁵

²³⁴ xxx *Autonomia Albaniei a devenit act oficial* [Autronomi e Shqipërisë u bë akt zyrtar], në "Epoca", XVIII, nr. 318, 18 nëntor 1912, p. 1.

Me principatën e re na bashkojnë jo vetëm simpatitë, të cilat identiteti i ngjarjeve historike i cakton dhe midis popujsh qoftë edhe të ndryshëm, por na lidh dhe popullata e madhe arumune, e cila prej kohësh dhe me lidhje të forta vllazërore, ka hequr së bashku me shqiptarët, barrën më të rëndë të robërisë. Dihet se i gjithë rajoni i Myzeqesë është kolonizuar me makedo-rumunë agrikultorë. Në Janinë dhe Berat, kanë nga një shkollë 9 vjeçare; Në Vlorë ku u shpall pavarësia, në Korçë dhe Elbasan kemi shkolla fillore.

Aq lidhje sa na kanë krijuar në mënyrë të pathyeshme dhimbjet e së shkuarës, na jep garancinë që elementi rumun do të ketë një rol parësor në shtetin e ri shqiptar, ndërsa bashkëkombasit tanë, të mbrojtur nga gara heleno-sllave, do të gëzohen në mbajtjen paqësore të gjuhës dhe vendbanimeve të tyre kulturore²³⁶.

12. Pas luftës rumuno-ruso-turke të vitit 1877, vetëdija kombëtare te shqiptarët manifestohet me një fuqi të jashtëzakonshme.

Duke parë se Kongresi i Berlinit nuk mori në konsideratë kërkesat e tyre, shqiptarët krijojnë Lidhjen e Prizrenit dhe fillojnë luftën kundër turqve të cilët i kanë përndjekur prej dy vjetësh.

Prej atëhere, vetëdija kombëtare e popullit shqiptar shpërthen sa vjen dhe me më shumë forcë.

Filluan të mendohen te një kulturë shqiptare, e cila t'ju forcojë rruajtjen e kombësisë, bënë një alfabet origjinal, botuan abetaret e para shqip dhe bënë të mundur botimin e revistës mujore “Bessa” në Konstandinopojë. Në vitin 1881, komiteti i shpërndarjes së kulturës shqiptare në radhët e

²³⁵ Shiko në kontekst– Gelcu Maksutovici, *La solidarité du peuple roumain avec la lutte du peuple albanais pour l'indépendance (1877-1912)*, në “Revue des études sud-est européennes”, XV, no. 4, 1977, pp. 737-750; Idem, *România independentă și independența Albaniei (1877-1912)*, në “Muzeul Național”, IV, 1978, pp. 615-619; Gheorghe Zbucnea, *România și nașterea statului albanez* [Rumania dhe lindja e shtetit shqiptar], în “Albanezul”, Serie nouă, IV, nr. 5 (34), maj 1996, pp. 1, 7; nr. 6 (35), qershor 1996, p. 2 (dhe në „Anuar «Albanezul»”. 401. Supliment al revistei “Albanezul”, 1996, pp. 57-67); Ismet Dermaku, *Contribuția poporului și a statului român la mișcarea națională națională albaneză* [Kontributa e popullit dhe shtetit rumun në lëvizjen kombëtare shqiptare], në Ibidem, pp. 95-98; Rudolf Dinu, Ion Bulei, *Italia, România și chestiunea albaneză* [Italia, Rumania dhe çështja shqiptare] (1913-1914), në Constantin Hlihor (koord.), *Structuri politice în secolul XX* [Struktura politike në shekullin XX] /pe coperta I: *O viață închinată istoriei Constantin Bușe* [Një jetë e përkushtuar historisë]/ (Universitatea București. Centrul pentru Studiul Istoriei Secolului XX), Editura Curtea Veche, București, 2000, pp. 124-154; Gelcu Maksutovici, *România și independența Albaniei* [Rumania dhe pavarësia e Shqipërisë], në “Magazin istoric”, Serie nouă, XXXVI, nr. 12 (430), dhjetor 2002, pp. 81-83; Ionuț Nistor, *România, problema aromână și crearea statului albanez* [Rumania, problemi arumun dhe krijimi i shtetit shqiptar] (1912-1913), në Lucian Leuștean, Petronel Zahariuc, Dan Constantin Măță (ed.), “*In honorem Ioan Ciupercă*. Studii de istorie a relațiilor internaționale, Universității “Alexandru Ioan Cuza”, Iași, 2007, pp. 97-123; George Ungureanu, *România și crearea Albaniei moderne* [Rumania dhe krijimi i Shqipërisë moderne], në “Orizont XXI”, III, nr. 9, 2008, pp. 13-17; Stoica Lascu, *The Independence of Albania. In the Light of Vintage Romanian Testimonials (1912-1914)*, në “Annals of the Academy of Romanian Scientists. Series on History and Archeology”, Vol. 3, No. 3, 2011, pp. 7-32 (numurohen 167 referime bibliografike, në periudhën 21 shkurt 1912 - 21 shtator 1914); gjithashtu – Theodor Capidan, *Contribuția românilor la renașterea Albaniei* [Kontributa e rumunëve në rilindjen e Shqipërisë], në “Graiu românesc”, II, nr. 1, 1928, pp. 4-11; Ion C. Grădișteanu, *O pagină de istorie contemporană: România și începuturile deșteptărei naționale albaneze* [Një faqe historie bashkëkohore: Rumania dhe fillimet e rilindjes shqiptare], në “Almanachul aromânesc «Frăția»”. 1928, pp. 18-24.

²³⁶ xxx *Albania autonomă*, në “Ordinea”, V, nr. 1. 434, 20 nëntor 1912, p. 1.

shqiptarëve të terrorizuar nga turqit u detyrua të zhvendoste Selinë në Bukuresht, ku dhe u botuan libra mësimorë, broshura libra të cilat u shpërndanë në mijëra kopje në gjithë Shqipërinë.

Një influencë të madhe te populli shqiptar e pati broshura e poetit *Sami bej Frashëri* e quajtur *Shqipëria, ç'ka qenë ç'është dhe ç'do të jetë*²³⁷.

Kjo broshurë tregon domosdoshmërinë e ekzistencës së një shteti shqiptar të pavarur.

Po në të njëjtën kohë del gazeta: “Shqipëria”, “Sqiptari”, “Besa”, “Shqipënisë”, “Drita”, “Rilindja e Shqipërisë” etj.

Me ardhjen e regjimit të Turqëve të Rinj, shqiptarët të cilët nën sundimin e Abdul Hamid morën shumë të drejta dhe gëzonin favore në ushtri dhe detyrat publike, fillojnë të shtypen²³⁸. Urdhërohet carmatimi i plotë i shqiptarëve, ndaj të cilët këta të fundit përgjigjen me revolucion. Ata luftuan me heroizëm kundër ushtrive turke dhe një nga arsyet e Turqëve të Rinj ishte dhe ostiliteti i elementit shqiptar.

Popull energjik, me vjetërsi prtej mijra vjetësh në Evropë, duke rruajtur gjuhën dhe traditat, shqiptarët do të kenë së shpejti shtetin e tyre²³⁹.

13. Ngjarjet në Gadushillin Ballkanik patën aftësinë jo vetëm të kthejnë në fakt idealet kombëtare etopike të popujve të vegjël greko-sllavë, por dhe të ndryshojnë në mënyrë radikale mentalitetin e diplomacisë evropiane (subl. n.), e cila ishte e paaftë të evitonte luftën e tanishme.

Me të vërtetë, për inat të diplomacisë evropiane, sot është e propozuar një perandori sa e famshme, sa dhe e madhe dhe në rrënojat e saj ngrihen me krenari shtete, të cilat para dy muajsh nuk mund të guxonin as për të imagjinuar se do të fitonin, jo më t'i mundnin turqit në të gjitha frontet. Kush do të besonte ndonjëherë se bullgarët do të arrinin, vetëm në dy javë, përpara mureve të qytetit të Konstandinit, serbët në Usküb dhe Manastir dhe grekët (grekët e Domokos) të pushtonin Selanikun, pa hasur as edhe një rezistencë.

²³⁷ Është fjala për punimin-manifest *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhetë? Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga rreziket që e kanë rrethuarë* (= Albania – ce a fost, ce este și ce va fi? Gânduri despre salvarea patriei de pericolele care o pândesc), dalë në Bukuresht në vitin 1899 (autorui nuk përmënde); nuk i përket poetit kombëtar të Shqiptar (1846-1900), por vëllait të tij – jo më pak i njojturi si militant nacional-culturor shqiptar, në *Rilindja Kombëtare*, Sami Frashëri (1850-1904) (în 1913, ea a apărut și în limba germană: Sami Bey Frascheri, *Ëas ëar Albanien, ëas ist es, ëas ëird es ëerden? Gedanken und Betrachtungen über die unser geheiligtes Vaterland Albanien bedrohenden Gefahren und deren Abëendung*. Aus dem Türkischen übersetzt von A. Traxler, A. Hölder, Eien-Leipzig, 1913 /70 pp. /); rreth tij, shih – Bülent Bilmez, *Sami Frashëri or Şemseddin Sami? Mythologization of an Ottoman intellectual in the modern Turkish and socialist Albanian historiographies based on „selective perception”*, në „Balcanologie”, VII, no. 2, décembre 2003, pp. 19-46. [En ligne], mis en ligne le 19 février 2009. URL: <http://balkanologie.revues.org/index492.html>. Consulté le 13 janvier 2011; Nathalie Clayer, *Aux origines du nationalisme albanais. La naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe*, Éditions Karthala (kol. Recherches internationales), Paris, 2007 (kohët e fundit është përkëthyer dhe në gjuhën shqipe: *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*. Shqipëroi: Artan Puto, Përpjekja, Tiranë, 2012 /696 pp. /), pp. 272-284: *Shemseddin Sami Frashëri ou l'apparition d'un albanisme musulman?*; Robert Elsie, op. cit., pp. 153-154.

²³⁸ Më gjerë – Nathalie Clayer, op. cit., pp. 259-271: *La politique hamidienne “envers les Albanais” et la construction d'une image externe*.

²³⁹ Un albanez, *Independența Albaniei* [Një shqiptar, *Pavarësia e Shqipërisë*], në “Dimineața”, IX, nr. 3. 137, 26 nëntor 1912, p. 1.

Mundja e turqve i detyrohet, përveçse arsyeve të dukshme të një kombi të vjetëruar dhe të rënë, përhapjes së trupave nga përballjet me bullgarët dhe grekët si dhe neutralitetit të Rumanisë.

(.. .) Në qofte se Qamil Pasha²⁴⁰ do të shpallte autonominë e Shqipërisë dhe do të dekretonte reformat e propozuara nga Berchtold në Maqedoni, sot Turqia nuk do të ishte ulur aq sa të kërkonte paqen në Sofje dhe të kërcënohej me ekzistencën e saj si shtet, jo vetëm në Evropë, por dhe në Azi.

Por, ne, *shqiptarët dhe maqedonasit, kemi disa shpresa se do t'i shpëtojmë të padëmtuar coptimeve ballkanike* (subl. n.). Shpresojmë që, në një konferencë evropiane, e cila do të rregullonte përgjithmonë situatën e provincave të Maqedonisë, Epirit dhe Shqipërisë, diplomacia Rumune do të dijë të na sigurojë të drejtën për të jetuar në të ardhmen si komb i veçantë dhe me të njëjtat të drejta si popujt e tjerë të kombit të përbashkët.

(.. .) Ismail Qemal Beu, në cilësinë e tij të kryetarit të qeverisë, iu njoftoi shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë jo vetëm kabineteve të Evropës, por dhe atyre të Beogradit, Athinës Sofjes dhe Cetinjes, duke kërkuar njohjen zyrtare të Shqipërisë si shtet i pavarur në Ballkan²⁴¹.

(.. .) Shteti i ri shqiptar përbën pengesën më të madhe për ndarjen e plaçkës së luftës midis ballkanikëve.

Ata të Athinës nga njëra ane dhe ata të Beogradit nga ana tjetër, trumbetojnë *urbi et orbi* në dokumentat publicitarë të jashtme, që të krijojnë në radhët e opinionit publik evropian idenë që elementi shqiptar nuk ekziston si komb. Por e vërteta është se Shqipëria etnografike përfshin dhe teritorët e pushtuara nga bullgarët dhe grekët dhe popullata e tyre është 805 shqiptare, do të pakësonte pretendimet e grekëve dhe sërbeve, dhe kjo në limitet e principit të paraqitur prej tyre: “Balkani i ballkanikëve”.

Në qoftë se ky princip do të aplikohet në mënyre rigorozë, atëherë do të thoshte se dhe Maqedonia t’u ngelej maqedonasve dhe tani në koalicion, duke qënë se serbët dhe grekët në mënyrë të veçantë janë minoritetet në atdheun e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë²⁴², pushtimi i tyre i përkohshëm do të ngelet një ëndërr, në të cilën të krishterët kanë qënë viktimat e persekutimeve më burracake të të ashtuquajturve kryqëzues²⁴³.

²⁴⁰ Bëht fjalë për Vezirin e Madh Mehmed Qamil Pasha, i cili ka jetuar midis viteve 1833 dhe 1913 (ka qënë Vezir i Madh katër herë: 25 shtator 1885-4 shtator 1891; 2 tetor-7 nëntor 1895; 5 gusht 1908-4 shtator 1909; 29 tetor 1912-23 janar 1913).

²⁴¹ Shiko më gjërë – Afërdita Tafaj, *Diplomacia e Ismail Qemalit*, Shtëpia Botuese „Luarasi”, Tiranë, 1999 /110 pp. /; Gjon Keka, *Shqiptarët në prizin e diplomacisë ndërkombëtare*, Botart, Tiranë, 2011 /130 pp. /; kohët e fundit – Ilir Ikonimi, *Pavarësia, udhëtimi i paharrueshëm i Ismail Qemalit*, UET Press, Tiranë, 2012 /290 pp. /.

²⁴² “Pour ce qui est de la Macédoine, elle (harta e Shqipërisë e vitit 1912, e cila ilustron materialin e gjërë dokumentar respektiv – n. n.) ne correspond à rien: ce n’est pas le royaume ancien d’Alexandre-le-Grand, et il n’existe pas un peuple macédonien proprement dit, mais bien une conglomération de plusieurs peuples, amalgamés de telle façon, qu’aucune division territoriale ethnique n’est possible d’une façon absolue” – J. B. /Jules Brun/, *Albanie et Macédoine*, në “L’Écho des Balkans”, I, no. 1, 25 Nëntor 1912, p. 5.

²⁴³ N. Tacit, *Independența Albaniei* (Realizarea tuturor idealurilor utopice ale micilor popoare din Balcani) [Pavarësia e Shqipërisë (Realizimi i të gjitha idealeve utopike i popujve të vegjël të Ballkanit)], në “Ilustrațiunea națională”, I, nëntor 1912, p. 9.

14. Fuqitë e mëdha ranë dakort me krijimin e një shteti të ri në Gadishullin Ballkanik, Shqipërinë. Kështu ndërkohë që një perandori dikur krenare shuhet me gjak dhe tym plumbash, Konferenca e Londrës²⁴⁴ krijon bazat e një shteti të ri²⁴⁵ i cili, ku i dihet!, mund të bëhet i madh dhe i fuqishëm, më i fuqishëm se sa duan Fuqitë e Medha²⁴⁶.

Evropa, aq kokëfortë kur vjen fjala për t'u kuptuar atëhere kur flitet për shqirtin e drejtësisë të cilin predikon kultura e saj, bëri kësaj here një gjest drejtësie të lartë duke ofruar autonominë një populli i cili prej dhjetra vjetësh lufton për lirinë e tij.

(.. .) Realizimi i idealit shqiptar është triumfi i drejtësisë, principi i barazisë së të drejtave të kombeve të Gadishullit Ballkanik, në emër të së cilit filloi lufta kundër Turqisë. Shqiptarët, kanë, në virtytin e të drejtës historike, të drejtën për autonominë të cilën e morën në Konferencën e Ambasadorëve. Ata gjendet në trojet të cilat popullohen tani nga elementi autokton, ndërsa serbët dhe bullgarët erdhën këtu gjatë kohës së pushtimit osman.

Në Prizren dhe Prishtinë, të cilat kërkohen nga Serbia, jetojnë më shumë se 500. 000 shqiptarë dhe vetëm 230. 000 serbë dhe 171. 000 bullgarë. Popullata e vilajetit Skutari ka 68% shqiptarë dhe vilajeti i Janinës më shumë se 60%.

Në trojet e banuara me shqiptarë, jetojnë dhe shumë arumunë, të cilët kanë të drejtën të shprehin për më shumë drejtësi dhe për një të drejtë më të plotë për zhvillim në një shtet autonom shqiptar se sa nën dominimin brutal të grekëve ose nën pushtimin e interesuar të serbëve apo bullgarëve²⁴⁷.

²⁴⁴ Për këtë, midis të tjerave – Raymond Poincaré, *Lufta e parë dhe e dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913)*. Përkth. : Shaqir Shehu, Logos-a, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2006 /532 pp. /; Necdet Hayta, *Balkan savařlarının diplomatik boyutu ve Londra büyükkelçiler konferansı: (17 Aralık 1912-11 Ağustos 1913)*, Atatürk Araştırma Merkezi (*Dil ve Tarih Yüksek Kurumu*), Ankara, 2008 /VI + 174 pp. ; il., h. /; Claudiu Lucian Topor, *România și Conferința ambasadurilor de la Londra (decembrie 1912-august 1913)* [Rumania dhe Konferenca e Abasadorëve në Londër], në “Analele Universității din Craiova. Seria Istorie”, XIV, nr. 1 (15), 2009, pp. 201-211; Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926..*, pp. 218-227: *Traktati i fshehtë i Londrës*; de asemenea – Daniel Cain, *Un trimis al Majestății Sale. Nicolae Mișu*, Editura Anima, București, 2007, pp. 96-104.

²⁴⁵ Shiko dy sinteza të gjëra dokumentare në lidhja me evolucionin politik dhe institucional të shtetit të ri evropian, në – Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*. Organizimi shtetëror, jeta politike, ngjarjet kryesore, të gjithë ligjëvënësit, ministrat dhe kryetarët e shtetit shqiptar, Shtëpia botuese 55, Tiranë, 2006 /956 pp. /; Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë, Toena, 2009 /742 pp. /.

²⁴⁶ “Fuqitë njohën në datën 20 dhjetor Shqipërinë e pavarur, duke hedhur poshtë idenë, të kundërshtuar dhe nga shqiptarët në Kongresin e Triestes, për krijimin e një province shqiptare nën atributet e Sulltanit, por çështja e territoreve të saj të jashtme, – sespe Kuptimi i Trefishtë dëshironte ti ngushtonte në një brez të bregdetit Adriatik, - ishte aq e vështirë sa që vetëm në qershor, pasi ndodhën shumë gjëra te tjera, mundi të zgjidhej” – N. Iorga, *Istoria statelor balcanice în epoca modernă*. Lecții ținute la Universitatea din București de [Historia e shteteve Ballkanike në epokën moderne. Leksion i mbajtur në Universitetin e Bukureshtit]. Tipografia “Neamul Românesc”, Văleni-de-Munte, 1913, p. 371.

²⁴⁷ Shiko – Ionuț Nistor, “*Problema aromână*” în raporturile României cu statele balcanice [“*Problemi arumun*” në raportet e Rumanisë me shtetet ballkanike] (1903-1913), Editura Universității “Alexandru Ioan Cuza” (kol. *Historica*), Iași, 2009: cap. V. 2. *România, “problema aromână” și crearea statului albanez* [“*Problemi Arumun*” dhe krijimi i shtetit shqipatr] (1912-1913), pp. 248-270.

Pikërisht për këtë, autonomia e Shqipërisë do të pritët, veçanërisht te ne, me një kënaqësi të madhe dhe me një shpresë të padyshtuar dhe besim te shteti i ri shqiptar²⁴⁸.

15. Duket e vendosur se do të kemi një shtet shqiptar si rezultat i bisedimeve në Londër midis ambasadorëve të Evropës. Më vonë, pasi çështje të tjera të zgjidhen, sipas fituesve apo kundër tyre, do të bëhet fjalë, sipas përlllogaritjeve të historianëve dhe gjeografëve, persona të cilët kanë një rol në këtë drejtim në vendet e tyre, për shtrirjen e kësaj Shqipërie, autonome apo sovraane.

Në qoftë se nuk do të merremi atëhere me qartësinë, diplomatike ose ushtarake, të kompesimeve të sotshme ose të nesërme – sepse në të tilla raste është e vështirë deri sa të nisësh -, në këtë moment Rumania mund të flasë, duke përdorur të gjitha aleancat me të cilat është e lidhur,²⁴⁹ pa rezultat deri tani, si të gjitha mirësitë që i ofrohen – mund të themi se çfarë i mbledhet në shpirt²⁵⁰.

16. (...)

Rumania dhe Shqipëria

Për momentin e gjithë bota politike është e preokupuar me mbledhjen e ambasadorëve. Rreth kësaj konference bëhen hipoteza të të gjitha llojeve dhe shumë lloje parashikimesh. Në lidhje me këtë Konferencë dhe me propozimet të cilat do të bëjë Rumania, një telegram i dërguar nga Beogradi dhe i botuar në shumë gazeta te ne na njofton se Rumania *kërkon që Shqipëria autonome të përfshijë dhe ato territore të Turqisë në të cilat jetojnë arumunët dhe se nuk do të kënaqet me rregullimin e kufirit shqiptar, përveçse atij që do të zgjidhej nga një komision ndërkombëtar në bazë të principit të kombësive* (subl. n.). Natyrshëm që një lajm i tillë bëri bujë në qarqet politike serbe, sidomos dhe nga përhapja e fjalës se ky pretendim nuk u influencua nga politika austro-hungareze.

Më parë duhet të largojmë fajësimin se Austria *do të përdorte këtë rast për të bërë intriga*. (subl.). Sado miqësore të ishin midis atyre dy popujsh, asnjë nuk mund të mendojë se njëri influencohet nga tjetri kur vjen fjala për një princip kombëtar dhe patriotik. Secili mendohet më parë për veten dhe Rumania nuk ka nevojë për këshillën e askujt kur vjen fjala për t'u orientuar në jetën e saj kombëtare si shtet kombëtar dhe i pavarur. Në rrethanat e tanishme, kur lidhjet midis Serbisë dhe Austrisë nuk janë nga më sjellëset e paqes, është normale që Serbia të shohë në çdo lëvizjen tonë një influencë të perandorisë fqinje. Por ne nuk mund të anashkalojmë një dyshim të

²⁴⁸ M. Sărățeanu, *Un imperiu apune, un stat nou răsare*. Albania autonomă [Perëndon një perandori, lind një shtet i ri. Shqipëria e pavarur], në "Dimineața", IX, nr. 3. 155, 14 decembrie 1912, p. 1.

²⁴⁹ Vezi, pe larg, trei valoroase abordări ale istoriografiei române de astăzi – Gheorghe Zbucnea, *România și războaiele balcanice* [Rumania dhe luftrat ballkanike] 1912-1913. Pagini de istorie sud-est europeană [Faqe historie jug/lindor evropiane], Editura Albatros, București, 1999 /458 pp. /; Claudiu-Lucian Topor, *Germania, România și războaiele balcanice* [Gjermania, Rumania dhe luftrat ballkanike] (1912-1913), Editura Universității "Alexandru Ioan Cuza" (kol. *Historica*), Iași, 2008 /324 pp. /; Nicu Pohoată, *Politica externă a României în timpul războaielor balcanice* [Politika e jashtme rumune gjatë luftrave ballkanike] (1912-1913). *România și grupările politico-militare ale Marilor Puteri* [Rumania dhe grupimet politiko-ushtarake të Fuqive të Mëdha], Pro Universitaria, București, 2010 /334 pp. ; il. /.

²⁵⁰ N. Iorga, *Românii și statul albanez. Încă o ocazie care va fi pierdută* [Rumunët dhe shteti shqiptar. Dhe një rast tjetër i cili do të humbasë], në "Minerva", IV, nr. 1. 438, 15 dhjetor 1912, p. 1.

tillë, por e kundërshtojmë që të tregojmë se pretendimet tona janë “tonat” dhe i bëjmë në virtytin e interesave dhe në virtytin e principeve të cilat populli srb i njeh mirë²⁵¹.

17. (. . .)

Territoritoret e kërkuara

Duke ngritur zërin në emër të popullit shqiptar, të cilin qeveria jonë e përkohshme e përfqëson në tërësinë e tij, nuk mundemi t’u diktojmë Fuqive të Mëdha limitin e linjës të cilën do të ndjekin. I vetëdijshëm për të drejtat e tij dhe i udhëhequr nga shqetësimi për të ndihmuar kancelaritë e nderuara evropiane që të realizojnë një vepër të shëndetshme dhe të qëndrueshme, populli shqiptar inspirohet nga nevojat lokale dhe nga ndjenjat e popujve me të cilët fqinjësohet në Ballkan, për të deklaruar se paqja dhe qetësia e gadishullit nuk do të arrihen përveç me kushtin e dhënies së një konfigurimi homogjen Shqipërisë së ardhshme. Prandaj, populli shqiptar kërkon për Shqipërinë kufijtë e natyrshëm të cilët i detyrohen sa me kushtet etnike, aq dhe me të drejtën e pushtuesit të parë dhe është i bindur se vigjilenca e dashamirësisë së Fuqive të Mëdha do të bëjë të mundur respektimin e këtyre principeve bazë.

Kufijtë të cilët kërkojmë janë ato që formojnë një vijë shënuese nga territoret e tanishme të mbretërisë malazeze, duke përfshirë në veçanti, së bashku me hinterlandet respektive, qytetet Ipek, Mitrovica, Prishtina, Ueskiub dhe Manastir, deri në Meçovo, duke ruajtur kufijtë aktualë deri në Prevezë. Duke kërkuar këtë ndarje, populli shqiptar nuk ka si arsye veçse qëllimin e ruajtjes së marrëdhënieve të përzemërta dhe të qëndrueshme me fqinjët. Pavarësisht nga çështja etnike, gjeografike dhe historike të cilat militojnë në favor të kësaj ndarjeje racionale, është e dobishme të shtojmë se, në qoftë se do të zvogëlohej apo ulej jashtë kufijve të saj natyralë, Evropa do të rrezikonte të vendoste shtetin shqiptar në pamundësi materiale për të jetuar jetën e vet, sepse do t’i mungonin, nga ana ekonomike, burimet e paanashme zhvillimit normal.

Përveç kësaj, lokalitetet e përmendura më lart, banohet me popullatë me shumicë shqiptare.

Përsa i përket ndarjes në terren, do të ngarkohet më pas një ekip i përbërë. Ai do të punojë jashtë çdo lloj influence, të cilat do të mund të dëmtonin interesa të ndryshme dhe do të përbëhet në atë mënyrë që t’u sjellë qetësinë fqinjëve të ardhshëm të shtetit shqiptar.

Shpresa te Fuqitë e Mëdha

Popullit shqiptar i është ngarkuar që në rregullimin e konfliktit aktual, Fuqitë e Mëdha nuk do të neglizhojnë studimin e pikëve të ngritura nga ky memorie dhe se nuk do të jenë indiferente ndaj kërkesave të drejta të një kombi të denjë për një fat më të mirë, i cili ka vuajtur shumë në të shkuarën dhe i cili ka vënë në të ardhmen e tij besimin më të madh dhe shpresat e tij më të shtrenjta.

Këtë të ardhme kërkon Shqipëria, e cila dëshiron të bashkëpunojë në operën e progresit universal dhe të ketë vendin e saj krahas vendeve të qytetëruara, kërkon me këmbëngulje t’ia garantojnë Fuqive të Mëdha.

²⁵¹ xxx *România și regularea graniței Albaniei*. În virtutea principiului naționalităților, revendicat de aliații balcanici, afirmăm drepturile aromânilor. -Atitudinea Serbiei față de noi [Qëndrimi i Sërbisë karshi nesh], në “Conservatorul”, XII, nr. 279, 19 dhjetor 1912, p. 1.

Delegatët e qeverisë shqiptare: *Rasih Dino, Mehmed Conica, Philippe Nogga*²⁵²

18. Adrianopole nuk është çështja më e mprehtë e konfliktit ballkanik. Fortesën heroike e kërkojnë vetëm dy: bullgarët dhe turqit. Sipas mendimit të Z. Gabriel Hanotaux, pika me të vërtetë e zezë është çështja shqiptare²⁵³. Në këtë drejtim do të duhen thesare dijeje, durimi dhe zotësie sepse Shqipëria është nyja gordiane e Lindjes së Afërme.

(. . .) Të kujtojmë se çështja shqiptare është vënë në rendin e ditës për herë të parë nga konti Berchtold²⁵⁴ dhe, për herë të dytë nga ngjarjet e fundit.

Çfarë do të jetë nesër Shqipëria? Ja pra enigma e madhe që mundon Evropën.

Nga pikëpamja shqiptare, nuk shihet zgjidhje tjetër veçse një autonomi e gjerë, një autonomi me pavarësi të plotë dhe qartësi të përkufizuar. Do të duhet që Shqipëria të jetë e lirë, por përsëri bota pyet veten nëse mund të jetë: situata e saj gjeografike me një ballë të trefishuar, situata e saj fetare me një fe të trefishtë, fqinjësia e saj me një influencë të trefishtë dhe historia e saj me një origjinë të trefishtë – ja pra arsyet e shumta, të cilat do ta sundojnë përjetësisht, duke e provokuar tani si në të shkuarën, duke dënuar këtë vend të bukur dhe të fatkeq në stanjacioni dhe anarkia²⁵⁵.

19. LËVIZJA E SHQIPTARËVE

DY TELEGRAME DREJTUAR SIR GREY

Shqiptarët e Rumanisë i dërguan sir Eduard Grey këto dy telegrame, duke protestuar për pretendimet e grekëve për Korçën shqiptare dhe kundër presioneve serbe.

Ne të nënshkeuarit, shqiptarë nga Korça, në emër të atyre tre mijë patriotëve të cilët jetojnë në Rumani, interpretues të sinqertë të ndjenjave të shqiptarëve të qytetit tonë të lindjes, me respekt të thellë i lutemi Shkëlqesisë Tuaj të marrë në konsideratë protestën tonë energjike kundër pretendimeve të padrejta të grekëve, të cilët duan të marrin qytetin tonë. Korça është pastërtisht

²⁵² xxx *Ce teritorii revendică Albania. Memoriul guvernului provizoriu albanez prezentat lui sir Eduard Grey, ministrul de Externe al Angliei și președintele Conferinței Ambasadorilor la Londra* [ministër i jashtëm i Anglisë dhe president i Konferencës së Ambasadorëve e Londrës], në “Dimineața”, IX, nr. 3. 168, 29 dhjetor 1912, p. 8.

²⁵³ Politikani dhe historiani i njohur francez (1853-1944), shumë prolifi botues dhe publicistik, me autoritet të madh shkencor dhe formues opinionit në epokë, është autori, midis të tjerash dhe i botimit *La guerre des Balkans et l'Europe, 1912-1913* (Études diplomatiques. Deuxième série), 4 éd., Plon-Nourrit et Cie, Paris, 1914 /VI + 458 pp. ; il., h. /; gjithashtu, është firmëtari i hyrjes së – Gabriel-Louis Jaray, *L'Albanie inconnue*. Ouvrage illustré de 60 gravures tirées hors texte et d'une carte en noir. Préface de G. Hanotaux, Hachette et Cie, Paris, 1913 /XXIV + 240 pp. ; il., h. /.

²⁵⁴ Në thirjen e bërë burit të shtetit austro-hungarez (1863-1942) *Contelui Berchtold* (klancelar dhe ministër i jashtëm në periudhën 1912-1915), publikuar në “La Roumanie” nga 22 shtatori/5 tetor 1915, Take Ionescu shënon: „Fola gjithashtu (në datën 11 shtator 1913 – n. n.) dhe për Shqipërinë, për të cilën ai dëshironte krijimin e saj (subl. n.). U cudit totalisht për faktin se unë njihja aq mirë punët e Shqipërisë dhe shqiptarët. Duhet të pranoj se në këtë drejtim ishte shumë i dokumentuar. Megjithatë mu duk me një iluzionizëm të ekzagjeruar. Më tha se se në atë moment siguria në Shqipëri ishte më e madhe se në çfarëdo vend tjetër të Evropës” – Take Ionescu, *Amintiri. Discursuri pentru România Mare* [Kujtime. Diskutime për Rumaninë e madhe]. Edizione îngrijtë, cuvânt înainte și note de Nicolae Șerban Tanașoca, Editura Fundației Pro, București, 2005, p. 29.

²⁵⁵ xxx *Albania de mâine, punctul negru* [Shqipëria e nesërme, pika e zezë], në „Ordinea”, V, nr. 1. 464, 30 dhjetor 1912, p. 1.

shqiptare. Gjuha dhe traditat janë shqiptare. Ajo ka qënë gjithmonë djepi i nacionalizmit shqiptar. Atje gjendet shkolla shqipe dhe një shtëpi botuese e cila shtyp gazeta në gjuhën tonë.

(.. .)

Ne të nënshkeuarit, shqiptarë nga Dibra, të cilët jetojmë në Rumani, të deleguar nga patriotët tanë të mbledhur në datën 12 janar, protestëm me energji kundër presionit të bërë mbi bashkëkombasit tanë, të cilët ju deklarojnë nëpërmjet një telegrami se të kënaqur janë nga administrata serbe duke refuzuar të bëjnë pjesë në shtetin shqiptar. Njohja e gjuhës serbe në atë lokalitet, e njohur ngado si shqipe, nuk do asnjë origjinë serbe, kjo është gjuha e mësuar nga pnëtorët shqiptarë të cilët shkojnë në Serbi për të ushtruat zanatin e tyre.

Nuk aprovojmë këtë procedurë të padenjë të serbëve dhe deklarojmë se i kundërvihemi në mënyrë zyrtare çdo lloj sundimi²⁵⁶.

20. Shqiptarët apo arnautët, janë populli më afërsisht i lidhur me rumunët²⁵⁷, pa asnjë gabim mund të themi se janë vllazërit tanë të gjakut. Midis shqiptarëve dhe rumunëve që jetojnë midis tyre ose me ta ekzistojnë lidhjet më miqësore.

Pyetjes se çfarë janë shqiptarët i janë shënë shumë përgjigje. Vetëm në kohët më të reja, kërkimi shkencor i gjuhës të tyre dha përgjigjen e përshtatëshme me të vërtetën.

(.. .)

Do përqëndrohemi tani në gjuhën shqipe²⁵⁸ dhe ngjashmërisë së saj me gjuhën rumune²⁵⁹.

²⁵⁶ xxx *Mișcarea albanezilor. Două telegrame către Sir Grey* [Lëvizja Shqiptare. Dy telegrame për Lord Grey], në “Minerva”, V, nr. 1. 455, 3 janar 1913, p. 2.

²⁵⁷ Shiko – I. I. Russu, *Obârșia tracică a românilor și albanezilor. Clarificări comparativ-istorice și etnologice*. [Origjina trake e rumunëve dhe shqiptarëve. Qartësime historike të krahasueshme dhe etnologjike]. *Der Thrakische Ursprung der Rumänen und Albanesen. Komparativ-historische und ethnologische Klärungen*. Cuvânt înainte și îngrijitor de ediție: Mircea Russu. Versiunea germanë: Konrad Gündisch, Dacia, Cluj-Napoca, 1995 /212 pp. ; il., h. /.

²⁵⁸ Vezi sinteza – Shaban Demiraj, *The origin of the Albanians: linguistically investigated* (Academy of Sciences of Albania), f. e., Tirana, 2006 /235 pp. /; si dhe një material epoke – xxx *Limba albaneză* [Gjuha shqipe], në “Românul dela Pind”, VIII, nr. 3 (336), 16 janar 1910, p. 3.

²⁵⁹ Shiko, në këtë kuptim – H. Mihăescu, *La romanité dans le Sud-Est de l'Europe*, Editura Academiei Române, București, 1993 /600 pp. ; h. /, pp. 24-90: cap. II. *Les éléments latins de la langue albanaise*; Grigore Brâncuș, *Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române* [Kërkime për bazën trako-dake të gjuhës rumune] (Institutul Român de Tracologie. Seria *Bibliotheca Thracologica* VIII), f. e., București, 1995 (ripublikuar në vitin 2009, Në shtëpinë botuese Dacica /200 pp. /; dhe versioni shqip, i dalë në Tiranë në vitin 2009, me përkthimin e Luan Topciu: *Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune: gjuhësi* /208 pp. /); Idem, *Concordanțe lingvistice româno-albaneze* [Prafrime gjuhësore rumuno-shqiptare] (Institutul Român de Tracologie. Seria *Bibliotheca Thracologica* XXX), f. e., București, 1999 /262 pp. /; G. Ivănescu, *Istoria limbii române* [Historia e gjuhës rumune]. Ediția a II-a. Îngrijirea ediției, indice de autori și indice de cuvinte: Mihaela Paraschiv, Editura Junimea, Iași, 2000, pp. 51-60, 364-365; Cătălina Vătășescu, *Vocabularul de origine latină din limba albaneză în comparație cu româna* [Fjalori me origjinë latine i gjuhës shqipe në krahasim me rumanishten] (Institutul Român de Tracologie. Seria *Bibliotheca Thracologica* XIX), f. e., București, 1997 /542 pp. /; Eadem, *Studii româno-albaneze* [Studime rumuno-shqiptare]. Note semantice și etimologjike, Editura Academiei Române (seria *Etymologica* 22), București, 2006 /206 pp. /; Nicolae Saramandu, *Some Romanian-Albanian Etymological and Lexical Concordances*, në „Revue d'Études Sud-Est Européennes”, Tome XLIII, 2005, pp. 141-153; Idem, *Concordanțe lingvistice româno-albaneze* [Përafrime gjuhësore rumuno-shqiptare], në Gheorghe Chivu, Oana Uță Bărbulescu (ed.), *Studii de limba română. Omagiu profesorului Grigore Brâncuș* [Omazh

Do të kemi tjetër rast.

Por do të kujtojmë tani, organizimin e fiseve shqiptare dhe rumune. Gjithashtu, folklorin shqiptar si dhe një sërë traditash të tjera të cilat gjenden si te shqiptarët e vjetër ashtu dhe te rumunët e vjetër.

Si pasojë, rumunët të cilët janë trakë dhe ilirë të romanizuar komplet janë vllazër gjaku me shqiptarët²⁶⁰, ilirët gjyhsëm të romanizuar. Duhet pasur parasysh se rumunët edhe pse trakë dhe ilirë të romanizuar kanë rruajtur folklorin dhe traditat e trakëve. Nga nevoja dhe vetëm në sipërfaqe u është imponuar e drejta romake bizantine në disa degë të së drejtës

Ja pra përse Rumania ka një interes të madh që Shqipëria të lindë me të drejtë dhe të përfshijë sa më shumë territore të banuara me rumunë dhe të jenë ashtu si dhe rumunët të lirë për t'u qytetëruar në gjuhën e tyre kombëtare.

Njohja e thellë e shpirtit rumun nuk mund të arrihet pa njohjen e shpirtit shqiptar. Nuk mund të njohim as institucionet tona juridike, shoqërore më të vjetra, pa i përdorur ato të shqiptarëve, të cilët në shumë drejtime kanë ruajtur ato që te ne janë humbur prej kohësh ose kanë ngelur në forma aq të pazhvilluara sa që me vështirësi mund t'ju kuptojmë rolin e vërtetë.

profesorit Grigore Brâncuș], Editura Universității din București, București, 2010, pp. 203–208; gjithashtu – Manuela Nevaci, *Enquêtes sur l'aroumain parlé aujourd'hui en Albanie*, në “Géolinguistique” /Grenoble/, no. 11, 2009, pp. 223–237; Baki Ymeri, *Fenomenologia albanano-română. Un miracol al istoriei* [Fenomeni shqiptaro-rumun. Një mrekulli e historisë]. *The Albanian-Romanian phenomenon—a miracle of history*, në “Carmina balcanica”, II, no. 1 (2), May 2009, pp. 32–44 /tekst në dy gjuhë/; Irina Arapi, *Common Grammatical and Lexical Elements of Aromanian, Romanian and Albanian, on the Basis of a Modern Grammar*, në „Philologica Jassyensia”, VIII, nr. 1 (15), 2012, pp. 99–112; Eadem, *Albanisch-rumänische Parallelen im Bereich der Wortbildung: Die Suffixe*, në Eölgang Dahmen, Günter Holtus, Johannes Kramer, Michael Metzeltin, Eölgang Schëeickard, Otto Einkelmann (Hrsg.), *op. cit.*, pp. 123–152.

Në datën 8 qershor 2012, gjuhëtarja shqiptare Renata Topciu mbajti tezën e Doktoraturës me titull *Frazeologjia rumuno-shqiptare* në Fakultetin e Filologjisë së Universitetit të Bukureshtit (drejtues shkencor: prof. univ. dr. Grigore Brâncuș, antar korespondent i Akademisë Rumune).

²⁶⁰ Shiko më gjërë – Theodor Capidan, *Simbioza albanano-română și continuitatea românilor în Dacia* [Simboza shqiptaro-rumune dhe vazhdimi i rumunëve në Daki], në „Revista Fundațiilor Regale”, X, nr. 5, 1 maj 1943, pp. 243–270. Është një pozicion shkencor „me rastin e daljes së një studimi të profesorit gjerman Georg Stadtmüller i Universitetit të Lipsa: *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, apărut în «Archivum Europae Centro-Orientalis» (tom VII, fasc. 1-3, 1941, pp. 1-196) të Budapestit. Është një botim sintezë rreth fillimeve të popullit shqiptar, në të cilën autori, duke përdorur të gjitha disiplinat auxiliare historisë, por më tepër studimit të gjuhës dhe toponimeve, mundohet të paraqesë në një dritë të re periudhën e formimit të popullit shqiptar” (fq. 244). Ai tregon që “Gjatë gjithë kësaj kohe trazimi të popullit rumun të kudogjendur (ai tregon se arumunët u shkëputën nga dakorumunët rreth shekullit të dhjetë, kur, baza e unitetit të së folurës te të gjithë rumunët ishte i përkryer” – n. n.), kur gjuha merte në strukturën e saj të brëndëshme një formë më unitare, një pjese e stërgjyshëve tanë vinin në jug deri në takimin me stërgjyshërit e shqiptarëve” (f. 264); dhe përfundon: “Nga s i m b i o z a shqiptaro – rumune kanë dalë fjalë të ngjashme, por më tepër veçori gjuhësore, të përbashkëta te arumunët dhe shqiptarët, veçanti të cilat përbënë për ata të studiuarit e paktë të cilët shihnin atdheun primitiv të rumunëve në gadishullin ballkanik, një nga ato tre katër argumente të sjella kundër pranisë tonë ” (f. 264).

Gjithashtu, njohja e gjuhës, psikologjisë, folklorit, institucioneve të arumunët, është e domosdoshme për të njohur dialektet rumune, besimet dhe kompozimet tona, të cilat i ringjallim nga dokumentet më të vjetra dhe ruajtja e tyre të gjalla deri sot.

I ashtuquajturi *Jus valachichum* i rumunëve të Hungarisë dhe Polonisë, e drejta e tokës e rumunëve nga Moldavia dhe Muntenia, mund të kuptohen vetëm në qoftë se i krahasojmë me institucionet juridike të rumunëve të Ballkanit.

Ne nuk mund të lejojmë që sllavët, grekët e cilido tjetër të shfarosë vllëzërit tanë të gjakut, sepse të gjithë kudo që gjenden janë degë të dala nga një trung.

Ja pra përse është e drejtë dëshira e maqedonasve, rumunë, sllavë, grekë etj. të ndërtojnë një shtet autonom²⁶¹.

21. Shfaqja e një shteti të ri në hartën e Evropës, na kujton me shpërthimet e vullkaneve në oqean. Dridhet toka, dridhen thellësitë e ujrave, valojnë dallgët dhe pas këtij copëtimi uraganik të elementeve të natyrës, shfaqet një ditë mbi dallgët e qeta, një ishull, një thatësi në të cilën lidhet jeta. Ashtu është dhe çështja e Shqipërisë së sotme²⁶².

22. Paqja, e cila dukej ne të shkuarën se do të rivendosej në Ballkan, kërcënohet seriozisht. Komplikimet e dala Scutarilor, mbuluar me shumë mund dhe sakrificë, do të shpërthejë sërish kur të caktohen kufijtë e Shqipërisë. Këto ngjarje të reja priten dhe komentohen nga e gjithë diplomacia evropiane.

Por ka dhe ngjarje që vijnë papritur, kur asnjëri nuk e mendon. Këto ngjarje janë më të rrezikshmet sepse nuk mund të parashikohen dhe shmangen.

Rreth një ngjarjeje të tillë janë bërë këto ditë informime të bujshme, të cilat, sigurisht, nuk i themi këtu përvçse si informacion.

Do të jetë Shqipëria një provincë austriake?

Një shqiptar nga kryeqyteti, i cili ka marrë pjesë në shumë nga takimet e rretheve të luftëtarëve shqiptarë te ne, na thotë si në vijim:

Lufta e Ballkanit, fatkeqë për Turqinë, nuk na detyrohet ne shqiptarëve.

Kryengritjet e tyre ju hapën sytë shteteve ballkanike që të mund të shihnin sa e dobësuar është Perandoria Osmane.

Nëpërmjet kryengritjeve tona, ne shqiptarët, nuk deshëm vetëm se një autonomi më të gjërë, por një autonomi të dhënë prej Turqisë dhe nën feudalizmin e saj.

Pas luftës ballkanike punët ndryshuan; Austria i kërkoi Fuqive të njihnin një Shqipëri të pavarur dhe Fuqitë, nga motive të cilat iu përkasin ranë dakord me kërkesën e Austrisë.

Është e vërtetë se asnjë nga ne nuk mendonte të kishim një shtet të pavarur dhe të krijuar me aq lehtësi. Fillimisht u gëzuam, por gëzimi ishte i shkurtër.

²⁶¹ xxx *Ce sunt albanezii* [Çfarë janë shqiptarët], në *Voința națională*, XXVIII, nr. 209, 17 shkurt 1913, p. 3.

²⁶² Apostol D. Culea, *Albania și albanezii* [Shqipëria dhe shqiptarët], në "Ramuri", VIII, nr. 5, 1 mars 1913, pp. 143-150.

Austria nuk dëshiroi asnjëherë një Shqipëri të pavarur. Këtë e vërtetoi më pas dhe e tha në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, me qëndrimin e saj ndaj Malit të Zi kur kjo e fundit mori Shkodrën.

Austria, përpara se t'u propozonte fuqive pavarësinë e Shqipërisë, u kujdes të kishte simpatinë e të gjithë shqiptarëve jomyslymanë. Për këtë organizoi një trup me agjentë të cilët përgatitën popullin shqiptar për një politikë filo-austriake.

Shqiptarët e Austrisë, Italisë dhe Rumanisë luftuan me të gjitha forcat dhe vendosën në Shqipëri një qeveri te përkohshme. Kjo qeveri nuk ka veçse një synim, të kthente Shqipërinë në një provincë Austriake.

Një vendim i Kongresit të Triestes

Kongresi Shqiptar i Triestes u provokua nga Austria.

Diskutimet e këtij Kongresi ishin dy llojëshe, disa publike dhe disa sekrete.

Në diskutimet publike u diskutua për një Shqipëri të pavarur dhe u protestua kundër ndërhyrjeve greke dhe sërbe.

Në diskutimet sekrete, u diskutua dhe u vendos që Shqipëria të deklarohej, kur të vendosnin udhëheqësit e saj, provincë austriake.

Po në kongresin e triestes u vendos që Shqipëria të ketë një mbret të saj. Mbreti do të ishte një prin gjerman, por nën udhëheqjen e kurorës habsburge.

Plani i Austrisë u përhap në gjithë Italinë. Italisë do i jepet një pjesë e mirë e Shqipërisë sidomos ajo pjesë e territoreve të ujrave që rrjedhin në²⁶³.

23. Me qenë se ju premtuam lexuesve “Rumunëve” që do i mbajmë në dije me të gjitha ngjarjet e ndodhura në Shqipëri, mbyllim serinë e artikujve të botuara prej nesh me këto lajme të dërguara nga korespondenti ynë special.

Brindisi, 27 prill

Në rrethet e shqiptarëve të gjendur në portet austriake dhe italiane në Adriatik, shpallja e Esad Pasha Toptanit si princ i Shqipërisë prodhoi shumë bujë.

Ashtu si dhe ju njoftuam me kohë, mbreti Nikita²⁶⁴ duke rënë dakort me komandantin e ushtrisë serbe, i lejuan Esad Pashait të largohet nga Shkodra së bashku me trimat e tij shqiptarë, duke transportuar të gjitha municionet deri në Tiranë, ku hero i Shkodrës u shpall sovran i Shqipërisë të pavarur nga rreth 12. 000 shqiptarë, të cilët e shoqëruan deri te pronat e tij në Tiranë ku ka dhe origjinën.

Sigurisht që këtë hap të bindur e bënë me lejën e Serbisë, sepse Tirana është e pushtuar nga ushtria e mbretit Petri²⁶⁵, nuk mund të kalonte i armatosur të gjitha territoret shqiptare, nga Shkodra deri në Tiranë, duke rekrutuar të gjithë shqiptarët e aftë për të përballuar luftrat e ardhshme.

(.. .)

²⁶³ M. Buri, *Albania va fi anexată de Austria și Italia, după propria-i cerere* [Shqipëria do i aneksohet Italisë dhe Austrisë pas kërkesës së saj], në „Minerva”, V, nr. 1. 566, 27 aprilie 1913, p. 3.

²⁶⁴ Jetoi në periudhën 1841-1921, nga 1860 deri në nëntor 1918 ishte sovran i Malit të Zi (u kurorëzua në vitin 1910).

²⁶⁵ Petru Karageorge jetoi në periudhën 1844-1921, ishte mbreti i Serbisë në periudhën 1903-1918, respektivisht deri në vitin 1921.

Kur bazat e pavarësisë së Shqipërisë u farkëtuan në Tiranë me pjesëmarrjen e rinisë shqiptare ne ekspeditën e Ismail Qemalit për në Durrës dhe Vlorë, e gjithë Rumania ndoqi me interes të gjithë episodin e dhimbshëm të këtij akti të guximshëm, i cili dha aq shumë viktima. Tani që vllëzërit tanë shqiptarë shpifin kundër njëri-tjetrit duke u akuzuar për tradhëti, na gjakoset zemra nga dhimbja sidomos që numri i viktimave rritet çdo ditë duke u sakrifikuar në altarin e kombit.

Besojmë se ka ardhur kohë që e gjithë kolonia e Bukureshtit të marrë nismën për të mbledhur të gjithë vllëzërit e humbur në një këshillim të përbashkët dhe po aty të çimentohet baza e shtetit të ardhshëm shqiptar, duke ngrirë dhe më shumë vllazërinë për të cilën u fol aq shumë në Kongresin e Triestes.

Është e detyrueshme një mbledhja sa më urgjente e të gjithë shqiptarëve të ndershëm të Bukureshtit për t'u shpërbërë disa akuza të ngritura rreth disa të ashtuquajturish "kryetarë", të cilët bredhin nëpër Evropë, duke u quajtur të plotfuqishëm me disa mandate të përfytyruara për të folur në emër të të gjithë popullsisë së Shqipërisë.

Kolonia e Bukureshtit ka shumë ndikim moral mbi të gjithë intelektualët shqiptarë dhe nuk duhet të vihet nën shënjestër e pikëpyetjes se nuk do t'i dëgjohet zëri në këtë thirrje patriotike kur flitet për copëtimin e Shqipërisë.

Në Bukuresht u krijuan shoqëritë e para kulturor-kombëtare: "Drita", "Dituria", "Bashkimi",²⁶⁶ etj. Atje u botuan librat e parë në gjuhën shqipe dhe nga ku u shpërndanë në të gjitha anët e botës ku ka shqiptarë. Po në Bukuresht u njoh për herë të parë e drejta për t'u mbajtur mesha shqip. Po rinia e Kolonisë shqiptare të Bukureshtit u zgjodh nga ana e kryetarit të Qeverisë së Përkohshme duke u nisur fillimisht në Durrës dhe më pas në Vlorë për të ngritur qeverinë e përkohshme dhe senatin, duke duruar mungesat e rënda, si materiale ashtu dhe morale, që më pas të njollosej ky sanktuar i lirisë nga ana e albanofobit Xhavid Pasha.

Përfundoj se nuk mund të sigurohet pavarësia absolute e Shqipërisë në qoftë se nuk do të bëhet një lëvizje e madhe e rinisë shqiptaro-rumune të Bukureshtit nëpërmjet thirrjes së një kongresi urgjent ku të njoftohen të gjithë patriotët kontrabandë që lëvizin në ujra të turbullta, duke u zgjedhur dhe një komitet ekzekutiv, i cili do të luftojë me miratimin e të gjithë njerëzve të mëdhenj dhe të ndershëm, të cilët gjenden në territorin e Shqipërisë ose jashtë, vetëm kështu mund të sigurohet lumturia dhe madhështia e atdheut²⁶⁷.

²⁶⁶ Shiko midis të tjerash dhe – Elvino, *Înființarea unei mari societăți albaneze în Capitală*. Albanezii din Capitală au desființat toate societățile, punând bazele unei singure societăți [Shqiptarët e kryeqytetit mbyllën të gjitha shoqëritë duke krijuar vetëm një shoqëri], në "Românul dela Pind", IV, nr. 49 (191), 11 dhjetor 1906, p. 2. *Statutet e saj janë vendosur në Poporul român și lupta de eliberare* [Populli rumun dhe lufta për çlirim].., pp. 557-561 (dok. 219/1906); po këtu, një dokument tjetër për aktivitetin e mëpasshëm – pp. 582-584 (dok. 226/1909), p. 610 (dok. 244/1914); respektiv, në Gelcu Sefedin Maksutovici, *op. cit.*, pp. 109-115, pp. 116-118, p. 131; shiko dhe Rafail Anastasiu despre Societate "Bashkimi" [Rafail Anastasiu për Shoqërinë "Bashkimi"]. [Memorii datate] *București, 22 februarie 1960* (Documentul a fost adus în redakție de Baki Ymeri [Dokumenta të datuara Bukuresht 22 shkurt 1960.], në "Albanezul", Serie nouă, IV, nr. 4 (33), prill1996, p. 3.

²⁶⁷ xxx *Epilogul independenței Albaniei*. -Dela correspondentul special al , "Românului" [Epilogu i pavarësisë së Shqipërisë], në "Românul", III, 18 prill/1 maj 1913, p. 6.

24. Mbrëmë u mbajt në Shoqërinë Makedo-Rumune një mbledhje ku maqedonasit kërkuar bashkimin me Shqipërinë. Nën presidencën e at Dumitru Constantinescu, një luftëtar i vjetër i cili, duke marrë fjalën, tha se ka dy lloj mbledhjesh – mbledhje me interesa të veçanta dhe mbledhje të shenjta, me qëllimin e ruajtjes së interesave të të persekutuarve.

Ne jemi mbledhur këtu për qëllimin e dytë, të protestojmë si disa njerëz të qytetëruar kundër veprimeve të pushtuesve të paqytetëruar. Jemi vrarë dhe torturuar. Asnjëri nuk interesohet për ne. Jemi mbledhur për të kërkuar ose pavarësinë e Maqedonisë ose bashkimin e një pjese të saj me Shqipërinë.

D. prof. Murnu se dhe udhëheqesit e këtushëm janë menduar, qysh prej fillimeve të dhunës në Ballkan, për çështjen e bashkimit të maqedonisë me mbretërinë shqiptare. Por u menduan për një zgjidhje tjetër, më e mirë, ajo që makedo-rumunët të qëndrojnë një komb i veçantë, por i bashkuar me kombin shqiptar. Gjuha zyrtare në shtetin e ri, të jetë Makedo-Rumunia dhe në udhëheqjen e shtetit të ri shqiptar makedono-rumun të marrin pjesë dhe maqedonas.

Këtë ide – thotë folësi - e kam paraqitur dhe para kabineteve të huaja²⁶⁸. Në Londër u diskutua dhe në mbledhjen e ambasadorëve, tani ngelet që ju të luftoni për këtë çështje, duke iu drejtuar së pari Italisë, sepse sigurisht që ky shtet do na dëgjojë dhe ndihmojë.

Të zgjidhet nga radhët tuaja një komision, i cili të shkojë ose në Itali ose te ministri italian i këtushëm dhe të kërkojë dashurinë dhe mbështetjen e këtij vendi si motër.

Z. Nușiu Tului i falenderon udhëheqësit makedo-rumunë, të cilët shkuan jashtë shtetit për të folur çështjen e këtij kombi të shtypur²⁶⁹.

25. Në linja të përgjithshme duke përshkruar natyrën dhe karakterin e popullit shqiptar, do të themi në fillim se shqiptari është mbi të gjitha xheloz për lirinë e tij. Natyrë luftarake, i

²⁶⁸ Për më shumë shiko te – Nicolae-Șerban Tanașoca, *Idealism și realism în "chestiunea aromânească". Un episod diplomatic din viața lui George Murnu în lumina corespondenței sale inedite (1913)* [Idealizëm dhe realizëm në , çështjen arumune’]. *Një episod diplomatik nga jeta e Xheorxhe Murnut nën dritën e korespondencës së tij të pabotuar*, në „Revista istorică”, Serie nouă, Tom VIII, nr. 11-12, 1997, pp. 719-738 (studim i përfshirë në – Anca Tanașoca, Nicolae-Șerban Tanașoca, *Unitate și diversitate balcanică*. Contribuții la istoria romanității balcanice [Kontribute në historinë e romanitetit ballkanik]. Cu un cuvânt înainte al autorilor, Editura Fundației PRO, București, 2004, pp. 230-254). Është për tu nënvizuar që N. Iorga protestoi, në Parlament, për të, e bërë nga tre profesorë “me origjinë arumune”, të cilët “bredhin Evropën që t’u thonë Kabineteve të ndryshme Evropiane një zgjidhje të tyre, një zgjidhje e cila parashikon autonominë e Maqedonisë”; në argumentimin e tij, ai nisët nga premiza – me të drejtë – se “Interesat e maqedonasve mbrohen nga Rumania zyrtare, si, meqënëse nuk ka në Evropë bullgarë, sërbe, grekë të cilët me përjashtim të qeverive bullgare, greke, sërbe të kërkojnë vëmendjen dhe simpatinë e Kabineteve evropiane, nuk duhet që as edhe rumunët e Maqedonisë, përvçse qeverisë rumune, dhe me një zgjidhje që nuk e ka shprehur qeveria rumune, të bëjë kërkesa kabineteve të ndryshme evropiane” – N. Iorga, *Açțiunea militară a României...*, p. 30.

²⁶⁹ M. B., *Macedonenii cer încorporarea lor la Albania*. -Întrunirea de aseară. -Cuvântarile d-lor Murnu, Nușiu Tului și dr. Șunda. -O delegație [Maqedonasit kërkojnë bashkimin e tyre në Shqipëri], në “Minerva”, V, nr. 1. 555, 26 maj 1913, p. 5.

predispozuar për kryengritje nga mosha 15 vjeçare dhe lart, ai nuk ka një mik më të pandashëm se “manlikerën” e tij – armë të cilën Austria ia u shpërndan të mbrojturve të vet me një dorëdhënie sado të shpjegueshme. Thashë, kur shpjegoja origjinën e tyre se beu shqiptar krenarohet me titullin “brigand”. Karakter i papajtueshëm dhe besnik, shqiptari shquhet për pastërtinë e normave dhe mikpritjes së tij dhe nga kjo pikëpamje vetëm arumunët ju ngjasin në të gjithë Gadishullin Ballkanik.

I përkushtuar dhe besibik, shqiptari nuk di cfarë është mosmirnjohja. Një e mirë e bërë njuë shqiptari i jep një borxh të shenjtë, me të cilin beson se është i detyruar të të mbrojë edhe me rezikun e jetës së tij. Fjala e dhënë është e shenjtë, ai nuk e shkel kurrë. Besnicë – ndaj atyre që ju shërben – vetëm ata kishin besimin e sulltanit Abdul Hamid – sulltani më me frikë dhe më me mosbesime -, gardën personale të cilën e përbënin vetëm shqiptarë.

Hakmarrës si korsikanët – me të cilët ngjasin në shumë drejtime – ata nuk falin asnjëherë armikun dhe mbajnë hakmarrjen deri në brezin e nëntë.

(.. .)

Shqiptarët ishin luftëtarët më të betuar për liri dhe ata “hapën rrugën për shpërthimin e shteteve ballkanike”. Nuk mund të flitet për liri në Gadishullin Ballkanik pa i përmendur shqiptarët.

E njëjta liri për të cilën luftonin në të shkuarën, e mohuar në territoret shqiptare, e dhënë Greqisë dhe Serbisë nga ana e Kongresit të Londrës, i vendosi luftën kundër pushtuesve të rinj. Diplomacia evropiane u tregua pa dije në lidhje me aspiratat e popujve të ballkanit dhe në mënyrë të veçantë të shqiptarëve. Pa marrë parasysh kërkesat e tyre, krijuan një Shqipëri të përgjysmuar dhe artificiale, me qëllimin e kënaqjes së njërit dhe të tjetrit. Shqiptarët nuk mund të jenë dakord me kufijtë e caktuar në mënyrë arbitrare nga diplomacia evropiane. Dhe me shqiptarët nuk bëhet shaka. Nuk janë populli që mund të bëjë pas. Ata do të bëjnë një luftë të ashpër – luftë për jetë a vdekje -, në të cilën nuk do të kërkojnë vetëm kënaqësi, por dhe hakmarrje. Prandaj, besojmë se burrat e shtetit të Serbisë dhe Greqisë do të arrijnë në përfundimin se çmimi i kërkesave të shqiptarëve është më i vogël se sakrificat të cilat duhet të bëhen për mposhtjen e shqiptarëve – një mposhtje e përkohëshme – në qoftë se do të mund të bëjnë edhe këtë.

Procesi i shkatërrimit kundër bashkëkombasve të tyre, tashmë thellësisht të vrarë nga shkaputja nga trupi i Shqipërisë i qyteteve kombëtare, thirrëse të së shkuarës, si: Djacova, Prizreni, Dibra, Ipeku dhe Gjirokastra, i dëshpëroi dhe dëshpërimi i tyre mund të ketë pasojë fatale për Serbinë dhe Greqinë. Prandaj, rikthimi te ndjenjat më të mira për ta dhe lëshimi ndaj Shqipërisë të dy-tre qyteteve, e cila ishte një humbje shumë e dhimbshme për ta, do të jetë veprimi më i zgjuar të cilin do e bënin diplomacitë e këtyre shteteve, duke kaluar mbi shpirtin egoist, i cili i karakterizon, dhe e cila do bënte të mundur pajtimin me shqiptarët, nga e cila do të fitonin më shumë se shqiptarët të cilët nuk kanë ç’ të humbin²⁷⁰.

²⁷⁰ Titu D. Panaitescu, *În chestia albaneză* [Në çështjen shqiptare], në “Seara”, IV, nr. 1. 322, 21 shtator 1913, p. 2; nr. 1. 323, 22 shtator 1913, p. 2; nr. 1. 324, 23 shtator 1913, p. 2.

27. Së shpejti, areopagu evropian do të shprehej në lidhje me kufijtë e juguorë shqiptarë²⁷¹. Ky fakt nuk është indiferent për fisin tonë në Pind. Përkundrazi bashkëngjitja e Epirit të Veriut me Shqipërinë është një çështje jetësore.

Në memoriumin dërguar qeverisë nga ana e rumunëve të Epirit dhe Maqedonisë, tregohet rëndësia e madhe e ekzistencës së një populli: konservimi i idealit politik. Dhe vetëm në Shqipëri mund të flitet për ideal politik për rumunët. Hyrja e Konicës, Koricës dhe Zagorisë²⁷² në provincën e re autonome të Ballkanit, do të thotë krijimin e një qendre rumune me më shumë se 60 komuna, të cilat do të kenë peshë në udhëheqjen e Shqipërisë së nesërme.

Dhe cili rumun nuk do të ndihej krenar, se përveçse Rumanisë tonë ekziston dhe një shtet tjetër me karakter rumun, i cili do të ishte vatra e ngrohtë e rumunëve të tjerë të Pindit dhe Thesalisë, shtet i cili do të vendosë, ndoshta, njëherësh dhe fatin e rumanizmit në përgjithësi, kur, në ditën e madhe të luftës për ekzistencën e popujve do të vendoset dhe e ardhmja jonë si popull?

Një qeveri rumune, e cfarë do nuançe të jetë, nuk mund të ngelet indiferente ndaj kërcënimit me të vogël të një grupi rumunësh.

Duhet të lëvizim ndaj ç'është do ngacmimi të vogël të trupit tonë kombëtar²⁷³.

28. Historia përsëritet.

Brengat në të cilat kalon shteti i ri shqiptar, kujtojnë brengat të cilat kanë karakterizuar fillimet e shteteve të tjera.

Brengat e Shqipërisë janë dhimbjet e formimit, me dallim të natyrshëm në një shtet ku vetëdija kombëtare është duke u formuar. Populli shqiptar nuk ka akoma një unitet organizimi kombëtar. Ata janë të ndarë në fise të veçanta të udhëhequra nga bejlerë të cilët kanë shpeshherë interesa egoiste. Kësaj ndarjeje i shtohet dhe diferenca fetare, shqiptarët ndahen në raport fetar në tri grupe: muhamedanë, katolikë dhe ortodoksë. Po të kemi parasysh faktin se populli shqiptar gjendet në një gjendje kulturore të prapambetur, e cila krijon hapësira për intriga të ndryshme, do të kuptojmë më mirë brengat të cilat shoqërojnë krijimin e shtetit shqiptar.

Kësaj gjendjeje kaotike të brendshme i shtohen veprime të interesuar nga jashtë. Shqipëria është një krijim i Fuqive të Mëdha.

Austro-Hungaria dhe Italia duke dashur të dominojnë Detin Adriatik, i propozuan Konferencës së Ambasadorëve në Londër, krijimin e shtetit shqiptar, sepse në këtë mënyrë asnjë shtet sllav nuk

²⁷¹ Fundi i volumit të konceptuar nga N. Iorga në bazë të “leksioneve” të mbajtura në Universitetin e Bukureshtit 1912-13” (Hyrja është datuar *Văleni-de-Munte, 3 gusht 1913*) nxjerr në pah vizionin e savantit të madh: „*Gjithsesi çështja shqiptare dhe maqedonase janë çështjet e së ardhmes* (subl. n.). Do të mund të pranohet Serbia nga ana e popullatës, të prononcohet ndryshe Evropës? Do të jetë Shqipëria më shumë se një avanpost Austriak, dhe a do ta pranojë Italia në këtë cilësi në bregun tjetër të Adriatikut? (artikulli im «*Chestia albanesă*» në *Svensk Tidskrift*, 1913, fq. 447 dhe vazhdon., dhe kontributi im *Albanien* në vol. II të *Ėeltgeschichte* të Helmolt, botimi i dytë) Mundet që këto çështje të zgjidhen më shpejt. Por ato do të duhët të jenë pjesë e procesit të përgjakshëm austriak, e cila njoftohet për një të ardhme më të largët (subl. n.)” – N. Iorga, *Istoria statelor balcanice în epoca modernă..*, p. 377.

²⁷² Vezi, in conetxt – Ilia Laska, *Zagoria. Histori dhe tradita*, Albin, Tiranë, 2001 /296 pp. ; il. /.

²⁷³ Ion Foti, *Epirul românesc trebuie alipit la Albania*. Glasuri din Macedonia [Epiri rumun duhet ti bashkëngjitet Shqipërisë], në “*Viitorul*”, VI, nr. 2. 105, 17 dhjetor 1913, p. 1.

do të forcohet në bregun lindor të Adriatikut. Fuqitë e tjera, duke mos mohuar dot legjitimitetin e një shteti shqiptar, pasi pranuan principin “Ballkani i popujve ballkanikë”, aderuan në ndërtimin e një Shqipërie të pavarur, të cilën e morën nën garancinë e tyre kolektive. Por me gjithë karakterin evropian të këtij protektorati, Fuqitë nuk u morën vesh midis tyre rreth rëndësisë të popullit shqiptar.

Alenca e Trefishtë dëshiroi më shumë këtë punë, me qëllimin e frenimit të ekspansionit të Greqisë dhe Serbisë në dëm të Shqipërisë. Kuptimi i Trefishtë kërkoi të favorizonte interesat greke dhe serbe dhe për këtë arsye me vështirësi u arrit kompromisi midis dy grupimeve²⁷⁴.

²⁷⁴ xxx *În Albania [në Shqipëri]*, në “Viitorul”, VI, nr. 2. 116, 31 dhjetor 1913, p. 1.

TË DYJA LUFTRAT BALLKANIKE DHE PROBLEMI SHQIPTAR

Muzeograf Ion Teodoresku,

Kompleksi Kombëtar “Oborri Mbretëror”, Tërgovishte

Shekulli XIX u quajt me të drejtë “shekulli i kombeve”, sepse njerëzit që gjendeshin prej shumë kohësh në kuadër të Perandorisë Cariste, Austro-Hungareze, Osmane dhe Prusiane kërkuar nëpërmjet disa organizatash dhe fuqisë bindëse të krijojnë shtetet kombëtare.

Në kuadër të temës së diskutuar prej nesh në këtë studim, populli shqiptar, pjesë e Perandorisë Osmane me fe myslymane (sunite dhe bektashie) dhe të krishterë (katolike dhe ortodokse), u formulua për herë të parë në programi kombëtar në Deklaratën e Stambollit të Komitetit Qëndror për Mbrotjtjen e Të Drejtave të Kombit Shqipëtar (30 maj 1878) dhe i rishikuar më pas në Programin e Lidhjes së Prizrenit (10 qershor 1878).

Kjo kishte formuluar nëpërmjet Portës një seri kërkesash si kundërpeshë ndaj këtyre qëllimeve dhe për ruajtjen e *statu quo* territoriale në pjesët e Perandorisë Osmane të banuara nga shqiptarët. Këtu kihej parasysh marjra e një autonomie administrative më të madhe për katër vilajetet shqiptare, emërimi në pozicionet e administratës së nivelit mesatar dhe të ulët të disa personave me origjinë shqiptare, heqja e tatimeve dhe rekrutimeve të vendosura nga Tanzimati, refuzimin e dhënies territoriale ndaj shteteve fqinje në Ballkan.

Situata e pavarësisë së shqiptarëve që jetonin në vilajete osmane ishte e lidhur ngushtë me zhvillimet në Perandorinë Osmane dhe në Evropë.

Në vitin 1877 Abdul Hamidi i dytë u bë sulltan i Perandorisë Osmane. Ai donte të modernizonte Perandorinë, t'u jepte autonomi më të madhe subjekteve kombëtare dhe lejoi fillimisht të mbetej në fuqi kushtetuta e famshme osmane krijuar nga Mit'hat Pasha.

Pas Luftës Ruso-Turke të vitit 1877, në të cilën mori pjesë dhe ushtria rumune, nëpërmjet paqes së arritur për herë të parë në Shën Stefan, me ndihmën e Perandorisë Cariste, krijohej një shtet bullgar me dalje në detin Egje. Atëherë pasoi Traktati njohur i Paqes i Berlinit (1878), nëpërmjet të cilit Perandoria Osmane, Perandoria Cariste, Franca, Anglia dhe Perandoria Prusiane si fuqi mbrojtëse, njohnin pavarësinë e Rumanisë, Serbisë, Malit të Zi dhe krijuan një entitet autonom - Principatën Bullgare. Por projektave territoriale të shteteve të lartpërmendura qëndronin në hije dy lojtarët kryesorë: Perandoria e Habsburgëve dhe ajo Cariste.

Gjatë bisedimeve në Berlin, nuk u ngrit çështja e autonomisë së popullatës shqiptare në Perandorinë Osmane, Mbretërinë Greke dhe Malazeze. Bismarku kishte deklaruar me cicizëm se Shqipëria nuk është veçse një „shprehje gjeografike”. Teritoret shqiptare u panë ashtu si nga ana e fuqive të mëdha si dhe nga ana e shteteve ballkanike, si mall këmbimi për rehatimin ose përmbushjen e interesave vetijake, mbi kurizin e një populli të parë si besnik përballë Portës.

Pas Paqes së Berlinit, sulltani Abdul Hamid i dytë hfuqizoi Kushtetutën e Mid'hat Pashait dhe kaloi në një regjim më autoritar.

Me shpresën e besnikërisë së arumunëve ndaj interesave të fronit osman, në vitin 1905 sulltani njohu nëpërmjet një Iradeje statutin si *millet* për arumunët, nën këmbënguljet diplomatike të mbretërisë së Rumanisë.

Përpjekje besnikërie u bënë dhe ndaj shqiptarëve, por jo nëpërmjet dhënies të të drejtave administrative, kulturore dhe arsimore, përkundrazi nëpërmjet refuzimit të këtyre të drejtave. Në Stamboll konsiderohej se influenza e bejlerëve mbi popullatën shqiptare është më e fuqishme se ajo e militantëve nacionalistë dhe shqiptarët do vazhdojnë të jenë të çorientuar dhe do t'i shërbejnë me besnikëri Portës. – garantja e vetme e integritetit të territoreve shqiptare përballë pretendimeve të bëra nga fqinjët ballkanikë. Dhe kjo garanci kishte një çmim: heqja dorë nga kërkesat për arsim në gjuhën amtare dhe autonominë administrative.

Lëvizja e Turqve të Rinj determinoi heqjen e Abdul Hamid-it në vitin 1908. Principata Bullgare mori pavarësinë, Perandoria Austro-Hungareze mori Bosnjën dhe Hercegovinën, ndërsa qeveritë e Greqisë dhe Serbisë risollën në diskutim projektet e krijimit të një Greqie dhe respektivisht Serbie të madhe.

Krijimi i shteteve kombëtare, fillimisht grek në vitin 1825, më pas atij serb, marrja e autonomisë nga ana e Perandorisë Bullgare pas vitit 1878 ngriti çështjen e ndarjes territoriale të vilajeteve evropiane, të cilat i përkisnin Perandorisë Osmane. Rrjedhimisht Serbia, donte një Serbi të madhe, Greqia një Greqi të madhe dhe Bullgaria dalje në Detin Egje. Kështu, në vitin 1864 u mbyll një marrëveshje e fshehtë mes Serbisë dhe Greqisë për ndarjen e vilajeteve osmane, jo me kritere etnike, por fetare. Shqiptarët ortodoksë do të deklaroheshin serbë dhe grekë ndërsa ata myslymanë - turq (në realitet ishin etnikë shqiptarë).

Patriotët shqiptarë të fesë të krishtere ortodokse kuptuan rëndësine e shërbimeve fetare në gjuhën e tyre, si një faktor thelbësor në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare. Në mënyrë të pashmangshme, çështja e kishave ishte e lidhur me atë shkollore, duke pasur parasysh organizimin e të nënshtruarve osmanë në kombe fetare dhe jo etnike, me efekte të drejtpërdrejta në gjuhën e mësimdhënies për *milletin* e krishterë ortodoks të Perandorisë – etnia që kontrollonte Patriarkinë Ekumenike kontrollonte dhe rrjetin arsimor.

Lutjet e bëra nga ana e shqiptarëve ortodoksë në këmbët e Fronit ose në shkallët e Patriarkisë Ekumenike për lirinë e kultit në gjuhën shqipe u përballën me te njëjtat refuzime të përsëritura si përpjekjet e arumunëve për autonomi fetare.

Pasi Perandoria Osmane pranoi lëshimin territorial ndaj fqinjëve të saj ballkanikë²⁷⁵, objektivat kombëtare shqiptare u rishqyrtuan në vitet 1880-1881, në mbledhjet e Gjirokastrës, Dibrës dhe sërish në Prizren.

Lufta e shqiptarëve për arsim në gjuhën amtare, së bashku me kërkesa të tjera me karakter kombëtar, vazhdoi deri në pragun e fillimit të Luftës së Parë Ballkanike:

Qershor 1908,	Mbledhja e Ferizajt;
Nëntor 1908,	Konferenca e parë e Kongresit të Manastirit;
Mars 1910,	Konferenca e dytë e Kongresit të Manastirit;
Qershor 1911,	Memorandumi i Greçë "Libri i Kuq";
Maj 1912,	Kongresi i Junikut;
Qershor 1912,	Memorandumi i Sinjës;

²⁷⁵ P. Rago, *Tradita, Nacionalizmi, dhe Komunizmi në Shqipërinë Bashkëkohore*, Shtëpia Botuese "Dudaj", 2010 f. 122.

Gusht 1912, Kërkesat e Hasan Prishtinës²⁷⁶.

Por tundimi nacionalist ishte më i fuqishëm për udhëheqësit e Komitetit për Bashkim dhe Progres (Turqëve të Rinj) sesa misioni i tyre reformator, të cilin e mbështetën fillimisht dhe i cili ngjalli aq shumë shpresa në radhët e rajave²⁷⁷.

Për të ndaluar revoltën shqiptare, e cila përhapej edhe më shumë në mesin e muajt gusht të vitit 1912, qeveria osmane pranoi, së fundmi, të përmbushte disa nga pikat e programit kombëtar shqiptar²⁷⁸.

Ishte tepër vonë, sepse pas dy muajsh do të fillonte Lufta e Parë Ballkanike me pasojat e njohura në rikonfigurimin territorial të Gadishullit Ballkanik dhe për problemet kombëtare në Ballkan, të pazgjidhura as sot.

Italia dëshironte të bëhej një fuqi rajonale në Detin Mesdhe dhe në Detin Adriatik, duke vazhduar në epokën moderne, politikën veneciane të shekujve XV-XVI ndërsa *Risorgimento* përfaqësoi, nëpërmjet linjës arbëreshe (Ieronim de Rada), një nga burimet e frymëzimit për Lëvizjen e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Për më shumë, qeveria italiane mbështetej në këtë veprim në ekzistencën në jug të vendit të minoritetit shqiptar arbëresh. Dihet se Giuseppe Garibaldi dhe djali i tij mbështetën krijimin e një shoqërie të fshehtë, të formuar nga patriotë italianë dhe shqiptarë, e cila kishte si qëllim pavarësinë e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, ishte rritur interesi austro-hungaris në Ballkan, i lindur nga ndërhyrjet ruse nën pretekstin e pan-sllavizmit.

Perandoria Cariste dëshironte të fuqizonte influencën në Ballkan dhe të merrte kontrollin e ngushticave të Bosforit dhe Dardaneleve.

Lufta e Parë Ballkanike, filloi në bazë të disa komplikimeve ndërkombëtare të cilat tejkalonin zonën e Ballkanit: në vitin 1911 ndodhi një kryengritje kundër sulltanit të Marokut dhe forcat franko-spanjolle ju kundërvunë forcave të tij dhe atyre osmane. Ushtri italiane zbarkoi në veri të Afrikës duke pushtuar Tripolitaninë dhe Kirenaikën (Libia e sotme).

Bullgaria, Serbia, Greqia dhe Mali i Zi sulmojnë Perandorinë Osmane. Duhet të kujtojmë, që në fillimet e këtij konflikti, mbreti i atëhershëm i Rumanisë, Karol I, shpreh shqetësimin dhe pozicionin i qeverisë rumune ishte asnjëanës.

Në këtë situatë, duke pasur mbështetjen e heshtur të qeverisë britanike, patrioti shqiptar, Ismail Bei Vlora, ish guvernatori i Tripolitanisë, fillon një expeditë për marrjen e pavarësisë së Shqipërisë. Duke ardhur nga Bukureshti, pati bisedime me kryemistrin e Rumanisë të asaj kohe, Titu Maiorescu, i cili e siguroi për mbështetjen e qeverisë rumune në lidhje me çështjen shqiptare.

Nuk duhet haruar as mbështetja materiale dhe morale e diasporës shqiptare në Rumani. Ismail Bej Vlora vazhdon ekspeditën e tij duke bërë vizita në Vjenë dhe Romë. Iku nga Italia me një anije të armatosur, zbriti në Durrës dhe më pas në datën 28 nëntor në Vlorë deklaroi ekzistencën e një shteti të ri të pavarur në Ballkan dhe në Evropë. Shqipëria zgjodhi si flamur shqiptonjën dykrenare të zezë në sfond të kuq.

²⁷⁶ Paolo Rago, po aty., f. 130 – 135

²⁷⁷ I. Ikonimi, *Pavarësia: Udhëtimi i Paharruar i Ismail Qemalit*, UET Press, 2012, f. 32

²⁷⁸ Po aty.

Telegrami i parë i shteit të ri u dërgua drejt Qeverisë Rumune dhe njoftonte krijimin e shtetit të ri të njohur nga qeveria rumune e atëhershme. Është e vërtetë që juridiksioni i shtetit të ri ishte në zonën Vlorë-Fier, por ishte hapi i parë për zgjerimin dhe krijimin e shtetit kombëtar shqiptar.

Pasoi Lufta e Dytë Botërore, ku aleatët e mëparshëm, përfshi Perandorinë Osmane luftuan me Caratin Bullgar.

Nën këmbëgulljet e Italisë dhe Austro-Hungarisë, Konferenca e Ambasadorëve, e mbledhur në Londër nën presidencën e Sir Edëard Gray – sekretar i punëve të jashtme i Perandorisë Britanike, vendosi në la 29 korrik 1913 krijimin e një principatë shqiptar autonome, sovrane dhe e trashëgueshme neutrale, nën garancinë e të gjashtë fuqive dhe nën mandatin e një Komisioni Ndërkombëtar Kontrolli për të paktën 10 vjet.

Por, Statuti organik i Shqipërisë i miratuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, me 10 prill 1914, nuk i referohej as autonomies, por dhe as pavarësisë të principatës²⁷⁹. Kjo nuk ka ushtri

²⁷⁹ Statuti Organik i Shqipërisë / Vlorë, 10 prill 1914 /

Kapitulli I. Shqipëria dhe territori i saj

1. Shqipëria formohet si një principatë kushtetuese, sovrane dhe e trashëgueshme nën garancinë e të gjashtë Fuqive të Mëdha.
2. Shqipëria është e pandashme, territori i saj është i patjetërsueshëm. Kufijtë e principatës janë ata që janë përcaktuar nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha. Këta kufij nuk mund të ndryshohen apo të rektifikohen, veçse me anë të një ligji dhe me miratimin paraprak të gjashtë Fuqive të Mëdha.
3. Shqipëria është neutrale; neutraliteti i saj është i garantuar nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha. [.. .]

Kapitulli II. Sovrani

7. Froni i principatës shqiptare është i trashëgueshëm brenda në familjen e princit Vilhelm Vidi. [.. .]
14. Princi është kryetar i administratës civile dhe ushtarake; ai disponon forcën e armatosur dhe emëron oficerët e saj. Ai merr pjesë në bërjen e ligjeve sipas dispozitave të kapitullit IV; vendimet e tij, të nxjerra dhe të botuara rregullisht, quhen “dekrete” dhe duhet të kundërfirmohen nga kryetari i Këshillit të Ministrave dhe nga ministri kompetent.
16. Ai thërret zgjedhësit për zgjedhjet e Asamblesë Kombëtare. Ai thërret, mbyll dhe shpërndan Asamblenë Kombëtare.
17. Drejtësia jepet në emër të tij; ai ka të drejtën e faljes dhe të amnistisë si dhe të drejtën për të dhënë çmime dhe tituj nderi.
18. Ai ka të drejtën të shtypë shembëlltyrën e tij ose stemën e tij në monedhat, në medaljet dhe në vulat shtetërore, si dhe në çdo send ose objekt që përfaqëson pushtetin qeveritar.
19. Ai përfundon traktate ndërkombëtare. [.. .]

Kapitulli IV. Legjislacioni

40. Asambleja Kombëtare është organi legjislativ i principatës së Shqipërisë. [.. .]

Kapitulli V. Organet e qeverisë

A) Ministrinë dhe ministrat

72. Qeveria shqiptare përbëhet nga një Këshill Ministrash në krye të të cilit është një kryeministër. [.. .]

Kapitulli IX

Forcat e armatosura

149. Forca e armatosur përbëhet prej xhandarmërisë dhe prej milicisë.

A) Xhandarmëria

150. Meqënëse organizimin e xhandarmërisë Fuqitë e Mëdha ia kanë besuar Misionit Holandez, ky i fundit do të hartojë rregulloren përkatëse. Kjo rregullore do të hyjë në fuqi vetëm pasi të miratohet nga prince.

B) Milicia

151. Milicia është një forcë ushtarake vendase territoriale dhe sedentare. Ajo zë vend zakonisht në qendrat e saj dhe nuk mund të mobilizohet tërësisht ose pjesërisht veçse me dekret të princit.
152. Milicia ka për detyrë në kohë të mbështetë eventualisht veprimet e xhandarmërisë për ruajtjen e rendit publik brënda vendit. [.. .]
157. Në rast se organizimi i milicisë shtrihet nevojën e përdorimit të oficerëve të huaj, kufizimi i parashikuar nga Konferenca e Londrës për sa i përket përdorimit të oficerëve për organizimin e xhandarmërisë, vlen edhe për milicinë; përjashtim mund të bëhet vetëm në marrëveshje midis qeverisë princore dhe Fuqive të Mëdha.

kombëtare, por vetëm me xhandarmeri dhe milici, të cilat së bashku përbëjnë forcat e armatosura të principatës. Përmendja e parë për ushtrinë kombëtare shqiptare bëhet në Kushtetutën Mbretërore të vitit 1928, Neni 170.

Me Traktatit të Paqes së Londrës - 1913 - Fuqitë e Mëdha njohën autonominë e vilajeteve të Shkodrës, Durrësit, Vlorës (një sipërfaqe prej 28. 000 kilometra katrorë - shteti aktual shqiptar). Por shqipëtarët e Kosovës, Maqedonisë, Tetovës, Janinës - Greqi, mbetën jashtë njohjes të Traktatit të Londrës.

Mbretëria e Rumanisë përshëndeti menjëherë perspektivën e krijimit të shtetit të ri shqiptar **të pavarur**. Memorandumi i paraqitur Konferencës në 27 mars 1913 nga ana e Nikolae Mishu – i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë i Rumanisë në Londër, qeveria rumune deklaronte se “shihte me kënaqësi krijimin e një shteti shqiptar të pavarur..”²⁸⁰. Vihet re se Rumania fliste për një shtet shqiptar të pavarur ndërkohë që Fuqitë e Mëdha flisnin për një shtet shqiptar autonom²⁸¹.

Nëpërmjet Dekretit Mbretëror nr. 6949 të datës 18 dhjetor 1913, Rumania emëroi M. N. Burgele si të parin të dërguar të jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë pranë qeverisë së Shqipërisë (në Durrës), duke nisur me datën 15 dhjetor 1913. M. N. Burgele filloi misionin diplomatik në datën 25 shkurt 1914 dhe mbajti këtë detyrë deri në 15 janar 1915.

Traktati i nënshkruar në Bukuresht në vitin 1913, si pasojë e Luftës së Dytë Ballkanike, i cili reduktoi Bullgarisë pretendimet për dalje në Detin Egje dhe i dha Rumanisë rajonin në jug të Dobroxheas - duke e quajtur Kadrilater, nuk i krijoi hapësira për manovra diplomacisë rumune për të diskutuar problemin e shtetit të ri shqiptar të shfaqur në hartën e Europës.

Përveç veprimtarinë e intelektualëve shqiptarë të mërgimit (Rumani, Austri, Itali dhe ShBA), hynë në këtë, mund të themi lojë politike, dy vende: Italia dhe Perandoria Austro-Hungareze.

Italia donte, nëpërmjet veprimtarisë të saj, të lidhur me fenomenin "Risorgimento" (bashkimi i Italisë), të bëhej një fuqi lokale në Detin Adriatik, duke vazhduar në këtë periudhë moderne, në një mënyrë ose në një tjetër politikën veneciane të shekullit XVI. Për më tepër, qeveria italiane ka mbështetur këtë veprim në ekzistencën e pakicës shqiptare në jug të vendit, të njohur si arbëreshe. Është e njohur se Garibaldi dhe djali i tij mbështetën organizimin e një shoqërie të fshehtë, të përbërë nga patriotë shqiptarë dhe italianë, e cila kishte si qëllim pavarësinë e Shqipërisë.

Në të njëjtën kohë, Perandoria Austro-Hungareze forcoi praninë e saj në Ballkan, duke bashkangjitur Bosnjën.

Perandoria Cariste, e cila donte të forconte pushtetin e saj në Ballkan dhe përmes një pushteti të aftë të kontrollonte ngushticën Bosforit dhe Dardanele, në emër të pan-ortodoksisë, kërkonte shpërbërjen sa më shumë të Perandorisë Osmane.

²⁸⁰ Sipas “Dokumenta Diplomatike. Ngjarjet e Gadishullit Ballkanik. Veprimtaria e Rumanisë (shtator 1912 – gusht 1913)” në **Librin Jeshil**, Bukuresht, 1913 fq. 122.

²⁸¹ Ndryshe nga dokumentat burimore, në veprën e Sonila Boçit, “Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit: 1939 – 1949”, Qendra e Studimeve Albanologjike – Instituti i Historisë, Tiranë, 20129) cilësia e principatës sovraane përmendur për Shqipërinë është zëvendësuar me “principatë e pavarur”, në përputhje me A. Puto: “si principatë autonome e pavarur, e trashëgueshme dhe neutrale, nën garancinë e Fuqive të Mëdha” (fq. 50).

Në ana e tjetër, Rumania nuk mund të kishte pozicion tjetër përveçse mbështetjes së plotë të pavarësisë së Shqipërisë, në të cilën shihte dhe një atdhe të ardhshëm për arumunët. Pro-shqiptarizmi ishte një zgjedhje rrënjësore e politikës së jashtme, të cilën politikanët e Bukureshtit deshën ta konkretizonin nëpërmjet të gjitha mënyrave: mbështeje financiare për organizatat dhe publikimet shqiptare në Rumani, (Shoqata “Drita” – 1884/1887 – Shoqata “Dituria” kishte marrëdhënie me vëllezërit Frashëri dhe me Jani Vreton, botoi shumë libra shkollorë në gjuhën shqipe, të cilat me pas dërgoheshin në Korçë; Shoqëria “Drita” – 1887, mbështetje diplomatike, mbështetje arsimore, logjistike, fetare.

Ashtu si tregon dhe Nathalie Clayer në vëllimin **Në Fillimet e Nacionalizmit Shqiptar**, ”Veçoria e kësaj diaspore shqiptare [në Rumani, sh. y.] ishte se ajo ishte shumë e lidhur me emigracionin arumun”. Të njëjtat lidhje shumë të ngushta ekzistonin dhe në emigracionin e ShBA-së²⁸².

Vasile A. Urekia – presidenti i parë i Shoqatës së Kulturës Makedo-Rumune (themeluar në vitin 1879) ka pasur dhe pozicionin e presidentit të Shoqatës “Drita”-1887). Në vitin 1887, “Drita” publikoi një abetare shqiptare të realizuar nga arumuni Jovan Risto Lazi Tërova. Po ajo nxirrte revistën “Drita”, ndërsa në periudhën 1888 – 1903 Gazetën “Shqiptari/Albanezul”, me mbështetjen financiare të qeverisë rumune²⁸³.

Me Vasil Butanin si prezident dhe Nikolla Naço si zv/prezident, “Drita” themeloi në vjeshtën e vitit 1892 një shkollë normale për përgatitjen e mësuesve shqiptarë dhe arumunë të cilët do të jepnin mësim në Gadishullin Ballkanik. Shkolla normale do të funksionojë deri në vitin 1899, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit të Rumanisë.

Në frymën e të njëjtit bashkëpunim shqiptaro-rumun, Apostol Margariti – inspektori i përgjithshëm i shkollave rumune të Gadishullit Ballkanik ju drejtua në vitin 1880 konsullit austro-hungarez në Selanik me propozimin për një Shqipëri autonome. Të njëjtin propozim e shpërndau pastaj në median shqiptare, nëpërmjet një manifesti të redaktuar së bashku me Atin Faveyrial.

Po në vitin 1880, Ion Caraxhiani – profesor në Universitetin e Iashit, arumun dhe anëtar i Akademisë Rumune, shkoi në Itali për të mbështetur interesat e përbashkëta të shqiptarëve dhe arumunëve pranë qeverisë në Romë²⁸⁴.

Ndërsa tani, në Konferencën e Ambasadorëve, Rumania gjendej sërish pranë Shqipërisë.

Më shumë se kaq, me rastin e Kongresit Kombëtar Shqiptar të Triestes (27 shkurt – 6 mars 1913), pjesëmarrësit arumunë rikonfirmuan në emër të vllazërve të tyre, vendimin për të jetuar në një atdhe të përbashkët me popullin shqiptar.

Ashtu si del nga një artikull i Revistës ”Vëllazëria” i Shoqatës Kulturore “Arumunët e Shqipërisë”²⁸⁵, ”Kongresi u mbledh në një moment të vështirë historik, kur midis dy luftimeve ballkanike rrezikohej ekzistenca e Shqipërisë [.. .], pikërisht për t’u bërë ballë rreziqeve që i kanoseshin shtetit të ri dhe tërësinë tokësore të Shqipërisë.

²⁸² N. Clayer, *Në Fillimet e Nacionalizmit Shqiptar*, Shtypshkronja ”Marin Barleti”, Tirana, 2009, f. 131.

²⁸³ Po aty, f. 273.

²⁸⁴ Po aty, f. 267.

²⁸⁵ Revista *Vëllazëria*, nr. 5/6 (171/172), Maj - Qershor 2010, f. 5.

Dalloheshin, ndër të tjerët në këtë Kuvend figura të shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare si F. Konica dhe F. Noli, H. Mosi dhe N. Ivanaj, Asdreni dhe Z. Skiroi, F. Draga dhe B. Daklani, P. Evangjeli dhe Dh. Mole etj. ...

Përveç 150 delegatë, nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe përfaqësues nga kolonit shqiptar, pjesë e këtij Kongresi qe edhe një grup vllenjsh, me të drejtë dhe detyrë delegimi, si gjithë të tjerët. [...]

Në Memorandumi që iu dërgua Shteteve të Mëdha në mbylljen e Kongresit shkruhet që: “Shqiptarët të mbledhun në Kongres të Triestes e përfaqësues të gjitha besimeve e të gjithë elementavet të vendit **si edhe arumenët**, të bashkuem me interesa e vuajtje të përbashkëta kan nderin t’u pashtrojnë...”

Me mbështetjen e Nikolae Mishut – ministër fuqiptotë i Rumanisë në Londër, delegacioni arumun i formuar nga Xheorxhe Murnu, Iuliu Valaori dhe Nikolae Papahaxhi pati takime me abasadorin britanik, francez, gjerman, austro-hungarez, italian dhe me një këshilltar të ambasadës Ruse, në periudhën 14 - 27 mars 1913. Gjithashtu, delegacioni arumun u prit nga Sir Edëard Grey, sekretari i Foreign Office britanik dhe president i Konferencës se Ambasadorëve.

Pasojat e traktatave të Londrës (30 maj 1913) dhe të Protokollit të Florencës (17 dhjetor 1913) njihen dhe për këtë arsye nuk do të paraqiten këtu. Shqipëria ishte objekti i këtyre dokumentave të së drejtës ndërkombëtare pa qënë një nga firmëtarët e tyre.

E rëndësishme është që përcaktimet e së drejtës ndërkombëtare i lejuan Shqipërisë kalimin në një etapë të re të ekzistencës së saj si shtet. Njohja e qeverisë së Shqipërisë nga ana e Fuqive të Mëdha u bë me ardhjen e princit Vilhelm Vid, në 7 mars 1914²⁸⁶. Për të mbështetur atë dhe çështjen shqiptare, qeveria rumune dërgoi një trupë të jashtëzakonshme, të përbërë nga 200 ushtarë dhe oficerë të udhëhequr nga major Xhurësku.

REFERIME

Abdul Hamid II, *Kujtime*, Paris, 1923.

Arkiva MPJ së Rumanisë, problemi 18, Fondi 71.

Bercan, G., Ciachir, N., *Diplomația Europeană în Epoca Modernă* (Diplomacia Evropiane në Epokën Moderne), Editura Științifică și Enciclopedică, București, 1984.

Boçi, S., *Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit: 1939 – 1949*, Qendra e Studimeve Albanologjike – Instituti i Historisë, Tiranë, 2012.

Clayer, N., *Në Fillimet e Nacionalizmit Shqiptar*, Shtypshkronja “Marin Barleti”, Tirana, 2009.

Fevziu, B., *100 Vjet Pavarësi*, UET Press, Tiranë, 2012.

Frashëri, S., *Shqipëria, ç’ka qenë, ç’është, ç’do të bëhet*, Bukuresht, 1899

Guy, N., *Lindja e Shqipërisë*, Botime “Pegi”, Tiranë, 2012.

Hanotaux, G., *La Guerre et L'Europe des Balkans (1912-1913)*, Paris, 1914.

Ikonomi, I., *Pavarësia: Udhëtimi i Paharruar i Ismail Qemalit*, UET Press, 2012.

Maiorescu, T., *Ditarë*, Editura Academiei, București, 1974.

Marghiloman, A., *Ditarë*, București, 1927.

²⁸⁶ R. C. Hall, *The Balkan Ear 1912 – 1913: Prelude to the First World War*, Routledge, 2000, f. 131.

Mustaka, V., *Latinët e haruar. Mbi origjinën dhe historinë e arumunëve të Shqipërisë*, Shtëpia Botuese “Naimi”, Tiranë, 2010, f. 157-161.

Parlamenti i Rumanisë, *Diskutimet e Mbledhjes së Parlamentit*, Sesioni 1911-1912, 1, takimi I datës 15 nëntor 1911, f. 1

Rago, P., *Tradita, Nacionalizmi, dhe Komunizmi në Shqipërinë Bashkëkohore*, Shtëpia Botuese “Dudaj”, 2010.

Saramandu, N., *Romanitatea orientală* (Romaniteti Lindor), Editura Academiei Române, București, 2004.

Shatri, M., *Dokumente Britanike për Çështjen Shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, 1912 – 1913*, Botimet Toena, Tiranë, 2012.

Tanașoca, A., Nicolae Ș., *Unitate romanică și diversitate orientală* (Uniteti romanik dhe diversiteti oriental), Editura Pro, București, 2004.

Taube, M. de, Baron, *La Politique Russe d'Avant-Guerre et la Fin de l'Empire des Tsars (1904-1917)*, Paris, 1923.

Zbучea, G., Brezeanu, S., koord., *Românii de la sud de Dunăre. Documente* (Rumunët e Jugut të Danubit. Dokumenta), Arhiva Naționale a României, București, 1997.

Periodikë

Koleksioni i Revistës *Vëllazëria* (shqip-arumanisht)

La Revue des Etudes Sud-Est Europeenes, Tome XLVIII, 2010 (ndërkombëtar)

Burime elektronike

(<http://ëëë.shipkovica.com/Vlerakombetare/kongresiitriestes.htm>)

SHTYPI RUMUN MIDIS DY LUFTËRAVE BOTËRORE PËR MBRETIN AHMET ZOGU DHE SHQIPËRINË E VITEVE '30

Marius Dobrescu

Pas shpalljes së monarkisë dhe stabilizimit të situatës politike në Shqipëri, marrëdhëniet e Rumanisë me shtetin e ri shqiptar njohën një zhvillim të rëndësishëm. Sigurisht që në bazë të tyre qëndronin afëritë e shumëfishta, të pranura në mënyrë unanime, por dhe një numër i madh arsyesh të tjera. Midis tyre, situata e pakicave arumune dhe shqiptare apo ndjenja e lidhjeve mijëvjeçare kanë qënë, pothuaj gjithmonë, në krye të agjendës së takimeve diplomatike rumuno-shqiptare.

Kësisoj, në marrëdhëniet e tij me mbretërinë shqiptare, shteti rumun ka pasur gjithmonë parasysh fatin e popullsisë me origjinë arumune dhe ka pretenduar, me të drejtë, që kjo të gëzonte të gjitha të drejtat që i ka pasur popullsia shqiptare në Rumani për shekuj me radhë. Në këtë kontekst, është e qartë se vetë ekzistenca e minoriteteve të lartpërmendura ka përbërë (dhe përbën edhe sot e kësaj dite) një element lidhës qenësor midis rumunëve dhe shqiptarëve.

Duke u bërë jehonë ndjenjave që u dhanë jetë marrëdhënieve të rumunëve me shqiptarët, shtypi i Bukureshtit ka relatuar gjithmonë me simpati mbi realitetet në “vendin e shqiponjave”. Ja, për shembull, gazeta “Universul” ka realizuar, në numrin e saj të datës 19 shtator 1931, një intervistë me Eqerem bej Libohovën, marshall i Oborrit Mbretëror shqiptar, mbi gjendjen e marrëdhënieve midis dy shteteve. Bashkëbisedimi u zhvillua me rastin e vizitës në Bukuresht të një delegacioni të lartë shqiptar që kishte mbërritur në Rumani për t’i dorëzuar mbretit Karol i II-të Urdhrit “Skënderbeu”. Ceremonia u zhvillua më 16 shtator 1931 dhe vinte si rrjedhojë i një gjesti të ngjashëm që kishte të bërë pala rumune: dekorimin e mbretit Ahmet Zogu, më 1 qershor të po atij viti, me Urdhrin me Gjerdan “Mbreti Karol I”. Në delegacionin shqiptar që kishte mbërritur në Bukuresht në shtator të 1931 bënte pjesë dhe Sotir Martini, mjeshtër i ceremonive të Oborrit Mbretëror të Tiranës, shqiptar i lindur në Rumani. Duke iu referuar pritjes së bërë në Bukuresht, Eqerem bej Libohova theksoi që në fillim të fjalës së tij: “Nuk mundemi të falënderojmë mjaftueshëm për dashurinë spontane dhe të ngrohtë që na është treguar”. Duke komentuar më pas arritjet e regjimit të cilin përfaqësonte, i dërguari i Oborrit Mbretëror nga Tirana i deklaroi redaktorit të gazetës “Universul”: “Sovrani ynë ka realizuar në një periudhë prej katër vjetësh mbretërimi një vepër domethënëse për organizimin e shtetit, të cilën paraardhësit e tij nuk e realizuan dot për 15 vjet që nga pavarësia e Shqipërisë e deri në ardhjen në fron të Madhërisë së Tij, Mbretit Zog”. Dhe shembulli më i mirë që marshalli i Oborrit ofroi ishte ai që lidhej me rikthimin e rendit dhe disiplinës në vend. Nëse vetëm pak vite përpara, Shqipëria ishte kapluar nga anarkia, ndërsa konfliktet ndërrajonale dhe ndërpersonale ishin gjithnjë e më të shpeshta, me hipjen në fron të mbretit Zog, këto u shuan, kurse vendit iu kthye rendi dhe siguria. Cilësitë ushtarake të sovranit e thanë fjalën e tyre, shpirti i organizimit dhe disiplinës i zunë vendin kaosit dhe çorganizimit të mëparshëm. Ndër realizimet e regjimit të Zogu-t, marshalli i Oborrit Mbretëror, përmend ndërtimin e shumë udhëve urbane dhe rrugëve, të cilat kishin arritur

në mesin e vitit 1931 në një gjatësi totale prej 2000 km (në krahasim me 200 km që ishin në fund të vitit 1912). Tek e fundit, mbreti Zog dhe qeveria e tij parashikonin realizimin e një reforme agrare, pas së cilës fshatarët shqiptarë do të bëheshin pronarë tokash dhe do të ishin të detyruar të kultivonin tokat dhe të zhvillonin pronat e tyre.

Duke iu referuar marrëdhënieve dypalëshe, Eqerem bej Libohova pohoi se: “Me Rumaninë na afron gjithëcka dhe nuk na ndan asgjë” dhe, më pas: “Shqiptarët jetojnë në Rumani si në vendin e tyre, kurse vëllezërit tanë arumunë gëzojnë të njëjtat të drejta tek ne, duke qenë elementi më i rregullt dhe përkrahës i shtetit”. Intervista e dinjitarit të lartë shqiptar përfundon me një deklaratë të një fisnikërie të lartë: “Ruajmë për Rumaninë, dikur të vogël, por tashmë të madhe, gjithë mirënjohjen dhe dashurinë tonë”.

Pozicioni miqësor i gazetës “Universul” ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë nuk ka qenë i vetëm në shtypin rumun të asaj kohe. Nën titullin “Shqipëria, një vend i ri”, gazeta “Curentul” e datës 23 qershor 1933 paraqiste opinionet e një udhëtari rumun në Shqipëri, gazetarit Vlad Bănășeanu. Ky e fillonte artikullin me episodin e “Vilhelm de Vied-it dhe dështimin e tentativës për të hipur në fronin e Shqipërisë të një princi të huaj (1914)”. Viti 1925, thotë gazetari rumun, shënoi ardhjen në udhëheqjen e vendit të kolonelit Ahmet Zogu, moment ky që u pasua nga “një periudhë me një stabilitet të qëndrueshëm” në historinë e trazuar të shtetit të vogël ballkanik. Bănășeanu tregon me admirim për masat energjike të udhëheqësit të Tiranës për organizimin dhe modernizimin e ushtrisë shqiptare, duke e përshkruar mbretin si një njeri dinamik, me mendime të qarta dhe me veprime të shpejta. Duke e cituar në vazhdimësi gazetarin rumun, mund të shtojmë se, në vitin 1933, Zogu mori masa për dekurajimin e praktikave mesjetare të gjakmarrjes, të cilat bënin akoma shumë viktime në zonat rurale. Gjakmarrja u përfshi në kodin penal në kapitullin “Krime të së drejtës zakonore” dhe dënohej si një akt penal. Si rrjedhojë, sipas të njëjtave dispozita të qeverisë, të vetmit që ishin të autorizuar për mbajtje arme ishin vetëm bajraktarët dhe këta vetëm në bazë të një leje për armëmbajtje që lëshohej nga autoritetet. Ata që shkelnin parashikimet e këtij ligji dënoheshin me vdekje ose me varje. Në përfundim, me të njëjtin regjim dënimi “trajtoheshin” edhe ata që praktikonin zhvatjet në rrugë, duke u ekzekutuar në vend, me një procedurë urgjence. Konkluzioni i gazetarit rumun ishte se, nën udhëheqjen e vendosur të mbretit Zog, Shqipëria po drejtohej me hapa të shpejtë drejt modernizimit.

Siç shihet, toni i relatiemeve për Shqipërinë dhe shqiptarët është plot simpati. Opinioni publik rumun shihte në këtë vend të vogël në perëndim të Gadishullit si mikun e vetëm të vërtetë në rajon, në detin me sllavë që i rrethonte. Dhe më pas, nuk mund të harroheshin traditat e përbashkëta, afëritë gjuhësore dhe as evenimentet historike nëpër të cilat kishin kaluara së bashku gjatë pesëqind vjetëve të fundit.

SHOQËRITË PATRIOTIKE SHQIPTARE - URA MIQËSIE MIDIS DY POPUJVE

Dr. Pavllo Cicko

Departamenti i gjuhëve të huaja

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, UK “Fan S. Noli”

Për shkak të reaksionit të egër osman që u vendos pas Lidhjes së Prizrenit, mërgimi jashtë vendit mori përmasa më të mëdha. Qinda e mijëra shqiptarë u vendosën në Rumani, Bullgari, Egjipt, etj. Në këtë mënyrë u forcuan edhe kolonitë shqiptare që ekzistonin në këto vende. Meqënëse në Shqipëri lëvizja kombëtare zhvillohej në ilegalitet, veprimtaria e diasporës mori një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Shqiptarët e mërguar mbajtën lidhje të vazhdueshme me atdheun dhe dhanë një kontribut të çmuar, veçanërisht për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës kombëtare. Shoqëritë e krijuara organizojnë dhe udhëheqin këtë veprimtari patriotike. Ndonëse kishin synime të qarta politike, çlirimin e atdheut nga robëria, ato paraqiten si shoqëri kulturore. Kjo bëhej për të shfrytëzuar mjetet legale dhe për të shmangur pengesat që mund të nxirte qeveria rumune nën presionin e Portës së lartë.

Rumania ishte edhe në këtë kohë vendi kryesor i strehimit të emigrantëve shqiptarë. Shteti rumun përkrahte veprimtarinë e kolonive dhe të shoqërive shqiptare në vend për shkak të lidhjeve tradicionale dhe interesave të përbashkëta politike në Ballkan. Kolonia shqiptare e Rumanisë si dhe ajo e Bullgarisë mori përsipër një rol të veçantë, meqënëse vepronte në rrethana politike më të favorshme. Kështu ajo ndihmoi për ngritjen e shtypshkronjave, botimin e teksteve shkollore në shqip, nxjerjen e gazetave dhe hapjen e shkollave shqipe. Shoqëria e Bukureshtit zë fill pikërisht kur për simotrën e saj të Stambollit ishin krijuar kushte të vështira pune. Lufta e shqiptarëve nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit ushtroi ndikimin e vet dhe gjallëroi veprimtarinë patriotike të shqiptarëve të Rumanisë. Kontaktet e tyre me atdheun si edhe me shqiptarët e Stambollit dhe ata të Egjiptit po forcoheshin.

Kështu, në korrik 1881, në Bukuresht formohet dega e shoqërisë së Stambollit. Këtu shkojnë patriotët Jani Vreto dhe Pandeli Sotiri. Po kështu në dhjetor të vitit 1884 një kuvend i posaçëm krijon në Bukuresht shoqërinë “Drita”, e cila filloi të punojë për përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe dhe solli shtypshkronjën nga Vjena në Bukuresht. Patriotët S. Frashëri, N. Frashëri dhe J. Vreto përgatitën tekstet e para dhe ia dërguan shoqërisë që filloi t’i botojë në vitin 1886 në shtypshkronjën e saj. Po në këtë vit kjo shoqëri ndahet në dy shoqëri më vete. Në 1887 krijohet “Drita” e udhëhequr nga Nikolla Naço dhe shoqëria tjetër me emrin “Dituria”. Të dyja këto shoqëri vazhduan të veprojnë në mënyrë të pavarur. Kështu dega e shoqërisë “Drita” në Braile nxori në 1887 gazetën letrare “Drita”, ndërsa në gusht të 1888 –ës del numri i parë i të përjavshmes “Shqiptari”. Në artikullin “Çfarë kërkojmë?” paraqitet i përmbledhur programi i shoqërisë “Drita” i cili veç përmbajtjes kulturore kishte edhe atë politike dhe atdhetare sepse u bënte thirrje shqiptarëve që të kontribuonin “... me punën, mendjen dhe pasurinë e tyre për zhdukjen e robërisë së popullit shqiptar.”²⁸⁷ Shoqëria “Drita” u përpoq që me aktivitetin e saj të

²⁸⁷ Organizimi dhe veprimtaria e diasporës shqiptare. Shqipëria. com. Portali shqiptar. f. 1.

tërhiqte vëmendjen e opinionit publik europian për çështjen shqiptare duke dërguar memorandume për personalitete të ndryshme politike të kohës. Kjo shoqëri furnizonte shkollat shqipe me libra dhe para për mësuesit. Ndërsa shoqëria “Dituria” botoi kryesisht dorëshkrime të Naimit dhe Samiut dhe më vonë të Jani Vretos të cilat u shpërndanë në Shqipëri dhe në kolonitë e ndryshme shqiptare. Ajo ndihmoi mjaft për hapjen e shkollave shqipe në atdhe, sidomos në zonën e Korçës duke dërguar tekste falas dhe pagesa për mësuesit.

Formimi i shtetit kombëtar rumun dhe pavarësia ishin kushte që sollën një përparim më të madh të Rumanisë. Kushtetuta e Rumanisë e vitit 1923 përmbante ligje demokratike për lirinë e shtypit, atë fetare, të pakicave kombëtare, etj. Politika e shtetit rumun ndaj shteteve të tjera ballkanike dallohet për tipare të afrimit dhe miqësisë. Në bazë të kësaj politike qëndrojnë marrëdhëniet e lashta vëllazërore me bullgarët, shqiptarët, etj. Traditat, zakonet dhe vlerat e tjera kombëtare paraqesin specifikat e tyre, por përbëjnë njëkohësisht elemente të një identiteti kulturor të përbashkët të ballkanasve. Siç thekson dhe studiuesi K. Kyçyku: “Në këto rethana vërejmë se politika e shtetit rumun ndaj vendeve të ballkanit ka ndjekur parime të qëndrueshme dhe nuk është bërë pre e konjunkturave të ndryshme historike.”²⁸⁸ E ndikuar nga forcat përparimtare politika e ndjekur nga shteti rumun në periudhën midis dy luftërave botërore, ka synuar gjithmonë që Ballkani të ishte një zonë paqeje e bashkëpunimi reciprok të shteteve të këtij gadishulli. Një shembull i këtij bashkëpunimi tradicional është dhe ai i popujve shqiptar dhe rumun.

Lidhjet e hershme shqiptaro-rumune

Sipas dokumenteve dëshmitë e para të vendosjes së një numuri të konsiderueshëm shqiptarësh në Rumani janë rreth vitit 1659 kur sundimtari Mihai Trimi dha leje për vendosjen e tyre në vend. Arsytet e kësaj shpërnguljeje ishin përndjekja nga administrata turke por edhe arsye ekonomike. Shqiptarët e mërguar synonin gjithashtu të ruanin gjithashtu të paprekura fenën e tyre dhe identitetin kombëtar. Duke u vendosur në trevat mikëpritëse të Danubit të sipërm, ata gjetën një ambjent mikpritës dhe një jetë më të sigurtë. Ngjashmëritë gjuhësore, shpirti dhe mentaliteti, veti të karakterit si edhe toleranca ishin cilësi që do t’i bashkonin rumunët me shqiptarët.

Më vonë këto do të krijojnë kushte të përshtatshme që ata të zhvillonin luftën për çlirim kombëtar të Shqipërisë. Historiani i shquar rumun Nikolae Jorga do t’i quajë *kushërinj prej gjaku me rumunët*. Ky komunitet integrohet në masën e popullit rumun dhe prej tij dalin njerëz të shquar, luftëtarë, njerëz të artit, të kulturës, shkencëtarë, etj. Shqipëtarët do të gëzojnë respektin e banorëve vendas për shkak të karakterit, besnikërisë dhe trimërisë së tyre. Mund të përmendim këtu sundimtarët e familjes së Gjikas të cilët sunduan në Moldovë në shekujt 17-19-të. Por periudha më e rëndësishme e historisë së bashkësisë shqipëtare të Rumanisë është ajo e shekullit të 19-të, dhe sidomos e fillimit të shekullit të 20-të. Në këtë kohë shumë shqipëtarë do të largohen nga trevat e tyre për të jetuar përkohësisht ose përgjithmonë në Rumani. Janë njerëz të zakonshëm, por edhe patriotë intelektualë dhe luftëtarë të cilët japin një kontribut të madh në

²⁸⁸ K. Kyciky, *Vështrim historik në marrëdhëniet shqiptaro-rumune*, shtëpia botuese enciklopedike, Tiranë 1993, f. 19.

veprimtarinë e shoqërive kulturore shqipëtare, e cila zhvillohej në kushtet e mbështetjes nga populli dhe shteti rumun. Shumë luftëtarë shqipëtarë marrin pjesë në krah të patriotëve rumunë në revolucionin e vitit 1821. Përmendim këtu ndihmesën e madhe të Naum Veqilharxhit në këtë lëvizje të madhe demokratike. Lëvizja kulturore demokratike rumune, ndikon fuqishëm tek patriotët shqipëtarë të cilët organizohen dhe punojnë për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqipëtare.

Rilindja Kombëtare, si lëvizje e shqipatrëve në atë periudhë në Perandorinë osmane ishte shumë e frytshme në Vallachia e cila ishte një qendër e nismave kulturore të ndërmara nga Dora d'Istria, Naim Frashëri, Jani Vreto dhe Naum Veqilharxhi. Ky i fundit vendoset në qytetin Bejla dhe punon për të hartuar alfabetin dhe abetaren e gjuhës shqipe, të cilat i boton në Stamboll në vitet 1844-1845. Por një dokument shumë i rëndësishëm i Naum Veqilharxhit i hartuar në këtë kohë është manifesti me anë të të cilit ai fton shqiptarët të ngrihen në luftë kundër pushtuesit. Ky manifest është i një rëndësie të veçantë, një program për zgjimin dhe rilindjen e ndërgjegjes kombëtare shqipëtare.

Në këtë kohë studimet e gjuhës shqipe si një gjuhë e veçantë indoeuropiane ngjallën interesin e gjuhëtarëve të shumtë, ndër të cilët dhe të atyre rumunë. Veprimtaria publicistike e shkrimtares Elena Gjika, e cila shkruante me pseudonimin Dora D'Istria, ndihmoi mjaft luftën për të drejtat e popullit shqiptar dhe për njohjen e Shqipërisë. Bukureshti bëhet në këtë kohë një nga qendrat më të rëndësishme të lëvizjes kombëtare shqipëtare. Në vitin 1880, aty krijohet një degë e "Shoqërisë të të shtypurit të librave shqip", me seli në Stamboll. Kjo shoqëri harton një alfabet me gërma latine për gjuhën shqipe.

Inteligenca rumune ndiqte me simpati të madhe luftën dhe përpjekjet e popullit shqipëtar për liri. Kjo shprehet dhe në faktin se në poste të ndryshme të shoqatave të shqipëtarëve të Rumanisë u zgjodhën personalitete të jetës kulturore dhe politike rumune. Kështu historiani i shquar rumun V. A. Urekea u zgjodh president i shoqërisë "Drita". Në vitet që pasuan, udhëheqja e saj vijoi me patriotë shqiptarë.

Në këtë kohë themelohen dhe shoqëri të tjera kulturore shqipëtare si: "Dituria", "Shpresa", "Bashkimi", etj. Mbështetja dhe përkrahja e shtetit dhe personaliteteve të shquara rumune, për lëvizjen e Rilindjes Kombëtare shqipëtare përbëjnë një faktor që forcoi më tej lidhjet tradicionale shqiptaro-rumune. Një numur atdhetarësh shprehin mirënjohjen e tyre për këtë mbështetje. Jani Vreto shkruan në një letër drejtuar shoqërisë së shkronjave shqipe në Rumani: "Të rrojë Rumania me gjithë mirësinë e saj, me të cilën janë rritur këta vëllezër."²⁸⁹ Po kështu në fjalën e tij drejtuar anëtarëve të shoqërisë "Dituria" ai pohon se: "Në Rumani kemi liri të punojmë për të mirat e kombit tonë, andaj edhe gëzohemi në këtë festë..."²⁹⁰

Edhe dijetari i shquar Sami Frashëri në një letër dërguar nga Stambolli vlerëson se: "...vetëm shoqëria e Bukureshtit i ka shërbyer me besnikëri çështjes. Falë këtij shërbimi gjuha

²⁸⁹ Ç.. N. Maksutovic. XH, *Materiale historike e muzeografike*, Bukuresht, 1968, f. 2801.

²⁹⁰ K. Kyciky, *Vështrim historik në marrëdhëniet Shqiptaro- Rumune*, shtëpia botuese enciklopedike, Tiranë 1993, f. 23.

jonë shkruhet e pasurohet me literaturë...”²⁹¹ Fakti që një pjesë e mirë e veprave të vëllezërve Frashëri u botuan në Bukuresht, tregon edhe një herë mbështetjen e fuqishme që shteti rumun i dha çështjes shqiptare. Një tjetër atdhetar dhe patriot i shquar, Nikolla Naço shkruan në një letër që i dërgonte Asdrenit se shqiptarët nuk mund të harronin përkrahjen e tij të shkëlqyer dhe të mos shprehnin ndjenjat e mirënjohjes së zjarhtë.

Në vitet e para të shekullit të 20-të, lëvizja kulturore e shqipëtarëve të Rumanisë zhvillohet më tej. Në Bukuresht hapet në 1892 “Shkolla normale” e shoqërisë “Drita”, e cila subvencionohej nga shteti rumun. Patrioti Nikolla Naço siguroi përkrahjen e sferave të larta shoqërore dhe intelektuale rumune për hapjen e kësaj shkolle. Në këtë kohë kolonia shqiptare në Rumani ishte shumë e madhe dhe hapja e një shkolle shqipe ishte një kërkesë e kohës. Naço ishte drejtor kurse drejtues pedagogjik dhe shkencor u caktua akademik i njohur Bogdan P. Hazhdeu, njohës i mirë i gjuhës shqipe. Shkolla ndiqej nga nxënës shqiptarë por edhe nga rumunë. Në të mësuan edhe figura të shquara të letërsisë kombëtare si Mihal Grameno, Asdreni, Kristo Luarasi, Shahin Kolonja, etj. Synimi i shoqërisë ishte që pas studimeve, nxënësit e saj të dërgoheshin mësues në atdhe si edhe në kolonitë shqiptare në të gjithë botën.

Po kështu ishte marrë lejë nga bashkia e qyteteit për të ndërtuar një kishë për nevojat e komunitetit shqiptar. Porta e Lartë ishte natyrisht kundër këtyre lëvizjeve dhe protestonte pranë qeverisë rumune, por kjo nuk e pengoi shtetin rumun që të shikonte dhe mbronte me simpati veprimtarinë e shoqërive kulturore shqiptare. Në shkurt të vitit 1901, patrioti Nikolla Naço, president i shoqërisë “Drita” dhe botuesi i gazetës “Shqipëtar”, merr të drejtat civile dhe politike të nënshtrimit rumunë. Ky ishte rezultat i përkrahjes së drejtpërdrejtë të qeverisë rumune, për punën që ai kishte bërë për çështjen kombëtare shqipëtare. Kjo ndodhte kur qeveria turke kishte kërkuar dëbimin e tij nga Rumania. Dihet se në këtë kohë Porta e Lartë kishte marrëdhënie të mira me Rumaninë, por me gjithë këmbënguljen e saj, qeveria rumune nuk pranoi të merrte masa kundër shoqërive shqiptare dhe veprimtarisë së tyre politike dhe kulturore.

Në vitin 1905 kolonia shqiptare e Rumanisë organizon kongresin e shqipëtarëve në Bukuresht. Në të marrin pjesë shumë personalitete të shquara të kolonive të tjera shqiptare në mërgim, si dhe patriotë nga Shqipëria. Punimet e këtij kongresi u zhvilluan me sukses të plotë falë edhe qëndrimit mbështetës të shtetit rumun. Aty u shpreh edhe një herë mirënjohja shqiptare ndaj qeverisë së Rumanisë.

Ngjarjet e rëndësishme që zhvillohen në vigjilje të pavarësisë të Shqipërisë kanë ndodhur pikërisht në Bukuresht. Aty Ismail Qemali dhe patriotë të tjerë përcaktuan masat dhe veprimet që do të kryeshin për shpalljen e pavarësisë. Procesverbalin e mbledhjes historike të 5 Nëntorit 1912 në Bukuresht e mbajti poeti shqiptar Asdreni, një nga pjesëmarrësit më aktivë të kolonisë shqiptare.

Me interes është qëndrimi dhe vëmendja me të cilën qeveria rumune ndiqte zgjidhjen e çështjes shqipëtare. Kështu një material i rëndësishëm i titulluar “Kufijtë e Shqipërisë”, hartohet nga një diplomat i lartë rumun I. N. Papiniu, i cili dërgohet në Londër. Në kohën kur diskutohej

²⁹¹ Po aty, f. 25.

çështja e shtetit shqiptar në konferencën e ambasadorëve të Londrës, ky studim i shërbente interesave të shtetit shqipëtar.

Në vitin 1915, kolonia shqiptare e Bukureshtit zhvillon një veprimtari të dendur për të përkrahur në mënyrë aktive qeverinë shqipëtare. Në një artikull të titulluar “Rumunët dhe Shqiptarët” botuar në janar 1916 në gazetën “Flamuri i Shqipërisë” theksohet se në Rumani shqiptarët kanë themeluar shoqëritë e para të propagandës shqiptare, ku janë shtypur librat e parë të gjuhës shqipe. Gjatë luftës së parë botërore shqiptarët patriotë të Rumanisë vijnë në përpykjet e mëdha për njohjen dhe respektimin e të drejtave të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris. Ata i kërkojnë hapur qeverisë rumune, mbështetje për çështjen kombëtare shqiptare duke theksuar se në momentet më kritike të historisë së tyre, vetëm ajo qeveri ka përkrahur luftën kundër turqve.

Një tjetër ngjarje që dëshmon për lidhjet e ngushta të përpjekjeve të patriotëve shqiptarë me qëndrimin dhe veprimin mbështetës të opinionit publik dhe personaliteteve rumune është edhe zgjedhja anëtar nderi i shoqërisë “Bashkimi” të Konstancës e historianit Nikolae Jorga. Ky personalitet do të organizonte në vitin 1914 në universitetin e Bukureshtit një kurs të historisë së Shqipërisë. Në një vepër tjetër të titulluar “Shqipëria dhe Rumania” historiani i shquar do të shprehë rreth marrëdhënieve rumuno-shqiptare: “...lidhjet tona me shqiptarët janë tepër të vjetra dhe zënë fill qysh përpara saktësisht të kombësisë së njërit e të tjetrit, ato janë lidhje të vazhdueshme, të larme dhe me rëndësi të konsiderueshme për çdo popull.”²⁹² Studiues të tjerë rumunë kanë theksuar se lidhjet tona bazoheshin jo vetëm në prejardhjen e përbashkët dhe në ngjashmëri gjuhësore, por edhe në luftën dhe përpjekjet e përbashkëta për të hequr qafe zgjedhën e Turqisë.

Në 1919 në Bukuresht botohet në gjuhën frënge “Historia e shkurtër e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar” nga historiani N. Jorga. Ky botim ishte një kontribut i madh për të bërë njohura përpjekjet heroike të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi. Kështu në Konferencën e Paqes në Paris, fuqitë e mëdha njohin kufijtë e shtetit shqiptar të 1913-tës dhe pavarësinë e tij. Pra, siç shihet, veprimtaria patriotike e shoqërive shqiptare të Rumanisë bëhet pjesë e përpjekjeve kolosale të shqiptarëve për njohjen e të drejtave të tyre kombëtare.

Në veprën e mësipërme autori do të theksonte se “.... bëhet fjalë për një popull që e ka mbrojtur me trimëri tokën e vet kundër çdo të huaji, pa dashur që t’i japë një bazë më të gjerë territoriale ekzistencës së tij. Ajo që na intereson pra. .. është vitaliteti i një energjie të admirueshme dhe i një force rezistuese të habitshme, që formon pjesën me interes të historisë së shqiptarëve dhe shpjegon ekzistencën e tyre të sotme.”²⁹³ Vlen të përmendet se shqiptarët e Rumanisë shfrytëzuan mbështetjen dhe simpatinë me të cilën studiuesi rumun ndiqte problemet dhe të drejtat e popujve të vegjël në Europë. Për këtë arsye ata i kërkuan N. Jorgës që të shkruante për çështjen shqiptare. Ai u përgjigj shumë shpejt. Për veprën e tij në ndihmë dhe mbështetje të Shqipërisë dhe shqiptarëve ai do të vlerësohet në shumë artikuj të botuar në

²⁹² Kopi Kyciky, *Vështrim historik në marrëdhëniet shqiptaro-rumune*, shtëpia botuese enciklopedike, Tiranë 1993, f. 55. Cituar nga Nikolae Jorga “Histoire breve de l’Albanie et du peuple albanais”. Bukuresht, 1919, f. 1.

²⁹³ Po aty, f. 55. Cituar nga Nikolae Jorga “Histoire breve de l’Albanie et du peuple albanais”. Bukuresht, 1919, f. 1.

gazetën “Shqipëria e re”, e cila dilte çdo javë në qytetin e Konstancës. Midis të tjerash, gazeta botoi që nga viti 1928 edhe artikuj nga punimet e ndryshme të historianit, të cilat i kushtoheshin historisë së Shqipërisë. Ndërsa në një numër tjetër të po asaj gazete në vitin 1934, i bëhej jehonë fjalimit të këtij personaliteti të shquar dhe idesë së tij për të krijuar një institut i cili do të zhvillonte më tej kërkimet shkencore rreth Shqipërisë dhe historisë së saj. Po kështu shkrimtari ynë i shquar Asdreni, dekorohet për veprimtarinë e tij të shquar disa herë nga qeveria rumune me “Kryqin përkujtimor të luftës”, Kavalier të “Kurorës së Rumanisë” etj.

Në vitet '30 në Bukuresht gjenden shumë studentë shqipëtarë të cilët ishin të lidhur me qarqet përparimtare të vendit. Në festat që organizonin shoqëritë e studentëve forcohej më shumë dhe miqësia shqiptaro-rumune. tregohet dhe nga. Kurset e gjuhës shqipe dhe ato të historisë së Shqipërisë të cilat zhvilloheshin në universitetin e Bukureshtit, dëshmojnë për interesim nga qeveria rumune për njohjen e Shqipërisë në Rumani dhe më gjerë në botë. Në këtë kohë shohim një angazhim të disa shtëpive botuese për botimin e veprave të Asdrenit, Lasgush Poradecit etj.. Po kështu, krijimi i himnit tonë kombëtar, shkruar nga Asdreni me muzikën e muzikantit rumun të shquar Ciprian Porumbesku është një fakt shumë domethënës.

Pushtimi fashist i Shqipërisë do të ndiqet me keqardhje nga opinion publik rumun. Kjo ngjarje e hidhur u prit me shqetësim të madh nga të gjithë bashkatdhetarët tanë që jetonin në Rumani. Pati edhe përpjekje për organizimin e një nisme për vullnetarë që do të luftonin kundër fashistëve italianë, përkrah vëllezërve në atdhe, por ato nuk u realizuan dot dhe fondet e mbledhura u përdorën për të organizuar veprimtari antifashiste në Rumani. Në shtypin përparimtar rumun të kohës vlerësohej lufta çlirimtare e popullit shqiptar dhe shprehej solidariteti i qarqeve demokratike me të. Në 1 maj 1939 ky solidaritet shprehet i fuqishëm në demonstratat që zhvillohen kudo në Rumani.

Në shtypin e majtë ilegal do të pasqyrohej lufta dhe përpjekjet heroike të popullit shqiptar kundër ushtrive pushtuese fashiste italiane. Mbështetja e rezistencës së armatosur të popullit shqipëtar, jehona që i bëhej asaj në opinionin përparimtar publik janë një moment tjetër që dëshmon për forcimin e marrëdhënieve miqësore dhe tradicionale midis dy popujve tanë.

REFERIME

Castellan, G., *Histori e Ballkanit*, Çabej, Tiranë 1991.

Cazacu, M., *La péninsule balkanique au XVe siècle*, ” Cahiers balkaniques”, no 11, Paris 1987.

Clayer, N., *Le gout du fruit défendu ou la lecture de l'albanais dans l'Empire ottoman finissant* Revue des mondes musulmans de la Méditerranée. Septembre 1999. <http://remmm.revues.org/305>

Frashëri K., *Historia e Shqipërisë*. Tiranë 1964.

Gjika, Th., *Mihal Gramenoja publicist demokrat*, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë 1980.

Historia e Shqipërisë. Vëll 2, Tiranë 1965.

Islami, M., *Naum Bredhi Veqilharxhi*” Shtëpia botuese “8 Nëntori” Tiranë 1977.

Jorga, N., *Histoire brève de l'Albanie et du peuple albanais*,. Bukuresht, 1919.

Kycyku K., *Vështrim historik në marrëdhëniet shqiptaro-rumune*”, shtëpia botuese enciklopedike, Tiranë 1993.
